Zemra të Zjarrta

Tetë Gra në
Kishën e Fshehtë
Dhe Historitë
e tyre
Të një Besimi të
Kushtueshëm

Zemra të Zjarrta

Tetë Gra në Kishën e Fshehtë Dhe Historitë e tyre Të një Besimi të Kushtueshëm

Paraqitur nga Gracia Burnham

The Voice of the Martyrs
OM EAST

Originally published in English as
Hearts of Fire by W Publishing Group, a division of Thomas Nelson, Inc.,
P.O. Box 141000, Nashville, TN 37214.

© 2003 by Voice of the Martyrs, USA.
All rights reserved. No portion of this book may be reproduced, stored in a retrieval system, or transmitted in any form or by any means—electronic, mechanical, photocopy, recording, or any other—except for brief quotation in printed reviews, without the prior permission of the publisher.

Albanian edition © 2011 by Voice of the Martyrs, USA.
All rights reserved.

Published by Voice of the Martyrs.
Graphics by OM EAST

This project is a joint production by Voice of the Martyrs and OM EAST.

Kushtuar
Sabina Vurmbrandit

Hyrje

Jam shumë e nderuar që më kërkohet të shkruaj një hyrje për një libër të tillë. Nuk do të filloja duke e përfshirë veten në këtë grup grash të guximshme të besimit.

Ndërsa lexoj historitë e tyre të pabesueshme të një guximi të dhënë prej Perëndisë, mund ta gjej veten në shumë prej ndjenjave të tyre. Gjatë viteve (Maj2001-Qershor 2002) që kaluam unë dhe bashkëshorti im, Martini, kur u zumë rob nga terroristët e Abut Sajafit në xhunglën e Filipineve, edhe unë u ndjeva e pashpresë, duke dashur të vdisja. Isha pa strehë dhe duke vdekur urie... por e dija se sapo të lirohesha, do t'i kthehesha jetës sime pak a shumë të qetë. Tani jam në Amerikë në një shtëpi të bukur, kam mëse mjaftueshëm për të ngrënë dhe njerëz që më përkrahin ndërsa këto gra vazhdojnë të durojnë vështirësi si ushtare të mira të Krishtit.

Kështu që sa herë bëj një banjë të ngrohtë, lutem! Ndërsa përgatitem para pasqyrës dhe rregulloj flokët për t'u bërë gati për të folur, lutem! Kur vrapoj për të ndihmuar fëmijët, lutem! Kur vë re një tabelë inkurajuese jashtë një kishe, lutem për ata që nuk kanë këtë «infrastrukturë» që kam unë! Për ata që janë duke vuajtur, sepse besojnë te Jezusi. Për ata që mendojnë se janë vetëm, por përsëri i mbeten besnikë besimit të tyre.

Lutem për ata në të njëjtën mënyrë si u luta për vete në xhungël: «Zot, lejo që të të ndiejnë pranë! Ndihmoji të qëndrojnë besnikë ndërsa situata përkeqësohet! Tregoju një grimcë të mirësisë Tënde në mënyrë që ta dinë se nuk janë vetëm. Në fund të fundit, unë e di që Ti do të jesh atje».

Ah, sikur secili prej nesh, që lexon këtë libër t'ia përkushtojë përsëri veten dhe ta lejojë Perëndinë të na përdorë si të dëshirojë, madje edhe nëse kjo do të thotë të heqësh dorë prej lirisë apo rehatisë. Mund të vijë dita kur do të rrihemi apo madje do të vdesim për shkak se jemi ndjekësit e Krishtit. Le të marrim zemër prej këtyre grave të thjeshta.

Zoti nuk do të na tundojë përtej mundësive tona. Me tundimin, Ai do të japë një rrugë shpëtimi (do të sigurojë gjithçka që kemi nevojë) që të mund ta përballojmë. Unë zgjedh të besoj se Perëndia bën çdo gjë mirë. Njeriu jo. Ne e kemi bërë rrëmujë këtë botë të bukur. Nëse në këtë jetë ka diçka të mirë, kjo vjen prej Perëndisë. Ai ka një plan dhe është Sovran. Ne presim me durim që Ai ta bëjë çdo gjë të re në kohën e tij.

Deri atëherë, na dhëntë hirin për të jetuar për Të, ashtu siç po bëjnë këto gra. Ai është i denjë.

—Gracia Burnham
Misioni i Fiseve të Reja (New Tribes Mission)
Autorja e librit *Në Prani të Armiqve të mi*

Mirënjohje

Kur morëm përsipër këtë projekt në emër të «Zërit të Martirëve», e dinim se do të na duhej një grup i mirë bashkëpunëtorësh. Së pari kishim nevojë për gra të krishtera, që do të ishin të gatshme të ndanin dëshmitë e tyre. Pa këto, ky libër nuk do të ishte realizuar dhe u shprehim një falënderim të përzemërt.

Çdo kapitull (me përjashtim të Sabina Vurmbrandit) kërkonte një personel në terren dhe disa përkthyes. Në më tepër se gjysmën e historive, vendndodhjet sekrete janë ndryshuar dhe janë vendosur disa protokolle sigurie. Sigurisht që nuk do të kishim mundur ta ndërmerrnim këtë projekt pa mbështetjen e stafit dhe të bashkëpunëtorëve të «Zërit të Martirëve (ZIM)». Për shkak të rrezikshmërisë, s'mund t'i përmendim emrat e këtyre punëtorëve, por do të donim të drejtonim falënderimet tona ndaj të gjithë atyre, që ndihmuan në secilin prej vendeve ku kemi udhëtuar.

E falënderojmë gjithashtu në mënyrë të veçantë drejtorin e ZIM, Tom Uajt, i cili ndihmoi në procesin e krijimit dhe mori pjesë në grumbullimin e historive nga Aida dhe Mai. Vizioni dhe drejtimi i Tomit për të qenë një zë për kishën e sotme të persekutuar, vazhdon të jetë shumë i vlefshëm në sigurimin e burimeve të tilla.

Tod Netelton dhe Su An Xhons kanë qenë ndihmë e jashtëzakonshme. Faleminderit!

Nuk është gjithmonë e lehtë të merresh me projekte, që kanë të bëjnë me persekutime dhe disa realitete të ashpra të besimit tonë. Por Greg Daniel dhe skuadra e «Grupit Publikues» kanë treguar edhe një herë përkushtimin e tyre në sjelljen e këtyre historive të

pabesueshme të këmbënguljes dhe kurajës në dritë. Faleminderit që bëtë të mundur realizimin e «Zemra të zjarrta»!

Një falënderim të veçantë për fëmijët tanë, Xhordanin dhe Elenën, të cilët «hoqën dorë» nga mami dhe babi për shumë net dhe fundjava gjatë udhëtimeve jashtë shtetit. Ne lutemi që këto histori të bëhen pjesë e themelimit tuaj në besim.

Stiv Dhe Xhini Klieri

Hyrje

Zemra të Zjarrta me Kurajë dhe Bindje

E rrëmbyer, e rrahur, e burgosur. Në shumë vende të botës sot, këto fjalë janë sinonim i të qenët e krishterë. Për gratë e krishtera në këto zona, ekziston një sfidë tjetër: «njolla shoqërore», që shihen si një klasë më e ulët, e papërshtatshme për drejtim dhe që i përkasin kontrollit dhe drejtimit të burrave.

«*Zemra të Zjarrta*» tregon historitë e tetë grave, të cilat, pavarësisht rrethanave, kanë treguar kurajë të pabesueshme, bindje dhe dashuri për Jezu Krishtin dhe kishën e Tij. Në situatën më të vështirë, ato janë bërë drejtuese, me guxim dhe këmbëngulje të jashtëzakonshme, duke refuzuar të zmbrapsen prej nevojave dhe mundësive, që i kanë sfiduar. Është ironike që vetëm në vuajtje ato kanë të njëjtat të drejta si burrat; në disa raste ato kanë vuajtur madje më tepër.

Kur konsideruam në fillim një libër me dëshmi për gratë e krishtera të persekutuara për besimin e tyre, u përballëm me një numër sfidash. Së pari dhe mbi të gjitha, donim që dëshmitë të ishin sa më aktuale. Për këtë duhej të udhëtonim në çdo vend ku banonin këto gra që në shumicën e rasteve ende përballen me rrezik të lartë. Donim gjithashtu të paraqisnim shembuj të grave, të cilat jo vetëm janë përballur me vuajtje personale, por kanë shfaqur edhe cilësi drejtuese në shërbesa. Së fundi, përtej tregimeve dramatike të dhimbjes dhe vuajtjes, donim të paraqisnim shembuj frymëzues të shpresës së patundur dhe se si këto gra, madje edhe në vendet më të errëta, e gjetën mënyrën për të lejuar dritën e Krishtit të shkëlqente.

Është e rëndësishme të vësh re se gratë e përmendura në «Zemra të Zjarrta» janë vetëm një shembull i vogël i një numri të madh grash në mbarë botën, që përballen me situata të ngjashme. Ne zgjodhëm ato, që përfaqësojnë një shumëllojshmëri rajonesh, ku të krishterët persekutohen; ato me të cilat mundëm të kontaktonim personalisht. Në intervista zakonisht na thoshin se gra të tjera do të ishin kanditate më të mira me histori më dramatike. Asnjë nuk donte të tërhiqte vëmendjen te vetja si një shembull unik heroizmi të krishterë.

Historitë përfshijnë një shumëllojshmëri mahnitëse. Ndërsa disa prej grave kanë shërbyer me vite në mërgim, të tjerat kanë përjetuar vështirësi të një lloji tjetër. Mosha e tyre ndryshon gjerësisht sikurse edhe prejardhja, duke nisur që nga krishterimi tek islami, hinduizmi apo ateizmi. Më mahnitëse janë madje ngjashmëritë: një nxitje e thellë që ka shtyrë secilën prej grave përtej pritjeve dhe dobësive njerëzore.

Lutja jonë është që, pasi të kesh lexuar «Zemra të Zjarrta», të kesh arritur në një bindje më të fortë dhe drejtim më të qëndrueshëm për të përballuar vështirësitë e jetës. Nëse vetëm mahnitesh, ky do të jetë dështimi ynë. Nëse mund të gjesh ngjashmëri në jetën tënde me njërën prej këtyre dështmive dhe nëse merr fuqi prej këtyre shembujve të jashtëzakonshëm kuraje, ne ia kemi dalë mbanë dhe po ashtu, edhe këto gra, që kanë ofruar të ndajnë historitë e tyre me ty.

Në fillim, kur ndërmorëm këtë projekt, planifikuam të përfshinim disa mendime të shkurtra si përfundim të çdo kapitulli. Megjithatë, pasi përpiluam historitë, e kuptuam që kjo nuk ishte e nevojshme. Të gdhendura në çdo dëshmi janë gurët e çmuar të besimit dhe qëndrueshmërisë. Ne besojmë se këto cilësi do të ndezin një shkëndijë në jetën tënde ndërsa përjeton «Zemra të Zjarrta».

Zëri i martirëve.

Adela/Mel:

Mes Tmerrit, Shpresë

Indonezi
5:00 pasdite E hënë, 10 Janar, 2000

Adela mblodhi rreth pesëdhjetë fëmijë nën hijen e palmave përkundëse. Ngriti zërin ndërsa filloi të këndonte «Përpara ushtarë të krishterë». Ajo mund të dallonte frikën në sytë e fëmijëve, ndërsa ata këndonin.

«Nuk dua të vdes», – thirri njëri prej tyre. Ai nuk ishte as dhjetë vjeç.

«Nuk do të vdesim. Eja, duartrokit bashkë me ne!» Adela u përkul drejt tij duke i folur në vesh aq lart sa të mund të dëgjohej edhe prej fëmijëve të tjerë.

Djali i frikësuar u bashkua me hezitim. Kënduan një këngë tjetër duke përplasur duart që u dridheshin. Adela po përpiqej të shuante të thirrurat, ulërimat dhe terrorin që vinte nga shpati i kodrës, rreth një kilometër më poshtë.

E dinte se duhej t'i mbante fëmijët që të mos qanin, sidomos ata më të rriturit. Nëse do fillonte të qante ndonjë prej tyre, do të kishte histeri në masë. Adela e admironte guximin e tyre. Madje edhe prindërit që ishin mbledhur në grupe të vogla rreth fëmijëve dukeshin sikur merrnin fuqi prej guximit të të vegjëlve.

Ndërsa vazhdonte kënga, Adela ktheu sytë nga të rinjtë, që ishin mbledhur e dalloi dy fëmijët e saj. Kristina ishte tashmë nëntë dhe Kristiano shtatë. «Adela, ti mund të jesh e guximshme», e siguronte ajo veten; ajo mund të ishte e guximshme për fëmijët e saj dhe për gjithë të tjerët. Besimi i saj ishte i rrënjosur thellë te Krishti, por shqetësohej për ta, veçanërisht për Kristianon, «Auton» e vogël. Ai ishte shumë i vogël dhe i imët për moshën që kishte.

Adela u lut në heshtje për mbrojtjen e Perëndisë dhe ishte mirënjohëse që kishte rrëmbyer Biblën para se të arratisej prej shtëpisë. E hapi me kujdes, duke shfletuar faqet e venitura në pasazhe të njohura dhe lexoi me zë të lartë: «Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon.»[1] Më pas kaloi në fund të Biblës, ku kishte shkruar shumë këngë dhe i drejtoi fëmijët në një këngë tjetër.

Ndërsa ishin duke kënduar, disa prej fëmijëve filluan të ankoheshin se ishin të uritur e të etur. Ishin në kodër që prej mesditës dhe tani dielli që po perëndonte, kishte shpalosur në qiell një shkëlqim të kuqërremtë gjallërues. Perëndimet e diellit mund të jenë spektakolare këtu në ishullin indonezian të Dodit. Por sot, muzgu përbënte një paralajmërim kërcënues për errësirën, që do të mbulonte fshatin e tyre.

Papritur klithmat e Metjus ndërprenë këngën e fëmijëve. «Vraponi! Adela, vraponi!» Adela u vërsul për në skaj të kodrës dhe u përpoq të shihte në dritën e mekur të diellit. Me zor dalloi siluetat e njerëzve që po vinin në rrugicën e thepisur. Zëri i Metjus oshëtiu. «Merri fëmijët, Adela! Nxito! Duhet të vraposh drejt xhunglës!»

Por Adela u shtang e paralizuar nga zhurmat kërcëllitëse të zjarrit që tani po përpinte kodrën, ndërsa tymi ngrihej në qiellin e errësuar. *I kishin vënë flakën të gjithë fshatit*. Çdo shtëpi duhej të ishte bërë shkrumb, me siguri, edhe e saja.

Ishte në agoni për zgjedhjen që duhej të bënte. A duhej ta ndihmonte Metjun ndërsa ngjitej në rrëpirën shkëmbore, apo të vraponte drejt fëmijëve të saj? Gjithçka po ndodhte shumë shpejt. Në të njëjtën mënyrë jeta i kaloi nëpër mend në çast, e shkuara dhe e ardhmja u «përleshën» në mendjen e saj: dy fëmijë të mrekullueshëm, një bashkëshort të dashur, kishte qenë jetë e mirë.

U kthye drejt fëmijëve dhe më pas i hodhi një vështrim të fundit Metjus. Në çast, iu kujtua djali i guximshëm shtatëmbëdhjetë vjeçar që ishte ulur me kokëfortësi në divanin e nënës së saj...

«VETËM PERËNDIA MUND T'JU NDAJË TANI»

Korrik 1989

«Mami, ai duket si majmun!» – u ankua Adela duke vështruar fshehurazi nga dera e kuzhinës djaloshin që priste në dhomën e ndenjies.

E ëma nuk ishte e habitur për të bijën. Adela mund të ishte shumë e re për t'u martuar, por përsëri mund të tregonte pak respekt dhe vlerësim për vendosmërinë e pareshtur të djaloshit.

Ai vinte në shtëpinë e tyre afërsisht në të njëjtën orë çdo ditë. Adela nuk e dinte nëse ndihej e përkëdhelur apo e mërzitur ndërsa Metju vinte çdo ditë, ulej i sigurt në divan dhe përsëriste të njëjtën kërkesë. Në fakt, Mel(emri tjetër i Adelës)i kishte kthyer përgjigje shumë herë, por Metju ose refuzonte ta pranonte përgjigjen e saj ose hiqej sikur nuk e dëgjonte.

«Nuk dua të martohem. Jam shumë e re. Edhe nëse do të doja të martohesha, nuk dua të martohem me *ty*!» – këmbëngulte Adela. Edhe ajo ishte shtatëmbëdhjetë vjeç dhe bukuria e saj sapo kishte shpërthyer. Por nuk ishte e interesuar për të filluar një marrëdhënie, megjithëse kishte shumë mundësi.

Metju as argumentonte dhe as ofendohej nga vërejtjet e saj të rrëmbyera. Ai thjesht ulej atje me durim dhe i shpjegonte përsëri Adelës se ajo duhej të ishte gruaja e tij. «Është plani i Perëndisë, edhe pse mund të mendosh se dukem si majmun.»

Adela qeshi mbyturazi ndërsa vuri re shkarazi buzëqeshjen e nënës. I palëkundur, Metju paraqiti kërkesën e tij edhe një herë: «Kështu pra, a do të martohesh me mua?»

Ajo e dinte që nuk kishte kuptim të përgjigjej, kështu që thjesht qëndroi duke pyetur veten se kur do të largohej Metju. Më në fund, ai u ngrit për t'u larguar, por para se të ikte hoqi këmishën, e palosi dhe ia vuri në prehër. «Ja ku e ke», – tha ai, – «ti s'do të më përgjigjesh, kështu që këmisha ime do të presë në mungesë të pranisë sime.»

Adelës nuk mund të mos i bëhej qejfi nga gjesti i tij i sinqertë rinor. Tek e fundit, nuk ishte dhe aq i keq.

Tre muaj më vonë ata u martuan.

Ishte një martesë tradicionale sipas zakoneve të zonës. Filloi herët, një pasdite të shkëlqyer tetori dhe vazhdoi deri në mbrëmje. Dy vakte të plota iu shërbyen të gjithë fshatit që erdhi për të qenë dëshmitar i ngjarjes së gëzueshme. Të gjitha këto i kaluan shpejt ndër mend Adelës ndërsa luftonte me valët e herëpashershme të ankthit, duke u shqetësuar se ishte shumë e re për t'u martuar dhe se martesa ishte një gabim i tmerrshëm. Ajo ishte e para nga motrat e vëllezërit që martohej; si mund t'i kuptonte detyrimet e saj si bashkëshorte? Vetëm fjalët e pastorit pas ceremonisë e ngushëlluan nusen e re. «Adela», – tha ai, – «vetëm Perëndia mund të të ndajë nga Metju tani.»

Adela mbeti shtatzënë një muaj pas martese, por fëmija lindi i vdekur. Adela dhe Metju u dëshpëruan.

Por pesë muaj më vonë, Adela mbeti sërish shtatzënë. Këtë herë, foshnja lindi tre muaj më herët dhe nuk pritej të jetonte. Miqtë që erdhën për t'i bërë vizitë e ngushëllonin dhe e inkurajonin: «Bëhu e fortë.»

«Fëmija im nuk do të vdesë!» – përgjigjej Adela me këmbëngulje. Zemra e saj ishte plotësisht e bindur dhe refuzonte të dyshonte prej opinionit të familjes apo fqinjve. Ajo nuk do të humbiste një fëmijë tjetër.

Adela e vendosi ngadalë vajzën e saj të sapolindur në një jastëk dhe i foli butësisht, duke iu lutur në të njëjën kohë Perëndisë. «Pse je këtu, Kristina?» – pëshpëriste ajo. «Ti nuk e plotësove kohën tënde në barkun tim, por je këtu. Megjithëse je kaq e vogël, Metju dhe unë të duam shumë dhe e di që Perëndia do të të mbrojë.»

Për habinë e familjes dhe të fshatit të saj, Kristina u rrit dhe u bë fëmijë i shëndetshëm. Dy vjet e gjysmë më vonë, ajo u bë me vëlla, Kristianon.

S'kishte gëzim më të madh për Adelën dhe Metjun. Shumë shpejt pasi lindi Kristiano, ata mundën te kishin një shtëpi të tyren. Ishte shtëpi e thjeshtë, me tre dhoma kryesisht prej bambuje, dhe nuk kishte dysheme të shtruar. Nuk kishte kushte, por ishte e tyrja. Ndoshta kur fëmijët të rriteshin edhe pak, do të mund ta përballonin një shtëpi më të mirë e më të madhe. Do të donin ta

kishin një të tillë, por për momentin ishin të lumtur thjesht që nuk ishin më nën të njëjtën çati me prindërit e Metjus.

Pothuajse të gjitha familjet e fshatit të Adelës ishin të krishtera dhe ajo merrte pjesë me entuziazëm në programet e të rinjve në kishë. Kishte më shumë se pesëdhjetë fëmijë afërsisht në të njëjtën moshë me Kristinën dhe Kristianën dhe Melit i pëlqente shumë të lexonte të njëjtat histori nga Bibla, që i kishte lexuar edhe asaj gjyshi kohë më parë. Dukej sikur ajo po bënte të njëjtën punë si edhe gjyshi i saj, predikonte ungjillin, edhe pse kjo ishte për fëmijët e lagjes.

U KËRCËNOHET XHIHADI

Jeta kalonte pa shumë telashe për Adelën dhe të tjerët në fshatin e saj, derisa myslimanët fqinj bënë vizitën e tyre të parë «zyrtare».

Megjithëse atëherë ajo nuk e kuptonte, makthi filloi në orën tre të pasdites në 9 Shtator 1999, një ditë, që do të mbetej e pashlyer në kujtesën e Adelës. Me të dëgjuar zhurmën aty afër, doli jashtë me nxitim dhe gjëja e parë që i ra në sy ishte një parullë. Ishin shkruar vetëm dy fjalë me shkronja të mëdha: «Cinti Damai», që do të thotë «Duam Paqe». Rreth e rrotull parullës ishin tridhjetë burra, gra dhe fëmijë nga një fshat mysliman i quajtur Dahma.

«Njerëz të Dodit», një mesoburrë ezmer tha: «Ne jemi fqinjët tuaj dhe duam të përkushtohemi për të jetuar në paqe me njëri-tjetrin.» Nuk kishte ndonjë sistem zëri, por zëri i tij kumbues u dëgjua lehtë në turmë. Ai qëndronte në këmbë dhe mbështetej në platformën e drunjtë të shtëpisë së takimeve. Nuk duhej të kishte keqkuptime apo përleshje midis fshatrave myslimanë dhe të krishterë. Ata të gjithë duhej të jetonin në paqe.

Meli dhe të tjerët që ishin mbledhur rreth platformës menduan se kjo ishte e çuditshme, sepse nuk kishte pasur ndonjë konfrontim të mëparshëm, por ata u zgjatën dorën e miqësisë vizitorëve të tyre, të cilët përforcuan marrëveshjen e pasdites.

Më vonë atë mbrëmje, pasi Metju ishte kthyer nga puna në minierat e zonës, Adela i tregoi ngjarjet. «Po zërat që qarkullojnë?» – pyeti Metju.

Sipas një thashethemi të çuditshëm, dita e nëntë e muajit të nëntë të 1999-ës do të ishte një ditë e errët për të krishterët në ishullin e Dodit. Megjithatë, Metju dhe Adela i konsideruan këto thjesht si thashetheme e asgjë më tepër. Tani po mendonin për vizitën e myslimanëve duke qenë në një mendje se nuk kishte ndonjë kërcënim të dukshëm. Në fakt, kishte qenë një atmosferë e gëzueshme ndërsa fëmijët e tyre luanin së bashku.

Kaluan pothuajse katër muaj pa ndonjë incident apo shkak për dyshim, dhe banorët e Dodit menduan se thashethemet kishin qenë pa bazë, derisa, pikërisht pas Krishtlindjes, kur Julpiusi, një tregtar i ri, u kthye në fshat pas një përpjekjeje të dështuar për t'u larguar nga ishulli. Duke e parë që ai u kthye shumë shpejt pasi ishte larguar, fshtatarët e pyetën cila kishte qenë arsyeja.

«Nuk më lanë të largohesha», – tha Julpusi.

«Kush? Pse jo?», – pyeti njëri prej burrave ndërsa të tjerët u afruan me ankthin që u shtohej.

Julpusi vazhdoi: «Një numër burrash myslimanë më ndaluan dhe nuk e di pse. Në fillim, thjesht më thanë që të mos udhëtoja tani, ishte shumë e rrezikshme. Kundërshtova dhe u thashë se më duhej të lija ishullin për t'u furnizuar, por ata s'donin t'ia dinin. U acaruan vërtet dhe dukej sikur u ofenduan që isha i krishterë. Njoha disa prej burrave; ishin pjesë e grupit që na bënë vizitë për të na shpallur të ashtuquajturën paqe. Unë s'doja telashe të tjera, kështu që u ktheva në shtëpi.»

Adela, Metju dhe shumë të tjerë filluan të mendonin për ndodhinë e Julpusit, duke sjellë ndër mend thashethemin për 9 Shtatorin. Por pa asnjë provë të një rreziku të menjëhershëm, s'mund të bënin asgjë. Më pas, më 10 Janar, frika e tyre më e keqe përfshiu fshatin si stuhi e tërbuar.

Adela po pushonte me Kristianon e sëmurë rreth mesditës, kur u zgjuan nga zhurma e një trazire që po ndodhte midis fqinjve. Adela vrapoi për nga dera kryesore dhe u habit me pamjen e shtëllungave të mëdha të tymit, që ngriheshin në distancë. Një fshat fqinj, fshat i krishterë, po digjej. Më pas u dëgjuan thirrjet e panikut. Duhej të arratiseshin prej shtëpive. Tre mijë myslimanë të armatosur po vinin dhe nuk kishte shpresë të ndalej xhihadi që po u kanosej.[2]

Adela u kthye brenda duke thirrur Kristinën dhe Anton, por asnjë nuk iu përgjigj. Zemra sa s'po i dilte nga kraharori ndërsa kërkonte si e marrë fëmijët, duke vrapuar jashtë e duke thirrur emrat e tyre. Më në fund dikush i tha se i kishin parë duke u ngjitur drejt kodrës, që ndodhej pas fshatit. Adela u kthye edhe një herë brenda dhe rrëmbeu me nxitim disa gjëra. Ndërsa do dilte, dalloi Biblën në tavolinë. E rrëmbeu... dhe iku vetëtimë.

«MAMI, A DO TË VDESIM?»

Ora 6 pasdite, E hënë, 10 Janar, 2000

Metju dhe një burrë tjetër nga fshati i kishin sprapsur për katër orë sulmuesit myslimanë, por ata ishin shumë dhe të armatosur mirë me thika, pishtarë dhe armë zjarri.

Tani i gjithë fshati ishte në flakë dhe thirrjet e turmës «Allah Ekber! Allah Ekber!»[3] mbushnin qiellin. Metju dhe burrat e tjerë u turrën si të marrë drejt rrëpirës së rrëshqitshme, duke shpresuar që luftëtarët e xhihadit të kënaqeshin vetëm me shkatërrimin e fshatit. Por, një zemërim sadist sikur u shpërnda mbi ta dhe shumë shpejt edhe ata po i ngjiteshin kodrës, duke shkrepur egërsisht pushkët e tyre në drejtimin e të krishterëve të mbledhur.

Metju dhe Adela mblodhën me të shpejtë fëmijët dhe nënat e tyre ndëkohë që të gjithë filluan të vraponin në drejtime të ndryshme. Duke shpresuar të shmangnin të shtënat e pareshtura të armëve, u hodhën midis barit të dendur dhe vazhduan të zvarriteshin me sa mundësi të kishin në drejtim të xhunglës. Por udhëtimi i mundimshëm me këmbë e duar u vështirësua ndërsa filloi të binte shi, duke e kthyer tokën djerrë në një pellg balte.

Pasi ecën duke u zvarritur për pothuajse dy orë përmes xhunglës së dendur, mbërritën në një kasolle të braktisur në skaj të një plantacioni me arra kokosi. E ndërtuar me dru me tre anë dhe një çati, ishte përdorur nga fermerët si vend pushimi prej vapës mbytëse të pasdites gjatë kohës së korrjes. Ata shpresuan që tani të shërbente si strehim për familjen e lodhur. Ishin shumë të rraskapitur për të udhëtuar më tej.

Kristinën dhe Kristianon i zuri gjumi menjëherë sapo Adela i shtriu mbi një rrogoz bambuje, që e gjetën në ndërtesën e braktisur.

Ashtu si pjesa tjetër e familjes, fëmijët ishin bërë qull dhe ishin tërë baltë. Megjithëse kasollja e rrënuar siguronte njëfarë strehimi, çatia ishte plot vrima, që lejonin pika të vazhdueshme shiu të binin mbi fëmijët.

Adela s'mund të duronte më. Lotët i rridhnin faqeve ashtu si shiu ndërsa qante me zë të lartë.

Kur e mori veten, bashkë me Metjun u lutën për pak çaste dhe më pas u ulën qetësisht pranë nënave të tyre për të kaluar natën e frikshme. Në agim Kristina dhe vëllai i saj u zgjuan duke kuptuar dalëngadalë se makthi i tmerrshëm që kishin menduar se kishin parë në ëndërr ishte në fakt, i vërtetë. Për pak kohë, ndenjën qetësisht duke parë të rriturit. Sytë e tyre të mëdhenj kërkonin disa fjalë ngushëllimi, por një qetësi vdekjeprurëse kishte rënë mbi familjen e frikësuar dhe asnjë nuk dinte çfarë të thoshte.

Më në fund Kristiano u ankua: «Mami, kam uri.»

Sytë e Adelës u mbushën me lot ndërsa u përpoq të mos qante, por kur e uli djalin në prehër, filloi të qante me ngashërim.

«Të lutem, mos qaj Adela», – iu lut Metju. «Do të shkoj unë për ushqim.» Ai u përpoq ta siguronte gruan, por e dinte që ajo kishte arritur kufirin e saj. Zemra e Adelës sa nuk u copëtua nga dhembja ndërsa vështronte e pashpresë vuajtjen e fëmijës së saj të dashur.

Metju po shkonte në fshatin e shkatërruar për të kërkuar ushqim. Adela iu lut të mos shkonte, por e dinte se duhej të bënin diçka. S'mund të qëndronin në kasolle pa ushqim e pa ujë.

Koha sikur s'kalonte fare që kur iku Metju. Një ndjenjë e thellë frike vazhdonte ta pushtonte Adelën. Duke mos qenë në gjendje të luftonte ankthin, e çoi familjen e saj përsëri në xhungël. Iu bashkuan të tjerëve nga fshati, që ishin fshehur në skaj të fushës me misër. Adela çoi Kristinën, Anton dhe nënat përmes rreshtave të misrit dhe ata filluan të mbledhin kallinjtë e thatë. Të paktën do të kishin diçka për të ngrënë.

Disa orë më vonë Metju erdhi te familja duke mbajtur dymbëdhjetë kanaçe Koca-Kola. Kaq mundi të gjente. Por ndërsa fëmijët zgjatën duart për të hapur kanaçet, shpërthyen të shtënat që oshëtinin si një gjëmim në të gjithë fushën. Asnjë nuk e dinte se

nga ç'drejtim vinin, kështu që u hodhën përtokë, duke mos pasur asnjë ide se nga të vraponin. Më në fund Kristina vështroi Adelën dhe e pyeti: «Mami, a do të vdesim?»

Po, ai ishte mendimi i parë, që i përshkoi mendjen, por ajo e dinte se duhej të ishte e guximshme për fëmijët e saj. I thirri dhe u tha se çdo gjë do të shkonte mirë. Por Adela e dinte se fjalët ngushëlluese s'mund të zëvendësonin realitetin e tmerrshëm të situatës së tyre. Ajo e dinte ç'duhej të bënte. Ishte biseda më e vështirë që do kishte pasur ndonjëherë me fëmijët e saj, por s'kishte rrugë tjetër. Duhej t'ua thoshte.

«Kristina dhe Anto, ju lutem më dëgjoni me shumë kujdes! Nëse do të kapemi nga ata të xhihadit, do t'ju pyesin nëse doni të bëheni myslimanë. Nëse thoni jo, mund t'ju vrasin.» Adela i pa fëmijët në sy. Ajo e dinte se kishte vetëm një përgjigje të drejtë, por si mund të presësh që fëmijët kaq të vegjël të jenë aq të guximshëm?

Të dy fëmijët e saj u përgjigjën: «Ne duam të ndjekim Jezusin.»

Pa menduar më gjatë, Adela hapi Biblën që kishte sjellë me vete në një pasazh që i shkonte vazhdimisht ndër mend që kur kishin lënë shtëpinë. Gjyshi i Adelës ia kishte lexuar shumë herë kur ishte fëmijë dhe i kishte mbetur në zemër: Psalmi 23. Ajo i udhëzoi fëmijët të përsërisnin pas saj dhe filloi të lexonte, «ZOTI është bariu im; asgjë s'do të më mungojë... Po, megjithëse eci në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kem frikë nga asnjë e keqe; sepse Ti je me mua...» Ajo vazhdoi derisa të dy e mësuan psalmin përmendsh. Dhe të dy ishin shumë të guximshëm, por Adela pyeste veten nëse ata e kuptonin vërtet rrezikshmërinë e situatës.

Duke ndier lotët të formoheshin në cepat e syve, i fshiu me nxitim me të pasmen e dorës dhe pyeti: «Kristina, nuk ke frikë se mund të të vrasin nëse thua se je e krishterë?»

Kristina iu afrua së ëmës, e vështroi drejt e në sy dhe u përgjigj butësisht: «Mami, të lutem mos u shqetëso! Unë nuk kam frikë të vdes.»

Pasi të shtënat reshtën, ata që ishin në fushën e misrit u shpërndanë. Adela, Metju dhe familja e tyre u drejtuan për në xhunglën e papërshkueshme, ku udhëtuan me mundim për dy ditë të tjera. Ecnin në errësirën e natës dhe flinin vetëm disa orë para

se të agonte dita. Në njëfarë vendi, Metju takoi të tjerë nga fshati i tyre dhe mësoi se disa të krishterë ishin vrarë tashmë. I shqetësuar për njerëzit e tij të dashur, ai i shtyu edhe më thellë në xhungël.

Të gjithë ishin të rraskapitur, kështu që Metju dhe Adela e kuptuan se s'mund t'i çonin fëmijët më tutje. Megjithëse kishin një sasi qumështi të freskët, dhembja e urisë po përkeqësohej dhe Meli qante sa herë që njëri prej fëmijëve kërkonte për të ngrënë. Ata kishin takuar edhe babanë dhe vëllanë e Metjus.

Mbërritën në një vend që Metju besonte se ishte i sigurt për të pushuar e mblodhi disa gjethe të thata palmash që të mund të uleshin fëmijët. Duke dëgjuar zhurmat gurgulluese të një përroi poshtë luginës, ai dhe i vëllai vendosën të guxonin për të parë nëse mund të gjenin diçka për të ngrënë.

Në një moshë kaq të vogël, Anto nuk e kuptonte pse nuk kishin pasur ushqim në ditët e fundit dhe pyeti shumë hapur nëse mund t'i jepnin oriz dhe peshk. «Babi do të kthehet shumë shpejt dhe ndoshta do të ketë peshk. Atëherë mund të hamë», – i tha Adela duke u përpjekur ta inkurajonte. Por ajo e dinte se nuk kishte të ngjarë që Metju të gjente ushqim dhe e afroi Anton pranë vetes, duke i kënduar një melodi të një kënge e duke e përkundur.

GJAKU I PLOTFUQISHËM I JEZUSIT

Nuk kishin kaluar më shumë se dhjetë minuta kur ajo dëgjoi Metjun të ulërinte. Në fillim Adela mendoi se ishte çmendur që thërriste në atë mënyrë, duke e ditur se luftëtarët e xhihadit mund të ishin afër. Më vonë e kuptoi se Metju ishte i rrethuar, dhe po thërriste që Adela dhe pjesa tjetër e familjes të largohej. Ajo dëgjoi përsëri fjalët që i kishin ngrirë zemrën disa ditë më parë. «Vrapo, Adela! Vrapo!»

Përpara se Metju të mund të thërriste përsëri, Adela dëgjoi krismën e shpejtë të një automatiku. U ngrit menjëherë, por me krahët e Antos akoma rreth qafës së saj, u pengua. U kthye pikërisht në kohë sa për të parë kalimthi Kristinën duke vrapuar në drejtim të të thirrurave të Metjus. Adela mori frymë për t'i thirrur për të ndaluar, por ishte shumë vonë. Ishin të rrethuar nga burra me veshje të gjata të bardha.

Anto ishte shtrirë në tokë atje ku e kishte lënë Adela. Kur u përpoq të ngrihej, njëri prej burrave vërtiti thikën e cila e zuri në shpinë me anën e gjerë të tehut. Adela ulëriti me sa fuqi që kishte dhe u hodh mbi djalin për t'ia mbrojtur trupin e vogël nga një goditje tjetër. Ajo mund të shihte fytyrën e djalit të zbehej nga frika ndërsa kaloi në shok, por përpjekjet e Adelës për ta ndihmuar Anton ishin të kota ndërsa njëri prej burrave e kapi prej flokëve të zinj e të gjatë dhe e ngriti në ajër me lehtësi.

Një thikë me njolla gjaku shtrëngohej në qafën e Adelës ndërsa burrat e detyruan të shkonte drejt dy pemëve të bambusë. I kuptoi synimet e tyre ndërsa filluan t'i shqyenin rrobat. Ishte ende duke shtrënguar fort Biblën, por ajo ra në tokë po aq lehtë sa edhe rrobat e saj. Adela mbylli sytë, duke u lutur në heshtje për familjen e saj dhe duke iu përgjëruar Zotit ta shpëtonte nga dhunimi.

Ajo dëgjoi të thirrurat e nënës së saj, të vjehrrës dhe të Antos së saj të dashur dhe e dinte që ishin masakruar nga kriminelët e neveritshëm, që i kishin dëbuar prej shtëpive të tyre. S'mund të duronte më. Teksa po i binte të fikët, ra në gjunjë ndërsa pa ata që i kishin sulmuar familjen, të vinin në drejtim të saj. Gjaku u rridhte nga anët e thikave. Ishte gjaku i Antos.

«Oh, Zot!» – thirri Adela. Nuk e dinte se si mund të vazhdonte. Njëri prej burrave hoqi çallmën e djersitur dhe ia lidhi rreth kokës. Në të shkruhej «Allah Ekber». Me grimcën e fundit të fuqisë Meli thirri «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm!»

«Ajo është e krishterë! Një derr! Një derr i qelbur! Le ta dhunojmë dhe t'i japim fund», tha me përçmim një zë. Një numër i madh myslimanësh të tërbuar e rrethuan, duke diskutuar se çfarë të bënin me të. Ata po flisnin me dialektin vendas dhe nuk e kuptuan se Adela mund të kuptonte gjithçka që thoshin.

Duke u përpjekur të fshihte lotët, ajo u lut në heshtje në zemrën e saj: «*Zot, të lutem, ndihmoji të kuptojnë se çfarë janë duke bërë. Është kaq e ligë... të lutem bëji të kuptojnë. Ata s'mund ta dinë se çfarë po bëjnë. Nuk është e mundur nga ana njerëzore*». Ndërsa po vazhdonte të lutej, në atë pështjellim iu duk të dëgjonte para vetes një zë të qetë dhe të butë t'i pështpëriste: «Adela, ti je?»

Ajo ngriti sytë dhe pa se ishte kapur edhe një burrë nga fshati i saj, që quhej Hans.

Edhe Hansin e kishin zhveshur dhe po kullonte gjak. U dëshpërua edhe më tepër, sepse ishte e sigurt se ai nuk do të mbijetonte. E pyeti nëse kishte parë Metjun apo Kristinën, por ai tundi kokën në shenjë mohimi.

Njëri prej burrave grumbulloi rrobat e Adelës dhe ia vendosi nën krah. Nuk i lejohej t'i vishte. Vështroi Biblën e saj që ishte bërë copë e çikë...

Dy robërit u çuan drejt një rruge të thepisur mali me thikat që preknin pjesët më delikate të trupave të rrahur. Ndërsa rrugica bëhej më e ngushtë, Adela vështroi poshtë duke e kuptuar se sa lart ishte dhe sa lehtë mund të hidhej. E dinte se ndoshta do të vdiste nëse hidhej, por s'prishte punë. «*Më ndihmo, o Zot! Të lutem, më ndihmo*», përgjërohej ajo vazhdimisht. Duke i rezistuar tundimit për t'u hedhur, më në fund erdhi në majë të malit, ku ishin mbledhur mbi një mijë luftëtarë të xhihadit. Ata kishin të gjithë mosha të ndryshme, disa ishin pothuajse adoleshentë, por ishin veshur njësoj, me veshjen e bardhë të gjatë dhe me çallma të lidhura fort në kokë.

Nën tytën e armës, njëri prej ushtarëve detyroi Adelën dhe Hansin të qëndronin me shpinë ndaj njëri-tjetrit. Ushtari ishte mesoburrë me shpatulla të gjera. Vendosi pushkën në anë dhe me ngadalë nxori një thikë nga këllëfi. Adela vështroi rreth e rrotull dhe e kuptoi se ajo dhe Hansi ishin të vetmit të krishterë në gjithë atë det veshjesh të bardha. Mbylli sytë duke besuar e shpresuar se më në fund do përfundonte gjithçka.

Brenda pak sekondash, ndjeu rrjedhjen e ngrohtë të gjakut në fytyrë dhe trup. «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm!» bërtiste ajo herë pas here. Edhe Hansi po bërtiste. Ajo mund të dëgjonte zërat e zemëruar të burrave të tjerë që thërrisnin në distancë. S'guxonte të hapte sytë. Mendonte se po t'i mbante mbyllur mjaft gjatë, do të mund t'i hapte në botën tjetër, në parajsë. Por pasi priti pak kohë, që iu dukën shekuj, s'mundi më të rrinte pa i hapur. Para saj ndodhej trupi i gjymtuar i Hansit.

GJASHTË FJALË TË THJESHTA

Adela ishte mbuluar me gjak, por s'mund ta dallonte nëse ishte i saji apo i Hansit. Kishte dhembje të tmerrshme nga goditjet e shpeshta të myslimanëve, por nuk dukej se kishte ndonjë plagë të hapur në trup. Zëri sa vinte e po i dobësohej, por arriti të përsëriste fjalët: «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm. Në njëfarë mënyre ajo e dinte se Perëndia po e mbronte. Deri tani duhej të kishte vdekur shumë herë. Kishin kaluar pesë orë që kur i kishin shqyer rrobat dhe kishin filluar ta rrihnin. Ajo e dinte tashmë se Anto, nëna e saj dhe nëna e Metjus kishin vdekur dhe dyshonte se edhe të tjerët kishin vdekur bashkë me ta. Por ajo ishte ende gjallë dhe kishte një arsye pse. Në mes të sulmit të tmerrshëm, Adela ndiente në njëfarë mënyre një dritë të zbehtë të çuditshme shprese.

Banda e luftëtarëve të xhihadit kishte mbledhur armët dhe i thanë Adelës se ishte koha për të ikur. Ajo do të ishte udhërrëfyesja e tyre. E çuan në fillim të rreshtit dhe ajo i drejtoi në një rrugë gjarpërushe në anën e kundërt të malit. Adela nuk e kishte fare idenë se ku po shkonin. Ecte në një gjendje jo plotësisht të vetëdijshme dhe përpiqej të largonte nga mendja zhurmën e ekzekutimit brutal të Hansit dhe pamjen e trupit të tij të gjymtuar. Duke mos qenë të kënaqur që e kishin prerë në copa, burrat e mbuluan trupin e tij me gjethe palmash prej pemëve të kokosit aty rrotull, i hodhën lëndë djegëse dhe i vunë flakën kufomës.

Kur arritën në fund të malit, Adela nuk nevojitej më si udhërrëfyese. Burrat e shtynë në drejtim të Dahmës, fshatit të tyre, duke i tërhequr vazhdimisht flokët e gjatë dhe duke e goditur me të dyja anët e thikave të tyre. Në çdo goditje, Meli vazhdonte të thërriste, «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm! Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm!» Ndonjëherë ndonjëri prej burrave vraponte pas saj dhe ia vërviste egërsisht tehun e sheshtë të thikës pas koke. Ajo binte në tokë si një kukull lecke duke ruajtur kokën me pëllëmbët e duarve. Ndjente sikur një mijë gjilpëra t'i ishin ngulur në kokë, por kur shihte duart, habitej që nuk i rridhte gjak.

LUFTA KUNDËR URREJTJES SË BRENDSHME

Adelës iu shtua guximi kur e kuptoi se Perëndia po ia kursente në mënyrë të mrekullueshme jetën. Por pse? Ajo s'mund ta kuptonte pse merrte ende frymë ndërsa shumë të tjerë ishin vrarë mizorisht. Madje edhe rrëmbyesit e saj kishin një pamje të hutuar në fytyrat e tyre dhe ajo pyeste veten nëse edhe ata kishin të njëjtën pyetje: se si një grua e pambrojtur kishte qenë në gjendje t'u mbijetonte sulmeve të tyre të përsëritura. Ata u tërbuan edhe më tepër, sepse ajo vazhdonte të shpallte gjakun e Jezusit.

Më në fund njëri prej tyre e ndaloi, ndezi një dorë gjethesh duhani dhe ia vendosi me forcë në gojë. Sytë e Adelës u zgurdulluan ndërsa shihte gjethet në flakë në drejtim të saj. U përpoq të rezistonte, por nuk mund t'i kundërshtonte krahët e tij të fuqishëm. I bindur se më në fund e kishte pushtuar këtë «të pabesë», burri u buzëqeshi me vetëkënaqësi të tjerëve. Por pasi hoqi dorën prej gojës së Adelës, ajo pështyu me zemërim gjethet dhe tha me siguri: «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm.» Gjashtë fjalët e thjeshta ishin bërë edhe më reale ndërsa makthi i ferrit të Adelës vazhdonte.

Dielli perëndoi dhe drita nga hëna pothuajse e plotë ndriçoi rrugën e tyre ndërsa vazhdonin për në Dahma. Adela mund të shihte dritat nga shtëpitë dhe siluetat e fëmijëve, që luanin e vraponin. Iu kujtua fshati i saj dhe solli ndër mend me trishtim se si fëmijët atje luanin në mbrëmje ashtu si edhe këta fëmijë.

Grupi ndaloi dhe Adela u urdhërua të vishte rrobat. Dy djem të rinj, jo më shumë se njëzetë vjeç, u lanë për të ruajtur me pistoleta ndërsa të tjerët vazhduan për në fshat. Adela i pyeti dy të rinjtë nëse e dinin se çfarë i kishte ndodhur vajzës së saj.

«Po, ne e vramë» – u tall njëri prej tyre.

Adela e ndjeu se ata po gënjenin, por mund të shihte urrejtjen në sytë e tyre. Ndjeu zemërimin t'i rritej brenda vetes dhe iu lut Perëndisë t'ia largonte.

Pak më vonë e çuan në fshat, ku përsëri iu nënshtrua talljeve dhe torturave. Luftëtarët ishin mizorë, por ajo ishte e fortë. Nëse ishte koha që të vdiste, madje edhe në duart e ushtarëve të xhihadit, ishte gati. Adela e kuptoi se s'kishte peng tjetër. As që

guxonte ta imagjinonte se sa të tjerë ishin vrarë. Në atë moment nuk e dinte se cila ishte më keq, të vdiste apo të mbahej peng nga këta të njerëz të ligj e të çmendur. Pavarësisht nga torturat, ajo vazhdonte të shpallte me zë të lartë «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm» sa herë që një ushtar ushtronte terror në trupin e saj të brishtë.

Në postkomandën e xhihadit, atë e zhveshën përsëri. Tre gra e çuan në një dhomë të pasme, ku e lanë me ujë të ftohtë në një vaskë të ndryshkur metalike. «Ju lutem, më lini të lahem vet!» – iu lut Adela. Por ato refuzuan, dhe pasi ajo ua përsëriti, e rrahën me një lugë të madhe druri. Pas banjës së ftohtë, i dhanë një bluzë të vjetër dhe një palë pantallona të shkurtra që ishin plot vrima. Rrobat e saj i përkisnin një «derri të ndyrë, ndaj do të digjeshin», – i thanë gratë.

«KU JANË FSHEHUR TË KRISHTERËT?»

Njëmbëdhjetë burra u caktuan për ta marrë në pyetje Adelën ndërsa tridhjetë a dyzetë të tjerë u mblodhën rreth tyre. Ajo njohu disa prej udhëheqësve; ishin të njëjtët që kishin ardhur me parrullë në fshatin e saj në 9 shtator duke thirrur: «Paqe ishullit të Dodit.» Burri që drejtonte pyetjet ishte i njëjti, që kishte folur me kaq siguri nga platforma atë ditë. Adela mund të ndiente përsëri urrejtjen t'i shtohej ndërsa e kuptonte që pikërisht ata njerëz që kishin ardhur për të bërë një besëlidhje «paqeje», ishin kthyer për të sulmuar fshatin e tyre dhe për të vrarë miqtë dhe familjen, përfshirë edhe Anton e saj të dashur. Tani, ndërsa uleshin të sigurt në karrigen e drunjtë në qendër të dhomës, pyeste veten se cili ishte vërtet përkufizimi i tyre për *paqen*.

«Ku fshihen të krishterët e tjerë?» – pyeti me qetësi burri i gjatë dhe i dobët.

«S'mund t'jua tregoj. Edhe nëse më vrisni, nuk do t'ju përgjigjem.» Adela e dinte se shumë prej tyre ndoshta po fshiheshin dhe ishte e sigurtë për atë që mund t'u ndodhte nëse tregonte.

«Hë, pra. Nuk do t'u bëjmë keq. Duam vetëm të dimë se ku janë. Nuk do që të shkosh në shtëpi?» Adela qëndroi në heshtje duke refuzuar t'u përgjigjej pyetjeve të tyre. Marrja në pyetje

vazhdoi edhe për tridhjetë minuta të tjera duke përfunduar me shuplaka në fytyrë. I vendosën përpara një pjatë ushqim, por ajo refuzoi të hante. Të vendosur, dy burra i hapën gojën me forcë dhe i futën ushqim me zor. Adela e pështyu të gjithë, edhe pse nuk kishte ngrënë asgjë për tri ditë.

Fjala se Adela refuzoi të hante apo të fliste u përhap me shpejtësi në Dahma, dhe shumë njerëz u mblodhën jashtë postkomandës duke thirrur: «Na e dorëzoni neve! Do ta presim në copa dhe do ta groposim!»

Duke dëgjuar zërat e zemëruar, Adela u mbush njëherazi me urrejtje dhe frikë. Më në fund një burrë i moshuar, i njohur si Sabom Sabar, hyri në dhomë. Ai nuk dukej se nxitej nga i njëjti zemërim që kishte pushtuar të tjerët. Duke u ulur në gjunjë pranë Adelës, e pyeti nëse mund t'u tregonte se ku ishin fshehur të krishterët e tjerë.

«Jo, s'mundem», – u përgjigj ajo ndërsa s'e përmbante dot më frikën dhe lotët filluan t'i rridhnin. Sabari u ngrit dhe i tha komandantit. «Është më mirë nëse ky fëmijë vjen me mua. Nëse qëndron më gjatë këtu, do të vritet.»

Një grup burrash vazhduan t'i bërtisnin Adelës dhe ta kërcënonin se do e vrisnin kur ta çonin në shtëpinë e Sabarit. Ata premtuan se do prisnin jashtë që në rastin e mundshëm ta sulmonin. Por Sabari i tha: «Këtu do të jesh e sigurt. Mund të flesh në dhomën tjetër.»

Kur hyri në dhomën paksa të mobiluar, Adela mbylli shpejt derën. Më pas u shtri në shtrat, një rrogoz kashte, dhe lotët nisën t'i rridhnin ndërsa mendonte për Anton e saj të dashur.

«A MENDON SE AI MUND TË TË SHPËTOJË PREJ KËSAJ?»

Të nesërmen një grup ushtarësh me uniformë hynë në fshat; u ndalën menjëherë në shtëpinë e Sabarit për t'u takuar me Adelën. Kishin të njëjtat pyetje si edhe të tjerët: «Ku janë fshehur të krishterët e tjerë?»

Adela refuzoi përsëri të përgjigjej. U lejua të kthehej në dhomë, por mund të dëgjonte bisedën e burrave përmes mureve të hollë. Ushtarët ishin të vendosur dhe kishin vetëm një objektiv: të gjenin të krishterët e tjerë. Kishin vendosur që Adela të shkonte me ta

si «udhërrëfyese». Ajo u tmerrua. Vendosi në zemrën e saj se më mirë vdiste se sa të shkonte me ta.

Më vonë atë pasdite, tre prej grave të fshatit i sollën Adelës pak ushqim, por përsëri ajo refuzoi të hante. Ndërsa gratë filluan të flisnin me njëra-tjetrën, Adela e kuptoi që i kishte njohur më parë. Ato ishin nga një fshat tjetër të krishterë në lindje. Megjithatë ishin martuar me burra myslimanë dhe ishin nxitur për të ndërruar fe. Njëra prej grave, Umi, filloi ta kritikonte Adelën me keqdashje. «Djali dhe nëna jote vdiqën për fajin tënd. Ti refuzove të bëheshe myslimane, por tani po e përjeton vetë. Ti dëshiron të besosh te Jezusi, por a mendon se Ai mund të të shpëtojë nga *kjo*?»

«Mbylle gojën, Umi! Mjaft fole ashtu», – e urdhëroi njëra prej grave. «Çfarë mendon ti? A mendon se Muhamedi do të na shpëtojë?» Adela mund të shihte butësinë në sytë e gruas dhe para se të nisej, e përqafoi. Gruaja filloi të qante dhe i pëshpëriti në vesh: «Ndoshta një ditë mund të kthehem te Krishti.»

Adela nuk e kuptoi nëse ajo po e deklaronte apo po pyeste nëse ishte e mundur. Vështroi fytyrën e saj të trishtuar dhe iu përgjigj me butësi: «Nëse vërtet dëshiron të kthehesh te Zoti, Ai do ta gjejë mënyrën.»

Ndërsa mbrëmja erdhi, ushtarët u kthyen. Ishte vendosur që të gjithë të krishterët në ishull duhej të mblidheshin dhe Adela do të ishte personi më i mirë që do t'i ndihmonte për t'i gjetur. Kur t'i grumbullonin, do t'i digjnin të gjithë, pa përjashtim. Asnjë nuk duhej të mbetej gjallë. Meli e dinte se asgjë s'mund ta ndalte planin e tyre dashakeq, kështu që mbeti e mbyllur në dhomën e saj dhe lutej për fuqi. Nëse e merrnin si udhërrëfyese, e dinte se refuzimi i saj për të bashkëpunuar do të thoshte vdekje e sigurt.

Disa burra filluan të thërrisnin jashtë shtëpisë së Sabarit dhe Adela u zvarrit drejt murit të jashtëm për të parë përmes të çarave për çfarë ishte e gjithë ajo trazirë. Luftëtarët kishin kapur edhe një familje tjetër të krishterë. Burri ishte vrarë, gruaja dhe tre fëmijët ishin rrugës për në Dahma. Ajo dëgjoi të thuhej se gruaja quhej Roza. Zemra e Adelës u mpak ndërsa u kthye në rrogozin e saj. E njihte mirë familjen. Njëri prej fëmijëve ishte në moshën e Antos dhe kishin luajtur bashkë në shtëpinë e tyre pothuajse çdo ditë.

Afër mesnatës, Sabari u kthye në dhomë. Kishte fytyrë të vrenjtur. «Mel, çfarë do të bëjmë? Ushtria ka kërkuar të shkosh me ta.»

Adela u habit që ai kishte thënë «ne». Sabari dukej sikur identifikohej me dhimbjen e saj. Mirësia e tij ofronte një ishull të vogël ngushëllimi në zemërimin që e rrethonte. Por Adela e dinte se nuk kishte zgjedhje. «Thuaju të më qëllojnë tani, menjëherë. Nuk do të shkoj me ta.»

«Pse ke kaq frikë prej tyre?» – pyeti Sabari.

«Sepse i njoh planet e tyre. I dëgjova kur bisedonin dhe nuk do t'i ndihmoj të vrasin ndonjë tjetër», – u përgjigj ajo.

Sabari u largua nga dhoma. Një natë tjetër pa gjumë dhe Adela kishte refuzuar përsëri të hante. Në orët para se të agonte, erdhën edhe më tepër raportime. Një familje tjetër e vrarë... më shumë gra dhe fëmijë të kapur... ishte gjetur një vajzë e vogël. Meli pyeste veten nëse do dëgjonte për Kristinën, nëse ajo kishte qenë njëra prej robërve të rinj. Mendoi se do të kishte qenë më mirë nëse ata do ta kishin vrarë Kristinën. Ishte mendim i tmerrshëm, por ajo kishte frikë për atë që mund t'i bënin vajzës së saj të ëmbël e të pafajshme ata ushtarë të poshtër.

KRISTINA

Në orën katër në mëngjes, Adela po i thërriste Perëndisë. «Pse nuk më le të vdisja?» Lotët vazhduan të rridhnin çurg në fytyrë ndërsa përsëriste pyetjen munduese «Pse?»

Kërcënimet e pareshtura vazhdonin jashtë dhomës së saj. Një burrë pothuajse ia doli mbanë ta godiste me thikë, duke e ngulur atë jashtë murit të dhomës ku ajo rrinte. Dy prej grave, që i kishin bërë vizitë Melit një ditë më parë, u kthyen duke iu lutur që të hante. Por ajo refuzoi. Qëndroi në dhomën e saj duke fjetur pak në qetësinë e mëngjesit, por pjesën më të madhe të kohës përplasej pas murit e qante. Vazhdoi të lutej për Metjun dhe familjen e tij, por kryesisht lutej për Kristinën.

Pastaj erdhi lajmi.

«Adela! Adela! – thirri Sabari ndërsa nxitoi për në dhomën e saj. «Janë disa burra jashtë. Thonë se kanë kapur vajzën tënde, Kristinën.»

Ishte e rrezikshme.., tepër e rrezikshme, por Adela duhej ta merrte vesh. A mund të ishte Kristina gjallë? Apo ishte thjesht një mashtrim mizor për ta nxjerrë prej shtëpisë së Sabarit?

Kishte vetëm një mënyrë për ta zbuluar.

Udhëtuan me varkë për në fshatin e Salubit: gjashtë ushtarë të xhihadit, Adela, Sabari, i cili me kërkesën e Adelës ra dakord ta shoqëronte, dhe një person i ri rob i quajtur Meksi. Një tjetër shoqe e Antos, Meksi, ishte vetëm shtatë vjeç. Adela e përqafoi fort vajzën e vogël. Qau ndërsa ia largonte flokët prej fytyrës. Ishte fytyrë e njohur, mike e familjes.

Adela u ul afër Meksit duke e përqafuar fort dhe duke e përkëdhelur në kokë gjatë udhëtimit të shkurtër për në Salubi. Meksi i kujtonte shumë Anton. Por ai moment i paqtë u zhduk menjëherë ndërsa Adela pa ushtarët e armatosur të prisnin në breg. E flakën jashtë varkës dhe trajtimi brutal i tyre, ende i freskët në kujtesë, i pushtoi mendjen.

Meksi u tmerrua ndërsa shikonte sulmet e tmerrshme ndaj Adelës. Ulëriti me zë të lartë dhe trupi i saj u përfshi nga të dridhura të pakontrollueshme. Kur dëgjoi të qarat e mikes së saj të vogël, Adela shpalli përsëri: «Gjaku i Jezusit është i plotfuqishëm!» Tani kishte frikë se udhëtimi për në Salubi s'kishte fare të bënte me Kristinën. Shpresa iu venit shpejt ndërsa të rrahurat vazhdonin. Sabari filloi t'u bërtasë burrave duke u lutur të ndalonin. Duke ia dalë mbanë të shkëputste Adelën prej kthetrave të tyre, e ndihmoi të hynte në një shtëpi të madhe pikërisht pas bregut, ku mbaheshin robërit e tjerë. Pastaj i tha se i duhej të largohej. «S'mund të bëj asgjë tjetër për ty. Nëse ndërhyj më, do të më vrasin edhe mua. Më vjen keq!»

Kishte gra të tjera në atë shtëpi, duke u dridhur nga thirrjet e tmerrshme të burrave që nuk reshtnin. Adela e kishte vënë kokën midis duarve kur dëgjoi hapa që vraponin drejt saj. Duke ngritur kokën, e pa. Ishte Kristina!

Iu hodh në krahë nënës duke u ngashëryer: «Mami, mami!» Ato shtrëngonin fort njëra-tjetrën dhe Kristina përpiqej të nxirrte fjalët. «Më vjen shumë keq, mami...më vjen shumë keq. Ata vranë gjyshen... Pashë trupin e tij, mami, pashë Anton.., e vranë edhe atë. Oh, mami!»

«E di Kristina, e di që i kanë vrarë.» Ky kujtim ishte akoma tepër i dhimbshëm për të dhe Adela filloi të vajtonte pa pushim. Kristina s'dinte çfarë të thoshte, kështu që thjesht e puthte t'ëmën duke mos reshtur së puthuri.

DUKE KËRKUAR NJË PËRGJIGJE QË NUK PO VINTE

Mbrëmjen e ditës së gjashtë të robërisë së saj, Adelën dhe gjashtëdhjetë robër të tjerë i mblodhën së bashku dhe u thanë se duhej të ktheheshin në myslimanë mëngjesin tjetër.

«Nuk do të bëhem kurrë myslimane», – u përgjigj Adela. «S'ka problem. Nuk je e detyruar ta bësh. Por nëse nuk e bën ti ose nëse dikush nga ju refuzon, do t'ju vrasim të gjithëve», – iu kundërvu komandanti. «Dhe gjaku i tyre do të jetë mbi kokën tënde.»

Atë mbrëmje u lejua që robërit e krishterë të mblidheshin së bashku për të diskutuar. Ata përqafonin njëri-tjetrin dhe derdhnin lot. Para të krishterëve ishin dy zgjedhje: A do të binin dakord të konvertoheshin apo do t'u bashkoheshin rangjeve të martirëve të krishterë? «Mund të përsërisim fjalët; mund të themi lutjet e tyre. Perëndia njeh zemrën tonë; Ai nuk do të na gjykojë», – ofroi më në fund si zgjidhje një burrë.

«Si mund ta bëjmë këtë? Kemi rezistuar kaq gjatë. E gjithë kjo ishte e kotë?»

«Po fëmijët tanë? A duam t'i shohim të ekzekutohen para syve tanë?»

«A dëshiron Perëndia që të vdesim të gjithë në këtë fshat mysliman?»

Ndërsa diskutimet vazhduan deri sa u zbehën, Adela mendonte për situatën e tyre të vështirë. Për vete, ajo mund të refuzonte lehtë të konvertohej; e dinte se besimi i saj do ta mbante deri në fund. Por a ishte e drejtë që veprimet e saj të përcaktonin fatin e të tjerëve, përfshirë edhe Kristinën? Dilema e pushtoi ndërsa i thirri Perëndisë për një përgjigje, por nuk mori asnjë.

Mëngjesin tjetër të krishterët i mblodhën në oborr. «A keni marrë ndonjë vendim? A do të konvertoheni, apo do vdisni?», – pyeti një luftëtar i xhihadit.

Askush nuk guxonte të përgjigjej i pari. Madje edhe fëmijët më të vegjël refuzuan të flisnin, të ngrirë në një gjendje frike dhe përleshjeje të brendshme për të qëndruar të vërtetë ndaj besimit të tyre. Komandanti po acarohej gjithnjë e më shumë prej heshtjes së tyre kokëforte dhe u dha urdhra vartësve të tij në gjuhën vendase. Ushtarët u kthyen me nja dymbëdhjetë lugë dhe me një ritual të çuditshëm filluan të përzienin baltë duke i detyruar të krishterët ta hanin. Komandanti i qëlloi Adelës në fytyrë ndërsa ajo e pështyu. «Haje! Haje tani!» – i bërtiti.

Adela refuzoi.

Sollën një zorrë uji dhe secili prej robërve u spërkat në një «pagëzim islamik» ndërsa myslimanët nisën të recitonin vargje nga Kurani. Kur përfunduan, kërcyen si të dehur dhe shkrepën pushkët në ajër, duke festuar fitoren e tyre të pretenduar të kthimit të të krishterëve në islam. Të krishterët, duke qëndruar së bashku në heshtje, vështronin në këtë turbullirë ushtarët që vazhdonin festimin e tyre të kotë.

Zemrat e tyre u dëshpëruan kur dalluan ushtarët ndërsa sillnin kanaçe gazoline në drejtim të grupit të mbledhur. Një oficer i veshur mirë, me pamje të spikatur, ecte përpara të tjerëve. Adela e njohu atë si një udhëheqës nga ishulli i Javës. Pa asnjë pikë dyshimi, me qetësi urdhëroi oficerët e tij t'i mbyllnin të krishterët në një shtëpi dhe ta lagnin me gazolinë.

Të mbyllur në një kasolle aty afër, të krishterët e terrorizuar filluan të bërtisnin ndërsa u mblodhën rreth fëmijëve të vegjël. Nuk kishin frikë të vdisnin për Krishtin. Secili prej tyre kishte dhënë gjithnjë prova për këtë gjatë robërisë. Por mendimi se do digjeshin të gjallë dhe të shihnin të vegjlit e tyre në flakë, ishte më shumë nga ç'mund të duronin. Menjëherë u ulën në gjunjë duke i thirrur Perëndisë që t'i shpëtonte nga një vdekje kaq e tmerrshme.

Ndërsa ishin duke u lutur, një grindje shpërtheu midis ushtarëve. Po debatonin nëse duhej t'i digjnin. Njëri prej tyre kundërshtoi duke thënë se të burgosurit ishin konvertuar tani në islam dhe mund të ishin të dobishëm në xhihad. Ata ranë dakord shumë shpejt. Nëse robërit pranonin të merrnin pjesë në xhihad, kjo do

të konfirmonte përkushtimin e tyre ndaj Allahut dhe si rezultat do të shpëtonin.

ÇMIMI I REBELIMIT

Kur dëgjuan grindjet jashtë, Adela dhe të tjerët ngrinë në gjendje shoku. Nuk ishte përgjigjja që kishin kërkuar. Por një vendim duhej marrë. Nëse robërit më të vjetër binin dakord të shkonin me ushtarët në xhihadin tjetër, të gjithë do të kurseheshin. Përndryshe do t'u derdhej gazolinë në kasolle dhe do të digjeshin. Robërit ngrinë në gjunjët që u dridheshin duke vështruar njëri-tjetrin për kurajë dhe pyetur veten se kush do të guxonte të fliste i pari. Komandanti hyri si rrufe në kasolle, duke dhënë lajmin e mirë. «Nëse jeni mjaft të rritur për të mbajtur një thikë, bashkohuni me ne në xhihad. Do të jetë qejf!»

Zemërimi i Adelës u rrit ndërsa dëgjonte talljen e neveritshme ndaj të burgosurve. Duke ndier një vrull kuraje, u ngrit. Komandanti buzëqeshi, duke menduar se kishte vullnetarin e parë. Por ajo iu drejtua të tjerëve. «Asnjë prej jush të mos shkojë me ta. Nëse do të na vrasin, është më mirë për ata të na vrasin këtu. Të paktën do të jemi të gjithë së bashku!»

Komandanti, i tërbuar nga shpërfillja e saj, e kapi prej krahu. «Çfarë the?»

Adela përsëriti: «Ne nuk do të bashkohemi me xhihadin. Tani të lutem dil jashtë.» Komandanti ia shtrëngoi fort krahun Adelës, duke e parë drejt e në sy. Nuk i duhej të fliste, sytë i komunikonin shumë mirë tërbimin e tij. Por Adela besonte se Perëndia do t'i shpëtonte. Besonte gjithashtu se rebelimi i drejtpërdrejtë do e kishte një çmim. Ndërsa komandanti u kthye dhe u largua nga dhoma, të tjerët, duke admiruar guximin e Adelës, pyesnin veten nëse ajo sapo kishte vulosur fatin e të gjithë atyre.

Në mënyrë të mrekullueshme, edhe ushtarët u larguan dhe të burgosurit u nxorën jashtë kasolles.

Kaluan dy javë dhe Adela ishte nën kërcënim të vazhdueshëm. Myslimanët e dinin se ajo kishte ndikuar te të burgosurit e tjerë dhe mendonin se duhej eliminuar. Forca fizike po i rikthehej ndërsa filloi dalëngadalë të hante me këmbënguljen e Kristinës.

Udhëheqësit ushtarakë shkonin e vinin në fshatin e vogël pothuajse çdo ditë për të diskutuar se çfarë të bënin me të burgosurit. Dyshonin nëse konvertimi i të krishterëve në islam kishte qenë i sinqertë dhe diskutonin se duhej t'i kishin djegur në kasolle siç ishte planifikuar më parë. Kështu do e ruanin fshatin e tyre nga ndotjet e mëtejshme. Me përpjekjen e fundit për të konfirmuar konvertimin e pengjeve, ata vendosën që të gjitha gratë duhej të rrethpriteshin.

Disa prej tyre ishin të tmerruara dhe filluan të qanin në histeri. Kundërshtimi konfirmonte dyshimet e komandantit të fshatit, ndaj ai këmbëngulte që ata të ekzekutoheshin. Të tjerët mendonin ende se të krishterët do të ishin të dobishëm nëse mbaheshin gjallë, kështu që u ra dakord midis myslimanëve, që për momentin, ata duhej të jetonin. Megjithatë, i morën të gjitha vajzat që nuk kishin arritur adoleshencën, duke përfshirë edhe Kristinën dhe i prenë mizorisht. Dhembja ishte e padurueshme dhe Kristina qante pa pushim. Zemërimi i Adelës u ndez, por ajo u përpoq të kontrollonte zjarrin brenda saj. Prova e saj ishte e vështirë, përtej imagjinatës, por të shihte të bijën të vuante ishte tejmase edhe më keq. Adela ndiente urrejtje për çdo mysliman përveç Sabarit. E dinte se urrejtja ishte si kancer për shpirtin dhe falja ishte i vetmi ilaç. Por falja dukej të ishte shumë larg, e pamundur. Gjithçka që mund të bënte ishte të lutej.

Kaluan gjashtë javë pa ndonjë kërcënim tjetër të drejtpërdrejtë ekzekutimi, por Meli ishte shumë e shqetësuar. E dallonte mënyrën si e shihnin burrat myslimanë dhe një grup prej tyre ishte përpjekur tashmë ta dhunonin. Ajo mund të ndjente epshin e tyre të rritej me kalimin e kohës dhe pyeste veten se sa kohë mund t'i mbante larg. Madje edhe komandanti i fshatit kishte bërë provokime të papërshtatshme. E kishte marrë malli për ngushëllimin e Metjus, duke pyetur veten nëse ai ishte gjallë.

METJU

Papritur një mëngjes, një grup i vogël zyrtarësh erdhi me varkë në Salubi. Ata po hetonin pretendimet mbi të krishterët po mbaheshin peng në fshat, një akuzë që ushtarët myslimanë e mohonin me

zjarr. Megjithatë, Nahori, njeriu që zotëronte varkën, ishte i krishterë dhe kishte dëgjuar se një grua me emrin Adela mbahej rob. Pasi la pasagjerët, u nis menjëherë për ta kërkuar.

«A je ti Adela?» – pyeti me qetësi Nahori pasi dikush e drejtoi tek ajo.

«Kush je ti?» – u përgjigj Adela me dyshim. Ajo me zor i nxori fjalët nga goja, kur Nahori e përqafoi fort dhe filloi të qante. «Kam dëgjuar për ty dhe për situatën tuaj këtu«, – tha ai.

«Çfarë? Nga më njeh ti?»

«Më ka thënë Metju.»

Adela s'mund t'u besonte veshëve. Metju ishte gjallë! Për herë të parë në më shumë se gjashtë muaj, ndjeu një burim gëzimi që e bëri të buzëqeshte. «Metju është gjallë?» – pyeti ajo, duke u siguruar që nuk e kishte dëgjuar gabimisht.

«Po, sigurisht që është gjallë. A dëshiron t'i shkruash një letër?» – pyeti Nahori.

Mendimi që mund t'i shkruante Metjus i kaloi shpejt nëpër mend. Sa do të dëshironte të lidhej me të! Por e dinte se kishte çështje më të rëndësishme. «Po, do të doja t'i shkruaja. Por kam diçka që duhet të bëj më parë. Shpejt, më jep një fletë dhe një stilolaps!»

Adela u ul dhe filloi të shkruante me nxitim emrat e të gjithë të burgosurve. Ishte ende duke punuar me listën kur pa komandantin që po afrohej. «Shpejt, merre këtë me vete, Nahor. Dhe të lutem ki kujdes!» Adela e përqafoi shpejt Nahorin dhe u largua, duke i ardhur keq që nuk kishte mundur t'i shkruante Metjus. Sa dëshironte t'i tregonte gjithçka.., sa shumë e donte.., se si Kristina kishte qenë aq e guximshme... Por nuk kishte kohë dhe duhej patjetër të hapte fjalë për të burgosurit e tjerë. Pa dyshim që familjet e tyre do të jenë të shqetësuara. Tani shpresonte që askush të mos e kishte parë duke biseduar me Nahorin.

«Çfarë po shkruan?» Komandanti u tërbua kur mësoi se Adela, jo vetëm që kishte folur me pronarin e varkës, por i kishte kaluar gjithashtu një copë letër. «Mos i dhe gjë letër?»

«Jo, nuk shkrova letër», – u përgjigj Adela.

«Çfarë shkrove?» Fjalët e tij dolën me tone të matura zemërimi ndërsa drejtoi thikën në fytin e Adelës.

E vendosur, Adela i tha: «Thjesht shkrova emrat e atyre që ju po i mbani këtu si të burgosur.»

«Çfarë bëre ti?!» Komandanti po tërbohej nga inati. Adela mendoi se me siguri do t'ia ngulte thikën në qafë, por për herë të parë, nuk kishte frikë. Kishte bërë çfarë duhej bërë dhe e dinte që Metju ishte gjallë. Ajo kishte qenë ditë e mirë. Një ditë që, madje edhe një komandant pa zemër s'mund ta prishte.

«Unë sapo sigurova oficerët e qeverisë se askush s'po mbahej këtu kundër dëshirës së tyre. Firmosa një marrëveshje. Tani ti u jep atyre një listë «të burgosurish»! Ti derr! Do të paguash për këtë.»

Komandanti e mbajti fjalën e vet. Melin dhe shumë gra të tjera i rrahën brutalisht atë pasdite.

Në më pak se dy muaj fshati i Salubit iu nënshtrua hetimit. Lista e Adelës kishte qarkulluar tek oficerët e policisë dhe midis familjarëve të të burgosurve, duke përfshirë edhe Metjun. Adelës i kishin ardhur fjalë se «Metju po vjen me zyrtarët e qeverisë për të të marrë ty dhe Kristinën.»

Adela ishte e ngazëllyer. Ajo dhe e bija i kishin mbijetuar një makthi që kishte qenë një ferr përtej imagjinatës, dhe tani po ktheheshin në shtëpi. Po ndjehej me e lehtësuar, madje e buzëqeshur. Por Kristina nuk dukej e bindur. «A po shkojmë vërtet në shtëpi?» – pyeti ajo me dyshim. «A do të ikim me babin? Po sikur të mos na lejojnë?»

Adela e dallonte ankthin në zërin e Kristinës dhe e dinte se pyetjet e saj ishin me vend. E përqafoi vajzën e saj të guximshme ndërsa mendonte se çfarë kurthi mund të përdornin rrëmbyesit për të ndaluar lirimin e tyre. E zbuluan të nesërmen.

«S'MUND TË VIJ ME TY»

Adela dhe Kristina u detyruan të qëndronin përpara të gjithë të burgosurve që ishin mbledhur. Komandanti, duke iu drejtuar të krishterëve tha: «Së shpejti do ta çojmë Kristinën dhe Adelën në Dahma për të takuar bashkëshortin e saj të krishterë.» Sipas gjithë parashikimeve, lajmi i ardhjes së Metjus tashmë ishte shpërndarë midis robërve. Ata e njihnin Adelën. Nëse lejohej të shkonte,

nuk do të pushonte asnjë çast derisa të gjithë të burgosurit të çliroheshin. Ajo do të ishte rruga e tyre drejt lirisë.

Më pas komandanti vazhdoi me një kërcënim tashmë të njohur: «Adela dhe Kristina do të pyeten nëse duan të qëndrojnë këtu me ju ose të largohen me Metjun. Nëse njëra prej tyre zgjedh të shkojë me Metjun, do t'ju vrasim të gjithëve.» Ndërsa komandanti largohej, u përkul para një vajze të vogël, jo më e madhe se pesë vjeç. Duke nxjerrë thikën prej këllëfit, ia vuri në fyt vajzës që dridhej dhe me keqdashje shtoi: «Madje do të të vrasim edhe ty».

Të krishterët vështruan Adelën. Si mund ta merrte ajo një vendim të tillë? Edhe ata vrisnin mendjen se çfarë do të bënin nëse do të kishin qenë në vendin e saj. Adela e dinte se askush s'do t'i vinte faj asaj apo Kristinës, nëse zgjidhnin të shkonin me Metjun. Por para se të mund të jepte ndonjë përgjigje, komandanti tha: «Shkojmë.»

Tani? Adela nuk e dinte se Metju po i priste. Çdo gjë po ndodhte shumë shpejt. Ajo kishte nevojë për kohë për të menduar, për t'u lutur dhe për të konsideruar nëse komandanti do t'i vriste vërtet ato apo thjesht ishte një blof. Si mund t'i kthente shpinën Metjus? Por a mund të bënte një zgjedhje, që nënkuptonte vdekjen e të burgosurve të tjerë?

Para se të merrte vesh ç'po ndodhte, e çuan në një dhomë ku Metju ishte ulur bashkë me oficerët ushtarakë. Ndërsa hynin, komandanti i pështpëriti Adelës në vesh: «Mos harro, nëse ndonjëra prej jush kthehet me të, do të vras çdo të burgosur. Jo vetëm ata, por do të vras edhe Metjun. Betohem se do ta vras edhe atë.» Fjalët e tij therëse i shkaktuan të rrënqethura, duke i hequr dyshimin se po mashtronte.

Adela mund të dallonte ankthin në sytë e Metjus. Sa dëshironte ai të kthehej bashkë me gruan dhe vajzën! Tre muajt e fundit mund t'i ishin dukur shekuj, por tani kishte shpresë. Ai ishte i vendosur dhe Adela e dinte se ai ishte i vendosur në zemër dhe nuk do të largohej nga dhoma pa to. Gjithçka që mund të bënte ishte të lutej për forcë.

Një oficer e prezantoi veten si zoti Said dhe pyeti pa hezitim: «Adela, a dëshiron të largohesh me Metjun apo të qëndrosh në

Salubi?» Adela e priste të tillë pyetje, e kishin udhëzuar fjalë për fjalë se si do të përgjigjej. Ajo u përpoq të fliste, por buzët e saj lëvizën pa nxjerrë zë. Zoti Said e përsëriti pyetjen me zë pak më të lartë. «Mel, a dëshiron të shkosh me Metjun apo të qëndrosh në Salubi?»

Adela pa Metjun, i cili pyeste veten pse po vononte ajo për t'u përgjigjur. «Metju...» Lotët i rrodhën faqeve ndërsa nxori me zor fjalët. «S'mund të vij me ty.»

Metju gati kërceu nga karrigia, duke dashur të dinte arsyen, por Saidi e mbajti, duke mos e lejuar të kthente përgjigje. Pa humbur kohë Saidi i bëri të njëjtën pyetje edhe Kristinës. Adela ishte ende duke qarë ndërsa shihte të bijën, duke mos e ditur se si do të përgjigjej ajo. Nuk kishte pasur kohë të merrej vesh me Kristinën dhe tani ishte e bindur se do t'i vrisnin të gjithë të burgosurit, edhe Metjun, nëse vajza binte dakord të shkonte me të. Por si mund ta kuptonte një vajzë nëntë vjeçare situatën e vështirë që do të pasonte nëse pohonte të bashkohej me t'atin?

«S'mund të vij me ty, babi. Më vjen keq...»,- ngashëreu Kristina, duke u përpjekur me dëshpërim t'i kërkonte falje babait dhe të shpjegonte situatën e vështirë.

Zoti Said ndërpreu me ashpërsi. «Mirë pra. Kemi mbaruar. Nuk do të kemi asnjë fjalë tjetër lidhur me këtë çështje. U kuptuam?»

Adelës dhe Kristinës iu lejuan pesë minuta me Metjun nën mbikëqyrje të rreptë dhe me udhëzimin që të mos pështërisnin asnjë fjalë. Duke shpërfillur urdhrat e tyre, Adela foli butësisht, duke u lutur që të mos dëgjohej. «Metju, më duhej të përgjigjesha në këtë mënyrë. Ata kërcënuan të vrisnin të tjerët nëse ne do të vinim me ty. Të lutem, mos më urre! Për aq kohë sa të jem gjallë, nuk do të heq kurrë dorë nga shpresa. E di, një ditë do të jemi të gjithë së bashku përsëri.»

Metju vështroi gruan e tij të bukur, duke parë dhembjen në sytë e saj, madje edhe duke admiruar kurajën e saj. Nuk kishte mbetur asgjë tjetër për të thënë. I hodhi një vështrim familjes së tij dhe thjesht u përgjigj. «E kuptoj.»

Të kapesh pas shpresës

Takimi mbaroi shumë shpejt, dhe Adela dhe Kristina u nxorën nga dhoma. Adela u kthye për të vështruar për herë të fundit Metjun, por komandanti e kapi dhe e goditi me grusht në brinjë. «Mos e shiko», – tha ai. «Ai është fëmijë i Jezusit. Është derr!» Duke qenë se shpresat iu shkatërruan, Adela dyshonte çfarë do t'i sillte e ardhmja. S'mund të bënte gjë veçse të qante.

Në javët në vazhdim, Adela mbahej shtrëngueshëm pas shpresës se një ditë mund të bashkohej me Metjun. Kjo e ndihmonte të lehtësonte dhembjen e pafund të burgosjes dhe i jepte diçka pas së cilës të kapej fort, edhe pse po i dukej si një ëndërr e largët.

Më vonë, më 10 Prill, ëndrra e saj u kthye në makth.

«Adela» – filloi komandanti, «E kam vendosur çfarë të bëj me ty. Më ke shkaktuar shumë shqetësime dhe është e qartë që je ngatërrestare. Kam vendosur që të lejoj njërin prej burrave të martohet me ty. Ndoshta ai do të jetë në gjendje të të kontrollojë.»

Meli s'mund ta besonte. «Unë s'mund të martohem me asnjë! Jam e martuar me Metjun!»

«Të thashë. Metju nuk është burrë. Ai është derr dhe nuk e njoh martesën e tij me ty. Nëse refuzon të martohesh me burrin që unë zgjedh për ty, do të të lë në duart e të gjithëve.» Komandanti nuk pranoi asnjë argument tjetër dhe Adela e kuptoi nga pamja e ngurtë se e kishte seriozisht. Nuk kishte rrugë shpëtimi.

Adela shkoi te gratë e tjera të burgosura dhe u kërkoi ta ndihmonin. E dinte se ato s'mund të bënin shumë, por shpresonte që të paktën të ishin me të për të protestuar për martesën e detyruar. Por të tjerat heshtën, duke pasur frikë për jetën e tyre. Më në fund njëra prej tyre i tha: «Nëse ti nuk martohesh me njërin prej tyre, mund të na dhunojnë e të na vrasin të gjithave.»

Adela u dëshpërua. Ishte përpjekur aq shumë për t'i përkrahur këto gra dhe tani ndihej e tradhtuar. Filloi të ngashërente: «Flou, si mund të më përdorni si një lloj rehatie dhe të më shisni për të shpëtuar veten?»

Të tjerat kërkuan falje ndërsa u mblodhën bashkërisht dhe qanë. Ato e dinin se nuk do të ishte hera e fundit që njëra prej tyre do të detyrohej të martohej.

Kur ajo dhe Kristina u detyruan të shkonin me Alminin, bashkëshortin e saj të ri, Adela besoi se situata s'mund të shkonte më keq. Por në fakt, u përkeqësua. Disa muaj më vonë, Adela mbeti shtatzënë.

NJË JETË E RE

Nga tetori gjendja emocionale e Adelës sa vinte e përkeqësohej. Ndihej sikur po rrëzohej në mënyrë të pakontrollueshme drejt një grope të pafundme. Këta përbindësha i kishin vrarë djalin, nënën dhe e kishin rrahur pa mëshirë aq herë sa nuk i vinte më ndër mend. Besonin tani se i kishin marrë edhe shpresën për t'u bashkuar me Metjun. Urrejtja që kishte filluar atë ditë të tmerrshme të kapjes së saj po rritej më shpejt se sa jeta brenda saj. Qante dhe kërkonte për shpresë, por nuk gjente. As që mund ta donte foshnjën në barkun e saj. Për Adelën ajo ishte vetëm një kujtim i asaj që i ishte marrë.

«Nuk do t'i lejoj të m'i marrin më», – vendosi ajo.

Priti derisa mbeti vetëm. Pastaj mori thikën nga banaku i kuzhinës. S'mund ta besonte që gjërat kishin shkuar kaq larg. Pyeste veten pse i ishte kursyer jeta vetëm për të përjetuar një dëshpërim të tillë. E dinte se Zoti e kishte shpëtuar, por nuk e ndiente më se mund të jetonte. Duke vendosur me ngadalë thikën në bark, mbylli sytë dhe iu lut Zotit që të mund ta falte.

«Mami, ndalo!»- thirri Kristina ndërsa erdhi duke vrapuar në dhomë dhe ia rrëmbeu thikën nga dora. Adela shpërtheu në lot dhe u përplas në dysheme. Kristina po qante bashkë me nënën e saj. «Mami, çfarë po bën? S'mund t'ia bësh vetes këtë. Dhe kjo foshnjë s'ka bërë asgjë të keqe. Është e pafajshme.»

Adela u thye. Qante për orë të tëra ndërsa fjalët e Kristinës i jehonin në zemër e shpirt. Iu lut Zotit ta falte ndërsa rrëfeu urrejtjen për ata që i mbanin peng. Filloi ta kuptonte se si zemërimi i saj pothuajse kishte shkatërruar një jetë të pafajshme, ashtu si kishin bërë luftëtarët e xhihadit me të. Ishte një e vërtetë që të

sillte në vete dhe megjithëse nuk ndiente falje të menjëhershme për ata që e kishin lënduar, e dinte se duhej të lejonte hirin e Zotit të punonte. Urrejtja kishte bllokuar fuqinë shëruese të Zotit, të dashurisë që filloi ta përjetonte përsëri.

Adela filloi ta përkëdhelte barkun e saj duke i folur jetës së re brenda vetes. Duke besuar se ishte vajzë, e quajti foshnjën Sara. «Sara, të lutem më fal! Të lutem fali mëkatet e nënës tënde! Ti s'ke bërë asgjë të keqe. Ti je e mira që mund të vijë nga një situatë kaq e keqe. Të dua.»

Një re e zezë sikur u ngrit ndërsa vazhdonte të lutej e të fliste me Sarën. Më parë e konsideronte foshnjën e palindur si një armik tjetër, fëmija e vrasësit të djalit të saj. Tani e kuptonte se ishte foshnja e saj dhe krijesë e Zotit. U krijua një lidhje e menjëhershme ndërsa i përqafoi të dyja vajzat e saj.

Të nesërmen, Meli mori një copë letër, duke menduar se duhej të komunikonte me Metjun. I duhej t'i thoshte se çfarë kishte ndodhur dhe t'i kërkonte falje. Edhe nëse ai nuk do ta konsideronte më si gruan e tij, e kuptonte dhe nuk do mbante mëri ndaj tij. Ajo e donte dhe dëshironte me gjithë zemër ribashkimin e tyre. Ndërsa shkruante, lotët kulluan mbi letër, duke u përzier me bojën e shkrimit. Dyshonte nëse ai do të mund të lexonte midis rreshtave. Kur mbaroi, pa se kishte shkruar gjashtë faqe. Për Melin, ishte letra e dashurisë më e dhimbshme dhe më e rëndësishme që kishte shkruar ndonjëherë. E palosi me kujdes dhe e fshehu, duke u lutur për ndonjë mundësi për t'ia çuar Metjus.

Më 24 Dhjetor, të gjithë të burgosurit u detyruan të punonin në plantacionin e arrave të kokosit. Ishte punë e vështirë, veçanërisht për Adelën, që tani ishte gjashtë muajshe shtatzënë. Të burgosurit e dinin se ishte dita para Krishtlindjes ndërsa sillnin ndër mend kujtimet e një viti më parë të kësaj kohe. Atë mbrëmje kur Adela nisi të këndonte butësisht melodinë e «Natë e Shenjtë», të tjerët iu bashkuan. Shumë shpejt të gjithë filluan të këndonin vargjet ndërsa rojat fytyrëngurtë dëgjonin me dyshim. Secili e dinte rrezikun e këndimit të këngëve tradicionale të Krishtlindjes. Ndoshta do të rriheshin, por e konsideruan rrezikun. Gëzimi i të kënduarit s'krahasohej me dënimin.

Vonë në mbrëmje këndduan dhe kujtuan familjet e tyre. Trupat e tyre mbetën të burgosur, por shpirtrat u çliruan ndërsa vazhduan të këndonin drejt qiellit. Të nesërmen në mëngjes kishin lot trishtimi dhe gëzimi, vajtonin për burgosjen e tyre, por prisnin me padurim kohëra më të lumtura. Kurrë nuk do ta harronin Krishtlindjen që kaluan së bashku në fushë.

Më 18 mars lindi Sara.

Tani që foshnja kishte lindur, Kristina e ndjeu se kishte ardhur koha për t'i thënë t'ëmës: «Duhet të përpiqesh të arratisesh, së bashku me Sarën. Duhet të largoheni. Nëse nuk largohesh, do të vdesim të gjithë këtu.»

«S'mund të të lë, Kristina. Nuk do të të lë kurrë», – e siguroi Adela të bijën.

«Mami, më dëgjo! Duhet të më lësh», – iu lut vajza dhjetëvjeçare këmbëngulëse në mendimin e vet. «Almini nuk do të na lërë kurrë të largohemi së bashku. Por nëse ti dhe Sara largoheni, ai do të mendojë se me siguri do të kthehesh, gjë që ti s'ke për ta bërë. Duhet të arrish te babi. Ai do të kthehet për mua. Është shpresa jonë e vetme.»

Adela e ndjente që e bija kishte të drejtë, por nuk mund ta kuptonte si mund të mendonte ajo ashtu. Nuk ishte e sigurt nëse Metju mund ta pranonte, tanimë që ishte edhe Sara. Adela nuk guxonte të planifikonte arratisjen e bllokuar ne dyshime.

Dhe ja, në prill vjen përgjigjja. Meli kishte më shumë se gjashtë muaj që e mbante letrën me vete, duke shpresuar dhe duke u lutur për një mundësi dërgimi. Një pasdite, ndërsa disa fëmijë erdhën në fshatin e tyre, erdhi mundësia. Adela e njihte njërin prej fëmijëve dhe qetësisht u drejtua për te vendi ku po luanin. Ia kaloi me të shpejtë letrën fëmijës që njihte dhe i kërkoi që t'ia dërgonte bashkëshortit të saj, Metjus. Fëmija mori letrën dhe tundi kokën në shenjë miratimi.

Adela u kthye në shtëpi, duke u lutur që letra do t'i shkonte Metjus, duke u lutur që ai do ta falte... që ai vazhdonte ta donte. Çdo ditë Adela zbriste në fshat duke pritur me ankth që fëmija të shfaqej dikur. Disa ditë më vonë pritja mori fund.

«A e takove Metjun? A ia dhe letrën? – pyeti ajo fëmijën, së cilës i kishte dhënë letrën.

«Po, ia dhashë dhe ai më dha këtë.»

Adela u habit kur vajza i dha letrën. Metju i kishte shkruar përpara se të kishte marrë letrën e saj. Dhe mund ta kuptonte nga zarfi i zverdhur dhe cepat e çngjyrosur që e kishte mbajtur për ca kohë, po ashtu siç e kishte mbajtur ajo letrën, që i kishte shkruar atij.

Mendoi ta lexonte menjëherë, por ndryshoi mendje. Po sikur Metju ta urrente? Po sikur të ishte martuar me një grua tjetër? Emocionet e Adelës ishin të papërmbajtura ndërsa u kthye me nxitim në shtëpi dhe hapi letrën. Sa s'i pushoi zemra kur lexoi fjalët.

«Adela, ti mund të kesh edhe dhjetë fëmijë me dhjetë burra dhe përsëri do të jesh gruaja ime. A nuk e mban mend se çfarë të tha pastori? Vetëm Zoti mund të na ndajë tani. Të dua! Metju.»

Adela e mori përgjigjen. Do të planifikonte arratisjen.

ARRATISJA DHE SHPËTIMI

Pothuajse dy muaj më vonë, më 18 qershor, Almini i dha leje Melit të vizitonte disa të afërm në një ishull aty afër. Duke shtrënguar fort dorën e Sarës, Adela kapi Kristinën ndërsa u bë gati të hynte në bordin e tragetit të vogël. Por Almini e tërhoqi mbrapsht Kristinën. «Ajo do të qëndrojë këtu.»

Adela iu lut Alminit që ta lejonte Kristinën të shkonte, por ai refuzoi. «Nuk do të iki pa Kristinën» – këmbënguli ajo. Por Almini nuk hiqte dorë nga e tija. Ai e dinte që «gruaja» e tij do të arratisej nëse Kristina shkonte me të.

Ndodhi pikërisht siç e kishte planifikuar Kristina. E përqafoi të ëmën dhe i pëshpëriti në vesh: «Të lutem, mami. Më premto që ti dhe Sara do të shkoni te babi. Të lutem, më dëgjo! Do të jem mirë». Adela e shtrëngoi fort Kristinën duke vrarë mendjen se si mund ta linte vetëm. Por lutja e Kristinës i preku zemrën. Si mund të ishte vajza e saj kaq e guximshme? E puthi dhe e përshëndeti. Nuk e kishte idenë sa kohë do të kalonte kur ta shihte përsëri. Ndoshta nuk do ta shihte më kurrë.

Adela qëndroi në direkun e anijes duke parë Kristinën të venitej në distancë. E përqafoi Sarën dhe filloi të qante edhe një herë duke

pyetur veten nëse po merrte vendimin e duhur. Ajo as që kishte ndër mend t'u bënte vizitë kushërinjve të largët. Do të shkonte drejt e te Metju para se Almini ta kuptonte që ishte arratisur. Pastaj, duhej të gjenin mënyrën për të marrë Kristinën.

Adelës iu deshën dy javë për të mbërritur te vendi ku ndodhej Metju. Udhëtimi kishte qenë i gjatë dhe i vështirë dhe ajo e kishte shmangur kontaktin me Metjun deri në këtë pikë, duke pasur frikë se Almini do ta zbulonte qëllimin e saj. U ul në shtrat duke mbajtur qetësisht Sarën në fund të dhomës së miqve e duke pritur me ankth. *A do të më dojë Metju? –pyeste ajo veten. Po Sarën?*

Edhe pse tani ishte e lirë, ndihej ende e burgosur. Më keq akoma, ndihej si tradhtare. Ishte martuar me një burrë tjetër dhe e kishte lënë vajzën e saj, Kristinën, pas. Si mund ta falte Metju? Vinte në dyshim herë pas here vendimet e saj dhe qau derisa e zuri gjumi.

Adela u zgjua menjëherë nga zhurma që bëri Metju kur hyri në shtëpi. Qëndroi në shtrat duke u dridhur; pastaj mori Sarën që ishte ende në gjumë dhe u ngrit. Papritur, e bindur se kishte bërë një gabim të tmerrshëm, bëri të largohej nga shtëpia. Nuk mendoi se ku mund të shkonte; thjesht do vraponte. S'mund të përballej me Metjun.

Por, para se të mund të arrinte te dera, Metju hyri. Pa ngurruar aspak, ai vrapoi drejt saj dhe e përqafoi me gëzim. Pastaj vështroi foshnjën që Adela mbante në krahë dhe buzëqeshi. «Kështu pra, kjo është vajza jonë e re», – tha ai. Adela qau, me lot të lumtur tani, duke iu gëzuar ribashkimit të shumëpritur. Donte të qëndronte gjithmonë e përqafuar me Metjun për të ndier sigurinë e krahëve të tij të fortë rreth saj. Por e dinte që Metjus i duhej të largohej. E dinte që ai s'do të gjente prehje derisa të shpëtonte Kristinën.

Adela priti ditë pas dite duke mos dëgjuar asnjë lajm prej Metjus apo Kristinës. Po sikur ta kenë vrarë tashmë Kristinën? *Po sikur Metju të ketë vdekur? A nuk është i gjithë faji im?* Ajo u përpoq të luftonte me pyetjet që i shkonin pa pushim ndër mend duke i thirrur Zotit për siguri.

Gjeti ngushëllim në pasazhet e njohura të Shkrimit, që i kishin munguar kaq shumë gjatë tetëmbëdhjetë muajve të burgosjes.

I kujtohej se si ushtarët e xhihadit ia kishin bërë Biblën copë e çikë, atje në xhungël. Meli u kthye përsëri te Filipianëve 4:13 dhe sipas zakonit të saj nisi të lexonte me zë të lartë: «Mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon.» I kujtohej hera e fundit kur i kishte lexuar këto fjalë. Ishte në kodër mbrapa fshatit të saj pikërisht në ditën e sulmit. Një jetë e tërë kishte kaluar që nga ajo kohë. Kishte shkuar deri në ferr e ishte kthyer. E dinte që makthi i saj s'kishte mbaruar ende, s'mund të mos mendonte për Kristinën, ndërsa hamendësonte se kishte qenë ajo që e kishte tradhtuar të bijën.

Ishin bërë tashmë dy javë që kur Metju ishte larguar, kur Adela mori vesh se atë e bijë ishin bashkë të dy dhe duhej të shkonte te ata pa humbur asnjë grimë kohë. Më në fund do të bashkoheshin përsëri si familje. Lot gëzimi i rrodhën faqeve ndërsa falënderonte Zotin që Metju kishte mundur ta shpëtonte Kristinën. Në vazhdim ajo vriste mendjen.., çfarë do të mund të bënte Almini për t'i romarrë ato të dyja?

EPILOG

Kur intervistuam Adelën, ajo dhe Metju po studionin në një shkollë të fshehtë Bible për t'u bërë ungjilltarë. Megjithëse kishin kaluar disa muaj që nga arratisja, Adela dhe familja e saj vazhdonin të ishin në lëvizje për të mos u gjetur nga Almini, i cili me ndihmën e shumë myslimanëve vazhdonte t'i ndiqte. Në më tepër se dy raste, Adela pothuajse u kap.

Asaj i duhej të merrej me dy çështje të rëndësishme kur u lirua. Së pari, ishte diçka që në fillim mendonte se s'do ta bënte kurrë. Si e krishterë, ajo e dinte se duhej t'i falte ushtarët e xhihadit. Procesi i vështirë kishte filluar tashmë me shtatzëninë e saj, kur Kristina e kujtoi se foshnja që po rritej brenda saj nuk kishte bërë asgjë të keqe, se Sara ishte e pafajshme. Adela e dinte se mund t'i thoshte fjalët «Unë i fal», por duhej t'i thoshte me gjithë zemër, prej vendit nga vjen vërtet falja. Në muajt pas arratisjes së saj, kaloi shumë kohë në lutje. Lutej për shpëtimin e atyre që e kishin lënduar atë dhe familjen e saj. Besonte se kjo lutje ishte kyçi për të qenë në gjendje t'i falte me zemër.

Çështja e dytë ishte po aq sfiduese. Adela duhej të falte veten. Për shkak të martesës së detyruar me Alminin, e mendonte veten si tradhtare. Fatkeqësisht, të krishterët e tjerë e konfirmonin këtë vet-akuzë, gjë që ia pllakoste vazhdimisht shpirtin, duke i sjellë shumë ankth, veçanërisht gjatë arratisjes. Kishte raste kur besonte se Metju dhe të krishterë të tjerë do ta «largonin» për shkak të martesës së detyruar. Kjo torturë e brendshme ishte më e vështirë për t'u përballuar se sa abuzimi fizik që kishte kaluar.

Kur Adela u lirua, u përkujdes nga një çift misionarësh të krishterë, që ishin miq të Metjus dhe kishin punuar si brenda vendit, ashtu edhe jashtë për të ndihmuar në çështjen e saj. Kur Adela takoi bashkëshortin e saj, Zoti e nxiti në zemër dhe fjalët e para që dolën prej gojës së tij ishin: «Adela, ti nuk je tradhtare.»

Me të dëgjuar këto fjalë, ajo shpërtheu në lot dhe prej asaj dite nisi ta falte veten.

Adela dhe Metju kanë vazhduar të punojnë për të siguruar lirimin e atyre, që ishin të burgosur bashkë me të. I rëndon ende në shpirt që disa prej personave të përmendur në këto faqe janë akoma të burgosur edhe sot.

Ajo kërkon lutjet tona!

Purnima:

Fëmijë i Burgosur, Shpirt i Çliruar

Butan
1 Mars 1993

Ishte veçanërisht ftohtë dhe vonë në mbrëmje, kur policia mblodhi edhe një herë grupin e besimtarëve dhe i flaku në zyrën e administratorit të zonës.

Vajza 13-vjeçare dridhej ndërsa bashkë me të tjerët u detyrua të qëndronte jashtë në oborrin e hapur, ndërkohë që marrja në pyetje vazhdonte pa reshtur. Oficerët i bombardonin me të njëjtat pyetje: «Pse doni të jeni të krishterë?» «Nga ju vjen ndihma?» «Ky është një vend budist, dhe ju na keni çnderuar duke pranuar këtë fe të huaj. Pse doni t'i ktheni njerëzit tuaj kundër jush?»

Një për një, të tridhjetë e pesë besimtarët u morën në pyetje gjatë gjithë natës së gjatë e të ftohtë. Kishte rreth njëzetë oficerë, shumica prej tyre trupmëdhenj dhe që të fusnin frikën. Purnima u mblodh kruspull ndërsa njëri prej tyre goditi me shuplakë një vëlla të krishterë afër saj. Disa prej grupit qanin; të tjerët përpiqeshin të ndanin ungjillin. Purnima e vogël qëndronte para burrave shtatlartë, duke u lutur që të kishte mjaft kurajë për t'u bërë ballë pyetjeve, që do t'i drejtoheshin.

«Kush ju dha leje për të festuar Krishtlindjen në fshatin e Purtahut? Ky është Butani. Nuk lejohet të festoni Krishtlindjen në Butan! Kjo është zgjedhja juaj e fundit: 'Ose bëhuni budistë ose largohuni prej Butanit!'» Oficeri po i fliste direkt Purnimës tani, dhe ajo e ndjeu ndikimin e ultimatumit të tij. «E merr vesh? Nuk lejohet të qëndrosh këtu dhe të praktikosh këtë fe të huaj. Ç'do të bëhet?»

Purnima nuk e dyshoi as edhe për një çast që oficeri e kishte seriozisht. Ishte çështje nderi që pasonte me detyrimin, ose të

krishterët të mohonin besimin, ose t'i denonconin publikisht si tradhtarë dhe t'i shtynin të linin vendin. Ajo ishte dëbuar prej shtëpisë dhe fshatit të vet. Nuk e kishte idenë ku të shkonte, por e dinte ç'duhej të bënte.

«Nuk do ta mohoj Krishtin! Nuk dua të lë vendin tim dhe nuk do të lë Krishtin. Ai është i vetmi që mund të më shpëtojë mua apo ty.» Purnima e ndjente trupin t'i dridhej ndërsa i foli me zë sfidues oficerit fytyrëkuq, por zemrën e kishte të patundur duke e ditur se fati i saj ishte vulosur. Asaj dhe të tjerëve iu lanë zyrtarisht pesë ditë për t'u larguar nga Butani. U thanë të shkonin në Nepal.

Pesë ditë.

Purnimës i kishte mbetur më pak se një javë prej jetës, që kishte njohur gjithmonë. Fjalët e kërcënimit të oficerit ishin shpërndarë shpejt në zonë dhe motra e kunati i saj tashmë ishin larguar, duke pasur frikë për jetën. Tani që të krishterët ishin quajtur zyrtarisht tradhtarë, disa prej fshatarëve më të devotshëm, e morën këtë si leje për t'i sulmuar.

Përpara se Purnima të largohej duhej të bënte edhe një gjë të fundit: të takonte nënën e saj. Kishte kaluar pak më tepër se një vit që kur prindërit e kishin dëbuar nga shtëpia. Tani ishte duke u kthyer fshehurazi, e sigurt se ata kishin dëgjuar tashmë për largimin e saj të menjëhershëm e duke u lutur qetësisht që prindërit do të donin ta shihnin vajzën e tyre të vogël edhe një herë të fundit. Purnima u kthye natën në shtëpinë ku ishte rritur, por që ishte detyruar ta braktiste në moshën 12-vjeçare...

SHËRIM I MREKULLUESHËM

Purnima ishte rritur në një fshat të vogël budist në kodrat e gjelbra të Butanit Lindor. I ati ishte mjeku magjistar i zonës dhe shpesh drejtonte rituale dhe bënte sakrifica kafshësh për të dëbuar shpirtrat e ligj, që kërcënonin të dëmtonin komunitetin e tyre. Familja e tyre prej tetë vetash s'ishte as e varfër, as e pasur duke marrë parasysh standardin e zonës. Kishin një shtëpi të madhe dhe marrëdhënie të ngushtë me njëri-tjetrin. Sivali, që ishte martuar me motrën e madhe të Purnimës, Majan, jetonte me ta. Purnima do ishte rritur si të gjithë fëmijët e tjerë të

fshatit, nëse Maja e sëmurë nuk do ishte shëruar në mënyrë të mrekullueshme.

Për tre vjet Purnima kishte parë se si i ati sakrifikonte shpesh pula në altarin e tij, duke i rënë daulles së bërë vetë dhe duke u thirrur shpirtrave për të shëruar vajzën e tij. Më pas, Purnima ulej pranë shtratit të Majës duke pritur që të shërohej, por ajo nuk përmirësohej. Kishte ditë të mira dhe ditë të këqija, por dhembja e pareshtur në stomak dhe dhembjet e tmerrshme të kokës e mbanin në shtrat, ndonjëherë edhe për ditë me radhë. Duke parë të motrën të vuante, Purnima e pyeste shpesh mamanë: «Pse janë kaq të zemëruar shpirtrat? Pse s'po funksionojnë sakrificat?» Por nuk merrte asnjëherë përgjigje.

Tani pas vitesh të dhimbshme nga kjo sëmundje, Maja ishte ngritur. S'kishte më dhembje.., as buçitje në kokë. Nëna dhe babai i Purnimës ishin të gëzuar që vajza e tyre po ndihej kaq mirë, por nuk ishin të kënaqur për deklaratën e re të Majas sipas së cilës ishte Jezusi ai që e shëroi.

«Si mund të thuash gjëra të tilla? Si mund t'i sjellësh një çnderim të tillë shtëpisë dhe komunitetit?» – thirri i ati. «Ne jemi budistë dhe nuk do të dëgjoj asnjë fjalë tjetër për këtë perëndi të huaj. A kupton? Asnjë fjalë tjetër!» Ai ishte tërbuar nga inati. Për më tepër, kishte frikë se çfarë do të mendonin bashkëfshatarët nëse e merrnin vesh. Në fakt, kishte frikë për jetën e vet.

Por Maja dhe Sivali s'mund ta mohonin besimin e tyre të sapogjetur. Kur njëri prej shokëve të Sivalit mori vesh për sëmundjen e Majas, tregoi se ishte i krishterë i fshehtë dhe i dha një Bibël. I tha se besonte që Jezusi mund ta shëronte Majan. Dhe Ai e shëroi. Pas kësaj, besimi i tyre u rrit shpejt ndërsa e lexonin Biblën së bashku.

«Nëse këmbëngulni për krishterimin, s'mund të qëndroni më gjatë këtu», – i tha babai i Purnimës, Sivalit dhe Majas atë mbrëmje të fundit. «Fshati s'do ta lejojë kurrë. Do të na dëbojnë edhe ne, dhe feja juaj e re do të sjellë fatkeqësi mbi të gjithë familjen.»

Purnimës iu thye zemra kur pa motrën dhe kunatin të dëboheshin nga shtëpia. Megjithatë, edhe pse në moshë të vogël,

gjashtë vjeçare, e kuptonte shumë mirë se çka po thoshte babai ishte e vërtetë. E dinte se fshati nuk do ta pranonte kurrë këtë fe të re, por përsëri s'mund të mos mahnitej në fshehtësi për shëndetin e rikthyer të Majas dhe pamjen e re që i shkëlqente në të gjithë fytyrën, madje edhe ndërsa Maja po mblidhte ato pak gjëra për të lënë të vetmen shtëpi që kishte njohur ndonjëherë. Dhembjes i shtohej edhe fakti që Maja ishte gjashtë muajshe shtatzënë.

Pasi ata u larguan, në shtëpi dukej sikur kishte ndodhur ndonjë vdekje. Nëna e Purnimës ishte e dëshpëruar dhe i ati i çorientuar. Purnima donte të fliste me nënën e saj për Majan, por asnjë nuk lejohej t'i përmendte emrin. Nuk u lejohej t'i bënin vizitë çiftit në vendin e ri të mërgimit; një shtëpi e vogël bambuje disa milje larg fshatit fqinj.

Kur Purnima dëgjoi se Maja kishte lindur djalë, s'mundi të duronte më. Ajo mahnitej me faktin se motra e saj kishte lindur një djalë të shëndetshëm, nuk ishte në gjendje të shuante kuriozitetin për shërimin e saj të mrekullueshëm. Imagjinonte kujt i ngjante foshnja.

Pyetje të fuqishme i pushtonin mendjen pa pushim: «*Çfarë lloj Perëndie do të shëronte pa të kërkuar asgjë si shpërblim? Çfarë gjetën Maja dhe Sivali në këtë fe që u dha kurajë t'u dilnin kundër familjes dhe shoqërisë, madje deri në pikën e dëbimit prej shtëpisë?*

Këto pyetje bënë që Purnima të gjente guxim e të shkonte fshehurazi në shtëpinë e motrës së saj për ta vizituar. Ndërsa u binte mes përmes fushave duke u fshehur nga prania e pemëve të dendura, e bëri rrugë këtë distancë që prej javësh e kishte ndarë nga e motra. Kur Maja hapi derën e shtëpisë së saj të vogël dhe gjeti Purnimën që dridhej në prag, habia iu shkri në një rrëke lotësh dhe përqafimesh ndërsa e mbështolli në krahët e saj.

Purnima filloi ta vizitonte rregullisht fshehurazi Majan. Asnjëherë s'mund të qëndronte gjatë, ndonjëherë largohej pas vetëm pesëmbëdhjetë minutash. Por sa herë që vinte, Maja i lexonte një histori nga Bibla dhe ajo dëgjonte me vëmendje duke përpirë çdo detaj. Magjepsej më tepër nga historia e Moisiut. Jo aq shumë nga gjërat e mrekullueshme që Perëndia bëri përmes tij, se sa nga fakti që ishte detyruar të linte shtëpinë duke u bërë

zëdhënësi i Perëndisë, edhe pse kishte vështirësi në të folur. Nëse do të ishte e krishterë do të donte të ishte si Moisiu.

Një vit më pas Maja lindi një fëmijë tjetër, Esterin, dhe vizitat e Purnimës u bënë edhe më të shpeshta. Për Purnimën e vogël ishte bërë si aventurë arratisja fshehurazi në rrugicat e fshatit për të vizituar motrën, nipin dhe mbesën. Edhe nëse kapej, – mendonte ajo, – nuk do të futej në telashe. Për më tepër që ishte vetëm një fëmijë.

Por nëna e Purnimës nuk e mendonte ashtu. «Purnima, ne të dyja e dimë se çfarë po bën», – i tha një ditë ajo. «E kam humbur tashmë një vajzë, nuk dua të humbas edhe një tjetër. E kupton?» Purnima tundte kokën në shenjë miratimi ndërsa e ëma i shpjegonte se krishterimi ishte një fe e huaj dhe për një klasë të ulët njerëzish. «Nuk është për fshatin apo për vendin tonë. Maja është mashtruar nga Sivali dhe miku i tij», – përfundoi e ëma.

E TËRHEQUR NË MËNYRË TË PASHPJEGUESHME DREJT ZOTIT

Por Purnimës i pëlqente koha që kalonte me motrën dhe vizitat e fshehta vazhdonin. Ditën e Krishtlindjes, Maja dhe Sivali i lejuan Purnimës të bashkohej me ta në një bashkësi të vogël të formuar gjatë tetëmbëdhjetë muajve të fundit. Vizitat e saj të shumta tek e motra, kishin mbjellë fara të qëndrueshme besimi në zemrën e Purnimës dhe ndërsa dëgjoi predikimin për lindjen e Krishtit, se si lindi nga një virgjëreshë dhe erdhi për të sjellë shpëtim, u ndie e tërhequr në mënyrë të pashpjegueshme drejt Zotit.

Për ditë me radhë nuk i tregoi askujt për vendimin e saj të pranimit të Krishtit derisa shkoi fshehurazi për një vizitë tjetër te Maja dhe i tha se donte të pagëzohej. Maja u gëzua jashtë mase për vendimin e motrës së saj, por përbrenda shqetësohej se si do t'ua tregonte lajmin prindërve. Rreth tre javë më vonë, në një mëngjes të shkëlqyer të diele, Purnima u pagëzua. Doli nga uji me një bindje. «Maja, e di se çfarë duhet të bëj tani. Duhet t'i them lajmin mamit dhe babit. S'mund t'ua fsheh më gjatë. Dua që të gjithë ta dinë se tani jetoj për Krishtin dhe nuk dua t'ia di se çfarë do të më thonë apo bëjnë!»

«Por Purnima, ti je shumë e vogël; je vetëm dymbëdhjetë vjeç dhe e di se çfarë do të bëjnë ata. Je gati për të gjitha këto? Unë kisha Sivalin, ndaj e pata më të lehtë të largohesha nga shtëpia. Ndoshta duhet të presësh për t'ua dhënë lajmin dhe vazhdo e lutu.»

Purnima nuk lëkundej. «S'mund ta bëj këtë, Maja. Tani i kuptoj të gjitha gjërat që kam dëgjuar, të gjitha gjërat që më ke treguar nga Bibla. Nuk jam ndier asnjëherë kështu më parë, dhe e di që është e vërtetë, ashtu si the ti. Si do të mund të jem në gjendje t'i fsheh brenda meje dhe të mos ia them mamit dhe babit? Përveç kësaj, të kam ty.»

Zemra e Majas u mbush plot kur e dëgjoi dhe e përqafoi të motrën. «Sigurisht që do të më kesh gjithmonë mua. Do që të vij me ty?»

«Jo,» – u përgjigj Purnima. «Është tepër e rrezikshme që të vish afër fshatit. Mos u shqetëso! Do të shkojë mirë.»

Maja e ndoqi me sy, e trazuar nga emocionet, ndërsa motra e saj e vogël nxitonte për në shtëpi. S'mund ta besonte vendosmërinë e vogëlushes, dhe megjithëse kishte frikë nga reagimi i prindërve, ndihej shumë krenare për guximin e Purnimës. *Ndoshta Zoti ka plane të veçanta për të,* mendonte ajo.

Me pafajësinë e një dymbëdhjetë vjeçareje, Purnima hyri në shtëpi dhe shpalli lajmin. «Mami, jam e krishterë.» Nëna e saj ngriu kur dëgjoi fjalët. «Sigurisht që po bën shaka», – tha ajo e shqetësuar. «Je shumë e vogël për të qenë e krishterë. Dhe përveç kësaj, të thashë që s'dua të humbas edhe një vajzë tjetër.»

Por Purnima konfirmoi vendimin e saj me vendosmëri. «Mami, nuk dua të largohem ashtu si Maja. Dua të qëndroj. Por kam vendosur të bëhem e krishterë dhe asgjë s'mund të ma ndryshojë mendjen.»

Ajo u detyrua të largohej po atë mbrëmje. Ndërsa u nis drejt rrugicës tashmë të njohur të shtëpisë së Majas me ato pak gjëra të sajat, mund të dëgjonte pas nënën e saj që qante. E dinte që nëna i donte të dyja vajzat, por prindërit kishin frikë nga ajo që mund t'u bënte fshati. Më parë edhe Purnima kishte frikë. Por ndërsa ecte në errësirë, vendosi të mos trembej.

Që nga ajo kohë kishte jetuar me Majan dhe Sivalin, dhe ndërsa kënaqej që ishte me familjen e motrës, kushtet ishin të mjerueshme dhe të gjithë luftonin për mbijetesë. Pastaj arrestimet filluan ditën e Krishtlindjes në vitin 1992, pikërisht një vit pas kthimit të Purnimës në të krishterë.

Policisë së fshatit i kishte hyrë frika nga numri në rritje i të krishterëve në zonë dhe kishin filluar të ushtronin presion ndaj besimtarëve. Të krishterët kishin duruar dhjetë herë marrjesh në pyetje në javë dhe çdo herë autoritetet përpiqeshin t'i bindnin të mohonin Krishtin dhe të ktheheshin në rrënjët e tyre budiste. Burrat rriheshin; disa prej tyre mbaheshin për një javë në një qendër të madhe burgimi ku rriheshin më keq. Gratë e kapura poshtëroheshin dhe akuzoheshin për prostitucion. Si pasojë, disa pjesëtarë të grupit të saj kishin pranuar të mohonin Krishtin, por Purnima e vogël këmbënguli edhe më shumë.

Tani për të, motrën e saj të madhe, kunatin dhe miqtë nga fshati fqinj udhëzimi më i fundit i autoriteteve ishte i thjeshtë, por i dhimbshëm: «Braktisni Butanin!»

«SI MUND TË JESH KAQ E GUXIMSHME?»

Duke çarë përmes fushave, Purnima pa dritat që ndriçonin përmes dritareve të shtëpisë së prindërve, që kishte qenë edhe shtëpia e saj. Po vriste mendjen se çfarë do t'i thoshte nënës dhe nëse ajo do ta lejonte të hynte. Ato nuk kishin folur dhe as ishin parë që atë natë që Purnima ishte dëbuar. Tani, e detyruar të linte Butanin, pyeste veten nëse do ta shihte përsëri nënën e saj.

Iu afrua me qetësi derës kryesore dhe vendosi të hynte. «Mami? Mami, jam unë.»

«Purnima!» – e ëma e shtrëngoi fort. «Të lutem, më thuaj që ke ardhur për të qëndruar! Të lutem, më thuaj që nuk je më e krishterë.» Purnima nuk foli për disa minuta. Mund të shihte se sa e trishtuar ishte e ëma; lotët po i rridhnin faqeve. Nuk donte t'i shkaktonte më tepër mjerim, por duhej t'i tregonte. «Mami, më duhet të largohem nga Butani. Policia nuk më lejon të jetoj më këtu. Më vjen keq!»

E ëma vështroi vajzën e saj të vogël dhe ia kishte zili guximin.

Por ishte ende aq e vogël dhe e pafajshme. «Purnima, ti nuk je as katërmbëdhjetë vjeç. Si mund të jesh kaq e guximshme? Si mund ta braktisësh vendin tënd?»

Tani Purnima po qante bashkë me nënën e saj. «Unë nuk po e braktis vendin, mami», – ngashëreu ajo. «Vendi im më ka braktisur mua.» Ajo e dinte se sa shumë e donte e ëma dhe e dinte se ajo kurrë nuk do ta detyronte të largohej nga shtëpia. Por të gjithë kishin shumë frikë. Frikë prej të krishterëve, frikë nga Krishtlindja, frikë nga Krishti. Purnima vriste mendjen se çfarë kishte kaq të frikshme te të gjitha këto gjëra.

«Ja, merri këto!» Babai i Purnimës i dha një shumë të vogël parash. «Dhe të lutem bëj kujdes.» Vështroi sytë e përlotur të vajzës, e përqafoi shpejt dhe doli nga dhoma.

Purnima mbeti me t'ëmën për disa minuta të tjera, duke u përpjekur të nguliste çdo tipar të fytyrës së saj të dashur, tonin e zërit, mënyrën se si i shkëlqenin sytë kur buzëqeshte. Nëna e saj ishte shumë e bukur dhe ajo nuk e dinte kur apo nëse do ta shikonte përsëri. Një përqafim i fundit dhe Purnima u zhduk përmes fushave për herë të fundit.

Të nesërmen në mëngjes iu bashkua tetë të krishterëve të tjerë nga bashkësia e saj, të cilët u dëbuan nga Butani. Qeveria kishte siguruar një autobus për t'i çuar nga fshati i tyre drejt kufirit të Indisë. Që prej atij vendi, do të ishin vetëm.

«Kush do të jetë udhërrëfyesi ynë?»- bënin shaka duke u përpjekur të çlironin ankthin. Asnjë prej tyre nuk ishte larguar nga komuniteti dhe askush nuk e kishte idenë se ku po shkonin.

Në një distancë të shkurtër pas kufirit, autobusi ndaloi dhe nëntë refugjatët zbritën. Panë përmes shtëllungave gri të tymit, ndërsa autobusi u kthye dhe u largua. Ai ishte kontakti i tyre i fundit me Butanin. U ishte thënë të ecnin «në atë rrugë» përmes kodrave të Indisë për në Nepal.

E PËRNDJEKUR NGA ENDRRAT

Të krishterët udhëtuan për tri ditë në këmbë pa mundim të madh, por u rraskapitën duke kaluar terrenin e vështirë malor. Kur iu afruan një peme çuditërisht të madhe përgjatë rrugës, Xhoni, i cili

kishte qenë drejtuesi i tyre jozyrtar, sugjeroi që të ngrinin çadrat nën pemë për një apo dy ditë që të merrnin fuqi. Nuk e kishin me nxitim, por realiteti i dilemës së tyre po fillonte të shfaqej dhe Purnimës po i shtohej frika. Nuk donte që të tjerët ta dinin, por kishte qarë derisa e kishte zënë gjumi dhe që kur la fshatin e saj, ëndrrat me nënën e kishin përndjekur në gjumë. Edhe kjo natë nuk ishte ndryshe...

8 Mars, datëlindja e Purnimës. *Purnima u struk pas s' ëmës, duke vështruar natën e qartë. Pëlqenin shumë të shikonin yjet së bashku duke treguar gjëra imagjinare. Duke qenë vajza e vogël, Purnima kishte mundësi të kalonte më shumë kohë me nënën dhe s'kishte vend më të sigurt për të se sa kur ishin ashtu së bashku.*

«Kështu pra, vajza e datëlindjes, çfarë do të bëhesh kur të rritesh?»- e pyeti e ëma.

«Kur të rritem? Çfarë do të thuash kur të rritem? Jam vetëm katërmbëdhjetë vjeç», – tha Purnima duke qeshur. Shpesh ndihej si e zënë në kurth midis shpirtit të saj rinor dhe përgjegjësive të një të rrituri, por sonte ishte thjesht vajza e vogël e mamit.

Gëzimi i Purnimës nuk zgjati shumë, papritur dalloi katër oficerë që vinin nga fushat drejt tyre. Ajo u tmerrua, sepse e kuptoi që po vinin për të. Çuditërisht, nëna e saj nuk dukej se i vinte re.

Përpara se Purnima të mund të arratisej, katër oficerët e rrethuan. Njëri prej tyre e kapi duke zgjatur gishtërinjtë e gjatë drejt krahut të saj aq fort, saqë dora iu mpi nga ndalimi i qarkullimit të gjakut. «Lërmë të shkoj! Po më vret!», – iu lut ajo.

Asnjë përgjigje. Ngadalë Purnimën e larguan zvarrë prej nënës së saj dhe shtëpisë. Të dyja sikur u shpërbënë në largësi.

«Mami! Mami!» – jehonte zëri i Purnimës drejt shtëpisë. «Të lutem më ndihmo! Të lutem ndaloji!» Por ishte e kotë. E ëma qëndronte ulur në karrige sikur të mos kishte ndodhur asgjë...

Purnima u zgjua me një lëvizje të rrufeshme, duke marrë frymë thellë ndërsa ngadalë u kthjellua. Ndjeu në shije kripën e lotëve,

që i ishin tharë rreth gojës. Pyeste veten nëse do të mësohej ndonjëherë me atë ndjesi vetmie.

Ishte errësirë pus, vetëm një grimcë e argjendtë e hënës hidhte një ndriçim të mekur në degët e mëdha sipër saj. Ndërsa i hynë të dridhurat, shtrëngoi fort xhaketën rreth supeve. Mori bluzën që e kishte përdorur si jastëk dhe i nguli sytë errësirës përqark. U habit se sa e frikshme mund të ishte heshtja e natës!

A është vërtet datëlindja ime? – mendoi ajo me vete. Purnima u përpoq të gjente se çfarë dite e muajit ishte, por ishte e kotë. Ngjarjet e javëve të fundit kishin ndodhur aq shpejt, saqë nuk e kishte idenë se çfarë dite ishte. Tani s'kishte më rëndësi.

Pyeste veten se si do të mbijetonte në ditët, javët, madje edhe në vitet e ardhshme. Me siguri dinte vetëm që e kishte marrë shumë malli për shtëpinë. Ndërsa po e zinte përsëri gjumi, mendoi edhe një herë për fytyrën e ëmbël dhe ngrohtësinë e prekjes së nënës së saj.

TË RRAHUR, TË GJAKOSUR DHE XHEPAT BOSH

«Ngrihuni! Ngrihuni dhe na jepni paratë, përndryshe do t'ju vrasim!»

Purnima u zgjua papritur nga zërat e lartë dhe prej shkelmit të çizmes në brinjë.

«Ngrihu të thashë!»

Dhembja i përshkoi trupin, ndërsa sulmuesi e goditi përsëri. S'mund ta dallonte se sa persona po e sulmonin, por ishin disa. Grupi i saj i vogël s'mund t'i vinte në mbrojtje.

Nga të thirrurat e forta të bashkudhëtarëve të saj e kuptoi se edhe ata po sulmoheshin ashpër prej grabitësve. Purnima u përpoq të mbrohej ndërsa e rrihnin dhe e shkelmonin vazhdimisht. Një frikë paralizuese ia pushtoi trupin, por papritur i erdhi ndër mend një varg nga Bibla. Mendonte se ishte nga ungjilli sipas Mateut: «Mos kini frikë nga ata që vrasin trupin.»[1]

«Vrasin trupin,» – përsëriste me vete, duke u lutur që ky nuk do të ishte fati i saj i menjëhershëm. Mendja i shkoi te shuma e vogël e parave, që ia kishte dhënë i ati. Ndërsa banditët vazhdonin të bënin kërdinë në kampin e tyre të sajuar dhe të gërmonin në

gjërat e tyre të pakta, Purnima u përpoq të rrëmbente paratë e fshehura në sendet e saj para se ta zbulonin grabitësit. Dora e saj kapi atë çka po kërkonte pikërisht para se një tjetër goditje e dhimbshme t'i vinte në shpinë, duke e lënë gati pa frymë. I thirri Zotit ndërsa mblodhi krahët për t'u mbrojtur dhe u përpoq të rrokullisej larg çizmes së ashpër, që i përplasej në trup.

Pasi banditët i kishin terrorizuar mjaft refugjatët e lodhur dhe u rrëmbyen të gjitha gjërat, rreshtuan katër prej të krishterëve, duke përfshirë edhe Purnimën. Asnjë prej refugjatëve nuk guxonte të nxirrte zë, ndërsa qëndronin përballë sulmuesve. Ishin rreth dymbëdhjetë prej tyre, secili me një shami të madhe të lidhur rreth fytyrës. Purnima pa të tjerët që qëndronin pranë saj. Të gjithë kishin ngrirë nga frika. E dinte se grabitësit nuk e kishin për gjë t'i qëllonin në vend.

«Këtë s'duhet t'ia raportoni policisë», – i paralajmëroi njëri prej burrave ndërsa vërtiste i shkujdesur pistoletën përpara tyre. «Nëse raportoni, do të kthehemi t'ju vrasim.» Gishtin e mbante te këmbëza dhe vazhdonte t'ia drejtonte armën secilit prej tyre për të përforcuar fjalët. Purnima mbylli sytë dhe po priste nëse arma do të shkrepej. Kur i hapi, grabitësit ishin larguar.

Viktimat e plagosura u mblodhën si të mundnin dhe panë dëmin e shkaktuar. Megjithëse i ishin mirënjohës Zotit që u kishte shpëtuar jetën, të gjithë ishin të rrahur e të gjakosur, dhe shpejt e kuptuan se nuk u kishte mbetur asgjë. Hajdutët kishin marrë gjithçka, madje edhe veshjet e tyre. Nuk e kishin menduar asnjëherë që udhëtimi për në Nepal do t'u sillte rreziqe të tilla.

Të nesërmen në mëngjes Xhoni mundi të ndalonte një kamion të madh, që kishte kuti druri të bëra vetë në kabinën e tij të ndryshkur. Kur e morën vesh që kamioni po shkonte për në Nepal, iu lutën shoferit ndërsa të tjerët u grumbulluan rreth tij. «Ju lutemi, a mund të na merrni me vete? S'mund të qëndrojmë këtu. Është shumë e rrezikshme.»

«A keni para?» – pyeti shoferi i moshuar ndërsa doli nga kabina, duke parë mundësinë për të fituar ca dollarë të tjerë.

Xhoni i shpjegoi se si i kishin grabitur një natë më parë dhe kishin humbur gjithçka që kishin. «Ju lutem,» – vazhdoi ai, – «disa

nga grupi zor se mund të ecin pas të rrahurave që pësuan.» Por edhe pasi pa plagët e tyre, shoferi i kamionit refuzoi t'i merrte në makinë. Mendjen e kishte ende vetëm te përfitimi.

Xhoni dhe të tjerët bënë të largohen, të shkurajuar nga humbja e mundësisë për të udhëtuar me makinë, kur Purnima foli. «Kam unë ca para.» Të tjerët e panë me habi, duke menduar se si mund t'i kishin mbetur para pas gjithë asaj çfarë kaluan. Hajdutët kishin kërkuar me imtësi.

«Le të themi që i fsheha me kujdes», – tha Purnima duke buzëqeshur ndërsa ia dha paratë shoferit. Më e vogla e nëntë refugjatëve u bë heroina e tyre, ndërsa të gjithë e përqafuan dhe e vunë mbrapa kamionit. Nuk do të ishte hera e fundit që natyra e zgjuar dhe bujare e Purnimës do të ishte e dobishme.

Dielli i pasdites e ripërtëriu grupin e vogël të të krishterëve dhe i çliroi nga të dridhurat e vazhdueshme prej të fjeturit në tokën e ftohtë e të lagësht. Ndërsa shumica prej tyre përfituan nga rasti për të marrë një sy gjymë, Purnimës i vajti në mend përsëri e ëma dhe për herë të parë filloi të vinte në dyshim nëse kishte marrë vendimin e duhur. Ndoshta duhej ta kishte mbajtur besimin e saj sekret siç ia kishte sugjeruar në fillim Maja. E hapi Biblën që i kishte dhënë Sivali pas pagëzimit dhe u kujtua të falënderonte Zotin që hajdutëve nuk u ishte dukur e përshtatshme për t'ia vjedhur.

Duke shfletuar, Purnima gjeti menjëherë pasazhet e saj të preferuara. I kishte lexuar qindra herë dhe i kishte nënvizuar që të mund t'i gjente kollaj. Që prej vizitave të hershme te Maja, ishte magjepsur nga historitë mahnitëse të Biblës. Mendoi për Marinë dhe Jozefin që u larguan për në Egjipt, për Davidin që u shpëtoi duarve të mbretit Saul dhe iu kujtua personazhi i saj i preferuar në Bibël, Moisiu, që ishte arratisur prej Egjiptit. Këto histori e mbushnin vajzën me kurajë për t'i bërë ballë një dite tjetër. Me Biblën e shtrënguar pas vetes, kishte sigurinë që ishte në shoqëri të mirë.

REFUGJATËT E RIBASHKUAR

Ndërsa ra mbrëmja, shoferi ndaloi më në fund në qytetin indian të Monit dhe u tha pasagjerëve se i duhej të merrte karburant dhe disa furnizime të tjera. U tha se kishin disa orë kohë para

se të niseshin përsëri. Duke përfituar nga mundësia aq shumë e dëshiruar për të çmpirë këmbët, Purnima dhe të tjerët bënë një shëtitje në qytet, ku takuan një pastor të zonës.

Pastori kishte qenë me origjinë nga Butani dhe u mahnit nga historia e tyre dhe nga dëshira për t'i lënë të gjitha pas për të ndjekur Krishtin. U habit më tepër nga Purnima e vogël. E mori veç Xhonin dhe e pyeti për moshën e saj.

«Nuk jam i sigurt, trembëdhjetë ose katërmbëdhjetë», – u përgjigj Xhoni.

«A po udhëton me ndonjë pjesëtar të familjes?», – pyeti pastori.

«Jo. Edhe familja e motrës së saj është nisur për në Nepal, por para nesh. Nuk e dimë ku ndodhen.»

Pastorit i erdhi shumë keq për Purnimën e vogël. E pyeti Xhonin nëse duhej ta ftonte të jetonte me familjen e tij. Xhoni e mendoi si ide të mirë. Edhe ai kishte qenë i shqetësuar për të. E nxiti pastorin t'ia bënte ftesën vetë Purnimës.

Purnima ra dakord të jetonte me pastorin dhe gruan e tij. Ishte shumë lehtësuese të ishe përsëri pjesë e familjes. Por nuk ishte familja *e saj*, ndaj ajo lutej vazhdimisht që të mund të ribashkohej me Majan. Nuk e dinte se si mund të ndodhte kjo; ajo thjesht lutej që të ndodhte. Kishin kaluar tre muaj, kur pastori e ftoi Purnimën në një konferencë të krishterë, që do të mbahej jashtë Asonit. Ajo pranoi me gëzim, duke mos e ditur që edhe kunati i saj, Sivali, do të merrte pjesë.

U hodh nga gëzimi kur e pa përsëri dhe shumë shpejt vendosi që të kthehej me të në Nepal; një vendim që e trishtoi pastorin dhe gruan e tij. «A je e sigurt që do të largohesh, Purnima?» – e pyeti pastori. «A e di sa e vështirë do të jetë për ty në Nepal? Do të detyrohesh të jetosh në një kamp refugjatësh.»

Purnima dëgjoi argumentet e tij duke e ditur që kishte të drejtë. Pastori dhe gruaja e tij e kishin trajtuar si vajzën e tyre dhe ishte e vështirë të largohej. Por e kishte vendosur. «Po, jam e sigurt», – u përgjigj ajo. «Dua të jem me familjen time. E vlerësoj gjithë mirësinë tuaj, por besoj se ky është vullneti i Zotit për mua.»

Purnima dhe Sivali mbërritën në kampin e refugjatëve në kufirin verior të Nepalit vonë në një mbrëmje me re, kështu që

ajo s'mundi t'i dallonte kollaj detajet e shtëpisë së saj të re. Më e rëndësishmja ishte vetëm që po takonte përsëri Majan. Motrat u hodhën në krahët e njëra-tjetrës gjithë gëzim. Më pas Purnimën e zuri menjëherë gjumi në një rrogoz të hollë bambuje.

«Purnima, zgjohu!» E vogla Ester i vinte rreth e rrotull, duke përplasur duart e duke qeshur në kasollen e vogël. Kur Purnima hapi sytë, gjëja e parë që vuri re ishte skeleti i paqëndrueshëm i bambusë i mbuluar me plastikë të trashë; «çatia» e kasolles së tyre. Ndërsa u ngrit, dëgjoi si një buçimë qindra zëra njerëzish jashtë hyrjes së kasolles. S'kaloi shumë dhe kushtet e rënduara e varfëria e skajshme e mijëra familjeve, që jetonin atje, u bënë të qarta për Purnimën. Sa më shumë e shihte kampin, aq më shumë zhytej në dëshpërim.

Maja, e lumtur që ishte përsëri me motrën e saj, u përpoq t'i ngrinte moralin. «Dëgjo, Purnima», – i tha ajo motrës së vogël. «E di që ky është vend i fëlliqur, por dora e Zotit është gjithmonë me ne, s'ka rëndësi se ku jemi. Ai duhet të ketë punë për ne këtu. Mendo vetëm pak për gjithë ata njerëz që nuk kanë dëgjuar asnjëherë për Krishtin. Dhe ti e di se si tërhiqen njerëzit nga ti. Të dëgjojnë kur u tregon për Zotin, ndoshta ngaqë nuk janë mësuar të shohin një predikues kaq të këndshëm.»

Purnima skuqej dhe buzëqeshte. «Besoj se është e vërtetë,» – tha ajo. «Por sa kohë mendon se do të na duhet të qëndrojmë këtu? A është vërtet plani i Zotit që ne të mos kthehemi më kurrë në shtëpi?»

Maja s'kishte përgjigje, por e tërhoqi Purnimën pas vetes dhe e përqafoi fort. Donte të ishte e fortë për motrën e saj të vogël, por e vërteta ishte se edhe ajo vetë shqetësohej për të njëjtat gjëra.

Me kalimin e javëve, Purnima zbuloi dalëngadalë rregullat e jetës në kamp. *Përpiqu* të sigurosh një «lejekalim» kur të largohesh prej kampit për në fshatrat aty afër. *Mos u trego* autoriteteve që do të shkosh të predikosh ungjillin dhe do ndash fletushka! *Mos organizo* takime të mëdha me të krishterë të tjerë në kamp; qëndro në grupe të vogla dhe zhvillo takime në «kisha-shtëpi». *Shfrytëzo* orët e mësimit të gjuhës që ofrohen dhe kështu me radhë. Kampi i refugjatëve kishte një kulturë e mënyrë të jetuari që për Purnimën ishte e papërshtatshme.

PASION PËR TË NDARË UNGJILLIN

Pika kulmore në jetën e kampit për Purnimën ishte rritja e ethshme e kishës midis mijëra refugjatëve. Asaj i pëlqente siguria e familjes së Krishtit dhe miqësia e afërt që ishte krijuar. Shumë herë ajo dhe miqtë e saj dilnin fshehurazi në grupe të vogla, pa u vënë re, për të vizituar të krishterë të tjerë në kampet dhe fshatrat fqinj; i përdornin këto mundësi për të praktikuar gjuhën e re ndërsa predikonin. Purnima kënaqej shumë gjatë këtyre aventurave, ndërsa vazhdoi të zbulonte dhuntinë për muzikë dhe pasionin në rritje për të humburit. E rrëmbyer nga pasioni për ndarjen e ungjillit, pothuajse e harronte mjerimin e jetës në kamp.

Së bashku me miqtë e saj i vazhduan këto ekspedita për ndarjen e ungjillit jashtë kampit derisa u kapën një vit më vonë. Grupi ishte nisur herët mëngjesin e një së diele të freskët gushti për një udhëtim dyditor drejt shtëpisë së Honas. Hona kishte dëgjuar për të krishterët në kampin e refugjatëve dhe kishte ftuar një grup prej tyre për të kaluar një kohë miqësie në shtëpinë e tij dhe për të ungjillëzuar tregun e zonës. Purnima dhe të tjerët pranuan me shumë dëshirë.

Qetësisht, në grupe dyshe ose treshe, njëmbëdhjetë prej tyre dolën fshehurazi nga kampi i refugjatëve dhe u takuan rreth një kilometër tatëpjetë rrugës. Duke mbajtur Bibla, disa ungjij, fletushka dhe një kitarë, të krishterët ishin të emocionuar për mundësinë e predikimit në një fshat të ri njerëzve, që mund të mos kishin dëgjuar kurrë për ungjillin. Por e dinin që duhej të ktheheshin në kamp pa rënë nata.

Arritën në shtëpinë e Honas në mesditë dhe pasi qëndruan së bashku për disa orë, u nisën për te tregu. Sapo kishin filluar të këndonin disa këngë kur Purnima dhe të tjerët u ndaluan nga pesë oficerë policie. «Ejani me ne», – urdhëruan ata.

Grupi i habitur s'kishte zgjedhje tjetër veçse të ndiqte oficerët, dhe shumë shpejt u gjendën të ulur përpara një kapiteni me pamje të ngrysur. «Nga jeni?» – pyeti ai. «Kush ju lejoi të dilni nga kampi? Kush ju dha leje për të shpërndarë fenë tuaj në Nepal?»

«NUK KENI ASNJË TË DREJTË KËTU!»

Pritën gjithë ditën në burgun e lagësht e të errët ndërsa kapiteni i mori në pyetje individualisht, në fillim burrat e më pas gratë. Purnima po lodhej dhe duke menduar se ishte thjesht një keqkuptim, vendosi ta sfidonte oficerin. «S'kemi bërë asgjë të keqe. Pse po na mbani këtu? Ju lutem na lini të shkojmë. Duhet të kthehemi në kamp para se të errësohet.»

«Jo», – thirri kapiteni. «Sonte do të qëndroni me ne, dhe ...

nesër jeni të ftuar nga komandanti i rajonit.» Purnima u tulat kur pa se sa i kënaqur dukej kapiteni që i kishte arrestuar. Ajo dhe tre gra të tjera u burgosën në një qeli të vogël të fëlliqur, ku u mblodhën së bashku dhe i thirrën Zotit gjithë natën, duke kërkuar mbrojtjen e tij. Ata e dinin se mund të ishte e rrezikshme të predikoje në Nepal, por kaq shumë njerëz që nuk kishin dëgjuar asnjëherë ungjillin po e pranonin me shumë etje dhe me këtë rezultat ia vlente të rrezikoje.

Të nesërmen në mëngjes policia i mblodhi të njëmbëdhjetë të krishterët. «Nëse keni para, mund të blini diçka për drekë», – u tha njëri prej oficerëve. «Tani do të bëjmë të gjithë një shëtitje të gjatë.»

Purnima shkëmbeu vështrime pyetëse me miqtë e saj, por vendosën të mos shqetësoheshin shumë. Sigurisht që e gjithë kjo do të zgjidhej atë ditë në zyrën e komandantit të rajonit.

Ecën tërë ditën përmes xhunglës, njëmbëdhjetë të krishterë dhe nëntë policë me armë. «*Ma merr mendja se duhet të dukemi shumë të rrezikshëm»,* – mendoi Purnima ndërsa shikonte armët. Muskujt e tensionuar nga terreni i vështirë ia bënin edhe më të vështirë ecjen. Duke mos patur asnjë qindarkë me vete, nuk kishin asgjë çka të hanin a të pinin, veç rastit kur kalonin në ndonjë përrua.

Ishte errësirë kur arritën më në fund në zyrën e rajonit. Purnima ishte e rraskapitur, kishte ftohtë dhe ishte e uritur, por përsëri ndihej e inkurajuar që Zoti ishte me ta dhe ishte e sigurt që do të kthehej në shtëpi së shpejti. Por shpresat iu venitën sapo filloi marrja në pyetje. Pesë oficerë u ulën pas një tavoline druri në dhomën jo shumë të ndriçuar dhe u drejtonin të krishterëve pyetje me zemërim: «Kush ju dha leje për të predikuar në tregun e Japas?

Kush ju mbështet? Ku i keni gjetur materialet? Ju refugjatë të ndyrë! Ju s'keni të drejta këtu.»

Kushdo që përpiqej të përgjigjej, rrihej apo shkelmohej, por ata rriheshin edhe kur nuk përgjigjeshin. Pyetje, rrahje për katër orë, derisa erdhi një oficer tjetër dhe tha: «Mjaft! Mjaft për sonte! Jepuni ushqim dhe do të vazhdojmë nesër!»

Kushtet në qeli ishin akoma edhe më të këqija se në burgun e parë. Purnima përcolli vrerin që iu krijua në fyt, prej erës së tmerrshme që e mbyti. Dyshemeja prej çimentoje ishte e ftohtë dhe nuk kishte as edhe ndonjë kovë, që mund të përdorej si tualet.

Në mëngjes, Purnima dhe gratë e tjera pritën me frikë në qelitë e tyre. Oficerët filluan t'i merrnin të burgosurit një nga një dhe u bënin pyetje. Komandanti i rajonit i tha Purnimës se ata kishin prova që ajo dhe miqtë e saj kishin shkatërruar një tempull budist dhe kishin fyer perënditë e tyre.

«Jo, nuk është e vërtetë!» – thirri Purnima me mosbesim. Oficeri e qëlloi me shuplakë në fytyrë.

«Ti gënjeshtare e pafytyrë!» – ulëriti ai. «Vetëm na trego të vërtetën dhe do të kesh dënim të lehtë. Nëse vazhdon të gënjesh, do të shkosh në burgun federal për një kohë shumë, shumë të gjatë.» Purnima nisi të tmerrohej, por e mblodhi veten. E rrahën dhe e shkelmuan mizorisht aq shumë herë, sa vajzës i ra të fikët. Me përjashtim të grabitjes natën e parë në Indi, ajo nuk e imagjinonte që njerëzit mund të ishin kaq të ligj. Por gjatë njëzetë e tetë ditëve të mëvonshme, mori një mësim të mirë. Ishte mësim i vështirë për një pesëmbëdhjetë vjeçare.

Ditët e gjata të marrjes në pyetje sikur s'kishin mbarim, ndërsa oficerët vazhdonin misionin e tyre për të munduar shpirtin e Purnimës dhe miqve të saj. Rutina ishte gjithnjë e njëjtë, përveç faktit që asnjëherë nuk e dinin se kush do të ishte i pari, që do të thirrej për raundin e përditshëm të marrjes në pyetje dhe rrahjeve. *Pyetje, përgjigje e gabuar, shuplakë. Një pyetje tjetër, një përgjigje tjetër e gabuar, dhe një tjetër shuplakë.* E kështu vazhdonte.

Në qelinë e tyre, Purnima dhe gratë e tjera këndonin me zë të ulët dhe luteshin në netët e gjata, duke u përpjekur të inkurajonin

njëra-tjetrën me fjalë shprese. «Qëndroni të forta! Do të përfundojë së shpejti dhe do të shkojmë në shtëpi», – pëshpërisnin ato në errësirë.

Shtëpi, mendoi Purnima me ironi, *ky është një term relativ tani*.

TË RREZATOSH PAQEN E PERËNDISË

Në kamp, Purnima kishte menduar vazhdimisht për prindërit e saj dhe se sa shumë e kishte marrë malli për shtëpinë në Butan. Por tani kishte shumë më tepër mall nga ç'mund ta kishte imagjinuar për motrën dhe kasollen e vogël në kampin e refugjatëve. Imagjinonte se çfarë ishin duke bërë nipi dhe mbesa dhe shqetësohej edhe për Majën. A kishte marrë ndonjë lajm ajo për vendndodhjen e Purnimës?

Oh, Maja, më vjen keq që po të shkaktoj kaq shumë probleme! Do të të ketë ikur mendja fare, – mendoi Purnima.

Në fakt, disa të krishterë në kampin e refugjatëve, duke përfshirë pastorin e bashkësisë, kishin dëgjuar zëra për arrestimin e grupit. Ata kishin udhëtuar madje deri në qendrën e të arrestuarve ku mbaheshin Purnima dhe të tjerët, por ishin rrahur keqas nga oficerët dhe i kishin kthyer. Njëmbëdhjetë të krishterët e burgosur e morën vesh se çfarë po ndodhte dhe u dërrmuan shpirtërisht nga sulmet e paprovokuara ndaj miqve të tyre.

Në ditën e njëzetë e pestë të burgosjes së saj, njëri prej rojave erdhi herët për Purnimën. Komandanti i rajonit po e priste në dhomën tashmë të njohur të marrjes në pyetje, i gatshëm për të shprehur mizorinë e tij. Pyetjet filluan edhe njëherë: «Kush të tha të predikosh? Ti je shumë e vogël. Ndoshta nuk është faji yt. Sigurisht që dikush ta ka futur në mendje këtë fe duke të premtuar para. Kush të dërgon mbështetje? Nëse më thua kush është, të rrahurat do të ndalojnë. Ndoshta mund të kthehesh edhe në kamp.»

Purnimës iu dukën shekuj minutat që pasuan. Ishte e lodhur dhe e rraskapitur fizikisht nga mungesa e ushqimit, të burgosurve u jepej oriz dy herë në ditë. Nuk kishin mundësi as të laheshin, por pavarësisht këtyre, ajo ndiente paqen e Perëndisë të shkëlqente brenda saj gjatë këtyre sesioneve. Përhumbja në praninë e Krishtit

e ndihmoi shumë ndërsa i lutej Perëndisë të falte persekutuesit e saj dhe t'i jepte forcë për atë që e priste më pas.

«Përgjigjiu pyetjeve të mia!» – ulëriti komandanti.

Purnima mori kurajë ndërsa priste shuplakën. E dinte që atij nuk do t'i pëlqente përgjigjja. «Nuk e pranova Krishtin për hir të parave për mbështetje apo për ndonjë gjë tjetër! E pranova, sepse motra ime, që ishte sëmurë për tre vjet, pasi pranoi Krishtin u shërua në mënyrë të mrekullueshme. Kam parë shumë mrekulli dhe kam paqe dhe gëzim. Nuk ka asnjë arsye tjetër.»

I zhgënjyer, komandanti iu afrua fytyrës së saj. Era e frymës së tij dhe tërbimi i egër i syve e frikësoi, por ajo u përpoq të mos dorëzohej. «Gënjen!» – i bërtiti ai në fytyrë. «E di që po fsheh diçka. Nuk po thua të vërtetën. Tani do të shkosh në burg për një kohë të gjatë. A je gati për këtë?» Para se Purnima t'i kthente përgjigje, ai e goditi fort duke e rrëzuar prej karriges. «Ktheje në qeli!» – urdhëroi ai.

Shoqet e qelisë klithën kur panë fytyrën e saj të brishtë të bërë copë e të ënjtur prej shuplakave të tmerrshme. «Mos u shqetësoni,» – gënjeu Purnima ndërsa sytë iu përlotën. «Nuk është aq e dhimbshme sa mund të duket.»

Gratë e dinin që nuk ishte e vërtetë, se edhe ato e kishin provuar dhembjen dhe poshtërimin nga oficerët e pashpirt. E ngushëlluan Purnimën si mundën, ndërsa u vinte keq që zyrtarët nuk donin ta besonin historinë e tyre. Ata e kishin të vështirë të besonin se Purnima dhe miqtë e saj nuk merrnin ndihmë financiare nga të huajt. Ishin të bindur se Biblat dhe fletushkat kishin ardhur nga jashtë Nepalit, sepse krishterimi ishte një fe e huaj. Refuzonin të pranonin që ajo po shpërndahej në vend pa detyrim dhe pa premtim të ndonjë fitimi personal.

Kaluan disa ditë në qetësi ndërsa Purnima dhe të tjerët mendonin për fatin e tyre. Lutjet dhe këngët e qeta i ndihmonin të qetësoheshin, por Purnima nuk ndjehej e qetë për shkak të ndërprerjes së menjëhershme të komunikimit me rrëmbyesit. – «Ç'mund të jenë duke bërë? Pse s'po na lejojnë të shkojmë?» – pyeste veten.

«SA E BEKUAR JAM!»

Më në fund, herët në mëngjes, të martën më 20 shtator, grupin e mblodhën përsëri në zyrën e komandantit të rajonit. Purnima e dinte që po ndodhte diçka, sepse deri në atë kohë, gratë e burgosura ishin të ndara veç nga burrat. Nuk u thanë shumë refugjatëve ndërsa i rreshtuan pa shumë ceremonira dhe u vunë prangat. Më pas marshuan përmes sheshit të fshatit për në gjykatën me çati llamarine. Purnima u kënaq aq shumë nga ngrohtësia e diellit, qoftë edhe për një moment të shkurtër, saqë harroi të shqetësohej për atë që i priste.

Dhoma ishte plot ndërsa i çuan në fillim të saj dhe i ulën përbri avokatit të caktuar nga gjykata. Nga ana tjetër e dhomës, avokati i qeverisë po paraqiste akuzat zyrtare ndaj të njëmbëdhjetëve. Ishte e çuditshme se, ndërsa akuzat e pabaza lexoheshin, një listë e tërë me gënjeshtra për shkatërrimin e tempullit budist dhe vrasjen e lopëve të shenjta, Purnima u mbush plot shpresë. Ndoshta kjo do të ishte dita e shfajësimit, do të liroheshin. Sigurisht që gjykatësi do ta kuptonte, që ata ishin të pafajshëm.

Avokati i tyre argumentoi mjaft bindshëm, por pala akuzuese duhej të ndiqte urdhrat, dhe bërja e të krishterëve një shembull dukej se ishte qëllimi i tij kryesor ndërsa dita pak nga pak i la vendin mbrëmjes. Ishte pothuajse ora dhjetë e natës kur gjykatësi mori vendimin, i cili iu lexua grupit të rraskapitur. Purnima u ngrit ndërsa iu thirr emri bashkë me të burgosurit e tjerë. Një tronditje ia përshkoi trupin, ndërsa gjykatësi lajmëroi me rreptësi se do të dërgoheshin në burgun federal për një periudhë prej tre vjetësh.

Tre vjet. Fjalët oshëtinin në mendjen e Purnimës.

Purnima i kishte premtuar Zotit se do të ishte besnike kudo që Ai ta dërgonte. Ai e dërgoi: larg prej shtëpisë.., jashtë Butanit.., në një kamp refugjatësh. Por, *në burg*? Kjo ishte më tepër se ç'mund të duronte një pesëmbëdhjetë vjeçare. Mbylli sytë dhe kërkoi përsëri ngushëllim në historitë e Biblës, që i kishte ruajtur në kujtesë. E imagjinonte Jezusin të ulur në majë të malit duke udhëzuar dishepujt e Tij, dhe mori kurajë ndërsa fjalët i vinin ndër mend: «Lum ata që persekutohen, sepse e tyrja është mbretëria e

qiellit. Lum ata që persekutohen...Lum ata...» Ndaloi dhe e kuptoi të vërtetën. «*Sa e bekuar jam*!»[2]

Ishte e vështirë ta mendoje një dënim me burg si bekim; shpirti i Purnimës e pranoi faktin përpara mendjes. Por në ditët që do të pasonin, ky premtim do të bëhej burimi i fuqisë së të burgosurve ndërsa e përsërisnin shpesh këtë fjalë në një zë.

Kështu u vunë prangat dy nga dy dhe u larguan prej sallës së gjyqit për të filluar një udhëtim tjetër të vështirë përmes xhunglës. Burgu ndodhej në një majë mali, disa kilometra larg. Ndërsa mendja e Purnimës përsëriste vendimin e gjyqit, bindej gjithnjë e më shumë për rolin e Perëndisë në atë që po u ndodhte. Ishin akuzuar më kot dhe po shkonin në burg për shkak të Krishtit. Kjo ishte ngushëlluese për të dhe ndihej e privilegjuar që u thirr për të vuajtur për Krishtin. Duke parë miqtë e saj ndërsa po kalonin xhunglën, e dinte që ishte në shoqëri të mirë.

«MIRË SE VINI NË FERR!»

Mbërritën në portat e burgut në orën tre të mëngjesit. Në dritën e hënës, Purnima mundi të dallonte muret e lartë që rrethonin vendin dhe portat e jashtme që kërcitën në mënyrë kërcënuese ndërsa u hapën për ta. Vendi kishte një atmosferë të errët imponuese dhe dukej sikur kishte qenë një fortesë e madhe më parë, por tani ishte pothuajse i shkatërruar. Ndërsa ecnin përmes oborrit për në ndërtesën e brendshme, Purnima hodhi një vështrim të shkurtër pas ndërsa portat u mbyllën. Përplasja e zhurmshme ushtoi nëpër burg, që tashmë do të ishte shtëpia e saj e re.

Purnimës dhe grave të tjera iu dha një rrogoz i hollë kashte dhe i çuan për në qelinë e tyre. Ishte thuajse errësirë e plotë, por pak nga pak mundën të dallonin siluetat e të tjerave që flinin në dysheme. Një zë i çuditshëm u dëgjua prej dyshemesë: «Mirë se vini! Mirë se vini në ferr!»

Purnima ishte kurioze të dinte se cilat ishin shoqet e qelisë. Çfarë krimesh kishin kryer? A ishin të dhunshme? A do ta pëlqenin? Pyetjet pa përgjigje i provokonin nervozizëm, ndërkohë gjeti një vend bosh përgjatë murit dhe mblodhi këmbët kruspull. Ishte e rraskapitur, por kishte shumë frikë të flinte.

Brenda disa orëve, një rreze drite hyri përmes të çarave lart në mure, duke i lejuar Purnimës dhe shoqeve të saj të vëzhgonin mjedisin. Dhoma nuk ishte e madhe, por s'kishte shumë njerëz. Kishte edhe pesë të burgosura të tjera në qeli dhe secila prej grave me sa dukej kishte vendin e vet, duke grumbulluar ato pak gjëra, që kishin në dysheme. Banja, nëse mund të quhej e tillë, ishte një pjesë çimentoje e ngritur që dilte në murin e jashtëm. Kishte një lavaman të ndryshkur, por nuk kishte sapun, as ujë të ngrohtë, as derë. Një gropë në çimento shkonte në një tjetër gropë të hapur. Duke gjykuar nga era e tmerrshme që mbushte qelinë, ajo nuk ishte pastruar kurrë.

Muret prej betoni të burgut ishin të njollosura me shtresa boje dhe përgjatë viteve ishin shndërruar në një ngjyrë të errët. Dyshemeja ishte e ftohtë, me lagështirë dhe shumë e ndotur. Një dritare e vogël e brendshme i lejonte të burgosurit të shihnin oborrin e gjykatës dhe qelinë shumë më të madhe të burrave përballë saj. Lart, mbi oborrin e gjykatës, ishte një rrugicë e rrethuar nga e cila ruanin rojat e burgut, megjithëse Purnima nuk kishte parë ende roja atje.

Tulasa ishte vetëshpallur kapoja i qelisë. «Pse je këtu?» – pyeti ajo drejtpërdrejt, duke ia ngulur sytë Purnimës. «Je pak e vogël për t'u burgosur, apo jo?»

«Nuk e di nëse jam shumë e vogël, – u përgjigj Purnima, – por jemi këtu, sepse jemi të krishterë.»

«Të krishterë?» – pothuajse pështyu Tulasa kur shqiptoi fjalën. «Pse do të të mbyllnin këtu, sepse je e krishterë? Budallallëku nuk është gjë kundër ligjit». Të tjerat iu bashkuan të qeshurës së saj. Ajo u prezantua, por në fjalët e saj nuk kishte ngrohtësi. «Thonë se kam vrarë vjehrrën», – u hakërrye ajo. «Kështu që do të jem këtu për ca kohë dhe do ta vlerësoja nëse do ta mbaje krishterimin për vete!»

Purnima i bëri ballë vështrimit të gruas, megjithëse u druhej fjalëve të saj të ashpra. Deri diku Purnima dyshonte se ekzistonte një shpirt i butë dhe i kujdesshëm pas pamjes së akullt dhe, prej atij momenti, nisi t'i lutej Zotit për një mundësi për ta zbuluar.

Tulasa u kthye në qoshen e saj të qelisë, duke lënë pas një lumë të sharash për të krishterët. Purnima vuri re se ajo kishte batanije

dhe sende të tjera personale, të marra nga miqtë apo pjesëtarë të familjes, që tregonin se kishte kohë që ishte aty. Të porsaardhurat nga ana tjetër, nuk kishin asgjë përveç rrobave të trupit. Mëngjesin e parë u mblodhën së bashku për t'u lutur, duke vendosur ta fillonin çdo ditë në lutje dhe të agjëronin çdo të premte. Iu dhanë edhe disa enë gatimi e çdo ditë merrnin dy racione, zakonisht oriz dhe patate. Ndonjëherë u jepej ndonjë shumë e vogël parash që të mund të blinin gjëra personale.

Të krishterët zbuluan se të përshtateshe me jetën e burgut ishte në njëfarë mënyre si të përshtateshe me jetën në një kamp refugjatësh: Të mësosh rregullat; të përpiqesh të qëndrosh larg telasheve dhe të ruash kokën. Ndryshimi i dukshëm ishte sigurisht mungesa e plotë e lirisë dhe ndërhyrja nga rojat kur ndodhte ndonjë sherr i pashmangshëm.

Por Purnima mendoi se të paktën nuk kishte marrje në pyetje të përditshme dhe rrahje e ato mund të kënaqeshin me kohën e tyre të qetë në bashkësi me njëra-tjetrën, pavarësisht talljeve të shoqeve të tjera të qelisë dhe sharjeve të vazhdueshme në një gjuhë të ndyrë. Frika më e madhe e Purnimës ishte prej orvatjeve seksuale të rojave të burgut, që kishin filluar pak pasi kishin ardhur ato.

Muajt e parë kaluan dhe Purnima nuk flinte shumë. E mësoi shumë shpejt pse gratë e tjera nuk e kishin zënë vendin pranë murit të jashtëm. Ishte shumë ftohtë atje. Me ardhjen e dimrit shëndeti i saj u përkeqësua dhe nuk kishte as rroba të ngrohta e as një batanije. Ngadalë, pamja e saj optimiste u zëvendësua nga një ndjenjë e brendshme dëshpërimi. Duke e kuptuar se çfarë po ndodhte, Purnima po shqetësohej për dobësinë e saj dhe besimin që po i zbehej. Pyeste veten nëse mos vallë kishte bërë një gabim të tmerrshëm. Ëndrrat për shtëpinë dhe nënën i ishin rikthyer, duke ia bërë netët edhe më të padurueshme. Ishte gati të hiqte dorë.

Një pasdite Purnima dëgjoi ulërima nga qelia e burrave, pasuar nga zëra të zemëruar duke thirrur «Kape! Kape! Jepi fund!» Nuk ishte e pazakontë të dëgjoje zënka, që shpërthenin në qelinë e burrave, por këtë herë u rrëqeth kur dëgjoi një zë të thërriste, «Jepi fund! Një i krishterë i vdekur as mund të lutet dhe as mund të këndojë!»

Purnima e dinte që kërcënimi ishte i vërtetë. Tulasa i kishte thënë se dikush ishte vrarë në qelinë e burrave jo shumë kohë para se të vinte grupi i tyre. Duke e ditur që në duart e pjesëtarëve të qelisë ishte një nga të krishterët e grupit, që po përballej me vdekjen, Purnima thirri me sa forcë që kishte një rojë, por nuk erdhi askush. Duke ngashëryer, ra në rrogoz dhe u lut. Në atë moment e kuptoi se sa më i rëndë ishte burgu për vëllezërit, që ishin ngjeshur në qeli me më shumë se dyqind burra të tjerë, shumë prej tyre kriminelë të dhunshëm. E kuptoi se sa e mbushur kishte qenë duke ndier keqardhje për veten, ndërsa nga ana tjetër e oborrit, njëri prej shokëve të saj po rrihej e madje do vritej.

«Zot i dashur», – u lut ajo, – «të lutem, mos i lejo ta vrasin; të lutem mos lejo të vdesë!»

Pastaj qau, dhe këtë herë jo vetëm për vete, por për të gjithë.

Një vëlla i quajtur Ashok kishte qenë viktimë e sulmeve në bllokun e burrave; kishte mbijetuar, por me shumë mundim. Falenderuese për shërimin e tij dhe e vendosur të mos fokusohej te vetja, Purnima përpiqej me të gjitha mënyrat për të qenë një dëshmi pozitive për gratë e tjera të qelisë. E dinte se duhej të qëndronte aktive nëse shpresonte të mbijetonte në tre vjet dënim. Në javët e mëparshme kishte lejuar t'i burgosej jo vetëm trupi, por edhe shpirti dhe situata duhej të ndryshonte. «Më trego se çfarë mund të bëj, Zot!» – u lut ajo. «Jam e lirë për të të shërbyer Ty, pavarësisht rrethanave.»

Kjo ndodhi atëherë kur ishte pothuajse Krishtlindje...

DHURATA E KRISHTLINDJES

Burri i njohur si «xhaxhai» ishte bërë figurë e përhershme në burgun federal. Kishte qenë atje për shumë kohë dhe vinte vërdallë i lirë. Të porsaardhurit besonin se ishte pjesë e stafit, por jo. Çdo javë vinte rreth e rrotull qelive, duke pyetur të burgosurit nëse donin t'u blinte diçka në treg.

«Mirëmëngjes Purnima», – i tha ai një ditë. «Çfarë mund të marr për ty sot apo do t'i ruash paratë derisa të lirohesh? Pse i kursen? Ç'të mirë ke kur nuk i shpenzon?»

Ndërsa ai po fliste, asaj i erdhi një ide. *E gjeta! Kështu do të veproj. Faleminderit, xhaxha!*

Ia vuri me nxitim të gjitha paratë që kishte kursyer në dorën e zgjatur xhaxhait dhe i pështpëriti në vesh përmes kangjellave të qelisë. Duke e parë të largohej nga qelia e grave, lutej që ai do të merrte pikërisht çfarë i kishte kërkuar. Xhaxhai kishte menduar se ajo ishte çmendur kur dëgjoi kërkesën, por iu përgjigj me ëmbëlsi; «Si mund të refuzoj një fytyrë kaq të pafajshme?»

Kur u kthye më vonë atë ditë, ia dha pakon Purnimës që priste me padurim. «I ke të gjitha këtu», – e siguroi xhaxhai. «Por mendoj ende se je e çmendur. Këtë të bën burgu, e di ti.»

Purnima i buzëqeshi për ta falënderuar dhe nxori dorën përmes kangjellave për ta përshëndetur. Pastaj filloi të bënte përgatitjet ndërsa të tjerat e shikonin. Më në fund, në pamundësi për të fshehur kuriozitetin, e pyetën se ç'po ngatërronte, por Purnima i shpërfilli duke vazhduar punës e saj. Iu desh e gjithë pasditja, por ishte e vendosur t'i bënte gjërat siç duhej. Kur mbaroi, u kthye nga të tjerat dhe tha: «Që kur kam qenë këtu, Zoti më ka vendosur në zemër ta kursej pjesën time të parave. Nuk e dija pse, deri këtë mëngjes kur kuptova se çfarë duhej të bëja. I kërkova xhaxhait t'i përdorte paratë për të blerë pulat dhe perimet më të mira, që mund të gjente. Dhe tani, i kam gatuar të gjitha për ju.»

Të mbetura pa fjalë, gratë vështronin të habitura. Tulasa e pa me dyshim, duke pritur «hilen» dhe duke vrarë mendjen se pse Purnima, të cilës nuk i kishte thënë asnjë fjalë të mirë, po bënte diçka të tillë. «Për çfarë po flet? Cila është hileja?» – pyeti ajo me sarkazëm.

«Thjesht, dua ta ndaj me ty, Tulasa. Me ju të gjitha. Nuk ka hile. Është dhurata ime për ju. Kështu që, le të hamë!»

Atë mbrëmje, të burgosurat në qelinë e grave hëngrën vaktin më të mirë që kishin pasur ndonjëherë. Madje, edhe rojat vinin e hidhnin ndonjë sy. Fjala u shpërnda shpejt në burg: Purnima kishte përgatitur një festë!

Mbrëmjen tjetër, Tulasa u ngrit nga qoshja e saj dhe u ul pranë Purnimës. «Pse e bëre këtë për ne?» – pyeti ajo sinqerisht dhe në mënyrë të sjellshme për herë të parë në praninë e Purnimës. «Ne

s'kemi bërë gjë tjetër veçse të kemi tallur ty dhe të tjerat që kur keni ardhur. Dhe ato ishin paratë e tua, gjithçka që kishe. Mund t'i kishe përdorur për vete. Hë pra, pse i shpenzove për ne?» Tulasa s'mund ta kuptonte një mirësi të tillë. Mendonte se Purnima, ose ishte shumë e zgjuar ose shumë budallaqe dhe donte të zbulonte se cila prej tyre qëndronte.

«Tulasa,» – e nisi Purnima me buzëqeshje në fytyrë, – «ke dëgjuar ndonjëherë për *Krishtlindjen*?»

Një miqësi e pazakontë u zhvillua midis një të dënuare për vrasje dhe një predikueseje adoleshente. Purnima i tregoi Tulasës historinë se si e kishte pranuar Krishtin gjatë një shërbese Krishtlindjeje pothuajse tre vjet më parë. Në mënyrë entuziaste dhe të butë, gjatë muajve që pasuan, Purnima i fliste shpesh për Krishtin Tulasës dhe çuditërisht u bënë shoqe të ngushta. Në njëfarë mënyre, Tulasa i kujtonte Purnimës nënën e saj dhe vajza ndihej e ngushëlluar nga shoqëria e gruas më të madhe në moshë. Megjithëse nuk e dinte se ç'e priste në të ardhmen, Purnima vendosi ta përballonte me guxim. E njihte dobësinë e saj, por refuzoi të lejonte ta burgoste. Do të përballej me sfidat dhe do t'ia linte pjesën tjetër Zotit, ashtu siç kishte bërë Moisiu.

EPILOG

Purnima, bashkë me të krishterët e tjerë, u lirua nga burgu pas katërmbëdhjetë muajsh e gjashtë ditësh. Fjala për arrestimin e tyre kishte shkuar deri në kampin e refugjatëve dhe në fakt u shpërnda në mbarë botën. Një grup ndërkombëtar drejtuesish të krishterë filloi t'i kërkojë qeverisë nepaleze lirimin e tyre: «Ne e dimë që po mbani njëmbëdhjetë të krishterë në burgun federal», – protestuan ata ndaj mbretit të Nepalit. «Dhe një prej tyre është veç një fëmijë!»

Purnima dhe të tjerët u informuan më vonë që lirimi i tyre kishte qenë një bekim më i madh se ç'e kishin menduar. Autoritetet e burgut kishin menduar t'i mbanin të burgosur për shtatë vjet (dënimi i përcaktuar nëse drejton dikë te krishterimi).

Menjëherë pas lirimit, për habi të stafit, këta të krishterë kërkuan një takim me ish-bashkëvuajtësit e qelisë. Vetëm pas tre

muajsh burgosjeje, të krishterëve u ishte lejuar të merrnin ndihmë nga pjesëtarët e familjeve. Ata u dhanë shokëve të qelisë gjithçka kishin mbledhur, edhe paratë që Purnima i kishte kursyer për një rast tjetër të veçantë. U kujtuan atyre që ishin persekutuar për shkak të besimit në Jezu Krisht. Disa prej të burgosurve që ishin bërë të krishterë, u inkurajuan të «ruanin besimin». Të njëmbëdhjetët premtuan t'i kujtonin ata dhe të burgosurit e tjerë në lutje.

Çuditërisht, njëri prej burrave që kishte marrë pjesë në rrahjen e Ashokut, doli përpara dhe tha: «Një dritë e bukur hyri në burgun tonë. Por tani po largohet.»

Përpara se të ikte, Purnima përqafoi Tulasën, tashmë e krishterë, për herë të fundit (Tulasa u lirua më vonë kur iu ndryshua dënimi. Ajo tani është një drejtuese aktive në kishë).

Që herën e parë që Maja i kishte lexuar historitë nga Bibla, Purnima kishte admiruar Moisiun. Ai kishte mërguar prej vendit të tij dhe, megjithëse nuk e kishte menduar kurrë veten të kishte qenë një folës i mirë, Perëndia e përdori fuqishëm. Po njësoj, Purnima, e cila ndihej shpesh e papërshtatshme për shkak të moshës së saj, tanimë ishte bërë e njohur në Nepal. E ftojnë vazhdimisht për të ndarë dëshminë e saj në kishat rreth e rrotull kampit të refugjatëve, ku jeton ende me Majan, Sivalin me nipin dhe mbesën.

Lutja e saj është që një ditë të kthehet në Butan, vendlindjen e saj, për të takuar nënën dhe për të predikuar ungjillin.

Aida:
Zëri i të heshturve

Rusi
Korrik 1968

Nuk donte avokat. Aida Mikhailovna Skripnikova nuk kishte nevojë për një zëdhënës, sidomos për dikë të caktuar nga qeveria sovjetike. Donte të fliste vetë, ta shtronte ajo vetë çështjen përpara gjykatësit. E ulur në anën e mbrojtjes në një sallë gjyqi të veshur me dru, ngriti sytë e pa fytyrën e ngrysur të Leninit, «atit» të sistemit që po e mbante të burgosur.

Prokurori ishte kundër kësaj ideje. Ai nuk donte që e akuzuara të mbrohej vetë; kjo do të thoshte t'i jepje shumë liri. Vuri në dukje që e akuzuara kishte qenë e shtruar më parë në një institut mendor. Si do të mund të ishte në gjendje të drejtonte një mbrojtje ndaj një krimi?

Gjykatësi i dha më në fund të drejtë Aidës, dhe avokati mbrojtës u largua nga salla e gjyqit, duke e lënë atë përgjegjëse për çështjen dhe për dënimin e saj. Për Aidën nuk ishte hera e parë që ndodhej në një sallë gjyqi, e denoncuar për praktikimin e besimit të krishterë. Nëse gjykatësi e shpallte fajtore dhe e dërgonte në një kamp pune, as atje nuk do të ishte hera e parë që shkonte. Jo, të gjitha këto gjëra i kishte hequr më parë. I vetmi ndryshim ishte se këtë herë s'do të kishte më një mbrojtje pasive të aprovuar nga qeveria. Kjo do të ishte hera e parë që do të fliste vetë, duke u shprehur qartë në mbrojtje të njerëzve të besimit në vendin e saj.

Kishte shumë akuza dhe gjykatësi lexoi secilën prej tyre me zë të lartë në një mënyrë që të ngrinte gjakun. Aida akuzohej se jetonte në Leningrad, pa leje të përshtatshme qëndrimi (leja i ishte tërhequr)dhe se ishte anëtare e një kishe të paregjistruar e shpërndante materiale të krishtera të paligjshme.

SHPIFJE KUNDËR TË VËRTETËS

Në thelb të akuzave kundër saj ishte vetëm një fjalë: *shpifje*. Sipas palës akuzuese, Aida kishte mbledhur dhe kishte shpërndarë informacion «të rremë» mbi raportimin e të krishterëve të arrestuar, gjykuar dhe burgosur në Bashkimin Sovjetik. Më e rënda në sytë e qeverisë ishte akuza se ajo ua kishte kaluar informacionin të huajve, në dëm të Bashkimit Sovjetik.

Ashtu sikurse pala akuzuese fokusohej në një fjalë të vetme, edhe mbrojtja e Aidës mbështetej në një fjalë të vetme, «*e vërteta*». Nëse informacioni që ajo kishte përcjellë ishte i vërtetë, arsyetonte ajo, s'mund të ketë qenë shpifje. Planifikonte të tregonte në gjyq se informacioni ishte plotësisht i vërtetë.

Ndërsa lexohej lista e akuzave, Aida për herë të parë e kuptoi se sa e hollësishme kishte qenë mbikëqyrja e saj. Ata ishin në dijeni për zonjën Jursmar, suedezen e këndshme që kishte ardhur për të marrë informacion prej Aidës. E dinin se kur dhe ku ishin takuar. Kishin konfiskuar bllokun e shënimeve të zonjës Jursmar, me shënime rreth takimit me Aidën. Gjykatësi listoi madje çdo objekt dhe informacion që Aida i kishte dhënë zonjës Jursmar, me një ton përbuzës e sarkastik.

«Jursmari u përpoq të merrte literaturën që kishte marrë jashtë vendit», – vazhdoi gjykatësi, «por gjatë kontrollit të doganës literatura e lartpërmendur u zbulua dhe u konfiskua». Ai ngriti sytë për të vështruar të pandehurën, me një buzëqeshje triumfuese në fytyrë.

Ata e dinin për Davidin, një mik tjetër i krishterë i huaj dhe kopjen e revistës së krishterë, «*Lajmëtar i Shpëtimit*», që ia kishte dërguar Aida. E dinin se kishte shkuar në një zonë tjetër për të takuar motrën, dhe i kishte dhënë revistat, që më vonë ua dhanë të krishterëve në kishën e fshehtë. Policia dukej sikur njihte çdo person që kishte takuar dhe çdo copë letër që kishte dhënë.

Aida vriste mendjen çfarë informacioni tjetër kishin marrë ata, cilët të burgosur të krishterë ishin ende të panjohur duke qenë se disa nga mesazhet e saj ishin zbuluar para se të kalonin kufijtë.

Sipas akuzave, Aida kishte shpërndarë deklarata jo të vërteta, që shpifnin kundër Bashkimit Sovjetik dhe rendit shoqëror.

NJË SIGURI E PAQTË

Aida qëndronte e qetë dhe e vetme në bankën e mbrojtjes, duke mos qenë rehat në karrigen e fortë të drunjtë. Druhej se do të ndihej nervoze apo e shqetësuar, por ndiente një siguri të paqtë, një ndjenjë të pranisë së Krishtit në sallë. Jezusi u tha ndjekësve të tij të mos shqetësoheshin se çfarë do të thoshin kur të ishin përballë mbretërve apo gjykatësve, dhe ajo nuk ishte e shqetësuar.

«Kur policia e mori në pyetje,» – tha gjykatësi, duke vazhduar të lexonte akuzat, – «ajo nuk e kishte pranuar fajin, megjithëse kishte pranuar se kishte shpërndarë materiale të krishtera.» «Kopje të shumë prej dokumenteve që kishte dërguar u gjetën në apartamentin e saj,» – tha policia, duke e lidhur qartë me çështjen. Aida tha se materialet nuk përmbanin shpifje, por thjesht «paraqisnin saktë situatën e kishës në vendin tonë».

Më në fund gjykatësi përfundoi së lexuari akuzat. Duke parë ashpër Aidën, e pyeti: «E pandehur, a i kupton akuzat ndaj teje?»

Ajo u kthye drejt tij, duke e parë ngultas.

«Po.»

«A shpallesh fajtore?»

«Jo,» – u përgjigj ajo me zë të qetë dhe të vendosur.

Gjykatësi u hodhi një sy shënimeve dhe më pas lajmëroi se gjyqi do të fillonte menjëherë. Ai tha se dështmitarja e parë do të ishte vetë Aida.

NJË FAMILJE E SHKATËRRUAR PREJ DHEMBJES

Kur filloi të ndiqte Jezu Krishtin në moshën njëzetë e një vjeçare, Aida nuk e kishte idenë që rruga ku Ai do ta drejtonte, do ta çonte drejt një salle gjyqi. Ajo kishte lindur në një familje të krishterë dhe e kishte njohur Jezusin që në moshë të vogël. Por familja u shkatërrua nga dhembja kur në vitin 1942, i ati i Aidës u arrestua, sepse refuzoi shërbimin ushtarak. I ishte premtuar një certifikatë, që e përjashtonte prej detyrimit, por ajo nuk erdhi kurrë. Ai u ekzekutua, duke lënë dyvjeçaren Aida pa asnjë kujtim prej tij.

E ëma u la të rriste familjen e vetme në një komunitet të vogël siberian, dhe ajo kishte arritur ta bënte këtë përmes punës së rëndë dhe lutjes. Ajo u lexonte fëmijëve rregullisht nga Shkrimet.

Pavarësisht rrezikut të arrestimit dhe persekutimit, i çonte fëmijët në takimet e të krishterëve, të cilët takoheshin fshehurazi në shtëpitë e njëri-tjetrit. Ndonjëherë daja i saj qëndronte jashtë për t'u ruajtur nga ndonjë shenjë policie apo ushtarësh në rrugë. Aida e mban mend qartë të dielën që policia hyri me dhunë në një takim në shtëpinë e tyre. Kur u larguan, morën dajën dhe dy të krishterë të tjerë në pranga dhe i akuzuan për vepra kriminale.

Kur ajo ishte njëmbëdhjetë vjeç, e ëma u nda nga jeta. Një nga kujtimet më të qarta që kishte Aida ishte shqetësimi i s'ëmës se fëmijët mund të largoheshin nga Krishti ndërsa rriteshin. Pavarësisht nga përpjekjet e saj, Aidës iu venit besimi. Nuk ishte një kundërshtim i vullnetshëm, por më shumë humbje interesi. Aida u rrit nga një motër më e madhe, dhe duke shkuar sa andej-këndej, familja reshti së shkuari në takimet e kishës. Në shkollë u mësohej se nuk kishte Zot dhe dalëngadalë kjo fjalë nuk përmendej më në shtëpi.

BESIMI I RILINDUR

Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare Aida u transferua në Leningrad (sot Shën Peterburgu). Vëllai i saj Viktori, pesë vjet më i madh, kishte mbaruar shërbimin detar dhe ishte vendosur atje, dhe Aida u transferua për të qenë pranë tij. Një ditë, tema e fesë u përmend ndërsa flisnin të dy.

Aida tha: «Nuk e di, nëse ka Zot».

Ajo u habit nga intensiteti i përgjigjes së vëllait të saj, por kishte nevojë për prova.

Shumë shpejt pas bisedës me të vëllanë, Aida kaloi nga një dyqan antik librash dhe iu kujtua se dikush kishte përmendur që aty shiteshin Bibla. Pothuajse në çast, shkoi brenda dhe kërkoi. Shitësi i tha se Biblat ishin të rralla dhe dyqani nuk kishte më. Ajo po largohej kur një shitës tjetër e ndoqi dhe i ofroi një Dhiatë të Re për pesëmbëdhjetë rubla.

Ishte pothuajse gjithçka që kishte, por i dha si shkëmbim për librin e vjetër. Vëllai i Aidës u emocionua nga veprimi i së motrës, veçanërisht sepse erdhi në kohën kur kishte më tepër nevojë. Ishte diagnostikuar me kancer dhe mjekët i thanë se do të ishte

vdekjeprurës. Viktori i kishte kërkuar Aidës të shkonte në shtëpinë e lutjes dhe t'u tregonte shokëve për gjendjen e tij shëndetësore.

Aida veproi ashtu si iu kërkua, dhe miqtë e tij vinin rregullisht për ta vizituar dhe inkurajuar. Ajo pa shpirtin e të vëllait të gjallërohej gjithnjë e më shumë ndërsa sëmundja e çonte trupin e tij drejt vdekjes. U habit kur pa se besimi i tij te Krishti bëhej më i fortë, ndërsa trupi dobësohej. Donte shumë të kishte besimin dhe sigurinë e të vëllait. Ai po i afrohej vdekjes pa shqetësim e pa frikë, por me një siguri të thellë për shtëpinë e Tij të përjetshme.

Katër muaj pas diagnozës, Viktori u nda nga jeta. Duke qëndruar pranë shtratit të tij ndërsa ai shuhej, Aida ndjeu se dëshira e tij ishte që ajo të kuptonte se nuk po thoshte «Lamtumirë» por, «Shihemi më vonë».

Ajo donte të kishte të njëjtën siguri. Jeta e Viktorit, ashtu si edhe vdekja e tij, u kishte dhënë përgjigje shumë prej pyetjeve të saj. Pasi i diskutoi disa prej pyetjeve të tjera me miqtë e Viktorit në shtëpinë e lutjes, vendimi i saj u bë i qartë: Ajo do të ndiqte Krishtin me besim.

Kjo do t'i kushtonte shumë vajzës së re, por nuk do të pendohej kurrë.

NJË SHKËMBIM I LITERATURES DHE FJALËS

«A dëshironi t'i jepni një shpjegim gjyqit për sa u përket akuzave kundër jush?» – pyeti gjykatësi.

«Po, dua,» – u përgjigj Aida duke e ditur se vetë gjykatësi do ta drejtonte marrjen në pyetje. Për këtë gjykim ai ishte akuzuesi, gjykatësi dhe juria. «E pranoj faktin që kam shpërndarë literaturë siç përmendet në akuza.»

Ajo pranon faktet. Kjo çështje po mbaron më shpejt seç shpresoja. Duhej ta kishte mbajtur avokatin, – do ketë menduar me vete prokurori. Me nxitjen e gjykatësit, Aida tregoi për çdo person, të cilit i kishte dhënë materialet e përmendura. Ajo përmendi një objekt, një ditar që nuk ishte më i gjatë se dy apo tre faqe, por pranoi që ua kishte dhënë edhe të huajve.

«Çdo gjë tjetër e përmendur në akuza është e saktë?» – pyeti gjykatësi kur ajo kishte mbaruar.

«Po,» – u përgjigj ajo. «Të gjitha faktet që kam shpërndarë janë të vërteta, por kjo literaturë nuk përmban deklarata të rreme që shpifin për shtetin sovjetik dhe rendin shoqëror; kjo gjë nuk përbën krim nën artikullin 190/1, dhe shpërndarja e literaturës në vetvete nuk është krim. Unë shpallem e pafajshme.»

Në vend që ta pranonte menjëherë vërejtjen e saj, gjykatësi e pyeti për suedezen, zonjën Jursmar, së cilës Aida i kishte dhënë materiale, duke përfshirë transkriptin e dy gjyqeve të të krishterëve në gjykatat sovjetike. Aida refuzoi të tregonte se ku e kishte takuar zonjën Jursmar duke e quajtur «çështje private».

Duke e dëgjuar të prezantonte çështjen e saj, prokurori ngriti sytë duke menduar se ndoshta e reja do të luftonte më tepër seç kishte menduar ai.

Aida dha detajet qejfprishur: Ajo dhe zonja Jursmar kishin një shoqe të përbashkët në Suedi dhe kishte qenë kjo shoqe që kishte organizuar takimin. Zonja Jursmar kishte sjellë pesëdhjetë Dhiata të Reja, të cilat Aida kishte planifikuar t'ua kalonte pjesëtarëve të kishës së fshehtë, derisa policia t'i konfiskonte. Si shkëmbim, Aida i dha asaj literaturë, duke përfshirë disa letra dhe transkripte të gjyqeve, që t'ia dërgonte punëdhënësit të saj, Misionit Sllav. Që andej do të printoheshin dhe do të shpërndaheshin në mbarë botën.

«Pse i dhe kopje të '*Lajmëtarë të Shpëtimit*' dhe '*Broshura Vllazërore*',[1] transkripte të gjyqeve në Moskë dhe Rizan, edhe letra të Khorevit e Makhovitskit?» – pyeti ashpër gjykatësi.

«Që të mund t'i lexonin dhe të mësonin për jetën e kishës sonë», – i tregoi të vërtetën Aida. «'Lajmëtarët e Shpëtimit' është gazeta ime e preferuar dhe 'Broshura Vllazërore' flet për jetën e kishës sonë. Gjyqet janë bërë kaq shumë pjesë e jetës së kishës, saqë, nëse do të dish për kishat në Rusi, duhet të dish për këto gjyqe.»

Në të vërtetë, për ata që zgjodhën të ndiqnin plotësisht Krishtin, gjyqet kishin qenë një pjesë e pranueshme e jetës në Bashkimin Sovjetik. Arrestimet, të rrahurat, dhe burgimet ishin pjesë e çmimit për të ndjekur Krishtin dhe revistat e kishës së fshehtë e pranonin dhe e botonin këtë fakt.

Gjykatësi s'mund ta pranonte që Aida i besonte një gruaje që sapo e kishte takuar dhe i kishte dhënë një informacion sekret kaq të rëndësishëm.

«Mes besimtarësh, miqësitë zhvillohen më thjeshtë», – u përpoq të shpjegonte Aida. «Unë mund të shkoj në një qytet të panjohur, të takoj besimtarë që nuk i kam njohur më parë, dhe pas disa minutash të bëhemi miq të ngushtë. Besimtarët janë një familje e madhe dhe ne interesohemi për gjithçka për njëri-tjetrin.»

Prokurori filloi të ndërthurte pyetjet e tij me ato të gjykatësit, duke e pyetur Aidën për të gjitha adresat e huaja në bllokun e saj të adresave. Donte të dinte nëse ajo kishte kontaktuar me të gjithë.

«Disa prej tyre», – u përgjigj Aida. Pastaj, me një ton therës shtoi: «Nuk njoh ndonjë ligj, që i ndalon qytetarët sovjetikë të kenë korrespondencë me miq jashtë shtetit».

Disa besimtarë që kishin ardhur për të vëzhguar gjyqin fshihnin buzëqeshjet e tyre ndërsa prokurori ngriti kokën ashpër ndaj vërejtjes së Aidës. Më pas filloi të lexonte çdo emër në bllokun e adresave.

NJË GUXIM I VEÇANTË PËR UNGJILLIN

Aida nuk e kishte filluar shërbesën si korrespondente në vijën e frontit të kishës sovjetike. Kur pranoi Krishtin, kishte qenë një vajzë e re njëzetë e një vjeçare, plot gjallëri për Mikun e saj të ri me dëshirën për t'u treguar të gjithëve për Të.

Vendimi i saj erdhi ndërsa një rizgjim po ndodhte në Kishën Baptiste në Bashkimin Sovjetik. «Për ca kohë besimi po dobësohej», – do të thoshte ajo më vonë, «dhe papritur erdhi rizgjimi. Ishte e mrekullueshme ajo çka pashë. Pashë të vdekurit, të vdekurit shpirtërisht, të ngriheshin përsëri dhe të dobëtit u treguan të aftë për vepra të mëdha. Njoha madhështinë e përulësisë dhe durimit dhe se sa i madh ishte mundimi i kishës. Rizgjimi nxiti edhe shpirtin tim, dhe nga ajo kohë e më tej nuk munda të rrija pa u përfshirë».

Miqtë e saj të rinj nga shtëpia e lutjes së Viktorit e inkurajuan të dëshmonte. Ajo kishte parë ndërsa ata printonin kartolina me tekste ungjilli dhe mesazhe, që i nxisnin lexuesit: «Pendohuni dhe

besoni Lajmin e Mirë». I vendosnin kartolinat në kutitë postare, duke shkaktuar trazira në Leningrad, madje duke u publikuar në faqe të parë të gazetave lokale.

Që në ditët e para të përkushtimit të saj ndaj besimit, Aida kishte një guxim dhe zell të veçantë për ta ndarë me të tjerët. Vetëm disa muaj pasi u bë e krishterë, ajo sajoi një mënyrë të re mirëseardhjeje për vitin e ri të 1962-it. Bleu kartolina me pikturën e Klaud Lorrainit, pamje e agimit mbi port dhe për ditë të tëra punoi gjatë kohës së lirë, duke shkruar një mesazh të thjeshtë në secilën prej tyre:

GËZUAR VITIN E RI 1962!

Një urim për Vitin e Ri!

Vitet tona shkojnë shpejt
Njëri pas tjetrit, pa u vënë re
Dhembja dhe trishtimi zhduken;
Dhe prej jetës merren tej.
Kjo botë, toka, është e përkohshme,
Çdo gjë në të shkon drejt një fundi.
Jeta është e rëndësishme...Mos ji i pakujdesshëm!
Si do t'i përgjigjesh në fund Krijuesit?
Ç'të pret ty, miku im, përtej varrit?
Përgjigjiu kësaj pyetjeje sa ka dritë ende.
Ndoshta nesër, përpara Zotit,
Do të t'duhet të përgjigjesh për çdo gjë tënden.
Mendo thellë për këtë
Se nuk je përjetësisht mbi këtë tokë.
Ndoshta nesër mund t'i shkëpusësh
Përgjithmonë lidhjet me këtë botë!
Kërkoje zotin ndërsa ai gjendet!

Poemat në kartolina përfundonin me një thirrje të thjeshtë, e njëjtë me ato në kartolinat e printuara nga miqtë e saj: «Pendohuni dhe besoni Lajmin e Mirë!».

Pasi i shkroi të gjitha kartolinat, Aida i mblodhi me kujdes për shkak të ajrit të akullt dhe doli jashtë. Në sheshin e madh para

Muzeut Historik të Fesë dhe Ateizmit, vajza e re me flokë të zinj filloi t'i shpërndante. Punonte shpejt duke ua dorëzuar kalimtarëve, ndërsa ndante përshëndetjet e Vitit të Ri.

Kartolinat pothuajse kishin mbaruar kur një dorë e fortë i shtrëngoi krahun. «Çfarë është kjo?» – pyeti një burrë me pamje të zemëruar, duke ia valëvitur kartolinën në fytyrë.

«Një kartolinë për Vitin e Ri», – iu përgjigj ajo duke u përpjekur të largohej. Dukej shumë e vogël përbri burrit të inatosur, i cili e kapi për krahu dhe e shtrëngoi fort. Ai pa rreth e rrotull dhe filloi të thërriste oficerin e policisë në një qoshe më tej.

«Nuk kemi nevojë për këtë», – i tha ai duke skërmitur dhëmbët. Nuk e la të ikte derisa polici e kapi nga krahu tjetër dhe e çuan për te makina e tij.

NJË SHIJE E ASAJ QË DO TË VINTE

Ishte vizita e parë e detyruar e Aidës në stacionin e policisë së zonës. U mbajt për disa orë dhe më pas u lirua, por jo derisa policia të hapte një dosje për të dhe të shkruante të gjithë informacionin për «kartolinat ungjillizuese». Aida u ul me qetësi duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre dhe duke u mahnitur edhe vetë nga siguria që ndiente. Zoti ishte me të, e dinte se nuk duhej të kishte frikë nga autoritetet. Ndërkaq mendonte nëse dikush mund t'i kishte treguar oficerit për dashurinë e Krishtit për të.

Policia ia raportoi incidentin si punëdhënësit, ashtu edhe konviktit ku jetonte. Fërkimi i saj i parë me sistemin ligjor erdhi atë prill, kur një i ashtuquajtur «shok» dërgoi të dhëna kundër saj. Aida u ul në një stol para tre «shokëve», që do të vendosnin fatin e saj. «Akuzuesit», njerëz nga komuniteti, u sollën për të folur kundër saj. Një burrë i moshuar dridhej prej zemërimit ndërsa ulërinte: «Nuk dua të thith të njëjtin ajër. Nuk dua të eci në të njëjtën tokë me të».

Dëshmitarë të tjerë deklaruan se Viktori kishte vdekur, sepse nuk i ishte lejuar të merrte ndihmë mjekësore (e çuditshme për t'u thënë, mendoi Aida, përderisa ai kishte vdekur në një spital). Deklaratat e akuzuesve vazhduan ta habisnin më shumë. A nuk

ishte akuzuar se kishte shpërndarë kartolina të krishtera? Ç'lidhje kishte kjo me të vëllanë? Aida u përpoq të fliste për të mbrojtur veten dhe madje, edhe e veja e Viktorit u përpoq të fliste, por turma e pranishme në gjyq e bëri të pamundur këtë. Në fund të gjyqit, të pranishmit kërkuan që çështja e Aidës të dërgohej në një gjykatë me juridiksion më të lartë, ku mund të jepej një dënim më i rëndë. «Në Gjykatën e Popullit! Në Gjykatën e Popullit!» – thërrisnin ata.

Aida çuditej nga fakti që disa kartolina të thjeshta po nxisnin një urrejtje të tillë në turmë.

Tre zyrtarët e «Gjykatës së Shokëve» i morën lejen e qëndrimit në Leningrad dhe e hoqën nga puna. Pas dëshmisë së dëshmitarëve, turma e pranishme nuk mendonte se dënimi ishte mjaftushëm i ashpër. Përplasnin këmbët dhe i ulërinin vajzës së re, që qëndronte para tyre, duke kërkuar dënim më të ashpër. Për sigurinë e saj, Aidës i duhej të shoqërohej nga rojat.

Vendimi i gjyqit nuk u zbatua për shumë muaj; duke i dhënë mundësi policisë të vëzhgonte dhe të mblidhte të dhëna kundër vajzës së krishterë, jo të dhëna aktiviteti kriminal, por të punës së saj të krishterë. Aida vazhdonte të jetonte në Leningrad, duke gjetur punë ku të mundej. Jeta ishte bërë më e vështirë, por ky ishte vetëm fillimi.

«TI REFUZON T'U BINDESH LIGJEVE TONA»

Marrja në pyetje vazhdonte, gjykatësi dhe prokurori e pyesnin Aidën për çdo kontakt të huaj, çdo lloj informacioni që u kishte rënë në dorë.

Më pas, kaluan te botimet e krishtera që kishte shpërndarë ajo. Gjykatësi mori njërën prej revistave nga grumbulli i të dhënave dhe hapi me ngadalë fletët, duke kërkuar paragrafët, që i kishin nënvizuar më parë. Duke gjetur atë që mendonte se ishte pjesa më inkriminuese, filloi të lexonte me zë të lartë, rresht për rresht. Në fund të çdo fjalie, vështronte Aidën, duke e sfiduar të shpjegonte apo të verifikonte deklaratat.

Gjykatësi e pyeti për denominacione të ndryshme të krishtera, duke theksuar se ato nuk përballeshin me persekutimin.

«Nuk di gjë për persekutimin e besimtarëve të denominacioneve të tjera», – u përgjigj e lodhur Aida. «Ne shkruajmë vetëm për persekutimin e besimtarëve të kishës Baptiste dhe Ungjillore të Krishterë».

Prokuroi deklaroi se kushdo jashtë vendit, që lexonte literaturën do të mendonte se të gjithë të krishterët në Bashkimin Sovjetik përballen me persekutimin. Ai vazhdoi ku e la gjykatësi, duke lexuar revistat dhe duke e pyetur Aidën për çdo fjali, që i dukej e kundërshtueshme. Theksoi deklaratat në një revistë, sipas së cilës fëmijët e krishterë përballen me persekutimin në sistemin shkollor sovjetik. «Shkollat», sugjeroi ai, «thjesht po përpiqen të rregullojnë dëmin e bërë nga prindër të zellshëm, që i helmojnë fëmijët e tyre me besëtytni të kota».

«Ligji ndalon imponimin e besimit tek të miturit», – tha ai, duke ngritur kokën për t'u siguruar që gjykatësi po e ndiqte me kujdes.

«Por ligji nuk ndalon imponimin e ateizmit», – ia ktheu Aida.

«Ateizmi nuk është fe. Një fëmijë rritet dhe pastaj duhet ta vendosë vetë qëndrimin ndaj besimit. Ateizmi nuk u imponohet».

«Atëherë, çfarë i thuhet një fëmije?» – pyeti Aida, duke parë herë prokurorin e herë gjykatësin. «Është e ndaluar me ligj të thuhet se Zoti ekziston, por lejohet të thuhet se nuk ka Zot?»

Askush nuk foli dhe gjykatësi ndryshoi temë, duke ditur se nuk kishte përgjigje. Ai kërkoi që «e pandehura të mos dalë jashtë teme».

Prokuroi vazhdoi, duke lexuar më tepër komente prej një reviste tjetër. «A e dini se një komunitet fetar duhet të regjistrohet?» – pyeti ai të pandehurën.

«Po». Aida e dinte se duke u regjistruar, kisha vendosej nën kontrollin e qeverisë komuniste, një qeveri që mohonte çdo ekzistencë të Zotit, të cilit kisha i shërbente.

«Komuniteti yt nuk është regjistruar; kështu që nuk lejoheni të zhvilloni takime, por jo se ka persekutim të besimtarëve në vendin tonë», – tha ai, si një mësues i paduruar që i jepte mësim një fëmije të kopshtit.

«Komuniteti ynë ka kërkuar regjistrim», – iu përgjigj Aida me qetësi. «Kemi aplikuar, por jemi refuzuar».

«Jeni refuzuar, sepse nuk doni t'i bindeni ligjit». «Cilit ligj refuzojmë t'i bindemi?» – pyeti ajo.

«Ju kërkoni hapjen e shkollës së të dielës dhe doni të organizoni aktivitete fetare për fëmijë nën moshë».

«Nuk më kujtohet që komuniteti ynë të ketë kërkuar shkollë të së dielës» – iu përgjigj Aida. «Dhe sipas ligjit, prindërit mund t'i edukojnë fëmijët e tyre si të duan».

«Jo, *nuk munden*!» – tha me ton të ashpër prokurori. «Është e ndaluar me ligj t'i përfshish fëmijët nën moshë në shoqata fetare. Por ti refuzon t'u bindesh ligjeve tona».

«Sipas kushtetutës, kemi lirinë e besimit. Termi nënkupton rrëfimin e besimit», – iu përgjigj Aida. «Kjo do të thotë që është e mundur t'u tregosh të gjithëve për Zotin, që do të thotë të shpallësh besimin lirshëm. A nuk është kështu?»

Këtu Aida po paraqiste thelbin e çështjes së saj. Kushtetuta sovjetike thoshte se njerëzit janë të lirë të besojnë sipas zgjedhjes së tyre dhe t'i praktikojnë këto besime. Por udhëheqësit sovjetikë kishin frikë për besimin e të krishterëve; ata donin që e gjithë siguria dhe varësia të ishin te Partia Komuniste. «Heqja e besimeve fetare», – arsyetonin ata, – «do t'i bënte njerëzit të besonin te Partia me më tepër pasion.»

Por përsëri, gjykatësi nuk kishte përgjigje ndaj pyetjeve të Aidës. Kështu, edhe një herë ai ndryshoi temë, duke thënë se, nëse materiali në të gjithë revistën ishte i vërtetë, pse tregohej aq e rezervuar Aida për shpërndarjen e saj?

«Sepse ata që persekutojnë nuk duan që kjo gjë të bëhet e njohur», – iu përgjigj Aida, duke u dukur gjithnjë e më tepër si një avokate e trajnuar dhe jo si punëtore e thjeshtë fabrike. «E di se në literaturën që i keni dhënë zonjës Jursmar nuk ka pasur asnjë deklaratë të rreme. Te '*Lajmëtari i Shpëtimit*' dhe në '*Broshurën Vëllazërore*' përshkruhet situata e besimtarëve ashtu siç është në të vërtetë. Bie dakord me ty që nuk është e pëlqyeshme, por kjo është jeta e vërtetë dhe për këtë duhet folur. Kur po ia jepja literaturën zonjës Jursmar, e dija që këto materiale mund të më sillnin burgosjen. E kuptoja këtë. Por kjo nuk e ndryshonte të vërtetën që deklaronte literatura».

Prokurori mbajti shënim dhe më pas u ul. Më në fund, marrja në pyetje e Aidës kishte përfunduar, por jo gjyqi. Tani ishte radha e dëshmitarëve. Në fillim ishin fqinjët e saj, Anatoli dhe Alla Lavrenteva. Si gjykatësi, ashtu edhe prokurori iu vërsulën me pyetje: «A fliste ajo për besimin e saj?», «A ju ka dhënë ndonjë literaturë?», «A kishte radio apo televizor?», «A jetonte sipas të ardhurave të saj?», «Si vishej?», «Çfarë gatuante?»...

As Anatoli dhe as Alla nuk thanë se ajo ishte kriminele.

«Aida shkonte mirë me të gjithë», – tha Anatoli. «Vetëm mirë mund të flasësh për të».

U thirr për të dëshmuar një tjetër fqinj dhe i bënë më tepër pyetje për veshjen, sjelljen dhe punësimin e saj.

Më në fund u thirr në bankën e dëshmitarit një bashkëbesimtare, Marja Akimovna Skurlova. Ajo kishte pesë vjet që e njihte Aidën. Të dyja kishin adhuruar dhe ishin lutur së bashku dhe, kur Aida doli nga burgu pas një viti dënim, Marja i gjeti një vend për të qëndruar.

Marja e pranoi që e kishte ndihmuar të pandehurën.

«Ju thoni se Aida u pushua nga puna sepse ishte besimtare», – pyeti gjykatësi. «Pse nuk të kanë pushuar edhe ty nga puna? Sigurisht që ti punon».

«Nuk ka ardhur ende radha ime», – u përgjigj Marja.

Marja e pranoi që të huaj kishin ardhur në apartamentin e saj kur ishte bashkë me Aidën, por nuk dinte nëse Aida u kishte dhënë ndonjë gjë.

Aida e pyeti shoqen e saj për persekutimin e besimtarëve të krishterë. Marja tha emrat e të krishterëve që ishin marrë në pyetje apo që u ishte kontrolluar shtëpia nga policia, dhe të tjerë që ishin arrestuar.

«E di që besimtarëve iu janë vënë gjoba», – dëshmoi Marja. «Sukovitsyni u gjobit...»

«Pse u gjobit?» – ndërhyri prokurori ndaj pyetjes së Aidës.

«Sepse u lut.»

«Ku u lut?»

«Ai i drejtonte lutjet në apartamentin e Lukasit. Kishte një takim atje.»

«Vërtet!» – tha prokurori, duke thirrur pothuajse me triumf. «Po mbahej një takim në një vend të paautorizuar. Ju keni shtëpi lutjeje; shkoni dhe luteni atje!»

Më vonë, prokuroi e ndërpreu përsëri kur Marja po dëshmonte se ishte gjobitur ngaqë kishte marrë pjesë në një takim të krishterë.

«Ku po zhvillohej takimi?» – pyeti ai.

«Në pyll.»

«Është e ndaluar të kesh shërbesë në një vend publik. Ja pse je gjobitur.»

Ai uli kokën në shenjë miratimi drejt gjykatësit me një buzëqeshje kënaqësie në fytyrë.

«Nuk kishte asnjë tjetër në pyll; ishim vetëm. Zhvilluam takimin dhe u larguam, por disa prej nesh u morën në platformë ndërsa po ktheheshim në shtëpi.» Marja përmendi shembuj të tjerë, ku të krishterët ishin sulmuar nga policia dhe më pas u lejua të largohej.

Dëshmitari i fundit i çështjes ishte Jekaterian Andrejevna Boiko, shoqe dhe bashkëbesimtare e Aidës. Ajo e identifikoi Aidën si shoqen e saj dhe dëshmoi se ishte «e mirë dhe e sjellshme».

Jekaterina pohoi se si policia kishte shkuar në apartamentin e saj për të kërkuar Aidën. Oficerët kishin dyshuar se Aida ishte spiune; dhe e nxitën Jekaterinën dhe fqinjët e tjerë të lajmëronin nëse e shihnin në ndërtesë.

Ishte e qartë që Jekaterina ishte dëshmitare kundërshtuese e persekutimit. Hera-herës, përgjigjet e saj ishin vetëm një rrokje. Herë të tjera, qëndronte e heshtur pasi i drejtohej ndonjë pyetje.

«Çfarë di për vizitën e turistes suedeze te Skripnikova?» – pyeti prokurori.

«Nuk dija asgjë për këtë. E zbulova të nesërmen. Policia erdhi në apartamentin e Aidës, ndërsa isha atje. Një polic tha se literatura ishte marrë nga një e huaj dhe se ia kishte dhënë Aida.»

Prokurori pyeti për arsimimin e saj, pasi kishte përfunduar klasën e dhjetë. «Pse nuk ke studiuar më tej?»

«Doja të shkoja në shkollë mjekësie,» – u përgjigj Jekaterina, – «por në referencat për karakterin tim shkruhej se isha besimtare dhe anëtare e baptistëve përçarës. Kështu që nuk hyra në shkollën e mjekësisë. Do të isha përjashtuar sidoqoftë.»

«Dhe madje, as nuk u përpoqe?» Një ton talljeje vërehej në zërin e avokatit.

«E dija nga shembujt e të tjerëve që gjithsesi nuk do të më lejonin të studioja.»

Kur erdhi radha e Aidës për t'i bërë pyetje dështmitares, ajo pa para vetes një mikeshë. Filloi me pyetje të përgjithshme dhe më pas kaloi në trajtimin e besimtarëve të krishterë nga shteti sovjetik. Aida pyeti specifikisht për besimtarët që ishin gjobitur nga policia dhe Jekaterian i përmendi, duke dhënë detaje për disa prej rasteve.

«Pse zhvilloni takime lutjeje në pyll?» – ndërpreu gjykatësi. «Ju keni shtëpi lutjeje në Poklonaja Hill. Pse nuk shkoni atje? Komuniteti juaj nuk është i regjistruar. Ju mbani takime në një vend të paautorizuar dhe prishni rendin publik. Ja pse je gjobitur.»

«Kemi aplikuar për regjistrim. Takimet tona në pyll nuk kanë shqetësuar asnjë në Lavriki.»

Prokurori pyeti nëse ajo ishte qytetare besnike, e detyruar t'u bindej ligjeve të vendit.

«Unë u bindem ligjeve,» – këmbënguli Jekaterina.

«Ju takoheni në pyll dhe në shtëpinë e Lukës dhe komuniteti juaj nuk është regjistruar,» – tha prerazi prokurori. «Kështu që ju nuk u bindeni ligjeve.»

«Takimet e lutjeve në shtëpinë e Lukës nuk janë kundër ligjit.» Ajo citoi me guxim Leninin, i cili i quante ligjet kundër besimit, «të turpshme».

Duke mos dashur të diskutonin për një prej themeluesve të komunizmit, prokurori e ndërpreu menjëherë dështmitaren dhe e la të lirë.

PIKA E KTHESËS

Aida ishte përpjekur ta praktikonte besimin e saj të krishterë brenda kufijve të ligjit sovjetik. Gjatë muajve të parë si e krishterë shkonte rregullisht në shtëpinë e lutjes, që ishte e regjistruar dhe e miratuar nga qeveria sovjetike. Ishte e lumtur dhe e kënaqur që adhuronte me bashkëbesimtarë të tjerë dhe nuk ishte ende e vetëdijshme për politikën brenda kishës së regjistruar.

Ndërsa vazhdonte të adhuronte dhe të shërbente, kufizimet filluan t'i viheshin kundër. Ishte e përfshirë në një studim Bible me të rinjtë, por u paralajmërua të mos ua bënte të ditur drejtuesve të kishës. Ligji komunist e ndalonte «ndarjen fetare» me të gjithë ata, që ishin nën tetëmbëdhjetë vjeç dhe udhëheqësit e kishës së regjistruar dukej se kujdeseshin më tepër për ligjin komunist se sa për shpirtrat e humbur.

Aidës i kujtohej shtëpia e lutjes, ku kishte shkuar me mamanë e saj. I kujtohej ndjenja e pranisë së Zotit atje dhe fakti që fëmijët dhe të rinjtë ishin të mirëpritur dhe trajnoheshin. T'i pengoje të rinjtë të dëgjonin ungjillin nuk i dukej e drejtë dhe as përkonte me mësimet e Shkrimeve.

Pika e kthimit ndodhi kur Aida filloi të punonte për të krishterët, që ishin burgosur për besimin e tyre. Vizioni i saj i hershëm ishte ndarja e informacionit dhe zhvillimi i një rrjeti lutjeje dhe mbështetjeje për ta. Udhëheqësit e kishave të regjistruara kishin listat e atyre që ishin në burg, por ato ishin trajtuar si sekret shtetëror dhe jo si informacion që të krishterët e tjerë duhet ta dinin.

Për Aidën, ky ishte pikërisht informacioni që të tjerët duhej ta kishin. Si mund të luteshin dhe t'i mbështesnin të krishterët e tjerë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera këta vëllezër e motra të burgosur, nëse nuk dinin gjë për vuajtjet e tyre?

Aida punoi për të përhapur fjalën, një përpjekje që i krijoi konflikt të drejtpërdrejtë me drejtuesit e kishave të regjistruara.

«Puna është se, me pak fjalë, autoritetet përpiqeshin të punonin në kishë nga brenda, përmes drejtuesve», – tha Aida më vonë. «Ata donin të vendosnin pengesa që të shtypnin jetën shpirtërore të kishës. Dhe në fakt, në vitet '60-të patën shumë sukses në këtë fushë.»

Pozicioni i drejtuesve kishte qenë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me përpjekjet e Aidës për të hapur fjalë për besimtarët e burgosur. Kështu, asaj i ishte dashur të përballej me një zgjedhje: të qëndronte brenda kishës së regjistruar dhe të punonte për të mbrojtur veten ose t'i bashkohej kishës së fshehtë dhe të punonte për të mbrojtur vëllezërit dhe motrat në burg. Tërheqja e kishës së regjistruar kishte qenë e vërtetë. Mbi

të gjitha, kishte qenë grupi, të cilit i kishte përkitur i vëllai para se të vdiste dhe ajo kishte shumë miq atje.

Por Aida e refuzoi zgjedhjen e lehtë pasive. Refuzoi të ndiqte drejtuesit, të cilët ishte e qartë se ishin më tepër të shqetësuar për miratimin e qeverisë se sa për të krishterët në burgje. Ajo u përfshi plotësisht në kishën e fshehtë, duke e ditur, që do të paguante një çmim për vendimin e saj.

Më 4 Qershor, 1962, doli një artikull në «*Smena*», një gazetë që shërbente si zëdhënëse e qeverisë sovjetike. Artikulli, i titulluar «Mos qëndro si kufomë midis të gjallëve», kërkonte të diskreditonte besimtarët në përgjithësi dhe kishën e fshehtë në veçanti. Politika e qeverisë thoshte se nuk kishte Zot dhe artikulli tallte dhe vinte në lojë ata që zgjidhnin të ndiqnin një mesia imagjinar.

Kur Aida e pa artikullin shkroi si përgjigje, një mbrojtje të besimit të saj dhe të atyre që e ndiqnin. Ia dërgoi përgjigjen gazetës «*Smena*», por sigurisht që iu refuzua botimi. Çështja mund të kishte përfunduar këtu, por Aida ia tregoi artikullin e gazetës dhe përgjigjen e saj bashkëbesimtarëve. Të mahnitur, ata kërkuan një kopje. Më pas, disa besimtarë erdhën për vizitë nga Ukraina; edhe ata kërkuan kopje. Shumë shpejt qindra kopje u shpërndanë nga një besimtar te tjetri, në të gjithë Bashkimin Sovjetik. Anëtarët e kishës së fshehtë u alarmuan kur lexuan për sulmet ndaj besimit të tyre dhe më pas u inkurajuan kur lexuan përgjigjen e guximshme dhe të arsyetuar mirë të një prej bashkëbesimtarëve. Aida ishte në krye të *zamizdatit*, një praktikë e re e një komunikimi të botuar vetë. Zyrtarët e qeverisë s'mund të ruajnë çdo fotokopje apo shtypshkronjë në vend.

Përmes shkrimeve të saj, emri i Aida Skripnikovës u bë i njohur për mijëra besimtarë, që nuk i kishte njohur kurrë. U bë e njohur edhe në sfera të tjera: rangjet e policisë sekrete.

ELEMENTËT KRYESORË

Duhej të kishte dëshmitarë të tjerë në gjyqin e Aidës, por nuk erdhën. Gjithsesi gjykatësi vendosi që gjyqi të vazhdonte.

E mërzitur, Aida u ankua se gjyqi kishte kaluar më shumë kohë duke u marrë me shtëpinë e saj, veshjen dhe madje edhe me gatimin se sa duke konsideruar çështjet themelore.

«I kërkoj gjyqit t'u kushtojë më tepër vëmendje elementëve kryesorë të çështjes», – u lut ajo. «Për shembull, do të doja të shpjegoja pse nuk është regjistruar komuniteti ynë. Si fillim, më thoni ju lutem, cilat ligje kemi thyer që na refuzohet regjistrimi?»

«E pandehur», – iu përgjigj gjykatësi me siguri, «gjyqi ju bën juve pyetje, jo ju gjyqit».

Duke parë zemërimin e gjykatësit, prokurori ndërhyri: «S'mund ta kuptoj çfarë kërkon e pandehura».

Aida mori frymë thellë duke mbledhur veten: «I kërkoj gjyqit t'u kushtojë më tepër vëmendje pyetjeve kryesore të akuzës në mënyrë që çështjet dytësore të mos errësojnë aspektet kryesore të çështjes në shqyrtim. Ky është peticioni im i parë. E dyta, ju kërkoj juve, gjyqit, të gjeni datën e saktë kur u konfiskua lejeqëndrimi im.»

Gjykatësi pyeti për ç'arsye ishte i rëndësishëm ky informacion.

Aida shpjegoi se gjyqi kishte zbuluar se policia kishte mbledhur të dhëna kundër saj shumë kohë para se t'i skadonte lejeqëndrimi. «Nëse gjykohem për një leje qëndrimi të skaduar, dhe jo për shkak të aktiviteteve të mia si e krishterë, atëherë pse isha nën hetim *përpara se të skadonte lejeqëndrimi?*», – pyeti ajo.

«Mund t'ju them pse filluan procedurat kundër meje», -vazhdoi ajo. «Dy herë në shtëpinë tonë të lutjes iu afrova të huajve dhe u kërkova një Bibël. Këto dy kërkesa iu bënë të njohura autoriteteve.»

«Pyetja për lejen e qëndrimit nuk ka të bëjë me çështjen», – tha gjykatësi. «Ti akuzohesh se ke shpërndarë hapur deklarata të rreme, që shpifin kundër shtetit sovjetik dhe rendit shoqëror.»

«Por çështja e punës dhe e lejeqëndrimit ka marrë shumë vëmendje në procedurat gjyqësore», – ia ktheu Aida.

«Këto çështje i interesonin gjyqit, jo sepse ti akuzohesh për to, por se ai duhet të përcaktojë personalitetin tënd. Mund të duket e çuditshme që gjyqi pyet madje edhe për karakterin tënd. Ai duhet të dijë se ç'lloj personi je. Në marrjen e vendimit, ai merr parasysh personalitetin e të pandehurit.»

Aida tha se, «nëse gjykata donte vërtet të dinte rreth karakterit të saj, atëherë ishte edhe më e rëndësishme të diheshin faktet e

vërteta të historisë.» Kërkesa e saj e fundit për gjykatësin ishte të thërriste edhe një dëshmitare të fundit, zonjën Jursmar, suedezen, së cilës i kishte dhënë literaturë. «Ky bllok i kësaj gruaje është përdorur si e dhënë kundër meje», – arsyetoi Aida, «por për ta kuptuar saktë, duhet ta kemi atë të pranishme».

Gjykatësi bëri sikur do ta konsideronte kërkesën e saj, duke i kërkuar prokurorit opinionin e tij, dhe më pas vendosi: «Pas konsultimit, peticioni i së pandehurës refuzohet».

U bënë edhe disa pyetje të fundit dhe më pas gjyqi u tërhoq për atë ditë. Kishin mbetur argumentet e fundit. Për prokurorin, kjo ishte mundësia për të mbrojtur sistemin sovjetik, për të shpjeguar se të krishterët e kishin lirinë e besimit, nëse vepronin sipas ligjit.

Për Aidën, ishte mundësia e fundit për të folur në emër të saj dhe të vëllezërve dhe motrave në kishë. Ndjeu barrën e rëndë të përgjegjësisë, duke qenë e sigurtë për rrezikun e riburgosjes, por ishte e inkurajuar nga ngushëllimi prej Atit qiellor.

NJË PËRPJEKJE NË «RIEDUKIM»

Kërcënimi me burgosje nuk ishte një fjalë goje. Ajo kishte qenë atje edhe më parë. Pasi «Gjykata e Shokëve» ia kishte tërhequr lejeqëndrimin në vitin 1963, kishte kaluar pak kohë për vizitë tek e motra në Ukrainë, ku aty i kishte bërë përshtypje këmbëngulja dhe guximi i besimtarëve. U kthye në Leningrad me vendosmëri të re. Ndërkaq policia po e ruante, por Aida hyri në qytet dhe ia doli t'i shmangej kapjes. Pa leje qëndrimi, mund të arrestohej në çdo kohë, por përsëri e vazhdoi punën e krishterë.

Aida dhe miqtë e saj vazhduan të mblidheshin në pyll jashtë qytetit për t'i shpëtuar gjurmimit dhe në vitin 1965, aty u bë arrestimi i parë zyrtar. Ishte njëzetë e pesë vjeç.

«Policia mbërriti dhe filloi të na ndiqte», – dëshmoi më vonë një prej dëshmitarëve. «Na shtynë dhe na kapën prej flokësh. Morën disa njerëz; disa prej tyre i gjobitën, ndërsa disa i burgosën për dy javë.»

Aida ishte një prej të arrestuarve dhe policia organizoi një gjyq për të. Në letër, akuza nuk kishte të bënte aspak me fenë.

Megjithëse ishte arrestuar jashtë kufijve të qytetit, u akuzua se nuk kishte leje të përshtatshme qëndrimi për në Leningrad.

Në gjyq, në një sallë të vogël në ndërtesën e gjykatës në Rajon, Aida nuk u lejua madje as të fliste. Ishte e qartë që gjyqi ishte një fasadë; përpjekje për të vendosur drejtësi kur në fakt kjo nuk ekzistonte. Kur përfundoi, u lexua vendimi: një vit burgim.

Ajo nuk u ndie shumë e prekur nga vendimi. Kishte pasur kontakte rregullisht me besimtarë që kishin qenë në burg dhe që ishin gati të shkonin përsëri, nëse aty do t'i drejtonte Krishti. Tani ishte radha e saj.

Qëllimi i burgut për udhëheqësit sovjetikë ishte riedukimi. «Këta njerëz të gjorë janë gënjyer», – shpjegonin zyrtarët, «dhe tani duhet të mbyllen dhe të binden për të vërtetën dhe fuqinë e sistemit sovjetik, lavdia e mëmëdheut».

Përveç sesioneve rutinë të riedukimit, Aida detyrohej të kalonte shumë net të ftohta në një dysheme të fortë çimentoje. Nuk kishte asnjëherë ushqim të mjaftueshëm, dhe kur kishte, ai nuk ishte i mirë as për kafshët. Gjatë burgimit, Aida u detyrua të shkonte në një qendër psikiatrike. Pas tridhjetë ditësh vlerësimi, mjekët thanë se ishte normale dhe mund të kthehej në qeli. Muajt në një sistem burgu mizor komunist i shtuan vite dhembjeje dhe vurrata vajzës së re të zellshme e të çiltër.

Aida nuk i ishte dorëzuar «riedukimit» sovjetik. Në vend që t'ia dobësonte besimin, kjo përvojë ia forcoi më tepër. Në vend që të reshtte së ndari Fjalën, ajo u largua prej burgut me më tepër pasion për të ndarë të vërtetën e Jezusit. Tani e dinte shumë mirë çmimin e të vepruarit në këtë mënyrë, por përsëri nuk u lëkund asnjëherë në vendosmërinë e saj.

«SHTETI NUK NDËRHYN»

Erdhi koha për argumentet përfundimtare në gjyqin e dytë të Aidës. Përmbledhja e prokurorit ishte e para, i cili zgjodhi të fillojë duke treguar historinë e kishës në Rusi.

«Pas revolucionit socialist të tetorit në vendin tonë, kisha u nda nga shteti dhe besimtarët e të gjitha besimeve morën të drejtën e lirisë së besimit», – deklaroi ai me krenari.

Më pas prokurori vazhdoi duke akuzuar të krishterët ungjillorë e baptistë dhe këshillin e kishave se inkurajonin besimtarët të mos u bindeshin ligjeve të shtetit.

«Komunitetet që mbështesin këshillin e kishave nuk janë të regjistruara», – akuzoi prokurori. «Takimet e tyre të paligjshme zhvillohen në shtëpi private dhe në vende publike. Disa besimtarë janë dënuar, sepse kanë thyer legjislacionin mbi kultet. Këshilli i kishave e paraqet këtë si persekutim ndaj besimit. Për shtatë vjet, këshilli i kishave ka vazhduar këtë përleshje titanike me autoritetet».

Nga historia e kishës dhe situata e përgjithshme midis besimtarëve, prokurori më në fund kaloi në gjërat specifike të çështjes së Aidës. «Skripnikova ka patur lidhje në mbarë vendin, por detyra e saj kryesore ka qenë organizimi me kontaktet jashtë vendit. Duhet thënë se ia ka dalë mbanë mirë», – shtoi ai me keqdashje.

Atëherë, toni i tij u bë më zotërues. «Ajo lindi në një familje baptistësh. Sigurisht që është për të ardhur keq që lejojmë një person të na rrëshqasë, por i kemi folur shumë dhe ia kemi bërë të qartë karakterin e saj antisocial».

Zëri i tij arriti kulmin ndërsa jepte komentet e fundit, duke cituar disa pjesë prej literaturës së gjetur në shtëpinë e Aidës. «Njëri prej artikujve citonte një njeri të quajtuar Krushkov që thoshte, në gjyqin e tij në Moskë: 'Ata vëllezër që janë në burg dhe kampe nuk vuajnë se kanë thyer ligjet sovjetike, por sepse i kanë qëndruar besnik Zotit.'»

Prokuroi tundi kokën solemnisht. «E gjithë kjo është një deklaratë e hapur false, që shpif kundër shtetit sovjetik dhe rendit shoqëror. Në Bashkimin Sovjetik ka besime të ndryshme, kishat janë të hapura dhe *askush* nuk persekutohet për shkak të besimit të tij. Shteti *nuk* ndërhyn në aktivitetet e trupit fetar nëse ata nuk thyejnë legjislacionin mbi kultet. Faji i së pandehurës Skripnikova, që ka shpërndarë vazhdimisht deklarata të rreme, që shpifin kundër shtetit sovjetik dhe rendit shoqëror, është *provuar plotësisht*. Këto veprime janë paraqitur saktësisht nga artikulli 190/1 i kodit kriminal. Kështu, kërkoj që gjyqi ta dënojë të pandehurën, Aida Skripnikova, me dy vjet e gjysmë heqje lirie.»

Me të mbaruar këtë, u ul me një pamje kënaqësie në fytyrë.

«PËR TË KRISHTERËT KA VETËM NJË RRUGË»

Gjykatësi iu kthye Aidës, duke i bërë të ditur se ishte radha e saj të paraqiste fjalimin përfundimtar në mbrojtje të vetes.

«Kisha ndër mend të flisja për thelbin e akuzave ndaj meje», – filloi ajo me zë të qartë e të qetë. «Por janë përmendur çështje të tjera, kështu që duhet të merrem me to, megjithëse ashtu siç është thënë, nuk kanë lidhje me çështjen».

Ajo filloi duke refuzuar disa prej çështjeve të vogla, që pala akuzuese i kishte ngritur që nga letra që kishte shkruar në *Pravda* në 1958-ën e deri te puna e saj në një laborator ndërtimi më vonë. Më pas filloi të merrej me çështje më të rëndësishme.

«Kur them se më pushuan nga puna e parë për shkak të besimit, më thonë: 'Kjo është deklaratë e rreme'. Por në të vërtetë kështu ka ndodhur. Pas lirimit tim nga burgu, gjeta punë në një shtypshkronjë. Një javë pasi fillova punë, kur isha në një takim lutjeje erdhi policia dhe mori emrin tim dhe të disa të tjerëve. E dija që do të më raportonin në vendin e punës», – tha Aida.

«Të gjithë në shtypshkronjë u alarmuan kur zbuluan se isha besimtare dhe filluan të më thoshin se, nëse nuk ndryshoja pikëpamjet e mia, do të pushohesha nga puna. Nuk ma fshehën këtë fakt. Më thanë menjëherë: 'Shtypshkronja është institucion politik. Jo çdokush mund të punojë këtu', megjithëse ajo ishte nën menaxhimin e hekurudhës dhe nuk printohej asgjë sekrete aty, vetëm formularë hekurudhash, leje hyrjeje dhe orare trenash. Nuk e dija çfarë kishte atje për të cilat unë s'mund të isha person i besuar», – vazhdoi ajo.

«Gjërat vazhduan në këtë mënyrë për tri javë. Më pas, më thirrën në zyrën e menaxherit dhe më thanë se isha e pushuar. Sigurisht që nuk më thanë se po më pushonin për shkak të besimit tim, sepse nuk kishte ligj të tillë, që i lejonte njerëzit të pushoheshin nga puna se ishin besimtarë. Kështu që më thanë se do shkurtohej vendi i punës. Kur thashë se më kishin pushuar se duhej shkurtuar stafi, punonjësit hapën sytë nga habia. Njërën prej makinerive nuk kishte kush ta vinte në punë.

Menaxheri më tha: 'S'mund të të punësojmë, sepse lejeqëndrimi yt është i vlefshëm vetëm jashtë qytetit', sikur të mos e kishte

parë më parë këtë gjë dhe të mos i kishte kontrolluar më parë dokumentet e mia.»

Aida tha se, nëse një polic fillonte t'i bënte pyetje, e siguronte atë se ky ishte tregues i një arrestimi të ri. «Vetëm gjashtë muaj kishin kaluar që nga lirimi im, dhe unë doja të bëja diçka të dobishme para se të shkoja përsëri në burg. Kisha një detyrë që më duhej ta kryeja».

Mori frymë thellë. Duke argumentuar se çështja e saj ishte rraskapitëse, se kërkonte një përqendrim mendor, emocional dhe shpirtëror që ishte i vështirë për t'u ruajtur për një kohë të gjatë, i kërkoi gjykatësit një pushim prej dhjetë minutash dhe ai pranoi.

Kur gjyqi filloi përsëri, Aida i përqendroi komentet specifikisht te çështja kundër saj. «Shpërndarja e botimeve nuk është krim në vetvete dhe, nëse pala akuzuese nuk gjen ndonjë deklaratë të rreme në revistat 'Lajmëtari i Shpëtimit' dhe 'Broshura Vëllazërore', atëherë nuk ka baza mbi të cilat të më gjykoni. Kështu që duhet të flas për përmbajtjen e kësaj literature.»

Ajo foli për një takim të ndaluar të të krishterëve dhe drejtuesve të krishterë, që diskutohej në literaturën që kishte shpërndarë. «Ligji 1929-të thotë se besimtarët kanë të drejtë të organizojnë kongrese», – vuri në dukje Aida. «Por në vend që të jepnin leje, autoritetet filluan t'i persekutonin ata, që kishin kërkuar një kongres».

«Tjetër gjë, hetuesi i prokurorit shënoi shtatëmbëdhjetë shprehje rebeluese, që i kishte nxjerrë prej literaturës. Sipas hetuesit, këto shprehje përmbanin deklarata të rreme, që shpifnin kundër shtetit sovjetik dhe rendit shoqëror».

Këtë herë Aida u kthye dhe iu drejtua gjykatësit: «Gjatë dëshmisë së saj, zonja Boiko filloi të citojë Leninin; do të plotësoj citimin që filloi ajo: 'Vetëm në Rusi dhe Turqi kishte ligje të turpshme kundër njerëzve fetarë. Këto ligje ndalonin drejtpërdrejt shpalljen hapur të besimit apo propagandën e tij. Ato janë më të padrejtat dhe më të dhunshmet'. Dua të tërheq vëmendjen ndaj fjalës propagandë. Vetë Lenini e quajti ndalimin e propagandës së besimit, të padrejtë dhe të turpshëm.»

Mori frymë edhe një herë dhe vazhdoi. «Tani do të tregoj se si më arrestuan. Në 11 prill shkova në një takim lutjeje. E vura re

që po ndiqesha, por nuk ia vura veshin. Të nesërmen policia erdhi në apartamentin tim dhe më arrestoi. Kërkime janë bërë edhe në shtëpitë e besimtarëve të tjerë. Në lidhje me çështjen time, kishte njëmbëdhjetë kërkime: tre në Leningrad, katër në Perm, tre në Krovograd dhe një në shtëpinë e motrës sime, në Magnitogrosk. Mund të kuptohet kërkimi në shtëpinë time dhe të motrës sime, por pse të bëheshin kërkime në shtëpitë e besimtarëve të tjerë? Këto u bënë vetëm për shkak të adresave të gjetura në bllokun tim. Dhe në asnjë prej këtyre vendeve nuk u gjet gjë lidhur me çështjen time.»

Më pas Aida iu kthye pyetjes se, «për çfarë po paditemi». «Ne themi se po paditemi për shkak të besimit tonë, por na është thënë: 'Kjo është një deklaratë e rreme, ju po gjykoheni se keni thyer ligjin sovjetik?' Jam anëtare e një komuniteti të paregjistruar, e cila kërkoi regjistrim. Të gjitha komunitetet tona kanë dërguar aplikime, që përfshijnë statutet tona, dhe kur e bëjmë nuk na thuhet: 'Nuk duhet të veproni kështu apo ashtu; është kundër ligjit', por, 'Firmosni se nuk do të thyeni ligjin'. Kjo nuk është procedura e rregullt për regjistrim.»

Aida vuri re se gjykatësit po i humbiste durimi, kështu që nxitoi të përmblidhte argumentin e saj. «Besimtarët *s'mund* të premtojnë të përmbushin ligjin, që i ndalon të flasin për Zotin dhe t'u ushqejnë fëmijëve besimin. Me gjithë besnikërinë e tyre ndaj autoriteteve, asnjë prind i krishterë nuk do të pranojë një ligj, që i urdhëron t'i rrisin fëmijët e tyre si ateistë. Do të zgjidhnin çfarëdolloj vuajtjeje, do të qëndronin më mirë në bankën e të akuzuarve se sa të premtonin t'i bindeshin një ligji të tillë.

Krishti tha se duhet t'ia predikojmë ungjillin çdo krijese», – vazhdoi Aida, – «dhe besimtarët s'mund t'i binden një ligji, që u ndalon të flasin për Zotin dhe shpëtimin. *Asnjë besimtar i vetëm nuk do ta bëjë këtë*. Edhe pse mund të mos jetë misionar apo predikues. Edhe nëse nuk është në gjendje të predikojë, nuk ka ndryshim, nuk do t'i bindet një ligji të tillë. Kështu që besimtarët nuk do të premtojnë se do ta zbatojnë këtë ligj pavarësisht respektit për autoritetet.

Do ta përsëris edhe një herë: Besimtarët s'mund të zbatojnë një ligj, që i detyron të mohojnë ungjillin. Kështu që kur gjykohemi

se thyejmë këtë ligj, jemi të justifikuar kur themi se gjykohemi për shkak të besimit tonë.

E di se '*Lajmëtari i Shpëtimit*' dhe '*Broshura Vëllazërore*' nuk përmbajnë ndonjë deklaratë të rreme. Po në të njëjtën kohë e di çfarë do të thotë t'i dërgosh jashtë vendit. E dija se ky veprim do të më sillte në bankën e të akuzuarve. S'do t'i kërkoja asnjëherë dikujt tjetër të dërgonte '*Lajmëtarin e Shpëtimit*' jashtë vendit, sepse e di që është e rrezikshme; ja, pse e bëj vetë.»

Aida pushoi, duke mbledhur fuqitë për fjalën e fundit të mbrojtjes të saj, mendimet e fundit pasionante. «Dikur njerëzit e kuptonin se ishte e padrejtë të ndalonin propagandimin e besimit, tani nuk e kuptojnë. Tani thonë: 'Kini besim te vetja dhe lutuni, por mos guxoni t'i flisni dikujt për Zotin!' Të bësh të heshtë ideologjinë e kundërshtarit me forcë nuk është fitore ideologjike. Ky është quajtur barbarizëm.»

Gjykatësi e ndërpreu i zemëruar që kjo kriminele po predikonte tani në sallën e tij të gjyqit. «Nuk duhet të flasësh për kishën, fol vetëm për vete», – tha ai, duke i theksuar fjalët ndërsa i drejtohej.

Aida qëndroi e patundur. «Për të krishterët ka vetëm një rrugë», – tha ajo. «Të krishterët s'mund të jenë tjetër veç konfrontues. Kur e njeh të vërtetën, duhet ta ndjekësh dhe nëse është e nevojshme të vuash për të. S'mund të jetë ndryshe. S'mund të veproj ndryshe. E dua lirinë dhe do të doja shumë të isha e lirë për të qenë me familjen dhe miqtë e mi. Por nuk dua të veproj kundër ndërgjegjes sime. Ç'të mirë do të më sillte liria nëse s'mund ta thërras Zotin, Atin tim? Të di se shpirti dhe mendimet e mia janë të lira, më inkurajon dhe forcon. Kjo është gjithçka që doja t'ju thosha.»

Aida u ul; me çështje të prezantuar dhe me zemër të pastër.

EPILOG

I paprekur nga shpirti i saj dhe i pabindur nga argumentet, gjykatësi e dënoi Aidën me tre vjet në një burg sovjetik, një dënim gjashtë muaj më shumë nga sa kishte kërkuar pala paditëse. Aida u largua nga salla e gjyqit e shoqëruar nga dy roja trupmëdhenj.

Por burgosja e saj s'mund t'ia ndërpriste punën. Transkripet e gjyqit të Aidës u kopjuan me zell në njëzetë copa rrobe të

prera nga çarçafët e krevateve dhe copa tjera të ngjashme dhe u nxorën jashtë Bashkimit Sovjetik. Në mbarë botën, besimtarët lexonin fjalët e «Aidës nga Leningradi» dhe luteshin për këtë motër besnike.

Aida u largua nga kampi i punës së burgut më 12 prill të vitit 1971. Kur u lirua, i thanë se nuk kishte mësuar asgjë prej dënimit të saj. Në të vërtetë kishte mësuar shumë, por jo çfarë kërkonin robëruesit sovjetikë. Ajo kishte fituar një doktoratë në besnikëri ndaj Zotit; dhe kuptim akoma edhe më të thellë të gëzimit dhe kënaqësisë, që vjen duke i shërbyer Atij. Ishte bërë anëtare e plotë në vëllazërinë që apostulli Pal e quante «Bashkësia e vuajtjeve të Tij».[2]

Sot, Aida Skripnikova jeton në Shën Petërburg. Besimi i saj ka shenjat e regjimit që kërkoi ta shkatërronte. Tashmë është e ligjshme për të krishterët si ajo të bashkohen për adhurim dhe predikim. Kisha e saj është mbledhur kohët e fundit për një kohë të veçantë për të festuar përvjetorin e dyzetë të shërbesës së kishës dhe për të kujtuar besnikërinë e Zotit ndaj anëtarëve të saj. Në një vend të veçantë nderoheshin ata, që ishin martirizuar për shkak të besimit të tyre.[3]

Sabina:

Një Dëshmitare e Dashurisë së Krishtit

Rumani
1945

Rusët i kishin shporrur nazistët jashtë Rumanisë dhe tani po ndërmerrnin hapa për të kontrolluar të gjitha aspektet e qeverisë dhe shoqërisë rumune. Përpjekja e tyre më e fundit ishte të mblidhnin në një takim drejtuesit e të gjitha feve dhe këtë e quajtën «Kongresi i Kulteve». Qëllimi i tyre ishte të bëheshin ata kreu udhëheqës i Klerit. Por për Sabinën taktika nuk ishte asgjë më tepër se sa një përpjekje për të fituar kontroll dhe për t'i kthyer drejtuesit fetarë rumunë në kukulla të shtetit.

Sabina ishte e vogël në trup, pothuajse pesëdhjetë centimetra më e shkurtër se bashkëshorti i saj, Riçardi, por kishte pasion për Krishtin. E ulur përkrah Riçardit në takim dhe duke dëgjuar përsëri një pastor tjetër, që e shpallte publikisht besnikërinë e tij ndaj komunistëve, të cilët kishin pushtuar vendin e tyre, Sabina tërhoqi të shoqin nga krahu. «A nuk do ta lash këtë turp nga fytyra e Krishtit, Riçard?» – iu lut ajo. «Duhet të thuash diçka. Ata po pështyjnë mbi emrin e Krishtit!»

Riçardi vështroi rreth e rrotull delegatët brenda ndërtesës së parlamentit. Ishte thjesht një shfaqje. «Liri e plotë fetare!», ishte motoja e shpallur e komunistëve. Ata shpallnin një bashkekzistencë paqësore midis Zotit dhe komunizmit ose më mirë midis Zotit dhe presidentit të nderit të kongresit, Josif Stalin. «Sa lehtë mund të mashtrohet bota», – tha Riçardi me butësi.

Riçardi dhe Sabina ishin në mes të katër mijë peshkopëve të tjerë, pastorëve, priftërinjve, rabive dhe hoxhallarëve, që kishin mbushur galeritë dhe katin e sallës së madhe. Myslimanë dhe çifutë, protestantë dhe ortodoksë, të gjitha besimet kishin përfaqësues.

Madje kishte pasur edhe një shërbesë fetare para se të fillonte kongresi. Udhëheqësit komunistë kishin mohuar veten dhe kishin puthur ikonat dhe dorën e patriarkut. Më pas kishin filluar fjalimet. Petru Groza, i cili ishte thjesht një kukull e Moskës, shpjegoi se qeveria e re rumune ishte në mbështetje të plotë të besimit fetar, të çfarëdo besimi, dhe se do të vazhdonin të paguanin klerikët, ashtu siç kishin bërë më parë. Në fakt, do t'u rriteshin edhe rrogat! Ky lajm u prit me duartrokitje të ngrohta.

Pas fjalimit të Grozës, priftërinjtë dhe pastorët u përgjigjën. Njëri pas tjetrit thanë se sa të lumtur ishin për këtë vlerësim të fesë. Shteti mund të mbështetet te kisha nëse edhe kisha mund të mbështetet te shteti. Ishte shumë e qartë. Një peshkop vuri në dukje se rryma të ngjyrave të ndryshme politike i ishin bashkuar kishës gjatë gjithë historisë. Tani do të hynte e kuqja dhe ishte i kënaqur. Të gjithë ishin të kënaqur. Dhe kënaqësia e tyre i transmetohej mbarë botës përmes radios, drejtpërdrejt nga salla.

«Në rregull», – tha Riçardi, «Mund të dal e të flas. Por nëse e bëj, ndoshta nuk do të kesh më bashkëshort».

Sabina e dinte se ai kishte të drejtë dhe që drejtuesit e tjerë fetarë po flisnin nga frika për familjet e tyre, punën dhe rrogën. Megjithatë ajo ndjente se dikush duhej të kishte guximin t'i demaskonte komunistët, që mbushnin sallën me lajka e gënjeshtra. Duke parë Riçardin drejt e në sy, thjesht u përgjigj: «Nuk kam nevojë për një burrë frikacak».

Riçardi miratoi në heshtje. Plotësoi një letër dhe e dërgoi përpara, duke thënë se dëshironte të fliste. Komunistët ishin të kënaqur. Pastor Riçard Vurmbrand, një pastor luteran i mirënjohur në mbarë vendin, një përfaqësues zyrtar i Këshillit Botëror të Kishave, dëshironte t'i drejtohej asamblesë. Tani vërtet që po bënin përparime!

KOHA PËR GUXIM E PËR TË VËRTETËN

Një heshtje e tensionuar ra në sallë, ndërsa Riçardi po drejtohej për në platformë. Sabina pyeste veten se çfarë po mendonin turmat ndërsa lutej ethshëm për bashkëshortin e saj.

«Faleminderit për privilegjin për t'u mbledhur së bashku dhe për të folur lirshëm», – filloi Riçardi. «Kur fëmijët e Perëndisë

mblidhen, edhe engjëjt bashkohen me ta për të dëgjuar urtësinë e Perëndisë. Kështu që është detyra e çdo besimtari, jo të lavdërojë njerëzit apo drejtuesit tokësorë që shkojnë e vijnë, por të lavdërojnë Perëndinë, Krijuesin dhe Krishtin, Shpëtimtarin, i cili vdiq në kryq për ne».

Atmosfera në sallë filloi të ndryshojë dhe zemra e Sabinës u mbush me gëzim. Më në fund, fokusi u largua nga propaganda e komunistëve.

«E drejta jote për të folur përfundoi!» – thirri papritur Burduka, ministri i Kulteve, ndërsa kërceu në këmbë. Duke e shpërfillur, Riçardi vazhdoi të inkurajonte drejtuesit e tjerë të vendosnin besimin e tyre dhe bindjen te Perëndia dhe jo te njeriu. Publiku filloi të duartrokiste. Ata e dinin se Riçardi kishte të drejtë, por ai ishte i vetmi që pati guximin për të thënë çfarë duhej thënë.

«Ndërprisni mikrofonin!» – u ulëriti Burduka vartësve të tij. «Largojeni këtë njeri nga podiumi. Tani!»

Ndërsa zëri i Riçardit nuk po dëgjohej më, turma filloi të thërriste pa pushim, «*Pastorul! Pastorul*!»[1]

Takimi përfundoi në një kaos të plotë, si një bekim për Riçardin ndërsa doli fshehurazi nga ana e pasme para se dikush të mund ta arrestonte.

Sabina qëndronte e qetë duke parë ngjarjet. Ishte krenare për bashkëshortin e saj. Krenare që ai pati kurajën të qëndronte në krah për Krishtin. Por krenaria e saj ishte e përzier me një ndjenjë ankthi ndërsa filloi të pyeste veten për çmimin, që duhej të paguante për këtë.

Sabina dhe Riçardi kanë pasur gjithnjë dashuri për rusët. Shpesh kishin diskutuar për të dërguar misionarë në Rusi për të predikuar ungjillin. «Tani Perëndia i ka sjellë rusët te ne», – mendonin të dy.

Kur rusët erdhën në fillim në Rumani në verën e vitit 1944, Riçardi dhe Sabina tridhjetë e një vjeçare shkuan për t'i përshëndetur me lule dhe fletushka ungjilli. Si çifutë rumunë, ata të dy kishin vuajtur humbje të pabesueshme nga nazistët. Dhe gjithë familja e Sabinës ishte asgjësuar në kampet e përqendrimit e Riçardi ishte arrestuar tashmë tri herë. Kur u bënë të krishterë, ata u

përkushtuan të punonin midis të gjithë të humburve, pavarësisht prej mëkateve të tyre. Në 1944-ën, kjo bindje i çoi për të arritur nazistët, që po arratiseshin, dhe komunistët e sapoardhur.

Gjatë pushtimit nazist, Riçardi dhe Sabina kishin fshehur shumë çifutë, që po arratiseshin prej shtëpive të tyre. Më pas, kur nazistëve u ishte dashur të arratiseshin, i kishin fshehur edhe ata. Njëri prej ushtarëve nazistë e kishte pyetur Sabinën se pse një çifute fshihte armiqtë e saj. Ajo i kishte thënë se nuk kishte armiq dhe se Perëndia i donte të gjithë mëkatarët. Ushtari e kishte falënderuar me premtimin se do ta burgoste nëse nazistët rifitonin pushtetin.

BLERJA E KOHES

Gjatë verës së 44-ës, Sabina dhe Riçardi gëzuan liri të përkohshme fetare. Diktatori i mëparshëm, Ion Antonesku, ishte çuar në Moskë dhe më pas e kishin sjellë përsëri dhe e kishin vrarë. Prelatët e kishës ortodokse që kishin ushtruar tirani ndaj çifutëve dhe protestantëve, e kishin humbur dominimin e tyre absolut.

Shumica e rumunëve mendonin se më në fund kishin një qeveri demokratike, por Sabina nuk ishte e sigurt për këtë.

Pas Kongresit të Kulteve, nuk u ndërmorën masa kundër Riçardit, por shumë shpejt komunistët nisën të fusnin hundët duke ardhur rregullisht për të prishur shërbesat që drejtonte ai. Javë pas jave, të rinj me pamje të egër rrinin në fund të kishës dhe fërshëllenin, talleshin dhe ndërprisnin.

«Duhet të jemi të kënaqur», – thoshte pastor Solheimi, pastori kryesor i kishës. «Më mirë një audiencë e zhurmshme, që e ka mendjen se sa një që rri në heshtje dhe hiqet sikur dëgjon!»

Më pas morën paralajmërimin e parë. Sabina po punonte në misionin e kishës bashkë me Riçardin një ditë, kur një detektiv civil hyri dhe iu drejtua bashkëshortit të saj.

«Inspektor Riosanu» – e prezantoi veten ai. «Ju jeni Vurmbrand? Atëherë ti je njeriu, që urrej më tepër në jetë.« Riçardi dhe Sabina e panë me mosbesim. «Por thjesht për t'ju treguar se nuk e kam me të keq» – vazhdoi ai, «kam ardhur për t'ju dhënë një këshillë. Një dosje e madhe për ju gjendet në selinë e policisë sekrete. E

kam parë. Dikush ka informuar kundër jush kohët e fundit. Keni folur shumë me rusët, apo jo?»

Riosanu mblodhi duart e tij të ashpra. «Dhe mendova se mund të biem në ujdi».

Ai tha se për një ryshfet do ta zhdukte raportin.

Sabina u bashkua në diskutim dhe ranë dakord për një shumë. Duke futur paratë në xhep, Riosanu tha: «Bëtë një blerje me përfitim. Emri i informatorit është...»

«Jo!» ndërpreu me të shpejtë Sabina. «Nuk duam ta dimë.» Inspektori vështroi gruan e imët me kuriozitet. Por Sabina tundi kokën në shenjë mohimi. E dinte se nuk donin ta dinin se kush kishte informuar kundër tyre. Nëse do ta dinin se kush ishte, mund t'i mbanin mëri këtij personi, dhe kështu do të mëkatonin.

Përsëri, Riçardi dhe Sabina e dinin se pagesa s'mund ta blinte sigurinë e tyre. Ajo ishte në dorën e Perëndisë. Por ndoshta kishin blerë pak kohë, një mundësi për të themeluar më tej kishën e fshehtë.

Në fund të vitit 1947, arrestimet e të krishterëve po shtoheshin dhe Sabina kishte humbur shumë miq në burg. Një pasdite të ftohtë dimri ishte në shtëpi, e sëmurë me bronkit, kur dëgjoi një trokitje në derë. E hapi dhe u habit kur pa Vera Jakovlenën, një mjeke ruse që nuk e njihte shumë. Ajo nuk kishte ardhur për të trajtuar sëmundjen e Sabinës, por për të dhënë një mesazh kritik. Fytyra e saj ishte një maskë tragjedie, ndërsa i tregonte Sabinës historinë e saj.

Vera vinte nga një qytet në Ukrainë, ku drejtues të panumërt dhe njerëz të thjeshtë të krishterë, duke përfshirë edhe atë vetë, ishin çuar në kampet e punës në Siberi nga i cili shumë pak prej tyre ishin kthyer.

Punonim për të shpyllëzuar pyllin, burra e gra së bashku», – tha Vera. «Kishim të drejta të barabarta: Mund të vdisnim nga uria ose mund të ngrinim për vdekje.»

Mjekja u përkul për të kapur krahun e Sabinës me dorën ku dukeshin qartë vraga të bardha dhe kujtoi me drithërimë. «Çdo ditë njerëzit vdisnin, rraskapiteshin nga puna e tepërt në borë», – tha ajo.

Një ditë Vera u kap duke folur me një të burgosur tjetër për Krishtin. Si dënim, u detyrua të qëndronte këmbëzbathur në akull për orë të tëra. Për shkak të dënimit s'ishte në gjendje të përmbushte kuotën e saj të punës dhe kështu rojat e rrihnin.

Pjesa më e madhe e të burgosurve në kamp vdiqën në kushte çnjerëzore apo prej torturave të shpeshta, por Vera ia kishte dalë mbanë të mbijetonte. Tani kishte ardhur te Sabina, jo thjesht për të treguar tragjedinë e saj, por për të treguar për besnikërinë e Perëndisë, madje edhe në kampin e punës. Në fatkeqësinë dhe në nevojën e saj, Perëndia kishte treguar fuqinë e Tij.

Sabina kishte dhembje koke. Në vend që të mendonte për mrekullinë, s'mund të mendonte për gjë tjetër veçse për faktin që edhe ajo mund të kalonte vuajtje të ngjashme. «Çfarë do të thotë? Pse erdhi për të më treguar gjëra të tilla?» – pyeste veten.

Ndërsa Vera u ngrit për të ikur, Sabina iu lut të qëndronte gjatë natës ose të paktën të priste derisa të kthehej Riçardi, që të mund të dëgjonte dëshminë e saj dhe të dinte çfarë po u ndodhte vëllezërve dhe motrave të tyre. Por Vera mbërriti tashmë te dera. Ndaloi shkurtimisht për të thënë: «Burri im është marrë nga policia sekrete. Ka dymbëdhjetë vjet që është në burg. Pyes veten nëse do ta takoj ndonjëherë në këtë tokë». Pastaj u largua.

«Dymbëdhjetë vjet!» përsëriste Sabina fjalët duke u dridhur. «Si mund të durojë dikush kaq gjatë?»

Me persekutimin në rritje të komunistëve ndaj të krishterëve, arratisja duhej marrë në konsideratë. «Nuk është shumë vonë, Sabina», – filloi Riçardi. «Mund të largohemi. Shumë të tjerë po paguajnë për t'u larguar.»

Sabina nuk u përgjigj. E dinte se as Riçardi nuk donte të largohej, por rreziqet ishin reale. Duhej të mendonin edhe për Mihain, djalin e tyre të çmuar tetëvjeçar.

Riçardi vazhdoi: «Kur u arrestova më parë nga nazistët, u lirova vetëm pas disa javësh. Me komunistët mund të zgjasë me vite dhe mund të të marrin edhe ty, Sabina. Ç'do të ndodhë me Mihain atëherë?»

Riçardi kishte prekur pikën e dobët të Sabinës. E dinte se, nëse të dy arrestoheshin në të njëjtën kohë, Mihai nuk do të kishte

vend ku të shkonte. Do të përfundonte duke jetuar rrugëve, duke lypur për ushqim. Ishte e tepërt për t'u duruar nga një nënë. Por përsëri ajo nuk u përgjigj.

Në fund Riçardi e kujtoi çfarë i kishte thënë një mik: «Arratisuni për jetën tuaj, – tha ai duke cituar fjalët e engjëllit për Lotin, 'Mos shiko pas!'»[2]

«Të arratisem, për *çfarë* jete?» – pyeti ajo.

Shkoi pastaj në dhomën e gjumit dhe solli Biblën e saj për të lexuar me zë të lartë fjalët e Jezusit: «Kushdo që do të shpëtojë jetën e tij, do ta humbasë dhe kushdo që do të humbasë jetën e tij për hirin tim do ta gjejë atë».[3] Duke mbyllur librin e ngrënë nga përdorimi, pyeti Riçardin: «Nëse ikim tani, a do të jesh më në gjendje të predikosh për këtë tekst?»

Për atë kohë, çështja e largimit ishte vendosur. Dhe disa muaj më vonë do të vendosej përsëri...

TË RESHTËSH SË EKZISTUARI

Një të diel në mëngjes, më 29 shkurt 1948, Riçardi u nis për në kishë duke thirrur ndërsa po dilte: «Sabina, shihemi atje».

Por kur Sabina shkoi në kishë, rreth tridhjetë minuta më vonë gjeti pastor Solheimin në zyrën e vogël, me pamje të mërzitur.

«Riçardi s'po duket», – tha ai. «Por ai është njeri që mendon për shumë gjëra njëherësh. Duhet të jetë kujtuar për ndonjë takim urgjent para kishe».

«Por ai më premtoi të më takonte pas gjysmë ore», – tha Sabina me frikën që i ndihej në zë.

«Ndoshta ka takuar ndonjë mik që ka pasur nevojë për ndihmë», – tha Solheimi. «Do të vijë».

Pastor Solheimi vazhdoi shërbesën ndërsa Sabina u telefonoi miqve dhe zbuloi se Riçardi nuk ishte me asnjë prej tyre. Frika iu shtua.

Atë pasdite Riçardi duhej të drejtonte një ceremoni martese për një çift të ri në kishë.

«Mos u shqetëso», – e inkurajonte pastor Solheimi Sabinën. «Asnjëherë nuk i dihet me Riçardin. E mban mend kohën në kamp, kur ai u largua për të blerë një gazetë në mëngjes dhe më pas

telefonoi gjatë drekës se nuk do të kthehej për mëngjes?»

Sabina buzëqeshi kur e kujtoi. Riçardit mund t'i ishte kujtuar ndonjë punë urgjente dhe ishte kthyer në Bukuresht. «Ke të drejtë. Duhet të ketë bërë përsëri të njëjtën gjë», – tha ajo duke u përpjekur të siguronte veten.

Dreka e së dielës në apartamentin e vogël të Vurmbrandëve ishte një rast i gëzueshëm. Nuk kishte asnjëherë shumë ushqim, por të krishterët mblidheshin për të biseduar e për të kënduar. Për ata që merrnin pjesë ishte koha më e bukur e javës.

Tani të gjithë qëndronin në shtëpi duke pritur Riçardin në qetësi. Por ai nuk erdhi. Pastor Solheimi e zëvendësoi në ceremoninë e martesës. Sabina u telefonoi të gjitha spitaleve dhe madje shkuan dhe në dhomat e urgjencës, duke menduar se mund të kishte pësuar ndonjë aksident. S'mundi ta gjente. Më në fund u bind se duhej të shkonte në Ministrinë e Brendshme. Sigurisht që Riçardin e kishin arrestuar.

Filluan orë, javë e vite kërkimi...duke shkuar nga një zyrë në tjetrën e duke shtyrë çdo derë, që mund të hapej.

Sabinës iu kujtua Vera, e cila ishte ndarë nga bashkëshorti për dymbëdhjetë vjet. Mendoi për torturën që kishte kaluar pasi kishte ndarë Krishtin me një të burgosur tjetër, një akuzë për të cilën Riçardi sigurisht që do të dilte fajtor. Sabinës i kujtohej se si ajo dhe Riçardi kishin falënderuar Perëndinë që të mund të ishin dëshmitarë për ushtarët pushtues rusë, të njëjtët ushtarë që e kishin marrë rob bashkëshortin e saj.

Ishte hapur fjalë që Riçardin e kishin çuar në Moskë, ashtu siç u kishte ndodhur shumë personave. Por Sabina refuzoi ta besonte. Çdo natë gatuante dhe ulej pranë dritares duke menduar. *Ai do të vijë sonte. Riçardi s'ka bërë asgjë të gabuar. Do të lirohet së shpejti. Komunistët s'mund të jenë më keq se nazistët, që gjithmonë e linin të ikte pas një apo dy javësh.* E ngushëllonte Mihain kur qante për t'atin. I thoshte të birit se Perëndia po kujdesej për të dhe për të gjithë ata. Luteshin së bashku që Riçardi të ishte i sigurt dhe që të vinte në shtëpi së shpejti.

Por ai nuk erdhi dhe biseda që ajo dhe Riçardi kishin bërë disa muaj më parë filloi ta përndiqte në ëndrra: «Kur u arrestova më

parë, u lirova pas vetëm disa javësh. Me komunistët, mund të zgjasë me vite...»

Sabina ndjehej në zemër e shqetësuar. Dashuria e tyre u kishte bërë ballë shumë sfidave, por këtë herë nuk e dinte se si ajo dhe Mihai mund të vazhdonin pa të. Pas disa javësh, pastor Solheimi e çoi Sabinën tek ambasadori suedez, aleati i tyre në të shkuarën, për t'i kërkuar ndihmë. Ambasadori Rojtërsvaerd tha se do të fliste menjëherë me ministren e Jashtme, Ana Pauker.

Përgjigjja e zonjës Pauker ishte shkruar qartë: «Informacioni ynë është që pastor Vurmbrandi është arratisur nga vendi me një valixhe plot me para, që iu besuan për punën për lehtësimin e urisë. Thonë se është në Danimarkë».

Ambasadori ia solli çështjen kryeministrit Groza. Por ai përsëriti të njëjtat fjalë dhe shtoi me një premtim: «Pra, Vurmbrandi mendohet të jetë në një prej burgjeve tona? Nëse mund ta vërtetoni, do ta liroj!»

Komunistët ishin të sigurt. Ndoshta ndaj thuhej se «Kur bie në kthetrat e policisë sekrete në Rumani, resht së ekzistuari».

NJE SHPRESË JETE PËR RIÇARDIN

Pas disa muajsh përpjekjesh të kota, Sabina ndodhej në kishë një mbrëmje kur u thirr për të takuar një të panjohur, që po priste në derë. Burri ishte i parruar dhe kundërmonte erë brendi kumbulle. Këmbëngulte të fliste vetëm me Sabinën.

«Kam takuar burrin tënd», – tha ai me thjeshtësi. Sabinës sa nuk i doli zemra nga vendi. Ishte hera e parë që po dëgjonte diçka që kishte të bënte me bashkëshortin e saj. «Jam rojë, mos më pyet se në cilin burg, jam thjesht roja që i çon ushqim. Ai tha se do të më paguaje mirë për ndonjë lajm».

«Sa dëshiron?» – pyeti Sabina, duke mos qenë e sigurt nëse ai kishte vërtet informacion. Kishte pasur shumë gënjeshtra.

«Po rrezikoj kokën».

Shuma që ai përmendi ishte shumë e madhe dhe nuk bënte ulje.

Pastor Solheimi kishte po aq dyshime sa edhe Sabina. I tha rojës. «Më sill disa fjalë me shkrimin e Vurmbrandit». Ai i dha

një çokollatë nga ndihmat. «Çoja këtë Vurmbrandit dhe sill një mesazh me firmën e tij.»

Roja u largua dhe Solheimi u kthye nga Sabina. «Kaq mund të bënim», – tha ai. «Nuk e kemi idenë nëse po na thotë të vërtetën, ndërkohë që na kërkon si këmbim një shumë të konsiderueshme parash».

Sabina e dinte se pastor Solheimi nuk donte që ajo të kishte shpresa të kota, që do të veniteshin përsëri.

Por dy ditë më vonë, ky njeri u kthye. Hoqi kapelën, gërmoi me gishta brenda saj dhe i dorëzoi Sabinës letrën e çokollatës. Duke e shpalosur me kujdes, lexoi: «Gruaja ime e dashur, të falënderoj për ëmbëlsinë tënde. Jam mirë. Riçardi».

Sabinës sa nuk i pushoi zemra. Ai ishte gjallë! Ishte shkrimi i tij! I guximshëm dhe i qartë, i vendosur, por i shqetësuar. Nuk kishte mundësi të mos e dalloje shpresën e furishme nëpër rreshta.

«Ai është mirë», – tha roja. «Disa nuk e durojnë izolimin. Nuk u pëlqen shoqëria me veten». Ai mbante përsëri era alkool. «Ju dërgon të fala».

Sabina ra dakord t'i jepte paratë nëse do të vazhdonte të dërgonte mesazhe. Më në fund ai tha: «Në rregull, por e dini që po rrezikoj shumë. Disa janë dënuar me dymbëdhjetë vjet për këtë gjë».

Ai ra dakord të rrezikonte lirinë e tij për shkak të lakmisë për paratë që i mundësonin pijen e dëshirueshme. Por dukej qartë që ai e admironte Riçardin dhe me raste i siguronte ca bukë më tepër për vakt.

Sabina ishte mirënjohëse për sakrificën e tij ndërsa vazhdonte të dërgonte mesazhe. Një rojë i dehur ishte bërë rruga e komunikimit me Riçardin. Për momentin mjaftonte.

DËNIMI I FAMILJES SË TË BURGOSURIT

Ligjet e komunistëve ishin të ashpra. Gruaja e një të burgosuri politik s'mund të merrte lata për ushqime. Ato ishin vetëm për «punëtorët». Gruaja e një të burgosuri politik as nuk mund të punonte. Pse? Sepse nuk kishte lata për racion, kështu që nuk ekzistonte.

Sabina iu lut autoriteteve. «Si mund të jetoj? Si mund ta ushqej djalin?»

«Ky është problemi yt, jo yni».

Sabina shqetësohej për Mihain. Që nga arrestimi i Riçardit e kishte parë të dobësohej gjithnjë e më tepër për shkak të mungesës së ushqimit të mirë. Dhe ajo e dinte që ai e kishte mendjen te «vëllezërit dhe motrat» e humbur, gjashtë fëmijë jetim që Riçardi dhe Sabina i kishin marrë pas masakrës së nazistëve në Rumaninë lindore.

Por atëherë, kur dëgjuan se rusët kishin vendosur të ripopullonin me refugjatë dy provincat që kishin marrë, Besarabin dhe Bukovinën, Sabina dhe Riçardi e dinin se herët a vonë, fëmijët do t'ua merrnin dhe do t'i dërgonin në lindje. Qindra jetimë të tjerë përballeshin me të njëjtin hall. Sabina mendoi se, nëse do t'i çonin në Palestinë, ku po formohej shteti i ri i Izraelit, çdo gjë do të shkonte mirë. Kështu, një ditë ogurzezë, i çuan fëmijët për t'iu bashkuar grupit të refugjatëve, që po hipnin në anijen me avull *Bulbul*. Ishte e vështirë t'i shihje të largoheshin, por dërgimi në Palestinë dukej më mirë se sa një fat i panjohur i rezervuar nga rusët.

Javë të tëra kaluan dhe nuk patën asnjë lajm për mbërritjen e anijes.

Çdo ditë që kalonte Sabina shqetësohej edhe më tepër. Filloi një kërkim ndërkombëtar që përshkoi Detin e Zi deri në lindje të Mesdheut, por anija ishte zhdukur dhe gradualisht shpresa u venit. Mendohej se *Bulbul* kishte goditur një minë lufte dhe ishte mbytur.

Dhimbja që ndienin ishte e tmerrshme. Sabina dhe Riçardi i kishin dashur si fëmijët e tyre dhe Mihai kishte qenë i kënaqur me ta si t'i kishte motra dhe vëllezër. Kur Sabina pranoi më në fund të vërtetën që jetimët kishin humbur, e gjeti veten në një gjendje të atillë depresioni, sa s'donte të shihte apo të takonte asnjë njeri përveçse njerëzve të shtëpisë. I gjithë besimi i saj u vu në provë të vështirë. *Si mund ta lejonte Perëndia këtë? Si mundi Perëndia të merrte fëmijët e mi*? E pyeste veten vazhdimisht ajo.

Sigurisht që Sabina e dinte se s'duhej t'ia hidhte fajin Perëndisë për luftërat dhe urrejtjen e njerëzimit, i cili ishte ndoshta shkaku

që rezultoi në mbytjen aksidentale të anijes. Por ajo i kishte dashur fëmijët, dhe dyshonte nëse do të mund ta përballonte dhimbjen.

Në vetë hidhërimin e saj, Sabina ishte afruar për të ngushëlluar Mihain, i cili qante me hidhërim sa herë që i kujtonte ata që ishin bërë pjesë e jetës së tij dhe i kishin dhënë ditë të gëzuara. E shtrëngonte dhe i përsëriste një histori, që e kishte dëgjuar nga goja e Riçardit.

Thuhet se gjatë mungesës së një mësuesi – rabi të famshëm, dy djemtë e tij vdiqën, të dy jashtëzakonisht të pashëm dhe të mësuar sipas Ligjit. Gruaja e tij, e turbulluar keqas, i çoi në dhomën e gjumit dhe u hodhi një çarçaf të bardhë përsipër. Atë mbrëmje rabini erdhi në shtëpi.

«Ku janë djemtë e mi?» – pyeti ai. «Kërkova në kopsht, por nuk i pashë.»

Ajo i solli një gotë ujë për ta freskuar, por ai vazhdonte të pyeste: «Ku janë djemtë e mi?»

«Nuk do të jenë larg», – tha ajo, duke i vendosur përpara ushqim që të hante.

Pas ushqimit, ajo iu drejtua: «Me lejen tënde, do të doja të të pyesja».

«Po, të lutem, vazhdo!»

«Pak kohë më parë një mike më besoi dy diamantë të bukur dhe jam kujdesur për ta si të ishin të mitë. Tani ajo kërkon t'ia kthej, a duhet t'ia kthej?»

«Çfarë?» – tha rabini. «A heziton t'ia kthesh dikujt atë që i përket?»

«Jo» – u përgjigj ajo. «Por mendova të mos i ktheja pa të pyetur ty më parë».

Më pas e çoi në dhomë dhe ngriti çarçafin nga trupat e vdekur të djemve. «Bijtë e mi! Bijtë e mi!» – vajtoi me zë të lartë i ati. «Bijtë e mi, drita e syve të mi!»

Nëna u largua dhe qau me hidhërim.

Pasi kishte kaluar kohë, e mori të shoqin prej dore dhe tha: «A nuk më ke mësuar që nuk duhet të ngurojmë ta kthejmë atë që na është besuar? Zoti ka dhënë dhe Zoti ka marrë; bekuar qoftë emri i Zotit!»

Historia nuk ishte aq ngushëlluese për Mihain, por ai e kuptonte çfarë thoshte e ëma dhe merrte forcë prej kurajës së saj. Ai ishte dhjetë vjeç tani dhe ishte i gjatë për moshën e tij, me faqe të mprehta dhe sy të ndritshëm kuriozë. Në shkollë po merrte mësimin e vështirë e të qenët «i përjashtuar nga shoqëria». Mihai e adhuronte të atin dhe nuk ishte e lehtë për Sabinën të shpjegonte se e kishin burgosur thjesht se ishte pastor.

Në atë kohë, dita ditës kishte njerëz që zhdukeshin.

Në një rast, një numër të burgosurish u liruan. Ata u kthyen në shtëpi me ambulancë dhe treguan shenjat dhe vurratat. Folën për torturat që kishin hequr. Kur fjala ishte hapur mjaft për trajtimin që kishin marrë, të gjithë u arrestuan përsëri.

Sabina urrente të mendonte për tmerret, që duhej të ishte duke hequr bashkëshorti i saj i dashur. Lutej që ai nuk do të thyhej e t'i tradhtonte miqtë e tij. Kishte premtuar që më mirë të vdiste, por kush mund ta thotë se sa mund të durojë një njeri? Pjetri kishte premtuar se nuk do ta tradhtonte Krishtin, por e tradhtoi tri herë.

TROKITJA NË DERË

Sabina ngushëllohej me faktin që, edhe nëse Riçardi vdiste, ata do të takoheshin në jetën tjetër. Kishin rënë dakord që ta prisnin njëri-tjetrin në njërën prej dymbëdhjetë portave, në Portën e Benjaminit. Jezusi kishte lënë një takim të ngjashëm me dishepujt, t'i takonte në Galile pas vdekjes së Tij. Dhe e mbajti fjalën.

Por nuk ishte jeta e përjetshme, ajo që e shqetësonte Sabinën. Ishte e trokitura në derë në orën pesë të mëngjesit...

Kishte punuar vonë një natë më parë, duke ndihmuar në kishë dhe duke bërë disa vizita nëpër shtëpi. Mihai ishte në fshat me shokët dhe një nga shoqet e Sabinës po rrinte përkohësisht me të në apartamentin e vogël. Zëri i ashpër i zgjoi dhe i habiti të dyja gratë ndërsa theu qetësinë e mëngjesit të hershëm: «Sabina Vurmbrand! Hape! E dimë që je aty».

Sabina shkoi drejt derës, me frikën se njerëzit pas derës mund ta shpërthenin nga çasti në çast.

«Sabina Vurmbrand!» – thirri burri qafëtrashë, që ishte në ngarkim kur ajo hapi derën. «E dimë që fshihni armë këtu. Na i trego ku janë, tani!»

Para se të mund të kundërshtonte, ata hapën dollapët dhe boshatisën sirtarët. Një raft librash u rrëzua dhe shoqja e Sabinës nxitoi për t'i marrë.

«Lëri ato», – ulëriti njëri prej burrave. «Vishni rrobat!»

Të dyja gratë duhej të visheshin para gjashtë burrave, që shkelnin mbi çdo gjë, ndërsa shkatërronin apartamentin. Herë pas here thërrisnin, si për të inkurajuar njëri-tjetrin për të vazhduar kërkimin e kotë.

«Kështu, pra, nuk do të na tregoni se ku janë fshehur armët? Do ta bëjmë këtë vend copë e çikë!»

Sabina tha me qetësi: «Arma e vetme në këtë shtëpi është këtu». U përkul dhe mori me kujdes një Bibël poshtë këmbëve të njërit prej ushtarëve.

Oficeri qafëtrashë ulëriti: «Do të vish me ne për të bërë një deklaratë të plotë!»

Sabina vendosi Biblën mbi tavolinë dhe tha: «Të lutem, na lejo të lutemi për disa minuta. Pastaj do të vij me ju».

Ndërsa po dilte, ajo rrëmbeu një pako, të dhënë prej një mikeshe, një palë çorape dhe disa ndërresa. Do t'i duheshin atje ku po shkonte.

DITA E LIRISË

Njëri prej rojave i mbylli sytë në mënyrë që Sabina të mos shihte ndërsa e morën me nxitim prej apartamentit. Pas një kohe të shkurtër duke e tërhoqur zvarrë në parking, ia hoqën shallin nga sytë ndërsa e çonin në një dhomë të gjatë të mbushur plot me gra të tjera. Herë pas here thirrej ndonjë emër. Elementët e «prishur të shoqërisë» së Rumanisë prisnin që emri i tyre të thirrej që të mësonin fatin e tyre.

Ishte 23 Gusht, Dita e Lirisë ose të paktën kështu e quanin komunistët.

Bukë e zezë dhe një supë e ujshme u shërbehej para se të binte nata dhe një ditë tjetër pritje. Më në fund u thirr emri i Sabinës.

Ata që ia mbyllën sytë më parë, u kthyen dhe bënë përsëri një rrugë tjetër me makinë. Këtë herë Sabina përfundoi te selia e policisë sekrete. E futën në një qeli të vogël me disa gra të tjera.

PYETJET NË FUND TË LABIRINTHIT

Kaluan disa ditë dhe Sabinën e nxorën nga qelia e zakonshme dhe e vendosën në izolim. Duke i hedhur një sy të shpejtë dhomës së vogël, ajo e kuptoi se çfarë mungonte. Kova. Gjatë kohës së shkurtër që kishte qenë e burgosur, e kishte mësuar tashmë se kova ishte e domosdoshme. Tani nuk e kishte as atë.

Sa herë dëgjonte çizmet e rënda të rojave që kalonin shpesh korridorit të ngushtë, pyeste veten nëse po vinin për të. Më në fund erdhi radha e saj. Dera e qelisë u hap me forcë dhe roja thirri: «Kthehu me shpinë!»

I mbyllën përsëri sytë.

«Lëviz! Kthehu djathtas. Tani majtas. Përsëri nga e majta. Lëviz!»

Një frikë e papritur e përshkoi Sabinën, ndërsa roja e shtyu shpejt përmes vendit, që dukej si labirinth. Filloi të mendonte se ndoshta kthesat e menjëhershme do të përfundonin papritur në një skuadër pushkatimi dhe se do të vdiste pa paralajmërim në errësirë. U përpoq t'i kontrollonte emocionet e shfrenuara, ndërsa labirinthi përfundoi papritur dhe sytë iu hapën.

E gjeti veten përpara një roje të gjatë, biond, thuajse në moshën e Sabinës. «Ti je e vetëdijshme për fyerjen ndaj shtetit, apo jo, zonja Vurmbrand?» Sabina u shpërqendrua nga ngjashmëria e pazakontë e oficerit me një njeri me të cilin kishte pasur një takim një herë në Paris. «Tani do të shkruash një deklaratë të detajuar për të» – urdhëroi ai, duke treguar stilolapsin dhe fletoren.

«Por çfarë duhet të shkruaj?» – pyeti Sabina. «Nuk e di pse më kanë sjellë këtu.»

Urdhrat vazhduan. «Shkruaj fyerjen ndaj shtetit!» Sabina mori stilolapsin që iu ofrua dhe shkroi disa fjalë duke deklaruar përsëri se nuk ishte e vetëdijshme për ndonjë fyerje. Togeri lexoi atë që kishte shkruar dhe e dërgoi me zemërim në qeli. Ndërsa dera u

mbyll, roja i tha: «Tani do të ulesh derisa të jesh gati të shkruash atë që të tha oficeri. Nëse nuk e bën, do të marrësh atë që meriton!»

«Çfarë do të më bëjnë?» – pyeste Sabina. Të më tallin dhe përbuzin? Torturojnë? Ishte folur aq shumë për atë me të cilën përballeshin të burgosurit e krishterë në burgjet komuniste, dhe ajo e dinte mirë që ata ishin të aftë të bënin gjithçka. Disa ish të burgosur kishin folur edhe për tortura mendore për t'i zbutur më tepër të burgosurit që marrja në pyetje të ishte «më e suksesshme». Komunistët vinin regjistrime të zërave, që ulërinin dhe u thoshin të burgosurve se ishin të qarat e fëmijëve të tyre ndërsa torturoheshin. Si mund ta duronte një prind me mendje të kthjellët një gjë të tillë?

Sesionin tjetër me togerin u theksuan çështjet që kishin të bënin me arrestimin e Riçardit. «Zonja Vurmbrand», – tha ai, «bashkëshorti yt akuzohet për aktivitete antirevolucionare. Ai mund të vritet. Kolegët e tij kanë folur dhe i mbështesin akuzat kundër tij,»

Zemra e Sabinës rrahu me forcë. Ky njeri po gënjente sigurisht, për të provokuar reagimin e saj. U përpoq sa mundi të mos jepte kurrfarë shenje ndërsa togeri vazhdoi: «Ata mund të përpiqen të shpëtojnë veten. Ndoshta *ata* janë antirevolucionarët e vërtetë. Ne s'mund të gjykojmë, nëse ju nuk na tregoni gjithçka që kanë thënë njerëzit, që punojnë me misionin. Çdo gjë. Fol, denonco antirevolucionarët e vërtetë, dhe ti e bashkëshorti yt do të liroheni nesër!»

Sabina u tundua shumë nga ky mendim, por nuk u besonte komunistëve. «Unë nuk di asgjë» – tha ajo, duke e parë togerin në sy.

Atë natë, duke u kujdesur për lëndimet e marra nga të goditurat e rojës, u shtri në shtratin e ngushtë e të vogël dhe ndjeu këmbët t'i preknin fundin e tij. *I gjori Riçard*, mendoi ajo. *Ai është i gjatë dhe këmbët duhet t'i varen jashtë shtratit*.

Çfarë po i bëjnë tani? Për një moment ishte gati të thoshte çdo gjë për të qenë e sigurt me të përsëri; mëngjesin tjetër vendosi të mos i dorëzohej tundimit. Dy dëshira kundërshtuese në pamje të parë përlesheshin në zemrën e saj. Donte që Riçardi të jetonte ndërkaq që donte edhe të rezistonte.

Një copë e bardhë gëlqereje kishte rënë nga muri i qelisë. Sabina e mori dhe vizatoi një kryq të madh në batanijen e saj dhe më pas falënderoi.

Dhe si një përgjigje e dhënë me pëshpërimë nga Ai që dëgjoi lutjen e saj, një mendim i erdhi ndër mend: shtatë. Sabina e kuptoi që ishte në qelinë numër shtatë. Numër i shenjtë. Numri i ditëve të krijimit.

Dukej si një dhuratë inkurajimi, ajo u shtri në shtrat dhe qau. Trupi i qëndronte në errësirë, por shpirti iu ndriçua nga një dritë e imagjinuar, që kalonte kufijtë e burgut. Fërkoi duart te kryqi, që kishte vizatuar në batanije dhe ndërsa po e zinte gjumi, pëshpëriti, «Ne jemi të kryqëzuar me Krishtin».

«Ngrihu!» Mielu, roja fytyrëkuq, ishte në prag të derës, herët mëngjesin tjetër. Sabina u ngrit dhe u kthye nga muri, ishte mësuar tashmë. I mbyllën përsëri sytë fort, dhe e drejtuan nga labirinthi i errët.

Këtë herë Mielu, një burrë më i madh se Sabina, e torturoi me pyetje përgjatë një ore. «Me kë ke fjetur? Çfarë ke bërë me ta? Dua të di me kë dhe sa shpesh, çdo gjë».

E rraskapitur emocionalisht dhe fizikisht, Sabina u habit nga rrjedha që kishin marrë pyetjet. Ajo u përgjigj me qetësi, «Nuk do t'ju tregoj atë që doni». «Edhe historia më e keqe seksuale nuk do ta ndalojë një person të bëhet shenjtor nëse Perëndia dëshiron», – u tha ajo. «Maria Magdalena kishte qenë e përdalë, por do të kujtohet edhe kur të jemi harruar prej shumë kohësh».

Mielu nxori një të sharë dhe e ktheu Sabinën në qelinë e saj.

JAM BLERË TASHMË!

Gjatë sesionit tjetër, Sabinën e detyruan të shihte fotografitë e personave të ndryshëm. Njohu njërin prej tyre, një rus që e kishin pagëzuar fshehurazi në shtëpinë e tyre. «Njihni ndonjë prej tyre?» – pyeti hetuesi tullac. Sabina e dinte çfarë do të ndodhte nëse jepte qoftë edhe një emër të vetëm. Atëherë, hetuesi e zbuti ofertën. «Na thuaj çka duam të dimë dhe do të të lirojmë ty dhe bashkëshortin tënd». Tundimi ishte i vërtetë, por e tillë ishte edhe dëshira për të dhënë jetën e saj për vëllanë. «Nuk njoh asnjë prej tyre».

Burri tullac dyshonte se ajo po gënjente dhe më në fund e pyeti cili ishte çmimi i saj. «Çdo grua e ka një çmim. Cili është yti? Liria? Një pozicion të mirë pastoral për bashkëshortin tënd? Para? Thuaje çmimin tënd.»

Sabinës i kishte ardhur në majë të hundës ushtrimi i vazhdueshëm i pushtetit dhe premtimet boshe. Interesi i tij i vetëm ishte tek arrestimet e tjera dhe Sabina nuk do të bëhej pjesë e qëllimit të tij. «Unë jam blerë tashmë!» – thirri ajo. «Jezusi u torturua dhe vdiq për mua. A mund të më ofroni një çmim më të lartë?»

Fytyra e tij u skuq nga inati dhe Sabina mendoi se do ta godiste, por ai e urdhëroi të kthehej në qeli.

Ajo u vendos përsëri në një qeli të përbashkët. Kaluan muaj, dhe filloi i ftohti i dimrit. Shqetësohej vazhdimisht për Mihain. Kush kujdesej për të? A po jetonte rrugëve? A kishte ftohtë? Ishte i sëmurë? Ndoshta komunistët e kishin arrestuar edhe atë. Qindra dyshime dhe ankthe ia thernin zemrën çdo moment.

Në nëntor drejtori i burgut erdhi në qelinë, ku rrinte Sabina. «Do të lexojmë një listë me emra», – shpjegoi drejtori. «Ato që dëgjojnë emrat duhet të bëhen gati për t'u larguar për dhjetë minuta».

Nuk kishte informacion të mëtejshëm. Të burgosurat u shqetësuan ndërsa roja, që shoqëronte drejtorin, filloi të thërrasë emrat, duke përfshirë edhe atë të Sabinës.

«Çfarë mendon?» – i pëshpëriti Sabina një gruaje afër saj, që po mblidhte gjërat e saj për t'u larguar.

«Mendoj se, ose do të na lirojnë ose do të na vrasin», – tha ajo me ashpërsi.

«ZOTI JU NDIHMOFTË, NËSE PËRFUNDONI NË XHILAVA»

Por, as nuk u liruan dhe as nuk u qëlluan, të paktën jo për momentin. Sabina dhe të tjerët u çuan në Xhilava, burgu më i frikshëm në të gjithë Rumaninë. Ajo i kishte dëgjuar të tjerët të flisnin për këtë burg famëkeq. Dhe me sa duket ishte një qeli që konsiderohej një vend tmerri e që s'mund të përshkruhej. «Zoti ju ndihmoftë, nëse përfundoni në Xhilava në qelinë numër katër!» – dëgjoheshin fjalë.

Një rojë që e kishte prezantuar veten si rreshteri Aspra i drejtoi të burgosurat drejt errësirës, në kalimet e harkuara që të çonin nëntokë. Më në fund qëndruan para një dere të madhe çeliku me kangjella të ndryshkura fund e krye. «Mirë se erdhët në qelinë numër katër!» – deklaroi Aspra me krenari.

Ishte mëngjes kur mbërritën, por qelia ishte thuajse plotësisht e errët. Një dritë e dobët varej nga tavani. Dy radhë shtretërish prej druri zinin dhomën hermetike. Në fund të qelisë, ndodhej një dritare me hekura.

Qindra sy vështronin të sapoardhurat. Sabinës, që gati po mbytej prej mungesës së ajrit, iu caktua shtrati i fundit ngjitur me kovën.

Pas një nate me ndërprerje, ajo u ngrit nga gjumi nga alarmi i zgjimit i orës pesë në mëngjes. Menjëherë, pesëdhjetë gra u rreshtuan për të përdorur kovën e vogël. Më vonë Sabina mësoi se dyqind gra mbaheshin në katër qeli ndërsa tre mijë burra kishin zënë pjesën tjetër të burgut.

Xhilava ishte projektuar për të mbajtur një total prej gjashtëqind të burgosurish.

Në orën njëmbëdhjetë, gratë qëndruan në radhë në kohën e ushqimit dhe Sabina u habit se sa të qeta ishin shoqet e saj të qelisë ndërsa shërbehej supa me një fetë bukë. Por sapo u hoq ena, dhoma e qetë u transformua në një grindje të ashpër. Gratë filluan të shanin njëra-tjetrën ndërsa luftonin për ushqim. Brenda disa minutash roja u kthye dhe filloi t'i godiste gratë me shkopinj, duke rrëzuar tasat majtas e djathtas derisa dyshemeja u mbulua me pellgje të mëdha supe. Aspra me zemërim premtoi se nuk do të kishte supë të nesërmen.

Qelia u qetësua përsëri ndërsa gratë mendonin për të nesërmen që nuk do të kishte ushqim. Dalëngadalë filluan bashkëbisedimet. Njëra prej të burgosurave e pyeti Sabinën pse ishte e burgosur. «Ti nuk dukesh e rrezikshme», – tha ajo, duke bërë që kokat të ktheheshin nga Sabina dhe të shihnin të burgosurën e re.

Sabina buzëqeshi. «Jam gruaja e një pastori», – tha ajo.

Me të dëgjuar përgjigjen, disa të burgosura u larguan duke mallkuar, por të tjerat u bënë kureshtare. «Atëherë duhet të dish

disa histori nga Bibla», – tha një e burgosur që quhej Elena, e cila u vendos pranë Sabinës në dysheme.

«Po, di», – iu përgjigj Sabina, përsëri duke buzëqeshur. «A dëshiron të dëgjosh ndonjë?»

Brenda disa orëve ajo pati një audiencë të interesuar ndërsa ndante historitë njëra pas tjetrës. Në kishën e saj të gjithë ishin dakord: Asnjë s'mund t'i tregonte historitë si Sabina. Duke dëgjuar të mahnitura historitë gjallëruese, gratë harruan për pak kohë që nuk do të kishte supë për tridhjetë e gjashtë orët e ardhshme.

Sabina u inkurajua nga interesimi i shoqeve të qelisë në historitë e Biblës, por shumë shpejt filloi ta kuptonte se fjalët për burgun e Xhilavës ishin të vërteta. Rojat femra i ndiqnin urdhrat me bindje të verbër. Nëse urdhëroheshin të rrihnin një të burgosur, e rrihnin pa mëshirë me shkopinj, aq egërsisht dhe në mënyrë të vazhdueshme sikur të ishte nje qilim që shkundej dhe jo njeri.

JEP PAK SHPRESË E MË PAS MERRE

«Ejani dhe merreni! Supë me karota, zonja!»

Ftesa me sarkazëm e rojës dhe era e keqe nga ena me avull tregonte se vakti po vinte. Shumë prej grave më të mëdha në moshë nuk lëvizën. Nuk kishin fuqi as për të qëndruar në radhë për ushqim. Megjithëse Sabina nuk e dinte në atë kohë, një dietë e tillë gati vdekjeprurëse ishte pjesë e përgatitjes për në kampet e punës. Dhe e kishte bërë punën e vet, duke nxjerrë në pah gratë më të dobëta.

«Sigurisht që është punë skllavi», – tha një mësuese e re. «Por në kanal merr pesëqind gramë bukë në ditë, edhe makarona!»

Burgu ziente nga zërat për kampin e ri të punës në kanalin e Danubit. Secili prej të sapoardhurve kishte diçka për t'i shtuar projektit të ri, që do të kushtonte miliarda megjithëse pjesa më e madhe e fuqisë njerëzore vinte nga të burgosurit që kryenin punë të detyruar. Kanali do të ishte gjashtëdhjetë e katër kilometra në pllajat e zhveshura të Rumanisë Jugore, që lidhte lumin Danub me Detin e Zi.

«Në kanal, mund të merrni çfarë të doni nga shtëpia!» – u tha njëri prej oficerëve të burgosurave.

«Edhe çokollatë?»

Sabina u habit. Duke qenë se i kishin hequr lirinë, çokollata ishte bërë ëndërr mbizotëruese.

Thuheshin fjalë se kishte edhe rroba të ngrohta falas në kanal bashkë me përkujdesje mjekësore. Por premtimi i fundit i tërhoqi vëmendjen Sabinës. Më mirë se veshjet apo çokollata, u tha se të burgosurve të kanalit u lejoheshin vizita të gjata nga familjarët e tyre!

Sabina u kap fort pas shpresës se do të shihte përsëri Mihain dhe nuk mendoi për asgjë tjetër.

«Por jo të gjithë do të kenë të drejtën të shkojnë e të punojnë në kanal», – paralajmëroi Viorika, një polic burgu. «Siç më tha oficeri politik dje: 'Në një shoqëri socialiste, puna është privilegj dhe jo shpërblim për banditët.'»

Ishte strategjia e burgut: të jepnin shpresë e pastaj ta merrnin. Më vonë, e ofronin përsëri në mënyrë tjetër. Në ditëlindjen e dymbëdhjetë të Mihait, më 6 janar 1951, Sabina zbuloi planin e tyre të ri.

«Do të të bëj një ofertë», – lajmëroi kapiteni Zaharia Ion një mëngjes. «Në vend që të shkosh të punosh në kanal, mund të qëndrosh këtu si një e burgosur e veçantë në rehati të mjaftueshme. Do të kesh të gjitha privilegjet siç do t'i kishe në kanal, por nuk do të të duhet të punosh. Është vërtet ofertë bujare».

Sabina e dinte se nuk kishte privilegje në burg pa një çmim; priti në heshtje që polici të vazhdonte. «Duhet vetëm të më raportosh herë pas here për të burgosurat e tjera, në konfidencë të plotë, sigurisht. Eshtë vërtet mjaft e lehtë dhe askush nuk do ta dijë për marrëveshjen tonë».

Pa ngurruar as edhe një çast, Sabina dha përgjigjen. «Faleminderit», – u përgjigj me respekt, – «por në Bibël mund të lexosh për dy tradhtarë, njëri që tradhtoi mbretin David dhe tjetri që tradhtoi Jezusin. Të dy varën veten. Nuk dua të kem të njëjtin fund, kështu që nuk do të të informoj.»

Sa hap e mbyll sytë, toni i Ionit ndryshoi nga tërheqës në kërcënues: «Atëherë nuk ke për ta parë kurrë lirinë!» – ulëriti ai.

Sabina pyeste veten nëse kishte humbur edhe mundësinë për të shkuar në kanal. E dinte që emri i saj ishte në listë dhe e

dinte që të burgosurat e zgjedhura duhej të largoheshin një ditë. E tmerronte mendimi i punës së detyrueshme, por do të bënte gjithçka për ta parë përsëri Mihain, veç jo të bëhej tradhtare.

Disa ditë më vonë, Sabina u transferua në kampin e punës së skllevërve të Danubit. Shumë shpejt ajo dhe të burgosurat e tjera e kuptuan se ishin mashtruar.

KANALI

Sabina u zgjua mëngjesin e parë në kamp nga era kutërbuese e jashtëqitjeve të minjve. Dëgjoi një zë t'i thoshte fqinjës së saj, «Duhet të lësh pak bukë për ta gjatë natës që mos të të kafshojnë».

Çdo ditë Sabina shkonte në punë me të burgosurit e tjerë, burra dhe gra. Po ndërtonin një argjinaturë dhe puna e Sabinës ishte të mbante shkëmbinj të mëdhenj për rreth dyqind metra për në varkë, t'i hidhnin brenda dhe të ktheheshin për të marrë të tjerë. Mendonte se do t'i thyhej shpina nga pesha e vazhdueshme. E kishte të vështirë të qëndronte drejt.

Çdo grup punëtorësh kishin një shef brigade dhe ndihmësit e tyre verifikonin se sa punë po bënin të burgosurit. Kërkesat normale ishin deri në tetë metra kub në ditë. Nëse punëtorët e përmbushnin kuotën e tyre, ditën që pasonte kjo kuotë rritej dhe, në të kundërt, nëse nuk e përmbushnin, ndëshkoheshin.

Sabina nuk i kishte imagjinuar kurrë kushtet që duhej të duronte në kamp. Nëse guxonte të kërkonte privilegjet që vetë ata u kishin premtuar, vetëm sa do të përqeshej.

Gjithnjë e më shumë gra filluan të vinin për të punuar në kanal. Si Sabina, secila prej tyre kishte mall për familjen, sidomos për fëmijët. Duke e kuptuar madhështinë e projektit të ri të kanalit, shumica prej grave filluan të humbisnin shpresën. Por Sabina u var tek një shpresë që ishte më e madhe se çfarëdo projekti apo sistem burgu. Shumë shpejt të burgosurat e tjera filluan ta vënë re. Ato donin të kishin të njëjtën shpresë që kishte edhe ajo.

«Të lutem, Sabina, na trego më shumë histori nga Bibla»! – i luteshin ato pas një dite të gjatë pune.

Sabina e njihte rrezikun, e dinte çfarë mund të ndodhte nëse kapeshin. Por shfrytëzonte çdo mundësi për të ndarë ungjillin me

shoqet e saj të qelisë. Gjithnjë e më tepër të burgosura vinin tek ajo, duke rrëfyer mëkatet e tyre dhe duke pyetur nëse ishte e mundur të faleshin. Sabina i siguronte se ishte e mundur dhe u thoshte diçka, që i kishte thënë Riçardi: «Ferri është të ulesh vetëm në errësirë duke kujtuar të këqijat që ke bërë». Siguristh që këto gra po përjetonin atë lloj ferri në këtë vend.

Ndërsa Sabina kishte refuzuar ofertën për t'u bërë informatore, të tjerat jo. Ndonjëherë të burgosurat e dinin cila ishte informatorja, por s'mund të ishin asnjëherë të sigurta. Kjo ishte dilemë e vazhdueshme. Ndonjë e burgosur mund t'i thoshte Sabinës se dëshironte të dinte më tepër për Krishtin si kurth, që ajo të ndante besimin me të, një veprim i ndaluar që kishte pasoja të rënda. Ose kjo grua mund të donte vërtet të dinte. Nuk kishte mënyrë që Sabina të kuptonte cila kërkesë ishte e vërtetë dhe cila ishte kurth, por në shumicën e rasteve zgjidhte të fliste.

Në më tepër se një rast, pasi informatorja kishte folur për të, Sabina ishte mbyllur në «burg», në një dollap aq të ngushtë saqë mund të zinte vetëm një person në këmbë. U dërgua në izolim menjëherë pas një dite pune, u la atje gjithë natën dhe e nxorën jashtë në mëngjes pikërisht në kohën për t'iu kthyer punës. Izolimi u bë vend i zakonshëm për Sabinën ndërsa ishte në kanal.

NJË RREZE SHPRESE

Ajo gjithnjë i pyeste të burgosurit e rinj nëse kishin dëgjuar ndonjë gjë nga Riçardi. Asnjë nuk kishte dëgjuar derisa një e burgosur i tregoi për një predikues, që kishin takuar në Vakaresti. Në fakt, nuk e kishte takuar, vetëm e kishte dëgjuar të fliste. Qelia e tij ishte afër tualetit dhe ndërsa të burgosurit prisnin në radhë, «predikuesi i burgosur» i inkurajonte të ndiqnin Krishtin e të pranonin dashurinë e Tij. Të gjithë në burg pyesnin se kush ishte, por asnjë nuk e dinte. Tani e burgosura i tha Sabinës se ishte e sigurt që ishte Riçardi.

Fytyra e Sabinës shkëlqeu nga gëzimi. Riçardi i saj ishte gjallë! Duhej të ishte ai predikuesi i burgut, por shpresat i humbën kur vizitorja përfundoi historinë. «Një ditë dëgjuam se predikuesi ishte shumë i sëmurë. Pas kësaj, nuk dëgjuam shumë

për të, në fakt nuk dëgjuam më asgjë. Kishte zëra që kishte vdekur. Më vjen keq!»

Lotët rrodhën në fytyrën e Sabinës, por ajo refuzonte të fliste. Do t'ia dorëzonte problemet e saj Zotit. U lut që Zoti t'i shtonte vite jetës së shërbëtorit të tij besnik, Riçardit, nëse jetonte ende. Ajo lutej gjithashtu për Mihain, me frikën se edhe ai mund të arrestohej e të dërgohej në kanal. Zemra sa nuk i pushoi një ditë kur pa një djalë në moshën e Mihait të punonte në kanal. Megjithëse u lehtësua kur pa se nuk ishte i biri, përsëri qau për djalin dhe nënën e tij, kudo që ishte dhe i përfshiu në lutjet e saj.

Erdhi më në fund një rreze shprese. Atë të diel do të ishte dita e vizitorëve! Sabina s'mund t'u besonte veshëve. Oh, do të shihte përsëri Mihain, sa e mrekullueshme! Kur erdhi dita, një nga të burgosurat i dha Sabinës hua një fustan; i saji ishte i grisur e ishte bërë copa nga mbajtja e gurëve të mëdhenj. Mezi priste, duke numëruar minutat për momentin kur ta kishte të birin përsëri në krahë. Por të burgosurave të mbledhura për vizitën e tyre, u thanë se duhej të qëndronin në anën tjetër të dhomës, ku ishin vizitorët me lejen për të folur me ta në distancë vetëm për pesëmbëdhjetë minuta.

Dhe ja, e pa. Zemra e nënës e përqafoi dhe i dërgoi dashurinë e ngrohtë përmes syve të mbushur me lot. Sa i dobët ishte, sa serioz! Emocionet e nënës e të djalit e ndalën kohën. Asnjëri s'mund të fliste dhe sigurisht që ishte e pamundur të thoshe ndonjë gjë intime. Kur koha përfundoi, Sabina thirri në hapësirën që i ndante: «Mihai! Oh, Mihai! Beso te Jezusi me gjithë zemrën tënde!»

Ishte këshilla më e mirë që mund të mendonte për të dhënë.

Fjalët e Sabinës u ndërprenë nga e shtyra e fortë e policit. Më pas u nxor nga rojat.

Kur u kthye në barangë, shoqet e qelisë iu mblodhën përreth, duke e pyetur se çfarë kishte thënë Mihai dhe se si dukej. Por ajo mundi të tundte vetëm kokën. Për orë të tëra s'mundi të fliste; ishte plot emocione që i mbushnin zemrën ndërsa mendonte për djalin e saj të çmuar.

Për fat të keq, shumë të burgosura kishin kaluar ditë të tëra duke pritur dikë që nuk u erdhi kurrë. Sabina vetëm mund të lutej

për to atë natë ndërsa qanin me zë të lartë në dyshekët e tyre prej kashte.

Dimri i gjeti Sabinën dhe të burgosurat e tjera në gjendje edhe më të mjerë. Ajo vazhdoi të punonte përgjatë Danubit të akullt, duke transportuar shkëmbinj të rëndë në një varkë. Në dimër, ashpërsia e kushteve u shumëfishua, sepse ishte e pamundur t'i hidhje shkëmbinjtë në varkë pa shkaktuar përplasje uji të akullt në ajër, që i bënte qull të gjithë punëtorët. Vetëm pak minuta pasi fillonte dita e punës, Sabina bëhej qull në ujë. Pastaj era e akullt i ngrinte rrobat dhe ajo zihej në një shtresë të fortë akulli si armaturë. Nuk i ndiente më gishtërinjtë e plasaritur dhe të enjtur nga puna dhe të ftohtët derisa përplasja nga ndonjë shkëmb i rëndë, i therte në zemër nga dhimbja.

Në mbrëmje, kur kthehej në barangë, rrobat e lagura i merrte me vete në shtrat. Nuk kishte vend ku t'i thaje dhe çdo rrobë që varej do të vidhej gjithsesi. Kështu që zakonisht flinte me fustanin e lagur të vënë poshtë kokës si jastëk për ta veshur sërish të lagur në mëngjes. Nëse ishte me fat, mund t'i thahej sadopak gjatë rrugës për në punë, pikërisht në kohën për t'u lagur përsëri. Tani Sabina ishte aq e dobët sa të krahasohej me një shkop dhe era e ftohtë dukej sikur e përshkonte tejpërtej.

«E PËRSHTATSHME PËR PUNË!»

Detyra tjetër e Sabinës ishte të ngarkonte gurë në karroca dore. Gratë e tjera i dërgonin gurët për tek anijet, që ndodheshin në Danub. Për shkak të punës, nyjat e gishtërinjve të Sabinës ishin bërë të ashpra, thonjtë e thyer e të gjakosur. Si për ironi mizore, për shkak të rraskapitjes, as nuk e ndiente dhimbjen që i përshkonte trupin.

Më në fund u zgjua një mëngjes me zhurmën e ujit që pikonte nga çatia e barangës. Kishte ardhur pranvera. Por me të erdhi edhe një sfidë e re: toka, që më parë ishte e ngrirë dhe e fortë si hekur, tani ishte kthyer në baltë.

Rojat që shoqëronin punëtoret vajtje-ardhje nga kampi ishin të vetmit burra që këto gra shihnin dhe disa prej grave bënin shaka vulgare kundrejt tyre ndërsa transportoheshin.

Eni, një prostitutë grindavece dhe shoqja e saj, Zenaida, ishin ato që bënin këto lloj bisedash, duke thënë komente të të gjitha llojeve.

«Ai Piteri i ka duart si të gorillës», – tha Zenaida një ditë, me zë aq të ulët, sa burrat s'mund ta dëgjonin. «Shiko gjithë ato qime në shpinë! Jam e sigurt që është i mbuluar me qime nga koka te këmbët, po të mund ta shihnim».

«Oh, po këtu kemi edhe gra që janë njësoj!» – u tall Eni duke treguar gojën plot me dhëmbë ari. Një e qeshur u dëgjua nga disa gra.

«Uh!» – thirri Zenaida duke u shtirur si e tmerruar. «Megjithëse s'mund ta imagjinoj se çfarë shohin tek ne. A mund të imagjinoni një grup krijesash më të pështira e më pak seksi se ne?»

Përgjigjja e pafytyrë e Enit ndaj komentit të Zenaidës shkaktoi një shpërthim të qeshurash nga shoqet e tyre. Fjalë edhe më të ndyra u shkëmbyen ndërsa Sabina vështronte përpara, duke u përpjekur t'i shpërfillte.

«Shenjtorja jonë e vogël nuk na e pëlqen të folurën e pistë», – tha Eni. «Mendon se jemi të tmerrshme!»

Sabina qëndroi në heshtje, gjë që i tërbonte më tepër të tjerat. Këtë herë, Eni, fjalët e së cilës ishin të ashpra, por rrallëherë të thëna me keqdashje, i shkaktuan Sabinës më tepër mizori se ç'mendonte.

Në fund të ditës së punës gratë u rreshtuan si zakonisht, të rraskapitura e të vrara drejt rrugicës me baltë përgjatë Danubit. Piteri, njëri prej rojave, i tërhoqi vëmendjen me bërryl shokut të tij, një të riu me hundë të sheshtë dhe më pas nxori këmbën për të penguar Sabinën ndërsa kalonte. Ajo ra përmbys në baltën e rrëshqitshme.

Rojat e tjera u gajasën së qeshuri.

Piteri u afrua dhe e ngriti. Ajo ishte e mbuluar nga koka te këmbët me baltë.

«Ajo çka të nevojitet tani, zonjë,» – u ngërdhesh ai,-»është një banjë».

«Hidhe në Danub!»- ulëriti një zë gruaje.

Sabina u përpoq të shpëtonte nga mbërthimi i rojës, por një rojë tjetër nxitoi për të ndihmuar shokun e tij. Ndërsa Piteri i

mbante kyçet e duarve, roja tjetër i kapi kyçet e këmbëve dhe e flakën në ajër. Ajo përfundoi në cekëtirën shkëmbore dhe sa nuk mbeti pa frymë. E shushatur, por ende e vetëdijshme ndërsa uji i akullt e mbulonte dhe rryma po e tërhiqte trupin e saj të vogël drejt shkëmbinjve. Kishte të thirrura nga bregu, por s'mund t'i kuptonte. Sa herë përpiqej të ngrihej, uji i rrëmbyer e tërhiqte poshtë. Ishte e kotë. Sabina s'mund të shpëtonte.

Papritur dy duar të forta e kapën poshtë krahëve dhe e tërhoqën në breg. Dikush tjetër e detyroi të ngrihej duke e goditur në shpinë. Ndihej pa fuqi dhe gulçonte ndërsa një dhimbje e mprehtë i shponte brinjën. I merreshin mendtë dhe veshët i gumëzhinin. «A ishte uji i jetës që rridhte në parajsë? – mendoi ajo. Por më pas hapi sytë dhe pa baltën, rojat dhe gratë e dobëta që qëndronin në breg të lumit, dhe e kuptoi se nuk ishte ende në parajsë.

«Është mirë. Ngrihu!» – tha një grua me zë të lartë, duke e parë ashpër Sabinën. Pastaj i pëshpëriti me të butë: «Lëviz, përndryshe do të ngrish!»

Duar të ashpra e ngritën gruan e pastorit në këmbë. Sabina po dridhej, por po vuante më tepër nga tronditja se sa nga i ftohti. Mbante kraharorin në agoni për shkak të dhimbjes në brinjë, që sa vinte dhe po shtohej.

Kur më në fund u kthyen në barangë, Sabina kontrolloi plagët. Brinja ishte nxirë keq dhe lëkura e duarve dhe e këmbëve i ishte çjerrë thellë. Përpjekja për të ngritur duart i shkaktonte aq shumë dhimbje saqë e linte pa frymë. Mundi të zvarritej deri te shtrati dhe u përpoq të flinte, duke u kthyer sa nga një anë në tjetrën gjatë natës që të gjente një pozicion të përshtatshëm. Por s'mundi.

Të nesërmen në mëngjes «mjekja» e kampit e vizitoi, një grua e ligë e quajtur Kretzeaunu. Një shenjë e madhe e verdhë e lejla në formën e hartës së Afrikës dallohej në njërën anë të trupit të Sabinës. Tani nuk mund të ngrinte as krahët.

«E përshtatshme për punë!» – deklaroi Kretzeaunu.

Sabina filloi të protestonte, por mendoi më mirë të heshtte. Debati do t'i shkaktonte dënim më të rëndë, ndoshta burgim. Lëvizi në drejtim të grave, që prisnin të transportoheshin në vendin e punës, por qëndroi në anë ndërsa ato lëviznin.

«Si e ke hallin?» – thirri mbikëqyrësi, duke parë që ajo kishte ndaluar.

Sabina tha: «S'mund të punoj sot. Kam shumë dhimbje. Mendoj se kam thyer brinjët».

Mbikëqyrësi mund ta kishte konsideruar pushimin, por Piteri në mënyrë kërcënuese i dha fund një mendimi të tillë. E kapi Sabinën nga kyçi i dorës dhe e flaku jashtë rreshtit, duke i shkaktuar dhimbje të tmerrshme. «Ajo nuk e realizoi normën dje. Tani, vazhdo!» E rrotulloi dhe e goditi me një çizme të madhe mbi shpinë. Nuk ishte shkelmuar ndonjëherë kaq shumë dhe u flak në rreshtin me gra.

Sabina shkoi të punojë atë ditë dhe çdo ditë më pas, duke u përpjekur të mbahej, megjithëse edhe pse doktorët e konfirmuan më vonë, ajo kishte thyer dy brinjë.

DIANA DHE FLOREA

Më në fund vera erdhi në vendin e trishtueshëm dhe Sabina u mbush me shpresë. Dy vajza të reja kishin ardhur në kamp dhe u caktuan në barangën e Sabinës. Ato njiheshin si gra rruge, por nuk flisnin shumë. Zunë me ndrojtje shtretërit në fund të dhomës.

Më vonë, Sabina mësoi se ishin motra, Diana dhe Florea. Të dyja vajzat ishin zeshkane, të sjellshme dhe me zë të qetë. Por kishin qenë prostituta, tha njëra që i njihte, dhe ishin përfshirë si të tjerat për të shërbyer dënimin «administrativ» në kanal.

Një hije trishtimi dhe misteri i rrethonte motrat. Askush s'mund të mësonte më tepër për të shkuarën e tyre, megjithëse shumë prej tyre i ngacmonin e përgjonin. Motrat punonin e pushonin dhe mund të kishin mbetur mister, nëse Diana nuk do të kishte dëgjuar emrin e Sabinës të thirrej një ditë nga njëri prej rojave.

Diana nxitoi të shkonte drejt Sabinës. «A e njihni Riçard Vurmbrandin?» – pyeti ajo.

«Jam gruaja e tij», – u përgjigj Sabina.

«Oh!» – tha ajo. «Kush e di se ç'mund të mendoni për mua?»

«Çfarë do të thuash?» – pyeti Sabina.

«Im atë ishte predikues», – tha Diana me zërin që i dridhej. «Ai na lexonte nga librat e Riçardit; i quante 'ushqimi i tij

shpirtëror'. Babai u burgos për shkak të besimit, duke lënë gruan e sëmurë dhe gjashtë fëmijë. Unë dhe Florea jemi më të mëdhatë. Të dyja humbëm punën në fabrikë kur babai u burgos. Na kanosej uria.»

Sabina zgjati dorën drejt krahut të vajzës për ta ngushëlluar, ndërsa ajo vazhdoi historinë e dhimbshme. «Një ditë një djalosh më kërkoi të dilja me të në takim. Shkuam në kinema dhe më pas për darkë. Më tha se mund të më gjente një leje pune. Dhe më pas...» Diana uli kokën dhe fshiu lotët që i mbushën sytë. «Pimë verë, shumë verë dhe më pas, ai më joshi.»

'Kjo ndodhi përsëri», – tregoi ajo, «por këtë herë nuk u përmend fare leja e punës.» Megjithatë, ai i dha para. Duke e ditur se sa shumë nevojë kishte e ëma për të mbështetur familjen, Diana i pranoi. Një javë më vonë, ky njeri e prezantoi me një mik dhe më pas i la së bashku. Kur ai u përpoq të përfitonte prej saj, ajo u inatos. Por kur edhe ai i dha para që i nevojiteshin aq shumë, tha se po vepronte vetëm sipas sugjerimit të mikut të tij. Diana u dorëzua.

Shumë shpejt Diana arriti të kishte një sërë «klientësh» dhe e shpërfillte turpin. U mësua me këtë jetë, madje duke e preferuar më tepër se punën e rëndomtë të fabrikës.

Megjithëse historia e Dianës dukej e tmerrshme, Sabina e ndjeu se vajza po fshihte diçka. Papritur Diana ndaloi dhe vështroi fytyrën e Sabinës. «Mendova se do të ndieje neveri», – tha ajo. «A nuk të mërzit fakti që unë vij nga një familje e krishterë dhe u bëra.., prostitutë?»

Sabina tha me butësi: «Ti nuk je prostitutë; je e burgosur. Dhe gjithsesi, askush nuk është prostitutë, shenjtore, kuzhinier apo zdrukthëtar gjatë gjithë kohës. Gjërat që bën janë vetëm veçori që përbëjnë një pjesë të qenies tënde. Ato mund të ndryshojnë në çdo kohë. Dhe besoj se tashmë kanë ndryshuar me rrëfimin e historisë tënde».

Diana donte t'i besonte fjalët e Sabinës, por dukej qartë që nuk ishte e ngushëlluar. U ul në shtratin e saj të ngushtë në kasollen e zbrazët, me duar të mbërthyera midis gjunjëve, me fytyrë të trishtuar dhe në faj.

«Sikur të kisha qenë vetëm unë.» – shpërtheu ajo më në fund, – «nuk do të kishte qenë aq keq. Por detyrova edhe motrën time. Ma sugjeroi i dashuri. Ai më tha se nuk ishte e drejtë që unë të mbaja të gjithë përgjegjësinë për familjen. Kështu që më në fund ia prezantova Floreas dhe e lejova të dilte me të.»

Shumë shpejt edhe Florea ishte futur në jetën e prostitucionit. Vështirësia kryesore e motrave ishte ta mbanin sekret prej vëllait të tyre, një djalë pesëmbëdhjetë vjeçar, i cili i adhuronte të dyja. Ashtu si i ati, ai ishte besimtar i fortë, me temperament të ndjeshëm, por nuk e kishte idenë si ishte bota. «Ai nuk do të donte që as edhe një mizë të vuante», – tha Diana duke tundur kokën. «Ne e dinim se, nëse do ta zbulonte, do të zemërohej e do të trishtohej. U përpoqëm t'ia fshihnim.»

Por mënyra e re e jetesës, orët e vona dhe përmirësimi i të ardhurave, i bënë fqinjët të dyshonin. Shumë shpejt njëri prej tyre e zbuloi se çfarë po ndodhte dhe i tregoi djaloshit.

«U çmend nga tronditja», – tha Diana me trishtim. «Përfundoi në një spital për të sëmurë mendorë».

Më pas i ati u lirua nga burgu. Kur zbuloi se sa thellë ishin zhytur vajzat e tij, tha: «I kërkoj vetëm një gjë Perëndisë, që të më dërgojë përsëri në burg që të mos shoh çfarë po ndodh me familjen time».

Vajzës i rridhnin lotët çurg.

«Mori atë që deshi», – tha ajo. «Ai filloi t'u mësonte fëmijëve mësime të ungjillit dhe shumë shpejt e denoncuan në polici. Informatori më tha më vonë se e kishte bërë që ta largonte tim atë në mënyrë që të mos ndërhynte me 'biznesin' tonë. Ishte i njëjti person që më kishte joshur për herë të parë».

Sabina u shtang dhe u trishtua nga historia tragjike, iu afrua dhe e përqafoi Dianën. «Të vjen turp për çfarë ke bërë dhe ke të drejtë», – tha ajo. «Në një botë vuajtjesh, ku madje, edhe Zoti gozhdohet në kryq, ti s'mund të lejosh që emri i Tij, të cilin e mban si e krishterë, të ndotet. Por kjo ndjenjë dhimbjeje dhe faji do të të çojë në një drejtësi rrëzëlluese. Kujto se ushtarët në kalvar e shpuan brinjën e Krishtit në mënyrë që mëkatarë si unë dhe ti të mund të hyjmë shpejt e të gjejmë falje.»

Diana mendoi rreth fjalëve të saj dhe u përgjigj me ngadalë: «Turpi dhe vuajtja, po, i kam përjetuar. Por kam edhe diçka tjetër për të rrëfyer. Nuk e urreja gjithmonë punën që bëja. Dhe tani mendime të këqija më vijnë në kokë gjatë gjithë kohës. S'mund t'i ndaloj».

Sabina lutej çdo ditë për Dianën e trazuar dhe në fakt vajza e gjorë u çlirua më në fund nga faji i saj. Sabina vazhdonte të mendonte se si Diana dhe motra e saj kishin mëkatuar për të siguruar ushqim për familjen e tyre. Ndoshta mëkati më i madh, mendoi ajo, u takonte të krishterëve të lirë, që nuk ishin treguar aq të ndjeshëm për t'u dërguar ushqim, dhe kështu s'do të kishin lejuar të ndodhte kjo situatë me vajzat.

«NË SYTË E TU SHOH VETEN»

Disa javë më vonë Sabinën e çuan te komandantja e kampit, një grua fytyrëkuqe me krahë të rëndë e të mëdhenj dhe dhëmbë të shkëlqyer. Uniforma e rëndë për trupin e saj dukej se e pengonte, njësoj sikur të kishte veshur armatim.

«Ti u ke predikuar për Zotin të burgosurave. Duhet të ndalosh!» – paralajmëroi ajo.

«Më vjen keq, por asgjë s'mund ta ndalojë këtë!» – u përgjigj Sabina.

Me zemërim, komandantja ngriti grushtin për ta goditur. Më pas ndaloi dhe e vështroi.

«Pse po buzëqesh?» – e pyeti ajo, me fytyrë të errësuar nga tërbimi.

Sabina tha: «Nëse jam duke buzëqeshur, është për shkak të asaj që shoh në sytë e tu».

«Dhe çfarë sheh?»

«Veten time» – u përgjigj Sabina. «Kur njerëzit afrohen, shohin veten në sytë e tjetrit. Në sytë e tu, shoh veten time. Edhe unë kam qenë impulsive. Zemërohesha dhe godisja të tjerët me fjalë të ashpra dhe mendime egoiste, derisa mësova se çfarë do të thotë të duash. Kur je në gjendje të duash, je në gjendje të sakrifikosh për të vërtetën. Që kur kam mësuar këtë mësim, duart e mia nuk kthehen më në grushte».

Oficerja u shtang nga guximi i Sabinës. Në heshtje, ajo vazhdoi: «Nëse sheh në sytë e mi, do të shohësh veten, ashtu si mund të të bëjë Perëndia!»

Ishte sikur komandantja të ishte gurtësuar. Qëndrimi i saj i zëmëruar nuk ndryshoi, por me qetësi i tha: «Largohu!»

Sabina vazhdoi të dëshmonte për Krishtin midis të burgosurave.

LIRIA

Kur papritur, e liruan. Sabina u përpoq të lexonte dokumentet, që urdhëronin lirimin e saj: «Vërtetim Lirimi» ishte titulli, por dielli kishte perënduar dhe ishte shumë errësirë për të lexuar pjesën tjetër, ndërsa e çuan drejt kamionit dhe e nxorën jashtë kampit. Pas pak e lanë në rrethinat e Bukureshtit.

Eci për orë të tëra nëpër periferi, me gjërat e saj të pakta në krah. Për herë të parë në afërsisht tre vjet, shihte njerëz që nxitonin për në shtëpi pas pune, duke bërë pazar për familjet e tyre, duke pasur të njëjtën jetë të përditshme, që kishte pasur edhe ajo para burgimit.

Sabina nxitoi me padurim drejt shtëpisë duke pyetur veten nëse shtëpia ende ekzistonte.

Vriste mendjen se me sa ndryshime duhej të përballej. Nuk e dinte se çfarë u kishte ndodhur të afërmve dhe miqve. Mihai ishte katërmbëdhjetë vjeç tani. Si do kishte ndryshuar në këto vite? Trembej ta imagjinonte, edhe pse priste me padurim ta takonte.

Sabina kaloi afër rrugës «Viktori», duke menduar me trishtim për stacionin e policisë ku e kishin arrestuar për herë të parë. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Portretet gjigante të njerëzve, që komunistët i quanin katër gjenitë – Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini- vështronin akoma drejt turmave, që nxitonin nëpër rrugë.

Arriti te ndërtesa që i dukej mëse e njohur dhe ngjiti shkallët. Trokiti në derë, duke shpresuar që edhe kjo të mos kishte ndryshuar. Gati sa nuk u shemb përdhe kur pa se dera iu hap nga një e njohura e saj. U ndje e lehtësuar.

«Sabina!» – thirri shoqja e saj, duke bërë një hap mbrapa e befasuar. «A është e mundur?»

Të dyja gratë u përqafuan dhe filluan të qanin. Më pas hyri në dhomë Mihai. Sabina u ndie sikur do t'i shpërthente zemra kur e pa të hynte në derë. Ishte i zbehtë, madje edhe më i gjatë se sa kur kishte ardhur në burg, dhe... më i dobët. Tani, ajo e vuri re se ishte bërë një djalë i ri.

Lotët u rridhnin ndërsa u përqafuan. Mihai u zmbraps dhe butësisht ia fshiu lotët me majat e gishtave. «Mos qaj shumë, mami!» – tha ai.

Sabina ishte aq e lumtur që po mbante të birin në krahë, sa mendoi se, këta ishin lotët e fundit për të.

DUHET VETËM NJË FJALË

Në ditët e para, Sabina ishte si një grua e ringjallur prej së vdekurish. Ishte shumë e emocionuar që ishte e lirë! Por shumë shpejt erdhi me këmbë në tokë. Megjithëse nuk ishte më e burgosur, ishte gjithsesi një e përjashtuar nga shoqëria, sepse, jo vetëm që ishte grua pastori, por edhe vetë kishte qenë e burgosur.

Pa lata ushqimi, s'mund të blinte as bukë dhe marrja e tollonit ishte e pamundur. Një mëngjes priti në radhë për katër orë në zyrën e qeverisë. Kur arriti te dritarja e vogël, një vajzë tha: «Ku e ke kartën e punës? Pa kartë s'mund të marrësh tollon».

«Por jam një ish e burgosur. S'kam si të gjej një kartelë pune», – shpjegoi Sabina.

«S'mund të bëj gjë. Nëse nuk ke kartelë pune, s'mund të marrësh tollon», – tha vajza, duke parë tashmë drejt personit që ndodhej pas Sabinës në radhë. «Tjetri!»

Përsëri Sabina dhe Mihai ishin të detyruar të mbijetonin me bamirësitë e të tjerëve.

Shtëpia e Vurmbrandëve dhe gjithçka zotëronin ishte konfiskuar. Fatmirësisht, miqtë e tyre jetonin në shtëpinë ku kishte qenë apartamenti i tyre dhe e ftuan Sabinën dhe Mihain të jetonin në dhomat, që ndodheshin në papafingo. Mobiliet mezi mbaheshin në këmbë, shtretërve të vjetër u ishin prishur sustat dhe nuk kishte ujë të rrjedhshëm dhe as banjë. Por Sabina ishte mirënjohëse që e kishte përsëri me të birin dhe kjo ishte arsye për ta shndërruar atë vend sërish në një shtëpi të ngrohtë.

Një mëngjes, disa muaj pas lirimit të Sabinës, një zyrtar nga Ministria e Brendshme u shfaq në derën e papafingos. Ishte burrë i shëndoshë me zë buçues dhe me flokë të zinj të ndarë në mes. Mbante një valixhe plot me letra që ishte gati të shpërthente.

Burri tha me zë të lartë se Sabina ishte nënë e keqe dhe nuk kujdesej siç duhej për djalin e saj. Sabina qëndroi në heshtje duke vështruar nga ai. E dinte çfarë do të ndodhte.

«Ç'dobi do të kishte», – tha ai më në fund, – «të qëndroje e lidhur me bashkëshortin, një antirevolucionar që nuk do ta shihje më kurrë?» Ishte vetëm një çështje e logjikshme që një grua inteligjente si ajo të merrte divorcin prej këtij armiku të shtetit. Nëse nuk vepronte kështu tani, me siguri do të vepronte më vonë. Sa gjatë, mendonte ajo se mund të kundërshtonte shtetin me një mosbindje të verbër e të kotë?

Ky njeri tallej ndërsa paraqiste pamjen zemërthyese të fatit përfundimtar të Sabinës. «Dashuria», – ironizoi ai, – «dashuria? Janë gjepura! Dashuria nuk ekziston!» Sabina kishte nevojë për një bashkëshort tjetër, një baba tjetër për fëmijën e saj. Nuk duhej të kishte dashuri për antirevolucionarët.

Duke zier brenda vetes, Sabina mendoi, «*Si guxoni të m'i thoni këto në shtëpinë time? Nuk u martova me bashkëshortin tim vetëm për kohët e lumtura. Jemi të bashkuar përgjithmonë dhe çfarëdo të ndodhë, nuk do të ndahem nga ai.*»

Ai vazhdoi të diskutonte dhe ta nxiste Sabinën përreth gjysmë ore, por gjatë kësaj kohe Sabina vetëm heshti. I erdhi ndër mend një thënie e vjetër: «Madje as Perëndia s'mund ta kundërshtojë dikë që qëndron në heshtje.»

Më në fund ai u largua, duke tundur kokën. «Herët a vonë do të vini tek ne», – tha ai ndërsa dera iu mbyll pas. «Të gjithë kështu veprojnë, ti e kupton».

Pavarësisht ashpërsisë së këtij njeriu, kishte një rreze shprese. Sabina mendoi me trishtim: «Nëse komunistët dëshironin kaq shumë që ajo të divorcohej, atëherë Riçardi duhej të ishte gjallë!»

Sabina e dëgjoi të zbriste gjithë zhurmë nëpër shkallë. *Drejt viktimës tjetër*, mendoi ajo solemnisht, *ku do të ketë ndoshta më tepër fat*.

Autoritetet bënin çdo përpjekje për t'i detyruar gratë e të burgosurve të kërkonin divorcin. Së pari, sepse fuqia e të burgosurit për të rezistuar, madje edhe për të jetuar, shuhej kur dëgjonte se ishte braktisur nga personi, që kishte premtuar t'i qëndronte besnik pavarësisht nga rrethanat. Së dyti, divorci ndihmonte gratë të përfshiheshin në mënyrën komuniste të jetesës. Kur divorci finalizohej, gratë mezi prisnin të harronin bashkëshortët e tyre, ndoshta prej fajit dhe mënyra më e lehtë për ta bërë këtë ishte të përvetësonin linjën partiake. Sabina njihte shumë gra, që përsërisnin sloganet e qeverisë, që tallnin të burgosurit politikë, burrat që dikur i kishin dashur dhe me të cilët kishin lindur fëmijë. Së treti, fëmijët pa baba ishin në mëshirën e shtetit për t'u indoktrinuar që në moshë të hershme.

Duhej vetëm një fjalë që kjo të ndodhte. Kur një grua i thoshte «po» divorcit zyrtar, kujdesej shteti për çdo gjë tjetër. Disa ditë më vonë, i thuhej bashkëshortit, para shokëve të qelisë, «Gruaja juaj po divorcohet nga ju». Atëherë burri do të mendonte: «Kush e vret mendjen për mua tani? Jam i marrë që nuk dorëzohem dhe të firmos çfarëdo lloj budallallëku që duan që të lirohem». Por edhe nëse firmoste, mund të mos lirohej edhe për disa vjet. Ndërkohë gruaja e tij ishte martuar përsëri dhe kishte fëmijë me bashkëshortin e ri. Kështu, shtëpitë, familjet dhe jetët shkatërroheshin.

Sabina i inkurajonte gratë, bashkëshortët e të cilave ishin të burgosur, të përgatiteshin për vizitat e zyrtarëve dhe të qëndronin përkrah bashkëshortëve të tyre, t'i donin, ashtu siç ishin dhe jo për atë që duhej të ishin. I kështillonte gratë të mendonin për çastet e bukura të jetës së tyre martesore që të përballonin tundimet.

Por shpesh dështonte në përpjekjet e saj. Presioni mbi gratë e të burgosurve ishte i madh.

NJË TUNDIM TJETËR

Më pas erdhi koha kur Sabina, në atë kohë dyzetë e tre vjeç, pati një tundim tjetër me të cilin duhej të merrej. Emri i tij ishte Pol dhe ajo e dinte që ai po binte në dashuri me të. Poli hyri në jetën e saj kur nuk kishte marrë prej kohësh asnjë lajm nga Riçardi prej muajsh, dhe ajo po fillonte t'i ndiente vitet që kalonin. Përsëri

pyeste veten nëse ai ishte ende gjallë. Shumë vetë kishin trokitur në derë e kishin thënë se kishin qenë në burg me pastor Riçard Vurmbrandin dhe se ai kishte vdekur. A ishte e vërtetë apo një hile tjetër e komunistëve?

Kur mendonte për Polin, Sabina e kishte të vështirë të dëgjonte fjalët e mençura, që u kishte thënë aq shpesh të tjerave. Ai ishte i mirë dhe i sjellshëm, një i krishterë tjetër çifut si ajo vetë. Jetonte në një dhomë me prindërit e saj, tashmë në moshë të thyer dhe ndonjëherë e çonte Mihain në kinema apo edhe e ndihmonte me mësimet. Sabina mendonte shpesh: »*Ja ku është dikush me të cilin një grua mund të jetojë me dashuri dhe besim.*»

Ndonjëherë Poli i kapte dorën kur bisedonin dhe Sabina nuk gjente vullnetin për ta tërhequr. Marrëdhënia e tyre nuk arriti asnjëherë në pikën që kisha apo ligji do ta quante kurorëshkelje. Por përsëri, Sabina e dinte se ishte e gabuar.

Një ditë pastori iu drejtua me pamje serioze në fytyrë. «Sabina, ti e di sa shumë të dua dhe të vlerësoj», – tha ai. «Dhe kjo s'ka për të ndryshuar, çfarëdo që të ndodhë. Të kam njohur ty dhe Riçardin për shumë vite. Dhe shpresoj ta dish që, mëkaton apo jo, e humbet besimin apo jo, unë do të kujdesem për ty ashtu si më parë, sepse e di cila je». Ai foli me emocion dhe sinqeritet të veçantë; dhe më pas ndaloi para se të drejtonte pyetjen. «Kështu që, më fal nëse të pyes», – tha ai, duke e parë Sabinën drejt e në sy. «Çfarë ka midis teje dhe Polit?»

Për një moment Sabina heshti.

Ai vazhdoi: «Mos mendo që unë nuk kam pasur tundime të tilla, ndaj të lutem, përgjigjiu pyetjes!»

«Ai ka rënë në dashuri me mua», – tha ajo, duke ulur kokën ndërsa fliste.

«Po ti, ke rënë në dashuri me të?»

«Nuk e di», – u përgjigj ajo me ndershmëri. «Ndoshta».

Pastori vazhdoi, më kujtohet diçka që thoshte Riçardi: «Asnjë pasion nuk reziston përpara arsyes. Nëse i jep vetes kohë për të menduar, do të shohësh dëmin që mund t'i bësh bashkëshortit, bashkëshortes apo fëmijëve të tu». Tani dua të marrësh një vendim të vështirë, Sabina, vendimin më të vështrië. Mos e tako më këtë njeri!»

Pastori kishte të drejtë. Ishte vendimi më i vështirë. Sabina donte t'i kontrollonte emocionet e saj të shpenguara dhe t'i mohonte ndjenjat për Polin, por ishte gjithashtu nënë edhe grua. E dinte që Poli do të ishte bashkëshort i mirë, një shok, që do t'ia largonte ndjenjat e vazhdueshme të vetmisë. Do të ishte edhe baba i mirë për Mihain. Tundimi ishte më i madh se ç'mund të mbante Sabina, veçanërisht kur vetë miqtë e kishës i thoshin: «Burri yt ka vdekur. Ke jetuar një jetë mjaft të vështirë. Lejoje këtë njeri të kujdeset për ty. Ai është i krishterë i mirë dhe të do».

Vetëm pastori i saj kishte qenë mjaft i guximshëm dhe i përkushtuar ndaj saj për t'i thënë atë që duhej thënë. Dhe Sabina e dinte që ai kishte të drejtë. E dinte që Satani donte ta shkatërronte dëshminë e saj. Kështu që me vështirësi të madhe, i tha Polit që nuk duhej të takoheshin më kurrë dhe vendosi sërish të priste Riçardin e saj.

DHJETË RRESHTA NË NJË KARTOLINË

Disa javë më vonë Sabina gjendej në kishë, duke pastruar dyshemenë, kur shoqja e saj, Marieta, hyri me nxitim duke i treguar një kartolinë. Lotët i rridhnin faqeve. «Mendoj, Sabina, mendoj se është nga...»

S'mundi të vazhdonte, u ul në gjunjë në dërrasat e lagura pranë Sabinës.

Sabina e ktheu kartolinën nga ana tjetër. Ishte shkruar «Vasili Gerorgesku». Por shkrimi i Riçardit, i madh, i rregullt dhe i bukur ishte i pagabueshëm. Ia nguli sytë dhe e shtrëngoi kartolinën pas vetes.

E dinte që të burgosurit politikë mund të shkruanin vetëm dhjetë rreshta të censuruara. Çfarë mund të thoshte Riçardi pas kaq shumë vitesh, duke mos ditur nëse gruaja apo i biri jetonin? Sabina mbajti frymën dhe i lexoi fjalët me sytë e mbushur me lot. «Koha dhe largësia mund të shuajnë një dashuri të vogël, por e bëjnë një dashuri të madhe edhe më të fortë», – kishte shkruar ai. Më pas i kërkonte ta takonte në një datë të caktuar në spitalin e burgut Tirgul-Okna.

Kartolina e Riçardit ishte lajmi më i mirë, që mund të merrte Sabina. Por mendimi se çdo javë duhej të raportonte në stacionin

e policisë së Bukureshtit ia theu zemrën, e dinte që s'mund të shkonte, ata refuzonin vazhdimisht të hiqnin ndalesën për t'u larguar nga qyteti. Kështu që nuk do të ishte atje ditën e caktuar për të parë fytyrën e bashkëshortit të saj të dashur. Por u lumturua kur mori vesh që mund të shkonte Mihai në vend të saj.

Tirgul-Okna ndodhet në Rumaninë Veriore, në anën tjetër të maleve Karpate. Treni nga Bukureshti udhëton qindra milje përreth maleve për të arritur në qytetin e vogël. Sabina i kërkoi një shoqeje, që ata e quanin «Teze Liza» që të shkonte me Mihain në burg. Por vetëm Mihai lejohej ta takonte Riçardin.

Sabina priste me padurim. Mihai dhe teze Liza ishin larguar prej dy ditësh, dhe gjatë kësaj kohe një milion mendime dhe shqetësime i kaluan ndër mend: «A do ta takonte vërtet Mihai babanë? A do të lejohej Riçardi të merrte disa rroba të ngrohta dhe ushqimin që i kishte dërguar? Që kur kishte qenë në senatoriumin e burgut kishte qenë shumë sëmurë. A do të ishte në gjendje të qëndronte në këmbë? A do të mund t'i fliste Mihait? Si do të ishte reagimi i Mihait kur ta shihte t'atin pas kaq shumë viteve? A do të ishte rrënuese për të ta shihte Riçardin shëndetlig?»

Arritën në shtëpi në një mbrëmje dhjetori. Sabina i dëgjoi të ngjiteshin në shkallë dhe, pa u futur ende në derë, Liza thirri: «E takuam! E takuam! Është gjallë. Është mirë!»

Hynë brenda me borë ndër supe.

«Mihail!» E takoi duke e mbështetur faqen te gëzofi i ftohtë e i ngrirë i palltos së tij.

«Mami! Babi është mirë dhe më tha të të tregoj se së shpejti do të kthehet tek ne. Nëse Zoti bëri mrekullinë që lejoi që unë ta takoja» – tha ai, – «atëherë Ai mund të bëjë edhe një mrekulli tjetër dhe të na bashkojë përsëri».

Të gjithë ishin të përlotur. «Duhej të prisnim në borë për orë të tëra»- tregoi Liza. «Na lanë të hynim nga porta kryesore, dhe më pas qëndruam në një vend të rrethuar larg ndërtesës së senatoriumit. Të burgosurit duhej të kalonin një vend të hapur për në një kabinë të madhe ku takonin vizitorët. Ishte e tmerrshme t'i shihje. E frikshme! Dukeshin si turma të errësirës, forma të mbështjella në borën e ndritshme. Si fantazma të errëta, ja, ashtu

dukeshin! Dhe midis tyre, pashë Riçardin! S'mund të gaboja, është shumë i gjatë. E përshëndeta me dorë si e çmendur, por s'po më dallonte. Ishim të gjithë në turmë dhe të gjithë po përshëndesnin me dorë. E pashë, por vetëm se Mihai nuk lejohej të fliste me të».

«Në kushte të tilla, s'mund t'i thoshim shumë njëri-tjetrit», – tha Mihai. «Por fjalët e fundit të babait ishin: 'Mihai, dhurata e vetme që mund të të jap si baba është këshilla: Kërko gjithmonë virtytet më të larta të krishtera, që të ruash masën e duhur në çdo gjë».

Sabina e kishte vendosur me kujdes kartolinën e Riçardit midis faqeve të Biblës. Herë pas here e merrte dhe e lexonte. Dikur, më vonë ai i tha se në burg dhe në sanatorium ishte bërë mjeshtër në shprehjen e gjërave të mëdha në letra të vogla që të burgosurit lejoheshin të shkruanin, kështu që ata vinin tek ai për t'i ndihmuar që çdo rresht që shkruanin të kishte vlerë. Pyesnin gjithashtu njëri-tjetrin mbi atë çfarë kishte sugjeruar Riçardi, kështu që fjalët e Riçardit u shpërndanë në të gjithë atë vend. Rezultati ishte që shumë të burgosur i fillonin kartolinat e tyre me: «Koha dhe largësia e shuajnë një dashuri të vogël, por e bëjnë një dashuri të madhe edhe më të fortë». Kështu që mesazhi i dashurisë dhe i shpresës së Riçardit lexohej anë e mbanë. Predikuesi i burgut i ishte kthyer punës.

NJË MËNGJES I MREKULLUESHËM

Viti 1956 filloi me një gjendje rebelimi të bllokut komunist. Planet pesëvjeçare të sovjetikëve nuk kishin çuar gjëkundi. Ushqimi ishte akoma i pakët dhe rrogat ishin të ulëta. Të gjitha shpresat që ishin rritur pas vdekjes së Stalinit ishin shuar.

Në muajin shkurt, gjatë kongresit të njëzetë të Partisë Komuniste, sovjetiku Nikita Krushov mbajti një fjalim sekret, ku denonconte Stalinin dhe punën e tij. Rusët nuk e botuan asnjëherë, por shumë shpejt, në çdo vend në Evropën Lindore njerëzit ndjenë një fllad të ngrohtë të zbutjes politike, që vinte nga Moska.

Shenjat e «destalinizimit» erdhën me shpejtësi. Forcat e mëdha të policisë, edhe të asaj sekrete, u reduktuan në numër. Kontrata miliona dollarëshe po negocioheshin me vendet perëndimore për

të shpëtuar ekonominë. Kolektivizimi u ngadalësua. Dhe për më tepër, qindra të burgosur politikë liroheshin çdo ditë si pasojë e amnistisë.

Sabina nuk guxonte të shpresonte që Riçardi të ishte mes tyre. Nuk kishte marrë asnjë shenjë, asnjë lajm që ai mund të lirohej më herët. Për më tepër, ai kishte edhe disa vite për të kryer dënimin. Kur, një mëngjes të mrekullueshëm, Riçardi erdhi më në fund në shtëpi. Sabinës sa nuk i ra të fikët ndërsa ai ia hodhi duart rreth qafës. Sa herë ishte druajtur që atë përqafim nuk do ta ndiente më kurrë. Në mbrëmje, miq nga i gjithë Bukureshti erdhën për ta takuar, dhe së bashku qanë e qeshën.

Riçardi kishte vuajtur shumë në burg. Ishte rrahur me shumëllojshmëri mjetesh torturuese, madje edhe e kishin droguar. Tetëmbëdhjetë shenja torturash kishte në trupin e tij të pakët, dhe mjekët zbuluan më vonë shenja të një tuberkulozi të shëruar në mushkëri. S'mund ta besonin se kishte shpëtuar tetë vjet e gjysmë (pothuajse tre prej tyre në izolim në një qeli të nëndheshme) pa u kuruar. Atij i kishin dhënë shtratin më të mirë në pavijonin e spitalit. E mahnitshme se si të burgosurit e liruar trajtoheshin me mirësi dhe bujari nga njerëzit kudo që shkonin. Ata ishin grupi më i privilegjuar në Rumani, një status që i tërbonte komunistët.

Shumë shpejt pasi Riçardi u përmirësua, ai dhe Sabina festuan përvjetorin e njëzetë të martesës së tyre. Nuk kishin asnjë qindarkë për t'i bërë dhuratë njëri-tjetrit, por Riçardi ia doli mbanë të gjente një bllok të bukur në të cilin shkruante çdo natë vargje, poema dashurie për Sabinën: dashurinë e jetës së tij.

Ata të dy u kishin mbijetuar tundimeve dhe torturave. Perëndia kishte qenë forca e tyre dhe dashuria motivimi. Por ndërsa një dekadë tragjike po lihej pas, një makth tjetër po u afrohej.

«VENDOS ENGJËJT E TU RRETH TIJ!»

Në mbrëmjen e 13 Janarit 1959, një grua nga kisha e tyre mbërriti në derën e Vurmbrandit me lot në sy. Një javë më parë, kishte marrë ca kopje të predikimeve të Riçardit dhe qindra fotokopje po qarkullonin në të gjithë Rumaninë, një situatë që ishte plotësisht kundër ligjit. Gruaja që po kërkonte ndjesë kishte ardhur për të

paralajmëruar Riçardin se policia kishte bastisur apartamentin e saj dhe ia kishin marrë të gjitha kopjet. Nuk do të zgjaste shumë dhe do të vinin për të.

Mësuan gjithashtu nga një mik tjetër që Riçardi ishte denoncuar nga një pastor i ri, i cili deklaronte të ishte miku i tij. Ata e dinin që atij mund t'i ishte bërë shantazh, mund të ishte detyruar të firmoste për shkak të kërcënimit të burgut.

Në orën një të mëngjesit tjetër, oficerë të zemëruar policie shkelmuan derën e Vurmbrandëve dhe hynë me rrëmbim në dhomën e tyre të vogël në papafingo.

«Ti je Riçard Vurmbrandi?» – tha kapiteni në ngarkim me zë të lartë. «Hyni të gjithë në dhomën tjetër dhe qëndroni aty».

Edhe një herë tjetër apartamenti i tyre i vogël u mbush plot me njerëz, që hapnin dollapë, zbraznin sirtarë, hidhnin letra në dysheme. Në tavolinën e punës së Riçardit gjetën fletë me shënime, predikime të shtypura dhe Bibla të përdorura. Të gjitha u konfiskuan. Më pas gjetën dhuratën e përvjetorit të Sabinës, bllokun e shënimeve në të cilin Riçardi kishte shkruar poema dashurie për të.

«Ju lutem, mos e merrni! Është diçka personale. Juve nuk ju hyn në punë», – iu lut Sabina. Por ata e morën gjithsesi.

Kapiteni në ngarkim i vuri prangat Riçardit dhe e nxori nga dhoma e pasme.

Sabina foli me guxim: «A nuk ju vjen turp të trajtoni një njeri të pafajshëm në këtë mënyrë?»

Riçardi shkoi drejt saj, por ata ia kapën krahët dhe e tërhoqën pas. Ai i paralajmëroi: «Nuk do të largohem nga kjo shtëpi, nëse nuk më lejoni të përqafoj gruan time».

«Lëreni të lirë», – tha kapiteni. Njëri nga policët ia hoqi prangat.

U ulën së bashku në gjunjë duke u lutur ndërsa policia sekrete qëndronte rreth tyre. Kënduan qetësisht një himn, me zërat që u «treteshin» në fjalët «Themeli i kishës është Jezu Krishti, Zoti i saj».

Një dorë e madhe rëndoi në supin e Riçardit. «Duhet të shkojmë. Është pothuajse ora pesë», – tha kapiteni me qetësi. Sigurisht që ai u habit nga dashuria e pabesueshme e Sabinës dhe Riçardit për njëri-tjetrin. Ishte i përlotur.

Riçardit iu vunë prangat edhe një herë dhe policët e nxorën jashtë dere. Sabina e ndoqi poshtë shkallëve. Në fund ai ktheu kokën dhe tha: «Përqafoje Mihain nga unë». Ndaloi pastaj për një moment para se të shtonte: «Dhe përshëndete nga unë pastorin që më denoncoi». Dhe e morën. Ndërsa automjetet e policisë u larguan, Sabina vrapoi pas furgonit në rrugën e akullt, duke thirrur e duke qarë ndërsa rrëshqiste në rrugët me baltë: «Riçard! Riçard i dashur!»

Më pas furgoni u zhduk pas qoshes, dhe ajo ndaloi, pa frymë dhe zemërthyer. Mbrapa, në apartamentin e papafingos, dera ishte e hapur. Sabina ra në dysheme, duke qarë në lutje. «Zot, e dorëzoj burrin tim në dorën Tënde», – thirri ajo. «Unë s'mund të bëj asgjë, por Ti mund ta nxjerrësh përtej dyerve të mbyllura. Ti mund të vendosësh engjëj rreth tij. Ti mund ta kthesh përsëri!»

U ul në errësirë duke u lutur derisa lindi dielli. Teze Liza erdhi atë mëngjes dhe e gjeti akoma në dysheme. Me sytë e skuqur e të përlotur, Sabina e vështroi dhe tha: «Ma morën sërish Riçardin».

EPILOG

Riçardin e mbajtën të burgosur edhe për gjashtë vite të tjera dhe Sabina pati mundësinë ta shihte vetëm një herë gjatë gjithë kësaj kohe. Ajo vazhdonte me vullnet punën e saj në kishën e fshehtë dhe priste me besnikëri bashkëshortin, duke mos besuar se Perëndia nuk do ta sillte më në shtëpi.

Në dhjetor të 1965-ës, Riçardi u lirua për një shumë prej dhjetë mijë dollarësh nga Aleanca Misioni Norvegjez për Çifutët dhe të Krishterët Hebrenj. Pagesa për një të burgosur politik në atë kohë ishte njëmijë e pesëqind dollarë. Riçardi dhe Sabina nuk donin të largoheshin nga vendlindja e tyre, Rumania, por besimtarët në kishën e fshehtë i bindën të shkonin që të ishin zëri i atyre, që persekutoheshin për besimin dhe dëshmi e dashurisë së Perëndisë në kohët më të vështira. Vitin pasues Riçardi, Sabina dhe Mihai mbërritën në Shtetet e Bashkuara.

Nën kërcënimet me vdekje nga komunistët, familja e Vurmbrandëve u bë menjëherë zëri i motrave e vëllezërve, besimi i të cilëve ishte nën sprovë.

Në tetor të 1967-ës, me vetëm njëqind dollarë dhe me një makinë të vjetër shkrimi në tavolinën e kuzhinës, Vurmbrandët shkruan letrën e parë të «*Zërit të Martirëve*». Që nga botimi i parë, kjo lloj letre ka vazhduar të botohet rregullisht, dhe pothuajse dhjetë milionë kopje shpërndahen në mbarë botën në shumë gjuhë.

Që kur Riçardi dhe Sabina erdhën në Shtetet e Bashkuara, punuan pa pushim për ndarjen e mesazhit të shpresës dhe të dashurisë përballë persekutimit dhe martirizimit. Jetët e tyre u pasuruan përmes sprovave që duruan.

Shumë pak, para se Sabina të ndahej nga jeta për shkak të kancerit në gusht të vitit 2000, i kërkoi Riçardit të saj të dashur (që ishte gjithashtu shumë i sëmurë) të shkonte pranë shtratit të saj. Në praninë e një grupi të vogël miqsh, Sabina i tha përsëri Riçardit se sa shumë e donte, dhe i kërkoi ta falte për ndonjë gabim gjatë bashkëjetesës së tyre. Sabina kishte dhembje të tmerrshme në ato çaste, por refuzoi medikamentet që të mund të ishte me mendje të kthjellët dhe e vetëdijshme kur t'i thoshte lamtumirë jetës së përkohshme, që i kishte sjellë aq shumë dhimbje, por edhe gëzim.

Ajo kishte jetuar prej dashurisë së Krishtit dhe dashurisë që u kishte dhënë gjithë të tjerëve pa çmim.

Tara:
Jetë në arratisje

Pakistan
Qershor 1985

Postieri u drejtua për nga vila e njohur dhe hodhi një sy përmes dritares. Vetëm hyrja e saj ishte e madhe sa shumica e e shtëpive në fshatrat e Pakistanit. «Kam një pako për Tarën», – tha postieri kur më në fund një shërbëtor hapi derën. «Më duhet firma e saj. A mund të hyj?» Ai mbante një kuti kartoni kafe jo shumë të madhe. Stilolapsin e kishte gati.

«Jo, s'mund të hyni brenda», – tha me ashpërsi shërbëtori. «Ma jep mua pakon dhe do t'ia jap Tarës. I ati nuk e lejon të vijë te dera». «Në rregull», – miratoi pa dëshirë postieri. «Por duhet të marr firmën nga Tara ose nga dikush tjetër me autoritet, përndryshe s'mund ta lë pakon. Më kupton?

«Po, po», – tha shërbëtori me padurim, duke zgjatuar dorën. «Tani, ju lutem më jepni pakon!»

Tara kishte nxjerrë kokën mbrapa qoshes, duke pyetur veten se ç'ishte gjithë ajo rrëmujë dhe kush do t'i kishte dërguar asaj një pako. «Çfarë është kjo?», – pyeti ajo shërbëtorin. «Prej kujt është?» Shërbëtori mblodhi supet dhe ia dha letrën për ta firmosur. Shënoi emrin dhe zgjati dorën për nga pakoja. Ishte më e rëndë nga ç'priste. E mori ndër duar dhe nxitoi të shkonte për në dhomë, duke mbyllur derën pas. Megjithëse familja e Tarës ishte e madhe, ajo e kishte dhomën e saj të mobiluar mirë. Përballë dritareve të mëdha kishte dollapë dhe në secilën anë të krevatit kishte abazhurë tërheqës, secila me nga një llambë elegante kristali. I ati i Tarës e kishte pikë të dobët vajzën e tij, dhe dhoma e saj ishte e mbushur plot me dhurata.

Ajo ishte shumë e emocionuar, aq sa mund të ishte një vajzë dymbëdhjetë vjeçare kur merr një pako të papritur me postë. E vuri kutinë në dysheme, u ul në gjunjë përballë saj, i hoqi ngjitësen që mbante të mbyllur kutinë. Duke parë brenda në kuti, Tara u habit. Kurioziteti i saj gazmor u kthye shpejt në tronditje. Brofi në këmbë dhe u drejtua për nga dera, e hapi sa për të nxjerrë jashtë kokën, vështroi lart e poshtë korridorit për t'u siguruar që askush nuk ishte afër. Mbylli përsëri derën, por këtë herë e mbylli me kyç para se të kthehej për të hapur kutinë në mes të dyshemesë së dhomës së gjumit.

Një zë i brendshëm i thoshte se duhej t'ia dorëzonte kutinë të atit. Kjo do të ishte gjëja më e sigurt për të bërë, thoshte me vete. Thjesht do t'i thoshte të atit se nuk e kishte idenë se nga kishte ardhur me emrin e saj në të. Por e vërteta ishte se Tara e dinte se nga vinte kutia. Ajo përmbante diçka për të cilën Tara kishte aplikuar. Disa javë më parë kishte plotësuar një kupon të vogël në një gazetë lokale dhe e kishte postuar. Porosia kishte ardhur, por ajo kishte frikë se mund të kapej me të. Mendimet i kalonin shumë shpejt në kokë. Duhej të vendoste ose ta mbante në një vend të fshehtë ose t'i tregonte t'atit.

Kurioziteti e mundi frikën dhe nxori një prej librave të vegjël nga kutia. Libri kishte vetëm një titull në kapakun e butë prej fildishi: *Zanafilla*. U ul në krevat, hapi kapakun dhe filloi të lexonte.

Që ditën e parë që i mbërrinte programi i studimit të Biblës, Tara i përkushtohej materialit, duke plotësuar dy ose më shumë kurse në javë. I mbyllte testet e përfunduara në zarfet, që i vinin me subjektin, dhe i kërkonte shërbëtorit të shtëpisë t'ia postonte. Brenda pak kohësh i vinte një certifikatë e re me postë, ku e përgëzonin për suksesin e saj.

Tara, që vinte nga një familje shumë e rreptë myslimane e njohur në të gjithë Pakistanin, nuk kishte ndër mend të ndryshonte besimin e saj. Thjesht e tërhoqi studimi i Biblës dhe veçanërisht i pëlqente të merrte certifikatat e bukura. Ishte studim i lehtë dhe argëtues, por i ofronte edhe një element emocionues rreziku ndërsa e vendoste kutinë me kujdes dhe ato që ajo përmbante,

poshtë krevatit të saj çdo ditë. Shërbëtorët që e ndihmonin për të postuar dhe për të marrë postën ishin betuar ta ruanin sekretin. Të gjithë e dinin se i ati do të zemërohej nëse do ta merrte vesh, por gjithashtu e dinin se Tara ishte vajza e preferuar e tij. Ai do të zemërohej, po, por kishte të ngjarë që thjesht ta qortonte dhe t'ia merrte librin. Ajo thjesht po argëtohej. *Çfarë dëmi do të më sjellë studimi?* -pyeste veten.

Dy vjet e gjysmë më vonë, Tara postoi testin e fundit. Kishte plotësuar të gjithë kursin, duke studiuar çdo libër të Biblës. Kishte një ndjenjë vetëkënaqësie dhe ende habitej që gjithçka ishte falas dhe sekreti i saj nuk ishte zbuluar. Disa javë më vonë u habit edhe më tepër kur erdhi një kuti tjetër. Ishte shumë më e vogël se ato të kursit, por relativisht e rëndë për përmasat e saj. Tara e dinte që ishte nga të njëjtët persona që i kishin dërguar kursin dhe certifikatat e përfundimit, por nuk e kishte idenë çfarë ndodhej brenda. Për habinë e saj ishte një Bibël e bukur blu me anët e faqeve të lara në ar. Ishte libri më i bukur që kishte parë ndonjëherë. Kur hapi kapakun, vuri re emrin e saj me shkrim të bukur në shenjë të mbarimit me sukses të të gjithë kursit biblik. Shfletoi faqet e holla para se ta fshihte dhuratën e saj të re poshtë shtratit me librat e tjerë. Nëse kapej me Bibël, e dinte që do ta paguante shtrenjtë.

Në fakt, as që mund ta merrte me mend ç'do t'i ndodhte.

I KRISHTERI

Një vit më vonë, pasi mbaroi klasën e dhjetë në shkollë me nota të shkëlqyera, Tara mori një ftesë që të zhvillonte një studim krahasues të feve në Iran. Familja e saj bënte udhëtime të shpeshta në Iran, dhe Tara kishte dëshirë t'i vazhdonte studimet universitare atje. Ajo besonte gjithashtu se studimi sekret i Biblës do t'i siguronte një fillim të mirë në studimin e krishterimit.

Familja e saj e shoqëronte në udhëtimet e studimit dhe ndërsa ishin në Iran, Tara takoi një të krishterë për herë të parë. Ndodhi kur ishte larguar një pasdite nga dhoma e hotelit, duke planifikuar të nxirrte në fotografi kopshtin jashtë xhamisë lokale për një prezantim, që i ishte caktuar për mësim. Ishte

e rrezikshme për një vajzë të huaj të lëvizte vetëm, por Tara i premtoi vëllait më të madh, që kujdesej për të atë ditë, se do të qëndronte afër hotelit, dhe ai aprovoi pa shumë dëshirë që ajo mund të shkonte.

Ndërsa shëtiste në oborr duke nxjerrë fotografi, i tërhoqi vëmendjen një pamje. Një njeri ishte ulur në tokë pranë një vajze disa vjet më e vogël se Tara. Kishte bashkuar fort duart dhe me sytë drejt qiellit, dukej sikur po fliste me dikë.

«Çfarë po bën?» – pyeti Tara, duke ndierë një tërheqje të çuditshme ndaj këtij njeriu.

«Po bisedoj me Perëndinë» – u përgjigj ai me thjeshtësi.

«S'mund të flasësh me Perëndinë», – diskutoi Tara, duke e përfunduar vërejtjen e saj me një të qeshur. «Ai nuk do të zbresë e të flasë me ty, dhe as ti s'mund të shkosh atje lart derisa të vdesësh. Si mund ta thuash një gjë të tillë, që je duke *biseduar* me Perëndinë?»

Burri e vështroi Tarën me durim dhe me një buzëqeshje shtoi: «Unë jo vetëm që fola me Perëndinë, por mora edhe një përgjigje».

Tani Tara ishte e sigurt që ky njeri ishte i çmendur. «Ke marrë përgjigje? Ti nuk je as profet dhe as engjëll. Si është e mundur të marrësh përgjigje nga Perëndia?»

«A dëshiron të dish se si mund të flasësh me Perëndinë?»

«Po, sigurisht që do të më pëlqente ta dija», – u përgjigj Tara. Ajo nuk i besoi as edhe për një çast, por donte të dëgjonte shpjegimin e tij, megjithëse do të ishte i kotë.

«Atëherë më tako nesër në orën katër. Do të ta shkruaj këtu vendtakimin». Duke nxjerrë një letër, burri shkroi adresën dhe udhëzimet për në kishën e tij. «Eja këtu dhe, jo vetëm që do ta dish se mund të flasësh me Perëndinë, por do të marrësh vesh që Ai të do».

Kur Tara u kthye në hotel dhe tregoi mbi atë çfarë i kishte ndodhur, i vëllai u tërbua. «Çfarë po mendon?! S'mund të shkosh në atë vend. Është kishë e krishterë! Ky është Irani dhe ti je myslimane. Mund të varesh nëse kapesh në një vend të tillë!»

«Më kanë caktuar për të studiuar fetë e ndryshme. Si mund t'i përfundoj studimet e mia, nëse nuk bëj kërkime?» – protestoi Tara.

Diskutimi përfundoi me të vëllanë që ra dakord të bënte një kërkesë zyrtare në stacionin e policisë lokale për të vizituar kishën. Nga atje, u dërgua në gjykatë, ku iu dha leja. Por oficerët kërkuan që ajo të shoqërohej nga dymbëdhjetë oficerë sigurie dhe nga vëllai i saj kur të vizitonte kishën.

«Nuk duhet të kesh frikë», – tha i vëllai. «Do të jem jashtë derës me policinë nëse ndodh ndonjë gjë». Tara pyeste veten se çfarë mund të ndodhte në kishë që duhej një siguri kaq e lartë.

Të nesërmen në orën katër, Tara hyri në kishë. Eci me ngadalë, me trupin që i dridhej, ndërsa rojat e sigurisë dhe i vëllai prisnin jashtë. Përveç burrit tek oborri, Tara nuk kishte takuar asnjë të krishterë. Pyeste veten se si mund të ishin ata, si silleshin. A ishin të rrezikshëm?

Gjeti një vend nga fundi i kishës. Zgjodhi atë që ishte afër hyrjes kryesore që të mund të dilte shpejt, nëse do t'i nevojitej. Shumica e stolave të drunjtë ishin tashmë plot dhe këngët kishin filluar. Anëtarët e kishës kënduan disa këngë dhe Tarës iu dukën të njohura disa nga vargjet e tyre nga studimi i Biblës. Pas këngëve, dikush doli në podium dhe filloi të flasë rreth lutjes. Ai pyeti nëse dikush kishte ndonjë çështje për lutje, të dilte përpara.

Ndërsa disa njerëz filluan të dilnin përpara, Tara pa burrin që kishte takuar një ditë më parë. Ai mbante një vajzë të vogël rreth tetë vjeç; Tara mendoi se mund të ishte e bija. Ajo ishte plotësisht e gjymtuar. Krahu i përplasej në shpinën e t'atit që e mbante. Kishte një vështrim të zbrazët dhe dyshoje që mund të ishte e gjallë.

Burri doli përpara dhe filloi të lutej me zë të lartë, duke i kërkuar Perëndisë të shëronte fëmijën e tij. Të tjerët në kishë iu bashkuan dhe filluan të luteshin për vajzën. Tara mendoi përsëri se një njeri duhej të ishte i çmendur që të fliste me Perëndinë në atë mënyrë. Pse do ta ndihmonte Perëndia këtë fëmijë? Për Tarën nuk kishte fare kuptim. Por, pavarësisht skepticizmit të saj, u mahnit nga aktiviteti dhe donte të kujtonte gjithçka që të mund t'i paraqiste në tezën e saj.

Më pas Tara vuri re se vajza e gjymtuar po fillonte të lëvizte. Këmbët iu drejtuan dhe i ati e uli butësisht në dysheme, duke e

ndihmuar të qëndronte. *Zoti i madh!* mendoi Tara. *S'mund ta besoj*.

Në kishë po këndonin këngë lavdërimi për Perëndinë ndërsa vajza e vogël, tani e shëruar nga sëmundja që e kishte lënë të gjymtuar, shkoi në korridorin qendror të kishës dhe vështroi drejt e në sytë e Tarës. Kur arriti në stolin ku ishte ulur ajo, tha: «Emanuel» dhe më pas u kthye tek i ati.

Tara u tmerrua nga ajo çka ndodhi dhe nga të gjitha mendimet që i kalonin në kokë. Pse duhej të vinte kjo vajzë pikërisht tek ajo, midis gjithë atyre njerëzve në kishë? Si iu shëruan këmbët? Dhe çfarë do të thoshte *Emanuel*? Studimet fetare për të cilat u dërgua po i sillnin më tepër pyetje se sa përgjigje. Ishte e vendosur të kuptonte çfarë po ndodhte.

Nuk guxoi t'i thoshte dikujt se çfarë kishte parë në kishë. Por sigurisht që nuk do ta harronte. Më vonë, kur mbërriti në shtëpi në Pakistan, shkoi në të vetmin vend që mendonte të gjente përgjigje. Shkoi te Bibla blu. Këtë herë nuk po lexonte për të kaluar provimin; ishte duke kërkuar për të vërtetën me gjithë zemër. Lexonte çdo ditë Shkrimet, duke u përpjekur të kuptonte ndryshimet midis Biblës dhe Kuranit dhe të zbulonte pse myslimanët ishin kundër të krishterëve.

Perëndia i të krishterëve duhet të jetë i vërtetë – mendoi ajo. *Përndryshe, si mund t'i dëgjojë Ai kur ata luten*?

E TRADHTUAR

Më në fund Tara e kuptoi se nuk mund të shkonte më larg e vetme. E dinte se duhej të bisedonte me dikë. Në vend që të kishte gjetur përgjigje nga kursi i fesë dhe dëshmia në kishë, i kishin lindur më shumë pyetje, ndaj dëshironte dëshpërimisht të kuptonte se çfarë po ndodhte.

«Babi, po dal me disa shoqe», – i tha Tara t'atit ndërsa përgatitej të largohej. Ishte hera e parë në gjashtëmbëdhjetë vjet që po e gënjente t'atin dhe turpi i përshkoi trupin ndërsa nxitoi të dilte nga shtëpia e madhe e luksoze e familjes. Por i duhej të zbulonte cili ishte besimi i krishterë. Kthimi në kishë ishte mënyra e vetme që dinte për ta bërë këtë.

Kaloi në qytet për të shkuar në një kishë dhe përsëri shkoi në një vend në fund të sallës, ndërsa shërbesa po fillonte. Më pas, u prezantua me njeriun që po drejtonte shërbesën duke shpresuar t'i bënte disa pyetje. Pastori ra dakord. Tara mendonte se kisha ishte kishë dhe një i krishterë ishte i krishterë dhe se çdokush prej tyre do të ishte në gjendje ta ndihmonte. Fatkeqësisht, në këtë rast gabohej.

Pastori u vu pak në siklet nga pyetjet e shumta të Tarës ndërsa vinte çdo javë për të biseduar me të. Ai ishte i shqetësuar për sigurinë e tij dhe i tha në më tepër se një rast se do të ishte më mirë të mos vinte më. «Por ku mund të shkoj tjetër për të gjetur përgjigje?» – pyeti Tara.

Këmbëngulja e saj e bindi për njëfarë kohe, por në fund pastori e ndjeu se rreziku ishte shumë i madh. Duke menduar që të shpëtonte nga ndonjë telash, takoi babanë e Tarës dhe i raportoi se ajo vinte në kishën e tij dhe i bënte shumë pyetje rreth Biblës. Brenda disa minutash ai e kishte tradhtuar një adoleshente myslimane, që po kërkonte të dinte se kush ishte Perëndia në të vërtetë.

«Çfarë mendoje se po bëje?!»- ulëriti babai i Tarës kur arriti në shtëpi atë pasdite. «A e ke idenë se çfarë turpi ke sjellë në këtë familje? Si munde ta takosh atë njeri? Ai nuk është mysliman. Është i krishterë! Sa e marrë që je! A mos je bërë një prej tyre?»

Tara u trondit nga zemërimi i babait; ajo nuk e kishte parë kurrë këtë anë të tij. U përpoq të shpjegonte se thjesht po bënte pyetje dhe nuk kishte ndër mend të kthehej në të krishterë, por ai nuk e dëgjonte. E urdhëroi me zemërim të largohej nga prania e tij dhe Tara iku nga dhoma e përlotur. Nuk e kishte idenë ku e kishte futur veten ose se sa do ta nxiste kjo zemërimin e t'atit.

Kishte ende pyetje pa përgjigje. Kur u kthye në dhomë, pavarësisht nga skena që sapo kishte përjetuar, Tara u ndie e tërhequr nga libri blu prej lëkure. Duke fshirë lotët, e hapi dhe u përpoq të lexonte ndërsa të sharat me zemërim vazhdonin të jehonin në mendjen e saj.

Pak nga pak fjalët e lashta e tërhoqën, duke i hequr ankthin dhe duke e inkurajuar me dashurinë e Perëndisë. U përfshi aq shumë në leximin e Shkrimit, saqë e humbi sensin e kohës dhe nuk e vuri

re që i ati kishte hyrë në dhomë. Në fillim fytyra e tij tregonte një njeri, të cilit i vinte keq që i kishte bërtitur me aq keqdashje vajzës së tij të vogël. Por kur e pa çfarë po lexonte, shprehia e penduar në fytyrën e tij u kthye në mëri.

«Ti je e krishterë! Tani e di që je!», – ulëriti ai. «Babi, të betohem, nuk jam e krishterë. Jam kurioze. Duhet të më besosh!»

«Mos më gënje! Atëherë, pse duhej të lexoje një Bibël?»

«Të lutem, babi! Po lexoj thjesht një libër. Ti e di që po bëj shumë studime kohët e fundit.« Tara po përpiqej me dëshpërim ta bindte për pafajësinë e saj kur dora e tij iu përplas në fytyrë.

«Si mund t'ia bëje këtë familjes? Ne jemi myslimanë!» Ajo u zmbraps prej tij e tronditur dhe me dhembje, e habitur që ai e kishte goditur. I ati e ndoqi dhe e qëlloi përsëri. «Ne kemi lindur myslimanë dhe myslimanë do të vdesim. Dhe ti nuk je më vajza ime!»

Ngashërimat e Tarës bënë që i vëllai të vinte me nxitim në dhomë për të marrë vesh ç'po ndodhte. «Motra jote është bërë e krishterë! Ka takuar një pastor dhe tani e zbulova që po lexon Biblën!»

Duke dëgjuar akuzat, vëllai i Tarës ndryshoi nga i shqetësuar në të zemëruar, dhe iu drejtua Tarës duke iu bashkuar t'atit në rrahje. Sytë i zunë Biblën blu dhe filloi ta grisë me zemërim. Babai i Tarës gjeti një rrip, e palosi më dysh dhe nisi ta qëllojë në fytyrë dhe shpinë, ndërsa ajo ngashërente me të madhe.

«Baba, duhet t'i gjesh një burrë. Dhe bëje shpejt, para se kjo të vazhdojë më tej», – tha i vëllai me fytyrë të skuqur nga zemërimi dhe lodhja. Ndërsa të dy u larguan nga dhoma, i ati pohoi me kokë.

«EMANUEL, EMANUEL»

Ndërsa Tara qëndronte në mes të dyshemesë, tha lutjen e saj të parë: «Perëndi, nuk e di se për çfarë po flasin babai dhe vëllai im. Unë nuk jam e krishterë; jam myslimane. Por tani nuk e di se në ç'rrugë të shkoj. Të lutem, më trego dhe do ta ndjek!»

Tara u ndie çuditërisht në paqe pasi u lut dhe e shtrirë në dysheme ra në gjumë të thellë. Pas pak ndjeu dikë që i ngrinte kokën dhe i përkëdhelte butësisht fytyrën. Mund të dëgjonte një zë; dukej sikur dikush në prapaskenë po lëvizte drejt saj. Zëri po thoshte: «Emanuel, Emanuel» Tara u ngrit me të shpejtë dhe

vështroi rreth dhomës, por nuk ishte askush. Ndërsa i kujtohej ëndrra e çuditshme, ishte ëndërr, apo... U përpoq të përsëriste fjalën e çuditshme që e dëgjoi për herë të dytë: «*Emanuel*».

Tara u shtri në shtrat, duke menduar përsëri për incidentin në Iran.

«Çfarë do të thotë?» – pyeti ajo veten me zë të lartë. «Dhe pse vazhdoj ta dëgjoj këtë fjalë?»

Preku fytyrën lehtë, duke u dridhur prej dhembjes. Gjatë gjithë jetës së saj, i ati nuk e kishte goditur asnjëherë dhe Tara ishte e shkatërruar nga zemërimi i tij dhe nga dëshira për ta rrahur. Ajo dhe i ati kishin qenë gjithmonë shumë afër. Por tani e dinte që nuk do të ishin më kurrë njësoj. E dinte që zemërimi i babait nuk do të largohej lehtë.

Dhe as këmbëngulja e saj për të vërtetën.

Disa ditë më vonë, babai i Tarës u ul me të bijën, fytyra e së cilës mbante akoma shenjat e rrahjes. Iu afrua përsëri duke shprehur keqardhje në sytë e tij. «Tara, më vjen keq për atë që të bëra», – tha ai. «Është turp për një baba të rrahë të bijën. Duhet të më kuptosh se nuk doja të të lëndoja. Përshtypja që më le më bëri të mos duroja. Të lutem më fal!»

Tara qëndroi e qetë duke mos i besuar plotësisht butësisë së rishfaqur të babait. «Tani e di që është koha që duhet të martohesh», – vazhdoi ai.

Tarës iu kujtua çfarë i kishte thënë i vëllai pas rrahjes. Por ishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk kishte ndër mend të martohej. «Babi, jam shumë e vogël për t'u martuar. Dua të përfundoj studimet». U përpoq të dukej e qetë.

I ati u ngrit me zërin edhe më të vendosur. «Thashë se do të ishte më mirë nëse martoheshe. Nuk është sugjerim».

Tara u drodh prej ftohtësisë së zërit të tij, por nuk kishte dëshirë të dorëzohej lehtë. «Jo, babi, nuk dua. Jam shumë e vogël dhe dua të përfundoj arsimimin në fillim. Nuk dua një martesë me mblesëri, babi! Kush është ai? Si e ka emrin? Çfarë feje ka?»

Fjalët i dolën nga goja para se ta kuptonte se çfarë po thoshte. Ishte marrëzi që një vajzë myslimane ta thoshte këtë. Për familjen e tyre kishte vetëm një fe: Islami. I ati i saj, përsëri i zemëruar,

ulëriti: «Çfarë do të thuash me çfarë feje ka? Kemi vetëm një fe këtu! Jemi myslimanë!» I kapi krahun dhe e afroi aq afër sa ta shikonte drejt e në sy. «Ti je e krishterë! Je, tani e di me siguri!»

Përpara se të mund të thoshte ndonjë fjalë në vetëmbrojtje, ndjeu përsëri dorën e fortë të babait në fytyrë. Ishte plotësisht i bindur se vajza ishte bërë e krishterë dhe si rezultat, bëri atë që mendonte se kishte për detyrë.

Duke hyrë në dhomë dhe parë t'atin ta godiste në fytyrë, njëra prej motrave të saj ulëriti e tronditur dhe e frikësuar.

Duke mos i marrë parasysh përgjërimet e anëtarëve të familjes apo të shërbëtorëve që u gjendën aty, babai i Tarës dhe i vëllai e tërhoqën zvarrë në dhomë dhe e mbyllën derën. E mbledhur kruspull në qoshe dhe duke u dridhur e tmerruar, Tara kishte arsye të forta për të pasur frikë për jetën e saj.

Babai dhe i vëllai e godisnin me çfarëdo gjëje që gjenin: kabllo elektrike nga një prej abazhureve të kristalit dhe një shkop nga dollapi i Tarës. Më pas rrëmbyen dhe i mblodhën duke i hedhur pa kujdes të gjitha gjërat e saj personale, rrugicat, shtratin, veshjet, gjërat elektronike, çdo gjë, dhe i grumbulluan në korridor. Kur skena e tmerrshme përfundoi, Tara u la e shtrirë në një pellg me gjak në mes të dhomës së saj tashmë bosh. Fjalët e fundit të babait para se të përplaste derën ishin: «Ose do të martohesh ose do të vdesësh. Zgjedhja është jotja. Nëse je e krishterë, atëherë nuk ka vend për ty në këtë qytet. Por nëse martohesh, mund të jesh vajza ime. Përndryshe do të vdesësh këtu e vetme».

ARRATISJA

Tara qëndronte shtrirë në dyshemenë e shtruar duke humbur ndjenjat herë pas here. Askush nuk lejohej ta ndihmonte. Familja mendonte se do të vinte në vete nëse e linin vetëm, pa ushqim dhe pa ndihmë mjekësore. Në ditën e tretë, Tara filloi të ngrihej, por një pellg gjaku i tharë kishte bërë që flokët t'i ngjisnin në dysheme. Ishte e trullosur, por po përpiqej të kujtonte çfarë i kishte ndodhur, ndjeu stomakun t'i përzihej dhe filloi ta mbulonte një valë trishtimi ndërsa shikonte plagët. Nuk e kishte imagjinuar kurrë që kërkimi për Perëndinë do ta sillte në një vend kaq të tmerrshëm. Por tani

mendonte vetëm për një gjë: të arratisej për të shpëtuar. Duke qenë se nuk kishte kaluar as edhe një ditë larg familjes së saj, nuk dinte çfarë të bënte, por nuk kishte rëndësi. E dinte që duhej të largohej.

Shkoi me mundim për te dollapi për të parë nëse i kishte mbetur diçka dhe gjeti të vetmen gjë, që u kishte shpëtuar: një çantë e vogël që prej udhëtimit të fundit në Iran. Kishte disa rroba, pak para, disa bizhuteri dhe pasaportën e saj. Ndërroi me qetësi rrobat e gjakosura, duke rënkuar prej dhembjeve pas çdo lëvizjeje. Kur u bë gati, qëndroi në mes të dhomës dhe hodhi sytë rreth e qark për herë të fundit. E dinte se, nëse largohej nuk do të mund të kthehej më kurrë në shtëpi. Në kulturën e saj arratisja ishte po aq e keqe sa edhe të qenët e krishterë dhe e dinte që familja e saj nuk do ta pranonte kurrë përbuzjen. Nëse e kapnin, ishte e sigurt që do ta vrisnin.

Me zemër të rënduar, doli fshehurazi nga dritarja e dhomës së gjumit dhe pa u vënë re u drejtua për nga stacioni i autobusit. Ishte e lënduar, e mpirë dhe zemërthyer. E vetmja gjë që e shtynte të vazhdonte ishte frika nga babai dhe i vëllai nëse e zbulonin, dhe etja në zemrën e saj për të njohur më tepër Perëndinë e krishterë. Kur arriti në stacion, bleu një biletë vetëm vajtje për në një qytet disa orë larg, një vend që e njihte pak. Kishte qenë atje disa herë me familjen dhe kishte në plan të kërkonte strehë në një kishë që kishte parë atje. Siguristh që çdo i krishterë do ta ndihmonte, mendonte ajo.

Udhëtimi me autobus ishte shumë i gjatë dhe njerëzit e vështronin dhe pëshpërisnin rreth adoleshentes së gjakosur. Si një vajzë tërheqëse nga një familje e ngritur, Tara u mblodh kruspull nga ndjenja e poshtërimit, duke e ditur se çfarë mund të mendonin pasagjerët e tjerë. Ishte përvojë e re për të dhe shpresonte që kërkimi për Perëndinë t'ia vlente gjithçka që kishte lënë pas. Ndërsa përpiqej të shmangte vështrimet, shpresonte që këta të panjohur nuk do ta dorëzonin në polici. Gratë në vendin e saj kanë shumë pak të drejta dhe rrallë shihen në publik pa një anëtar mashkull të familjes.

Kur autobusi arriti më në fund në destinacion, Tara zbriti me të shpejtë dhe u përpoq të përzihej me turmën. Nuk ishte e lehtë

në gjendjen e saj të dërrmuar dhe të gjakosur, por mendoi se sapo të arrinte në kishë do të pastrohej.

Kur arriti, takoi një oficer të Ushtrisë së Shpëtimit që po qëndronte jashtë derës. Çuditërisht, ai u përpoq ta bindte të mos kërkonte ndihmë atje. «Nëse do të isha në vendin tënd, nuk do të doja të isha vetëm me drejtuesin e kësaj kishe. Ka pasur thashetheme», – tha ai.

Tara ishte gati për të qarë. «Ç'është kjo?» – pyeti ajo. «Mendoja se një i krishterë është i krishterë. Ti po më thua se kjo kishë nuk është e mirë për mua? Për këtë jam larguar nga shtëpia?»

Eja në shtëpi me mua», – tha burri me mirësjellje. «Mund të të ndihmoj e të të mbroj».

Megjithëse Tara nuk ishte e sigurt nëse mund të shkonte në shtëpinë e këtij njeriu, nuk kishte zgjedhje tjetër. E ndoqi jo me shumë dëshirë. Zbuloi se ai kishte një grua dhe dy djem, dhe të gjithë në familje e trajtuan me mirësi për nja dy javë. Filluan thashethemet në familje; gruaja dyshonte se bashkëshorti i saj donte të kishte marrëdhënie me mysafiren e tyre të bukur e të re. Më në fund Tara s'mundi ta duronte tensionin; i kërkoi ta çonte diku tjetër. «Duhet të njihni dikë në qytet që mund të më ndihmojë», – u lut ajo. «Më dërgo atje, të lutem, dhe do të gjej një punë. E vlerësoj ndihmën tënde, por nuk dua t'ju shkaktoj më telashe ty dhe familjes tënde».

«Njoh një njeri që mund të të ndihmojë. Ai është në fakt nga vendlindja jote», – tha burri i Ushtrisë së Shpëtimit.

Tara u pushtua nga frika kur dëgjoi fjalët e tij. «Nuk mendoj se është ide e mirë», – tha ajo. «Të lutem, babai im nuk e di se ku jam dhe nuk dua që ta marrë vesh. Të lutem, mos ma bëj këtë!»

«Mos u shqetëso», – e siguroi burri. «E njoh këtë njeri. Do të të ndihmojë».

XHAXHAI I MOHUAR

Duke mos pasur mundësi tjetër, Tara ra dakord të takohej me këtë burrë. Por kur e pa për herë të parë, duke pritur në vendin e caktuar, pothuajse i ra të fikët. «Ai është babai im! Më ke mashtruar!» – ulëriti ajo.

«Jo, nuk është babai yt. Të siguroj», – tha burri. «Shko takoje!»

Për habinë e Tarës, burri ishte në fakt një xhaxha që nuk e kishte takuar kurrë, një njeri që kishte një ngjashmëri të frikshme me babanë e saj. «Pse nuk na ka treguar babai asnjëherë për ty?», – e pyeti Tara.

«U bëra i krishterë në vitin 1952, para se të hynte në fuqi ligji Sharia», – shpjegoi xhaxhai, duke iu referuar kodit islamik në vend. «Në atë kohë ishte e ligjshme të ndërroje fe, por nuk ishte e pranueshme në shoqëri. Babai yt më mohoi. Që atëherë kam punuar si pastor këtu. Tani e kuptoj që Perëndia të ka sjellë këtu. Mos u shqetëso! Do të kujdesem unë për ty; mund të jesh vajza ime».

Tara u ndie e lehtësuar dhe iu zgjua një fije shprese; ndoshta mund të rehatohej, të zinte një punë dhe të vazhdonte shkollimin.

Mësoi shumë shpejt që xhaxhai i saj ishte njeri i mirë, bujar dhe filloi ta donte dhe ta admironte. Ai kalonte orë të tëra duke biseduar me Tarën për krishterimin, dhe iu përgjigj të gjitha pyetjeve të saj. I shpjegoi madje edhe kuptimin e fjalës Emanuel. Pasi jetoi disa muaj në shtëpinë e xhaxhait duke studiuar me të, Tara e ndjeu se kishte një kuptim të qartë mbi Jezusin. U lut, duke i kërkuar Perëndisë t'ia falte të gjitha mëkatet dhe ia dorëzoi zemrën plotësisht Atij.

Kërkimi i Tarës për Perëndinë ia vlejti, por sprovat e saj sapo kishin filluar...

Telashet u dukën në prag kur një kushëri i largët erdhi të vizitonte xhaxhain e Tarës, i cili mendoi se e njohu Tarën. «Oh, jo» – e siguroi xhaxhai. «Ajo është thjesht një shoqe që ka ardhur për vizitë».

Por kushëriri nuk u bind dhe kur u kthye në shtëpi i telefonoi babait të Tarës dhe i tregoi se mendonte që vajza që po qëndronte me kushëririn e tij ishte Tara.

Vetëm disa ditë më vonë, ndërsa Tara po punonte në kuzhinën e xhaxhait, dëgjoi hapa të nxituar që vinin nga dhoma kryesore. Tara shkoi në atë drejtim dhe sa nuk u përplas me të, ndërsa ai hyri me ngut në kuzhinë, duke lëvizur duart si i marrë: «Është babai yt! Po vjen. Duhet të ikësh tani! Largohu! Shko te ferma e miqve të mi jashtë qytetit, të kam folur për të. Ja ku ke ca para;

tani, vrapo! Dhe mos u shqetëso! Nuk do t'i tregoj asgjë babait. Do të merremi vesh për disa ditë».

Babai dhe vëllai i Tarës ishin vërtet në krye të shkallëve të derës kryesore kur ajo u largua nga dera e pasme. Nuk kishte kohë të mendonte, i duhej të vraponte. Vetëm adrenalina e bëri të vazhdonte ndërsa vraponte me sa fuqi që kishte. Kërkoi në xhep për adresën që i kishte dhënë xhaxhai të cilën e mbante gjithnjë me vete, në rast se ndodhte diçka. Gati pa frymë dhe në dhimbje, Tara arriti në rrugën kryesore dhe ngadalësoi vrapin. Në këtë pjesë të qytetit, nuk donte të ngjallte dyshime. Pasi mori një taksi, u ul dhe mbylli sytë. S'mund ta besonte se po arratisej përsëri vetëm pas dy muajve me xhaxhanë e sapogjetur. Por, megjithëse adrenalina që e kishte bërë të vraponte aq shpejt i kishte shtuar rrahjet e zemrës, Tarën e përshkoi një ndjenjë e çuditshme paqeje. U lut në heshtje për babanë dhe vëllanë e saj, nuk donte që t'i shkaktonin shumë shqetësime xhaxhait.

Tara qëndroi në fermë dhjetë ditë derisa gjërat të qetësoheshin në qytet. Më në fund xhaxhai erdhi për ta takuar dhe Tara mezi priste të kthehej në shtëpi me të. Por kur e pa fytyrën e xhaxhait, e lëshoi zemra. «Çfarë ka që nuk shkon, xhaxha?» – pyeti ajo.

«Tara, ti e di sa shumë më ka gëzuar që të kam pasur këto dy muaj», – filloi ai, duke mos i hequr asnjëherë sytë prej saj. «U duk sikur Perëndia më dha bijën që kam dashur gjithmonë, si në gjak, ashtu edhe në zemër. S'mund të kthehesh me mua. Është shumë e rrezikshme. Më vjen keq që po ta them unë këtë gjë, por babai tha se ti duhet të vdesësh. Tha se ishte çështje nderi për të dhe familjen e tij.»

Tara e dinte se xhaxhai po tregonte të vërtetën. E dinte që i ati dhe vëllezërit nuk do të reshtnin asnjëherë së e kërkuari, dhe nuk kishte dyshim se çfarë do të ndodhte nëse e kapnin. Keqardhja për veten po i turbullonte mendjen, por trishtimi në sytë e xhaxhait i theri në zemër, duke e ndihmuar ta largonte fokusin nga vetja.

«Xhaxha, të lutem mos u trishto!» – tha ajo, duke i kapur duart. «Mua duhet të më vijë keq që të kam shkaktuar kaq shumë telashe. I jam mirënjohëse Perëndisë që më drejtoi te ti. Ti më dhe përgjigjet

që po kërkoja, dhe tani kam paqen që nuk e kam përjetuar kurrë më parë. Nuk do mundem kurrë të ta shpërblej këtë.»

Ishte një lamtumirë e përlotur ndërsa Tara u përgatit edhe një herë të shkonte në një shtëpi tjetër. Xhaxhai i saj kishte bërë të mundur që ajo të jetonte me një familje, që ai e njihte në një qytet të largët. Ajo u përpoq t'i fshihte shqetësimet e saj ndërsa u larguan, por përbrenda pyeste veten nëse do të mund ta ndalonte ndonjëherë arratisjen.

E BURGOSURA

Tara u mirëprit krahëhapur në shtëpinë e saj të re. Ishte familje e një pastori me gruan dhe tre djemtë e tyre. Djemtë e pranuan menjëherë Tarën si motrën e tyre të re. Djali më i madh, Rubini, e admironte veçanërisht për kurajën e saj.

Për ta mbrojtur nga babai dhe vëllezërit, që vazhdonin ndjekjen e saj, familja e re e Tarës i kërkoi të qëndronte në dhomën e saj pjesën më të madhe të kohës. Qëndronte atje gjithë ditën, edhe në mbrëmje, sa herë që dikush vinte për vizitë (gjë e zakonshme kur ke për bashkëshort apo baba një pastor).

Dhoma e Tarës ishte e ndarë në dy pjesë: njëra për të fjetur dhe tjetra për të qëndruar apo studiuar. Të dyja pjesët bashkë ishin më e vogël se gjysma e dhomës së gjumit në të cilën ishte rritur. Tara ishte e lehtësuar që po qëndronte me një familje, së cilës mund t'i besonte, por kufizimi ishte i madh për të. E dinte se s'mund ta duronte gjatë.

«Ju lutem, më lejoni të dal nga dhoma!» – u lut Tara një mëngjes. «E di që po përpiqeni të më mbani të sigurt, por ndihem si e burgosur. Nuk është mënyrë për të jetuar kjo.»

Pastori donte ta linte të lirë, por e dinte se i ati dhe të vëllezërit po e kërkonin ende. Në fakt, ata kishin ardhur edhe në atë qytet duke hetuar dhe zbuluar synimin e tyre për ta vrarë.

«Tara, edhe pak dhe shumë shpejt do të të lëmë të dalësh», – i tha ai. «Të lutem duro! Është për të mirën tënde».

Tara e dinte se nuk kishte zgjedhje. Nëse e shihnin në publik, do të vinte në rrezik jo vetëm veten, por edhe familjen e saj birësuese. Përpiqej ta shfrytëzonte mirë kohën duke studiuar, por kishte ditë

kur s'mund të bënte gjë tjetër veç të qante. Dhoma e saj e vogël do të ishte shtëpia e saj për një vit të tërë.

Më në fund, një mbrëmje Tara dëgjoi që pastori po thoshte se kisha kishte nevojë për një sekretare. Kur erdhi në dhomën e Tarës të nesërmen, ajo iu lut për këtë punë. «Të lutem, pastor», – i tha ajo, «të lutem, më lejo ta bëj këtë punë! Kam shtypur të gjitha predikimet e tua gjatë gjithë kësaj kohe; e di që mund ta bëj punën. Është bërë një vit që kur kam ardhur. Sigurisht që babai dhe vëllezërit janë larguar.»

Pastori nuk ishte i sigurt për vendimin, por e dinte që s'mund ta mbante Tarën gjithmonë në dhomë. Ra dakord të pyeste pastorin kryesor nëse mund t'ia jepte punën Tarës.

Javën që pasoi, Tara u bë sekretarja e kishës. «Tara, dëgjo me kujdes», – e udhëzoi pastori. «Ti je mbesa ime nga një qytet tjetër. Të lutem, mos m'u drejto më si 'pastor'. Që këtej e tutje, duhet të më thërrasësh 'xhaxha' dhe ne do të të thërrasim 'Rebeka'. Mos ia trego askujt historinë tënde! Kupton?»

Tara jo vetëm që kuptoi, por ishte edhe e kënaqur.

Ajo e bënte punën e saj për mrekulli. Kishte studiuar anglisht dhe pastori kryesor, i cili ishte nga Britania, e pëlqeu menjëherë. Iu dha mbikëqyrja e financave të kishës dhe madje filloi të jepte mësim në shkollën e së dielës.

Pastori kryesor, duke e ditur situatën e mëparshme të Tarës, e lejonte t'i shërbente një myslimaneje të kthyer në besimin e krishterë. Tara filloi të ndiejë se kjo do të ishte thelbi i shërbesës së saj, dhe e falënderoi Perëndinë që e lejoi të përjetonte të njëjtat sprova si këta besimtarë, të cilët inkurajoheshin nga dëshmia e saj e pabesueshme.

Gjashtë muaj pasi filloi punën e re, Tara u pagëzua fshehurazi në një cisternë të vogël në bazamentin e kishës. Vetëm familja e saj birësuese, pastori kryesor dhe xhaxhai u lejuan të merrnin pjesë.

PASION PËR TË UNGJILLIZUAR

Pas dy vjetësh qëndrimi me familjen e saj të re, Tara ishte bërë tashmë tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte dëshirë të dilte dhe të përfshihej më shumë në shërbesa. Ishte e lumtur me punën si

sekretare kishe, por kishte shumë dëshirë për të ungjillëzuar. Shumica e punëtorëve misionarë kishin lindur në familje të krishtera, por Tara mund t'u fliste myslimaneve si një ish-myslimane. Ajo i kishte mbijetuar brutalitetit të t'atit dhe të vëllezërve dhe ishte mohuar nga familja. Kishte një dëshmi për të ndarë dhe e dinte që të tjerët do ta dëgjonin.

«Të lutem, Rubin! Më lejo të vij me ty», – iu lut ajo një ditë djalit më të madh të pastorit që po përgatitej të shkonte në një udhëtim ungjillëzimi.

«Jo, Tara», – tha ai, edhe pse urrente ta refuzonte, sepse e dinte se sa me pasion dëshironte të ungjillëzonte. «Është shumë e rrezikshme. Dikush mund të ofendohet nga dëshmia jote dhe mund të raportojë tek autoritetet. Unë mund të arrestohem, por nëse të kapin ty, do të të vrasin me siguri.»

Rubini e donte Tarën si motër dhe s'mund ta duronte ta vinte në rrezik, por e dinte se do të këmbëngulte të vinte me të dhe kishte të drejtë. Ajo e kishte gati argumentin. «Rubin, çfarë është më e rëndësishme», – pyeti ajo, «siguria ime apo shpirtrat e humbur që po përpiqemi të arrijmë?».

Rubini e pranoi humbjen dhe Tara u nis në udhëtimin me të ndërsa ai i mësonte artin e ungjillëzimit.

Edhe dy vjet e gjysmë kaluan pa asnjë problem. Tara ishte rehatuar me jetën e saj të re si mbesa e pastorit dhe kishte përfunduar një pjesë të studimeve universitare. Kishte gjetur një rol të ri në organizimin e pagëzimeve të fshehta për ish-myslimanë dhe hindu. Shumica ishin rezultat i punës ungjillëzuese të saj dhe të Rubinit. Ajo kishte ndihmuar në fillimin e një programi kundër analfabetizmit dhe një shërbese me fëmijë.

Tara qëndronte gjithmonë vigjilente, por pas gjithë kësaj kohe më në fund po ndiente se kishte filluar një jetë të re larg kërcënimeve të babait dhe vëllezërve. Telashet e saj të vetme vinin nga disa anëtarë, që refuzonin të besonin se Tara ishte mbesa e pastorit dhe ishin xhelozë për shërbesën e saj gjithnjë e në rritje përkrah udhëheqësisë së kishës. Por ky ishte një problem që zgjidhej lehtë. Sepse problemi i vërtetë, i vështirë për t'u përballuar, po priste jashtë kishës, një pasdite të bukur kur Tara po dilte nga dera.

PËRSËRI NË ARRATI

Tara e njohu menjëherë; ishte kushëriri i saj. Çdo muskul i trupit iu tendos ndërsa i riu u përpoq ta shikonte drejt e në sy, por Tara ishte e vendosur të kalonte pranë tij pa i dhënë ndonjë shenjë, që e njihte.

«Prit! Dua të flas me ty», – thirri ai nga pas.

Tara e kuptoi nga toni i zërit që ai nuk ishte pozitiv për identitetin e saj. Ajo kishte më tepër se katër vjet që ishte larguar dhe kishte ndryshuar mjaft. Thjesht e shpërfilli kërkesën e tij sikur nuk e kishte dëgjuar dhe vazhdoi më tej. Më pas dëgjoi fjalën që nuk guxonte ta përmendte...

«Tara!»

Tara u kthye dhe iu përgjigj me mirësjellje të shtirur: «Oh, përshëndetje! Po flisni me mua? Më quajnë Rebeka. Nuk besoj se të njoh. Shpresoj të më falësh; jam me nxitim».

Fytyra nuk e gënjeu, por zëri po. E dinte që kushëriri i saj e kishte zbuluar atë që po kërkonte. Tani do të ishte thjesht çështje orësh para se babai dhe vëllezërit e saj të vinin. Ndjeu panikun t'i shtohej në zemër ndërsa vazhdoi me të shpejtë rrugën dhe u përpoq të humbiste në turmën e vogël të njerëzve që ndodheshin aty. Zemra po i rrihte aq fort saqë mendoi se do t'i shpërthente në kraharor.

Në rrugën e zënë, Tara mori një taksi. «Për në aeroport, të lutem», – tha ajo. Kishte para në portofol, por nuk e kishte idenë se ku të shkonte. Edhe një herë nuk kishte mundësi zgjedhjeje; donte vetëm të largohej para se babai dhe vëllai ta gjenin. Në aeroport vështroi tabelën e nisjes së avionëve, me dëshpërim u përpoq të vendoste ku të shkonte. Përfundoi duke fluturuar në një qytet në pjesën lindore të vendit; mendoi se do të ishte jashtë rrezikut atje, të paktën për momentin. Nuk e kishte fare idenë se ku të shkonte kur të zbriste dhe kaloi një natë të gjatë e të vështirë në aeroport. I kishte telefonuar Rubinit që familja birësuese të mos shqetësohej. Por përveç kësaj, s'mund të bënte gjë tjetër veçse të përpiqej të qetësonte veten duke u lutur në heshtje. I rezistoi nxitjes për ta pyetur Perëndinë, «Pse mua?» Por ishte e lodhur duke jetuar në arrati, dhe pyeti veten nëse do të kishte ndonjë vend ku do të ndihej e vendosur dhe e sigurt.

Të nesërmen, e rraskapitur dhe e shteruar emocionalisht, Tara u kthye te familja e saj birësuese. U ndie keq për ta. I kishin dhënë kaq shumë dashuri dhe mbështetje dhe, duke e ndihmuar, kishin vendosur veten dhe të gjithë kishën në rrezik. Tani Rubini i tha se po përpiqej të gjente një vizë që të mund të largohej nga vendi. Tara ishte e shqetësuar, por edhe pak e lehtësuar ndërsa mendonte për largimin. Të paktën në një vend tjetër nuk do t'i duhej të mbante barrën e të rrezikuarit të miqve të saj. Dhe jo vetëm miqtë e saj. E dinte se, nëse kapej, qeveria mund ta përdorte incidentin për të krijuar një skandal të madh për të gjithë komunitetin e krishterë në Pakistan. Po, do të ishte më mirë të largohej.

Tara mendoi se, nëse qëndronte në heshtje për ca kohë do të ishte e sigurt. Por dy anëtarë të kishës, që ishin xhelozë për vëmendjen që merrte Tara nga familja e pastorit, vendosën ta merrnin çështjen në dorë. I telefonuan CID-së, shërbimi i inteligjencës së Pakistanit dhe raportuan se një grua e re po ungjillëzonte vazhdimisht.

VAJZA E MOHUAR

Tara u thirr në zyrat e CID-së, ku iu tha se agjencia do të hapte një dosje për të dhe do të mblidhte informacion për të parë nëse akuzat ishin të vërteta. Agjentët donin të kontaktonin edhe familjen e saj. Tara s'mund ta besonte që kishte shpëtuar aq shumë herë e tani do të dorëzohej nga anëtarët e kishës. E dinte që shumica e bashkësisë ishin zemërmirë dhe e kuptonin se ishte e domosdoshme të qëndronte në heshtje për të shkuarën e saj. Por u deshën vetëm një apo dy veta për të ndryshuar rrjedhën. Tani u ndie sikur ishte zënë nga një vorbull, që e tërhiqte aq poshtë, saqë s'mund ta merrte më veten.

Tara i thirri Perëndisë që ta shpëtonte edhe një herë. Fjala Emanuel i erdhi ndër mend. E dinte që do të thoshte se Perëndia ishte me të dhe ky mendim e qetësonte. Besonte se, nëse Perëndia mund të bënte që një peshk ta nxirrte Jonën në breg, Ai mund ta nxirrte Tarën prej «gojës» së CID-së!

Por nuk do të ishte e lehtë. CID-ja i konfiskoi pasaportën dhe vazhdoi t'i bënte pyetje e të plotësonin formularë. Rubini ishte

me të dhe u përpoq ta bindte CID-në se ajo ishte e motra, por ata nuk e besonin. Emrat në pasaportë nuk përputheshin. Pasaporta e Tarës e identifikonte si myslimane. Kështu pra, çfarë bënte ajo në një familje të krishterë?

Pasi kaloi një ditë të tërë në mbikëqyrjen e CID-së, u lejua të kthehej në shtëpi, por me paralajmërimin, të mos largohej prej qytetit. Agjencia do ta kontaktonte së shpejti. Tara kishte nevojë për një shenjë nga Perëndia, diçka ku të kapej. Tani ishte pa pasaportë dhe ishte çështje kohe para se CID-ja të kontaktonte familjen e saj të vërtetë, një kthim ngjarjesh që do të sillte fundin e saj. Ndonjëherë, ajo pyeste veten çfarë metode do të përdorte i ati për ta vrarë...

Ndërsa po dilte jashtë zyrës së CID-së, njëri prej oficerëve i pëshpëriti Tarës. Ai e njihte familjen e saj, por nuk kishte folur, duke e ditur rrezikun që i kanosej. «Tara, më dëgjo», – tha ai. «Jam shoku i njërit prej kushërinjve të tu. E di kush je. Duhet të largohesh nga vendi sa më shpejt që të jetë e mundur. Nuk je vetëm ti në rrezik».

Tara u habit, por edhe u lehtësua. Ishte një mrekulli që oficeri i CID-së nuk e kishte dorëzuar. Jo vetëm që e kishte mbajtur sekret, por i kishte treguar çfarë duhej të bënte. Duhej të largohej nga Pakistani. Por si? Nuk kishte pasaportë. Edhe nëse do të kishte, ku të shkonte?

Rubini shkoi pa humbur kohë nga një ambasadë e huaj te tjetra, duke u përpjekur të merrte vizë. Vazhdimisht refuzohej. Ambasadat thoshin se duhej të kishin një lidhje me vendin e tyre, dikë që mund ta financonte. Më në fund një vend në Lindjen e Mesme i ofroi një vizë tremujore për një mijë dollarë amerikanë. Tara nuk ishte e gëzuar që po udhëtonte në një vend tjetër mysliman, por përsëri nuk kishte zgjedhje tjetër. Në të njëjtën ditë që pagoi paratë, mësoi se CID-ja po përgatiste një fletë arresti. Agjentët e tyre kishin zbuluar se ajo organizonte pagëzime për ish-myslimanë dhe se vetë ishte kthyer nga islami në krishterim. Ishte konsideruar e mohuar. Tara mësoi gjithashtu se edhe prindërit e saj kishin ngritur padi kundër saj. Ata konfirmuan konvertimin e saj dhe sipas ligjit islamik, kishin rekomanduar që të varej.

E zhytur në dëshpërim, Tara nisi të mbyllej në dhomë për ditë të tëra. Priste ditën kur familja e saj ta kapte dhe ta vriste. Më keq akoma, mund të lëndonin edhe familjen e saj të re. Dhe e gjitha, për shkak të saj. Lutjet u bënë më të shkurtra, por përmbanin thirrje tërë pasion që Perëndia të mos e braktiste, të ishte Emanueli i saj edhe nëse qëndronte para një laku.

«PERËNDIA DUHET TË KETË NJË PUNË TË RËNDËSISHME PËR TY»

Ndërsa Tara po humbiste shpresën, Rubini, i zënë me përpjekjet për të siguruar një pasaportë të re dhe dokumentet e identifikimit, e detyroi Tarën të priste flokët e të vinte syze për fotografinë. Kishte një dokument, që deklaronte se ajo ishte shumë e sëmurë dhe s'mund të shkonte në zyrat e qeverisë për të marrë dokumentet. Të dielën e Pashkës 1996, Rubini shkoi në dhomën e Tarës me lajme të mira: «Tara, i kam të gjitha dokumentet e tua të udhëtimit. Gëzuar Pashkën!»

«S'mund ta besoj!» – thirri ajo. «Si ia dole mbanë? Sa të kushtoi?»

«Mos u shqetëso për këtë!» – u përgjigj ai duke buzëqeshur me gjithë zemër. «Të thashë që Perëndia do të na ndihmonte. Nuk të solli deri këtu për t'u dorëzuar tek CID-ja. Ai duhet të ketë një punë të rëndësishme për ty, Tara, duke marrë parasysh të gjitha telashet që ke pasur deri tani.» Buzëqeshja e tij rrëzëllitëse sikur i thoshte se kishte qenë i kënaqur që kishte qenë pjesë e këtyre «telasheve».

Tara e nderonte besimin dhe këmbënguljen e tij. Ai ishte më tepër se vëlla; kishte qenë mik në kohë nevoje dhe nuk e kishte zhgënjyer asnjëherë. Duke menduar këto, një valë trishtimi e përshkoi Tarën, keqardhje që do të largohej nga familja e saj e krishterë dhe nga kisha, ku kishte pasur mundësi të shërbente.

«Kam edhe një kërkesë tjetër para se të largohem», – tha ajo. «Dua të marr pjesë në pagëzimin që kemi planifikuar për besimtarët e sapokthyer në besim.»

Rubini ishte gati të kundërshtonte, por ishte shumë i lodhur për të diskutuar me Tarën duke e ditur me siguri që ajo do të

fitonte gjithsesi. «Sigurisht», – tha ai duke mbledhur supet dhe duke buzëqeshur, «Por me kusht që të largohesh menjëherë pasi të mbarojmë.»

Të nesërmen në mbrëmje Tara mori pjesë në pagëzimin e fshehtë. Ajo i njihte të gjashtë besimtarët e rinj dhe secili e dinte historinë e pabesueshme të saj. Tara e dinte që mund t'u besonte. Ishin të gjithë në të njëjtin rrezik.

Disa prej besimtarëve ishin nga Pakistani, por pjesa më e madhe vinin nga vende të tjera. Njëri ishte nga Kina, një tjetër nga Afganistani, dhe dy të tjerë ishin nga Irani dhe Iraku. Nuk ishte e pazakontë që besimtarët të udhëtonin përmes Pakistanit nga vende të huaja.

Tara mahnitej se si e kishte përdorur Perëndia. Ajo do të largohej prej vendit të nesërmen për shkak të besimit të saj ndërsa të tjerët kishin ardhur aty dhe kishin gjetur besimin. Dhe pjesa më e madhe e të krishterëve në komunitetin e saj, duke përfshirë edhe ata në kishë, nuk e morën vesh kurrë se çfarë po ndodhte. Ishte e vështirë t'u besoje atyre, që kapeshin fort pas sigurisë personale.

PËRSËRI E TRADHTUAR

Tara u largua prej sfidave të Pakistanit për t'i hyrë një sërë sprovave të reja. Ishte e lirë nga ndjekja e familjes, por duhej të bënte kujdes e të mos e tregonte identitetin e saj. Madje, edhe vendi i ri mbartte rrezikun e vazhdueshëm të arrestimit nga policia islamike që do ta kthente mbrapsht në Pakistan. Dhe nëse kthehej, do ta dorëzonin menjëherë në duart e babait të saj, duke ia vulosur fatin përgjithmonë.

Tara u përball edhe me një sfidë tjetër. Në botën myslimane, një grua pritet të martohet para moshës njëzetë e pesë vjeç. Nëse nuk martohet, mendohet se është prostitutë dhe zakonisht arrestohet, riedukohet dhe i organizohet martesa. Tara nuk kishte dëshirë të martohej, të paktën jo tani që e kishte jetën rrëmujë, dhe sigurisht që nuk donte një martesë të organizuar nga zyrtarët islamikë. Për më tepër, ishte pa mbështetjen e familjes së saj birësuese dhe kishte vetëm një vizë tremujore.

Shumë shpejt e kuptoi se, nëse përqendrohej te situata, do t'i zhdukej edhe ajo shpresë që kishte. *Kam humbur gjithçka*, – i thoshte vetes, – *por kam gjetur Perëndinë: një humbje e vogël për një zbulim kaq të mrekullueshëm. Emanuel, Perëndia është me mua. Kush mund të jetë kundër meje? Kam fituar më tepër nga ç'mund të humbas ndonjëherë. Emanuel. Perëndi, qëndro me mua*! Kjo u bë lutja e saj, që e mbajti gjallë edhe një herë, kur përjetoi ferrin dhe kur u kthye...

Rubini e kishte rregulluar që ajo të zinte një punë si sekretare në një kishë në vendin e saj të ri, por me ato pak para, zor se siguronte ushqimin e jo më qiranë. Pjesën tjetër të kohës punonte duke gatuar për gruan e pastorit, e cila ishte e interesuar më tepër për bizhuteritë dhe modën se sa për Krishtin. Tara nisi e dyshonte nëse ky ishte besimi për të cilin po rrezikonte jetën dhe përsëri u shqetësua. Ajo po përballej me depresionin.

Në fakt, zuri një punë tjetër te një stilist veshjesh dhe ligjërisht mund të aplikonte për një leje qëndrimi trevjeçare. Një problem u zgjidh, por e priste një tjetër edhe më i vështirë.

Kur siguroi lejen e qëndrimit në vendin e saj të ri, Tara u përfshi në disa nga fushatat ungjillëzuese të kishës. E pati të lehtë të krijonte miq të rinj; por pak më të vështirë për t'u besuar.

Megjithëse nuk e kuptoi në atë kohë, njëri prej miqve të saj punonte për revistën «Të Krishterët në Pakistan». Nga kontaktet që kishte në Pakistan, ai e dinte identitetin e vërtetë të Tarës. Duke dashur të «siguronte historinë,» iu afrua një ditë pas kishe. «Tara, e di që duhet të jetë e vështirë për ty këtu në një vend të huaj, me gjuhë të re dhe pa familje», – tha ai. «Pse nuk vjen në shtëpinë tonë të hamë darkë së bashku? Na lejo të të ndihmojmë».

Tara ra dakord. *Do të jetë mirë të kem miq të rinj*, – tha me vete.

Në vizitat e para, reporteri e mbajti fjalën. E ftoi Tarën dhe disa të krishterë të tjerë në moshën e saj në shtëpinë e tij për miqësi dhe për të ngrënë së bashku. Megjithatë, në secilën prej vizitave, reporteri filloi t'i bënte më tepër pyetje Tarës, pyetje specifike rreth së shkuarës së saj.

«Të lutem, parapëlqej të mos flas për veten», – iu përgjigj ajo me mirësjellje, duke mos dashur të ofendonte mikun e saj të ri. Kur i erdhi ftesa tjetër, Tara refuzoi.

«Nuk je gati të dorëzohesh lehtë» – i tha reporteri Tarës të nesërmen në telefon. «Tara, e di që ke vështirësi financiare këtu, dhe unë e miqtë e mi duam vërtet të të ndihmojmë», – tha ai. «Të lutem, eja ndaje dëshminë tënde me ne, dhe do të mbledhim para për ty. Jemi miqtë e tu. Mund të na besosh».

Tara pranoi, por pa shumë dëshirë. Në atë pikë, të vetmit të krishterë që njihnin historinë e saj të plotë ishte familja birësuese në Pakistan. Ishte treguar mjaft e rezervuar. Mbajtja e fshehtë e identitetit ishte çështje për jetë a vdekje.

Kaloi një muaj dhe Tara kishte dhënë mjaft intervista me reporterë të tjerë. Çdo herë, ata që intervistonin tregonin dhembshuri dhe premtonin të bënin sa të mundnin për ta ndihmuar. Kaloi edhe një muaj tjetër me më tepër intervista, më tepër lot, por sërish asnjë të ardhur. Tara filloi të pyeste veten çfarë po ndodhte. Më në fund një zonjë e telefonoi një ditë dhe e pyeti sa para merrte nga banka çdo muaj.

«Për çfarë po flisni? Unë nuk kam llogari bankare. Dhe sigurisht që banka nuk më ka dërguar para. Pse duhet ta bëjë banka këtë?» – e pyeti Tara gruan.

«Oh, duhet të jetë bërë ndonjë gabim», – tha gruaja. «Njerëzit kanë dërguar para në këtë llogari, duke besuar që ishte për ty. Me sa kuptoj unë, është grumbulluar një shumë goxha e madhe».

Tarën e kishin përdorur; ajo konfirmoi të vërtetën e tmerrshme. Ishte ndërtuar një biznes dhe të tjerët po përfitonin nga dëshmia e saj. Shumë shpejt pas kësaj pa revistën. Historia në kopertinë tregonte për një vajzë myslimane, që kishte gjetur Krishtin në mënyrë të mrekullueshme, që ishte arratisur nga familja e saj, e cila e kërkonte të vdekur. Artikulli kishte emrin e saj! Tara s'mund t'u besonte syve.

«Si mundi të ndodhte kjo?» – psherëtiu ajo. Dhe për më tepër shqetësohej: «Si t'ia bëj që familja të mos më zbulojë?»

Tara s'mund të mbante më. Pyeste veten se sa prej këtyre mashtrimeve dhe dredhive duhej të duronte, kur një burrë tjetër

nga kisha iu afrua ndërsa ishte duke u larguar prej shërbesës së të dielës. Ishte e njëjta histori: «Ndaje dëshminë tënde me ne», – tha ai, «Dhe mund të sigurojmë para për të të ndihmuar». Por ky njeri e paraqiti kërkesën me hile. Duke menduar se Tara ishte shumë e bukur, dyshonte që mund të ishte e vetmuar.

Kjo ishte. Tara e tërhoqi dorën pas dhe i dha një shuplakë në fytyrë. «Ti ke një grua dhe një vajzë! – e qortoi ajo. «Je i krishterë! Si mund ta bësh këtë?»

Burri mbeti i shtangur nga agresioni i Tarës. Vuri dorën në fytyrën e skuqur dhe tha me zemërim: «Do të paguash për këtë».

Nuk guxoi të bënte ndonjë skenë më të madhe, sepse kishte njerëz në rrugë, jo shumë larg prej tyre.

«Në rregull» – u përgjigj Tara, ende e zemëruar nga sugjerimi i burrit. «Ti më thuaj sa duhet të paguaj dhe do të paguaj. Vetëm qëndro larg meje!»

Problemi ishte se ai nuk kishte ndër mend para.

Tre net më vonë, një tullë kaloi përmes dritares së apartamentit të vogël të Tarës. Ajo mundi të dëgjonte burrat që thërrisnin në rrugë, por s'arriti të dallonte se çfarë thoshin, sepse flisnin një arabishte të çalë. Vështroi pas perdeve ndërsa ata morën më tepër gurë nga rruga. Ia hodhën përsëri në dritare, duke thyer çdo copë xhami të mbetur. Këtë herë arriti të kuptonte disa prej fjalëve që thoshin: «Myslimane... tani e krishterë!...një e mohuar! Policia! Thërrisni policinë...»

Vështroi përsëri pas perdeve pikërisht në kohë për të parë burrat t'i hipnin një taksie dhe të largoheshin me nxitim. Kishte njohur dy prej tyre. Ishin miqtë e burrit, që i kishte dhënë një shuplakë.

Tara u lut që kërcënimet e tyre për t'i telefonuar policisë të ishin vetëm një mashtrim i radhës, një përpjekje për ta trembur. Dhe megjithatë, po funksiononte. Ajo ishte e frikësuar. Ishte e vërtetë. Disa orë më vonë, policia u gjend te dera e saj duke pyetur se çfarë kishte ndodhur. Pas pak Tara u gjend në stacionin e policisë.

DUKE IU DORËZUAR PLOTËSISHT PERËNDISË

«Kemi raportime që je myslimane e kthyer në të krishterë, dhe je edhe beqare», – filluan pyetjet. Tara e dinte që policia mund të gjente lidhjet e saj me babanë në Pakistan dhe të kishte hyrje në dosjen e saj atje. Jepte përgjigje të shkurtra dredhuese, duke përsëritur me vete të njëjtën fjalë pas çdo pyetjeje: *Emanuel*.

Disa orë më vonë, policia e lejoi të shkonte, por premtoi ta kishte nën kontroll. E pyesnin vazhdimisht pse nuk ishte martuar dhe i kishin sugjeruar të gjente një bashkëshort. Madje i ofruan edhe dikë, që e dinin se do ta pranonte.

Çuditërisht, Tara kishte kaluar nga të qenët viktimë, apartamenti i së cilës ishte sulmuar, në të akuzuar. Të tilla janë të «drejtat» e një të krishteri në një vend mysliman.

NJË BASHKËSHORT PËR TARËN

Katër muajt e tjerë kaluan pa ndonjë incident të rëndësishëm. Tara shkëlqeu si stiliste veshjesh dhe u bë më tepër aktive në programet e kishës. Ishte gjithashtu në gjendje të ndihmonte myslimanët e tjerë, që ishin kthyer në besim dhe ishin arratisur. Kjo ishte punë e përshtatshme për Tarën, e cila kishte më tepër se dhjetë vjet përvojë praktike në këtë fushë. Por përsëri e dinte që burri që ajo kishte goditur me shuplakë nuk ishte i kënaqur me mënyrën se si ishin zgjidhur problemet fillestare që kishte shkaktuar. Donte më tepër. Tara mund ta kuptonte nga mënyra se si e shihte. Ai donte ta kishte ose ta shkatërronte.

Për Tarën, asnjëra nuk ishte e mundur.

Ndodhej në apartamentin e saj kur ra zilja e telefonit. Ishte i njëjti person me nje lajm të ri. Ishte krenar të lajmëronte se kishte shkruar një artikull dhe e kishte vendosur në këndin e buletinit të kishës. Artikulli deklaronte se Tara ishte prostitutë. Ja pse vishte rroba aq të bukura dhe ishte ende beqare. E ftoi të shihte veprën e tij.

E tërbuar nga inati Tara përplasi telefonin. Ky njeri nuk do të dorëzohej. Nuk ishte e shqetësuar se çfarë do të mendonin njerëzit e kishës. Ata që e njihnin e dinin të vërtetën. Ajo s'mund të martohej për shkak të rrezikut të vazhdueshëm në të cilin ndodhej;

rrobat e bukura ishin thjesht modele të stilimeve të saj. Problemi i vërtetë do të ishte me policinë; do të ishte vetëm çështje kohe që raporti t'u shkonte në dorë. Ata i kishin thënë që të martohej dhe ky artikull vetëm do t'i nxiste të mbanin qëndrimin e tyre. Kur ta zbulonin, do ta arrestonin përsëri.

Një javë më vonë, frika e Tarës u bë realitet. E futën në një qendër islamike, ku duhej të riedukohej me mësimet e islamit dhe të martohej me një burrë mysliman. E vendosur në një dhomë të vogël, lutej në qetësi. Nuk e kishte idenë si do t'ia dilte të largohej nga qendra pa rënë dakord të martohej. Tani dukej sikur çdo gjë po përsëritej. I ati donte që të martohej dhe ishte gati ta vriste nëse refuzonte. Por Tara e kishte refuzuar planin e babait dhe nuk do t'u dorëzohej zyrtarëve të qendrës. Duke mos pasur mundësi të tjera, u lut duke iu dorëzuar plotësisht Perëndisë.

Kaluan pothuajse tre muaj. Tara merrte çdo ditë mësime nga Kurani. Kur nuk ishte në mësim, ishte e burgosur në dhomën e saj. Më në fund, një ditë një zyrtar e theu monotoninë me një lajmërim. «Tara, ke një vizitor».

«Si mund të kem vizitor? Askush nuk e di që jam këtu.» «Ai thotë se dëshiron të flasë me ty. Mendojmë se do të ishte ide e mirë të shkoje me të».

«Të shkoj me të?» – pyeti Tara. «Unë as nuk e njoh këtë njeri, dhe ju po më kërkoni të dal me të?» Ishte e mërzitur, duke besuar se ishte një hile tjetër për ta martuar. Megjithatë, burri premtoi se do ta kthente pas darkës. Nuk ishte e kënaqur me këtë ide, megjithëse do të ishte mirë të dilte nga dhoma. Vendosi të shkonte, por do ta shpërfillte burrin gjatë drekës.

Burri ishte në moshën e Tarës, i pashëm dhe fliste qetësisht, me zë të butë. «Tara, e di se kush je», – i tha ai. «Mësova për ty nga një mik mysliman». Tara u përpoq ta shpërfillte. Por sa më shumë që fliste, aq më tepër i tërhiqte vëmendjen.

«Edhe unë jam i krishterë», – tha ai, duke vazhduar me zë të ulët e të butë. «Por askush nuk e di. Jam larguar nga Pakistani ashtu si edhe ti. Në fakt, vij nga i njëjti qytet. E di gjithashtu që qendra ka organizuar që të martohesh me një mysliman që ka tashmë tri gra.»

Tara ngriu. I kishin thënë për këtë plan. U përpoq të shtirej sikur nuk kishte interes për atë që po thoshte ky njeri, dhe pothuajse ia doli mbanë derisa ai i tha: «Nëse refuzon, do të të kthejnë në Pakistan, te babai yt».

Tara nuk dinte çfarë të besonte. Si mund të ketë organizuar qendra që një i krishterë beqar nga qyteti i saj i lindjes të takohej me të?

«Mirë pra, çfarë dëshiron?» – pyeti më në fund Tara.

«Dua të martohem me ty», – tha ai.

NJË MREKULLI NË MISH

Kur Tara u kthye në qendër, tre zyrtarë ishin duke e pritur. «Kemi marrë një vendim, Tara», – tha njëri prej tyre. «Do të martohesh me Zahidin. Ai ka tashmë tri gra dhe pranoi të të marrë edhe ty. Është njeri i mirë. Do t'i bëjmë ne të gjitha organizimet. Nuk duhet të shqetësohesh për asgjë. Por nëse refuzon, do të të kthejmë në Pakistan».

Ky ishte çasti i vendimit. Ajo nuk i ishte përgjigjur propozimit të drekës. S'mund ta kuptonte. Çdo gjë po ndodhte shumë shpejt dhe kishte nevojë për kohë për t'u menduar, kohë për t'u lutur. Dëshironte shumë të fliste me familjen e saj birësuese, me dikë që e njihte të gjithë historinë e saj, me këdo që do të mund t'i jepte një këshillë.

«Nuk do të martohem me Zahidin», – u përgjigj Tara për habinë e zyrtarëve.

«Atëherë do të bësh gati plaçkat. Do të kthehesh në Pakistan».

«Do t'i bëj gati, por për një arsye tjetër. Do të martohem, por jo me Zahidin. Do të martohem me burrin që më nxori për drekë», – iu përgjigj Tara.

Zyrtarët ishin të habitur, por ranë dakord. Le të bëhej çfarëdo lloj gjëje, vetëm që kjo grua të frenohej.

Tara kontaktoi me burrin që kishte ngrënë drekë dhe i tha lajmin. Do të martohej me të. Nuk ishte ende e sigurt për motivet e tij të vërteta, kështu që ishte në rrezik, por jo më të madh se të martohej me Zahidin.

Kur vendimi u mor, Tara i thirri përsëri Emanuelit, Perëndisë që e kishte sjellë deri këtu. Ishte pothuajse njëzetë e shtatë vjeç dhe kishte dhjetë vjet që arratisej. Nëse bashkëshorti i ardhshëm do ta mashtronte, e dinte me çfarë problemi do të përballej. Por nëse ishte i sinqertë, ai do të ishte një mrekulli në mish. Do t'i jepte mundësinë të largohej nga qendra dhe t'u largohej thashethemeve për prostituimin e saj. Madje, ajo do të kishte një ndihmë në punën e saj në shërbesën ndaj të tjerëve, që ishin larguar në mënyrë të fshehtë nga islami. Por, a po ngrihej për t'u rrëzuar përsëri? Shumë pyetje e mundonin.

Më në fund Tarës iu kujtua lutja që kishte bërë kur kishte hyrë në qendër. Ia kishte dorëzuar gjithçka Perëndisë dhe kështu bëri sërish. Nuk ishte në dorën e saj tani. «Emanuel, Perëndia me ne», – u lut ajo, «Qëndro me ne të dy!»

EPILOG

Burri me të cilin Tara u martua doli të ishte një mrekulli në mish. Një i krishterë i përkushtuar, i cili ka shërbyer përkrah Tarës në shërbesën e saj të vazhdueshme për ata që janë kthyer në krishterim nga islami.

Tani ata kanë një djalë, Xhejmsin, dhe janë ende në arrati. Ajo dhe bashkëshorti i saj ruhen vazhdimisht nga zyrtarët e qendrës. E marrin në pyetje për aktivitetet e saj. «Kush ju vjen për drekë?» – mund të pyesin zyrtarët. «Pse qëndroi në shtëpinë tuaj ajo grua mbrëmë?» «Pse dole për katër orë sot?»

Për Tarën, jeta është si një lojë e vazhdueshme e maces me miun.

Sfida më të mëdha e presin. Pas disa vitesh, kur djali i saj të jetë mjaft i rritur për të folur, sigurisht që do të merret në pyetje nga oficerët islamikë. Një sfidë tjetër mund të jetë duke i trokitur në derë. Vetëm disa muaj para se të intervistohej për «ZEMRA TË ZJARRTA», Tara u njoh nga njëri prej kushërinjve të saj që ishte dërguar për ta gjetur në mënyrë që të kthehej tek i ati dhe kështu 'drejtësia' të mund të vihej në vend.

Për mbrojtjen e Tarës, s'mund të thuhet asgjë tjetër. As ku jeton apo ndonjë detaj për aktivitetet e saj të krishtera. Por një

gjë është e sigurt: ajo jeton një jetë krejt ndryshe nga shumë të krishterë. Shumë, madje edhe ata në kishën e saj, nuk dinë gjë për kthimin e saj në të krishterë dhe për rrezikun me të cilin përballet çdo ditë. Ndoshta nuk është e mundur që ta kuptojnë. Ndoshta për këtë Perëndisë i duhen ata si Tara që mund të ndriçojnë rrugën për bij dhe bija të tjerë të mohuar.

Ling:
Në Shkollën e Vuajtjes

Kinë

1973

Nëntëvjeçarja Ling dhe motra e saj më e madhe kishin të gjithë mëngjesin jashtë në fshat, për të lypur për ushqim. Po pushonin pak nën një pemë të madhe, që i mbulonte, kur nëna i thirri. «Ling, eja shpejt! Babai kërkon të të takojë».

Ajo dhe motrat e saj e kalonin pjesën më të madhe të kohës jashtë kasolles së vogël prej bambuje dhe kashte, por që familja e tyre e quante shtëpi. Pjesën më të madhe të kohës ishin, ose duke lypur ushqim ose duke gërmuar për qymyr nga fabrika e hekurit aty pranë; ua jepnin qymyrin prindërve për ta shitur ose për ta përdorur për gatim. Për aq sa dinte Ling, familja e saj kishte qenë gjithmonë shumë e varfër, por kohët e fundit gjërat ishin përkeqësuar. Shëndeti i babait po rëndohej dhe Ling ishte e shqetësuar për të ardhmen dhe për nënën e saj.

«Ling, të lutem, mos e lër babanë të presë!» – iu lut e ëma. U largua pa dëshirë nga vendi i saj i qetë poshtë pemës së vjetër dhe iu bashkua nënës, motrave dhe vëllait të vogël rreth shtratit të familjes, një shtrat që e përdornin të gjashtë. Ishte mobilja kryesore në kasollen njëdhomëshe.

«Ling, afrohu», – tha i ati. «Më lër të shoh fytyrën tënde të bukur». Ajo u ul në anë të shtratit dhe u përpoq të buzëqeshte. Urrente ta shihte të atin në atë gjendje. Që kur u kthye nga spitali herën e fundit, ai kishte qenë shumë i pafuqishëm, pothuajse pa shpresë. Nëna nuk e pohonte, por e dinte që babai po vdiste. Kanceri po ia gërryente trupin dhe nuk kishte qenë në gjendje të punonte për muaj të tërë.

Tani i ati ngriti dorën dhe e drejtoi butësisht nga ana e krevatit, ku ndodheshin gruaja dhe fëmijët e tij, që ishin duke qarë. «Fëmijë, ju lutem më premtoni që do të kujdeseni për mamanë tuaj dhe për njëri-tjetrin! Unë nuk do të jem edhe shumë gjatë këtu, por mbani mend që ju dua». Nëna e Lingut po ngashërehej në qetësi ndërsa i ati i përkëdhelte fytyrën. «Më premto që pasi të kem shkuar do të martohesh me një burrë më të fortë», i tha ai gruas së tij që së shpejti do të bëhej vejushë». Me dikë tek i cili mund të mbështetesh dhe që të kujdeset për ty më mirë se unë. Dhe të lutem mos harro të vazhdosh t'i lutesh Perëndisë!»

Dashuria e tyre ishte e dukshme për të gjithë ata, që i njihnin. Ling nuk i kishte dëgjuar kurrë të bërtisnin apo t'i thoshin fjalë të ashpra njëri-tjetrit. S'mund të duronte ta shihte t'atin të vdiste dhe urrente ta shihte t'ëmën aq të dëshpëruar. Mënyra se si ata flisnin për Perëndinë dhe se si luteshin ishte e pakuptueshme për të. Ling i kishte parë shpesh prindërit të gjunjëzoheshin pranë shtratit. I kishte pyetur një herë se çfarë po bënin dhe ata i ishin përgjigjur se po «bisedonin me Perëndinë».

Po ku është Perëndia tani? Pyeste veten Ling me dyshim. *Nëse ka me të vërtetë Perëndi, pse po vdes babai im*? Me zor mbajti të qarën dhe doli jashtë dhomës.

Më vonë atë pasdite nëna e Lingut u tha fëmijëve se vjehrri e vjehrra e saj, gjyshërit e tyre, do të vinin për vizitë. Ling u habit; e dinte që gjyshërit nuk donin t'ia dinin për djalin e tyre apo për familjen e tij. Në fakt, nuk ishte vetëm kaq. Gjyshja e saj e kishte mallkuar Emilinë, sepse nuk kishte mundur të lindte më shumë djem!

Gjyshërit erdhën disa ditë më vonë, por nuk hynë në shtëpinë e vogël kur djali i tyre ndërroi jetë. Refuzuan të ndihmonin edhe me varrimin.

Duke mos pasur para për të blerë një arkivol dhe as ndihmë nga prindërit e bashkëshortit, nëna e Lingut e mbështolli bashkëshortin e saj të vdekur me copën më të mirë blu që mund të gjente. Do të ishte një «varrim i lirë», i rezervuar për më të varfrit e më të varfërve.

Ling, nëna e saj dhe motrat e vëllezërit mendonin se sigurisht që gjërat s'mund të shkonin më keq se aq, por gaboheshin. Ndërsa po përgatiteshin të largoheshin, gjyshërit lajmëruan se do ta merrnin

vëllanë e vogël të Lingut me vete. Nëna e Lingut dhe fëmijët e tjerë protestuan me forcë, por ishte e kotë. Ata e morën djalin.

Tri vajzat mbetën me nënën e tyre në kasolle, duke pyetur veten se sa kohë mund të mbijetonin.

«Të lutem Ling, ulu në gjunjë dhe lutu me mua!» – e ftoi e ëma një mëngjes. Jo me shumë dëshirë, ajo iu afrua s'ëmës në anë të shtratit. Dimri po afronte, dhe dyshemeja ishte e ftohtë në gjunjët e saj. U zemërua nga kërkesa e nënës duke menduar se kishin vuajtur mjaft.

Duke qëndruar pranë saj, e ëma po qante butësisht. Në fillim, mendoi se po qante nga dëshpërimi; më pas e kuptoi që nëna po hapte zemrën e saj ndërsa po bisedonte përsëri me Perëndinë. Lingu nuk kishte ç'të thoshte. Do të vuante në gjunjë si shenjë mbështetje, por s'mund të bënte më tepër. E çfarë kuptimi kishte të flisje në erë? Edhe nëse Perëndia ekzistonte, nuk do të donte të fliste me Të. Jo, me gjithë ato gjëra që kishte lejuar të kalonin.

Disa muaj pasi i ati ishte ndarë nga jeta, familja e Lingut mundi t'ia dilte me ndihmën e disa fqinjëve, që u erdhi keq për to, por jeta u bë jashtëzakonisht e vështirë. Më në fund nëna e Lingut u tha se do të shkonin të jetonin me prindërit e saj në provincën e Henanit. Në kulturën kineze, gratë ishin rritur me besimin se duhej të vareshin nga burrat. Nuk ishte e përshtatshme që të ishin vetëm dhe qeveria refuzonte t'i ndihmonte në ndonjë mënyrë.

Kur Lingu mbërriti në shtëpinë e gjyshërve, u habit nga përmasat e saj. Prindërit e nënës së saj nuk ishin aspak të pasur, por shtëpia e tyre dukej si pallat krahasuar me kasollen e tyre ku ishte rritur. Gjyshja e Lingut i çoi vajzat përmes kuzhinës së ngushtë në një dhomë të pasme. Ishte një dhomë e vogël, e rrënuar, e përdorur më parë si magazinë. «Mund të qëndroni këtu», – tha gjyshja e Lingut me ashpërsi. Lingu vështroi dhomën e ngushtë e të shëmtuar dhe qeshi hidhur me vete. Ndihej si në shtëpi.

Kjo jetë e re solli një luftë të vazhdueshme të nënës së Lingut me gjyshen. Dhe konflikti u krijua, sepse nëna e Lingut donte të aplikonte për në grupin e prodhimit (zyra lokale e punës) në mënyrë që të siguronte një shtëpi të sajën, por gjyshja donte që vajza e saj të martohej.

NJERKU

Një ditë kur Ling u kthye nga shkolla, dëgjoi debatet e zakonshme para se të mbërrinte në derë. «Por, mama, nuk dua të martohem përsëri!» – thoshte e ëma e saj, duke iu dridhur zëri nga emocionet. «Nuk mund të dua kurrë dikë si doja Xhun. Ju e dinit që planifikova të qëndroja e vetme kur rashë dakord të vija te ju. Nëse do të flisni me grupin e prodhimit që të më lejojnë të punoj dhe të më ndihmojnë të kem një shtëpi timen, e di që mund të kujdesem për fëmijët. Të lutem mama! Mos e bëj këtë!»

«Ke dy vjet që je këtu», iu përgjigj gjyshja e Lingut. «S'mund të duroj më shumë! Nuk bëhen gjërat kështu. Shu-Tan është njeri për së mbari dhe mund të sigurojë për fëmijët e tu. Përveç kësaj, babai yt tashmë e ka vendosur: do të martohesh javën tjetër».

Një javë më vonë Lingu u bë me njerk.

Rrëqethej nga zëri i ashpër i tij dhe e merrte malli për tonin e butë të t'atit. Shu-Tan i trajtonte Lingun dhe motrat e saj si kafshë dhe në fshehtësi ajo e përbuzte. Të ishe e varfër ishte një gjë, por të jetoje me një njerk që e konsideronte si një shërbëtore ishte edhe më keq.

Ashtu, në kokëfortësinë e saj, Lingu i mbante mendimet për vete. Tani që nëna e saj ishte rimartuar, ato lejoheshin të punonin dhe kur Lingu nuk ishte në shkollë, punonte në fusha me barinjtë në grupet e prodhimit. Zyrtarët vendas kishin një sistem pikësh për të përcaktuar pagën dhe përfitimet e punëtorëve. Një njeri punëtor mund të fitonte deri në dhjetë pikë në ditë. Lingu fitonte nëntë.

Ajo ndihmoi edhe në projektimin e një makine të thjeshtë për të bërë tofu. Kur kthehej nga qetë, makina mund të përdorej për të pluhurizuar sojën midis dy gurëve të mëdhenj. Shu-Tan e pëlqeu shumë idenë, por s'mund ta përballonte një ka. Në vend të tij ishte Lingu dhe motrat e saj më të mëdha. Për katër vjet, «puna e qeve» u bë pjesë e rutinës së tyre të përditshme.

Si rezultat i gjithë punës së vështirë, në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, Lingu u bë e fortë dhe e shëndetshme dhe priste me padurim ditën kur të ishte e pavarur. Përbuzja ndaj njerkut rritej çdo ditë e më tepër ndërsa ai përfitonte nga tofu që prodhonin

Lingu dhe motrat e saj. Përsëri refuzonte të blinte një ka. E pse duhej ta blinte? Kishte vajzat për të bërë punën.

Nëna e saj, e cila kishte qarë pa pushim javët e para të martesës së saj me Shu-Tan, tani lutej më pak. Kishte vetëm disa besimtarë të fshehtë në fshatin e Ru Tain dhe vetëm një Bibël, të cilën, për shkak se ishte analfabete, s'mund ta lexonte. Lingu e dëgjonte ndonjëherë në qetësinë e natës: «Të lutem, Zot, mbroji fëmijët e mi, veçanërisht Lingun dhe motrat e saj. Ato detyrohen të punojnë kaq shumë. Të lutem ruaji! Vetëm këtë të kërkoj».

Lingu pyeste veten pse bisedonte e ëma me Perëndinë rreth punës së skllavit që po duronin ajo dhe motrat e saj kur duhej të ishte duke folur personalisht me vetë padronin! Perëndia sigurisht që nuk po i ndihmonte gjërat, mendonte Lingu me hidhërim sa herë që njerku i detyronte të punonin edhe më tepër. Duke dyshuar ndoshta për armiqësinë e Lingut, një ditë ai sugjeroi që të gjente një bashkëshort. Madje ofroi të zgjidhte ai një për të. «Do të ishte gjëja më e mirë për të gjithë», – i tha asaj.

Lingu e dinte që ai donte vetëm ta hiqte qafe. Do të thoshte një gojë më pak për të ushqyer.

NJË PERËNDI I PADUKSHËM

Ling u zu ngushtë mes vendosmërisë së saj dhe bindjes ndaj familjes. Nëse refuzonte të martohej, do të çnderonte të gjithë familjen dhe do të turpëronte t'ëmën: dhembje e vështirë për t'u duruar. Nëse martohej, kishte frikë se bashkëshorti i saj do të ishte si Shu-Tan. Mbetej vetëm një zgjedhje për të: të vriste veten. Vdekja dukej të ishte e vetmja mënyrë që të mund t'i arratisej skllavërisë dhe presionet e mendjes iu shndërruan në dhembje në zemër.

Nëna e Lingut e dinte që e bija po binte në depresion të thellë, dhe kishte frikë për mirëqenien e saj. «Ling, ti je drejtuese e lindur», – i tha ajo vajzës së saj, duke u përpjekur t'i ngrinte moralin. «Sigurisht që Perëndia ka planifikuar diçka të veçantë për ty».

Lingu refuzoi ta dëgjonte nënën e saj të bisedonte për Perëndinë e saj të padukshëm. I dukej e kotë. Para besëtytënisë së kotë të

s'ëmës dhe ngarkesës së punës prej njerkut të pashpirt, Lingu po ndjehej edhe më tepër e pashpresë.

Duke e ditur se vajza e saj nuk ishte në gjendje të mirë, e ëma nuk guxonte t'ia ndante sytë, e shqetësuar se mund të vriste veten. Një ditë më në fund ia doli mbanë ta sillte vajzën e saj të shqetësuar në një nga ato takimet e vogla të kishës që ishte formuar në fshat. Lingu e dinte që ishte më mirë se sa të bluante sojë për të bërë tofu, dhe në fakt u kënaq aty. Kishte vetëm katër persona: Lingu, mamaja e saj dhe dy të tjerë.

Ndërsa qëndronte atje duke dëgjuar të tjerët të këndonin një himn, mendoi për besimin e nënës së saj. Si mund të besojë ajo kaq verbërisht në një Perëndi që s'mund ta shohë? Pavarësisht dyshimit të saj, s'mund ta shpërfillte shkëlqimin në fytyrën e nënës. Dukej sikur po këndonte me engjëj të padukshëm.

TË BËHESH DIKUSH QË PERËNDIA MUND TA PËRDORË

Disa ditë më vonë, Lingu dëgjoi nënën duke u lutur përsëri për të, por këtë herë fjalët tërhoqën menjëherë vëmendjen e saj. «Oh, Perëndi», – lutej e ëma me butësi, – «të lutem shpëtoji fëmijët e mi, veçanërisht Lingun. Ti e di se sa vullnet të fortë ka ajo dhe sa e ashpër mund të jetë. Të lutem ktheje këtë kokëfortësi të saj në diçka që mund ta përdorësh». Kjo pjesë e lutjes ishte e njohur, dhe duke dëgjuar përsëri të njëjtat fjalë, Lingu veçse mund të buzëqeshte. Ishte pjesa tjetër e lutjes së nënës që i erdhi e papritur: «E kam dëgjuar historinë e Abrahamit, që ofroi djalin e tij, Isakun, si sakrificë për ty», – vazhdoi e ëma «Tani, edhe unë dua të të ofroj një prej fëmijëve të mi. Do të doja të të ofroja Lingun».

Lingu u drodh. Të më sakrifikojë mua? Është çmendur mamaja?

Kjo lutje iu ngulit ndër mend për disa ditë duke e torturuar dhe hutuar. Më në fund, kur e dëgjoi nënën të lutej përsëri një mëngjes, hyri furishëm në dhomë për ta konfrontuar. «Do të më sakrifikosh përsëri për Perëndinë tënd, mama? Do ta lejosh të më vrasë me punë të rëndë apo të më godasë me vetëtimë? Ku është ky Zoti Jezus për të cilin vazhdon të flasësh? Thuaji të qëndrojë përpara meje që të mund ta prek, atëherë do të besoj! E çfarë lloj njerëzish shkojnë në parajsë? Gra të moshuara e pa shpresë si ti?

Si mund të shkosh atje? Mendon se mund të ngjisësh një pemë apo një shkallë për të shkuar në parajsë?» Lingu mund ta shihte në fytyrën e nënës dhembjen që po i shkaktonte. Urrente ta lëndonte, por i kishte ardhur në majë të hundës.

Lingu dëgjoi zërin komandues e të ashpër që nxori nga goja dhe e kuptoi që ishte i njëjti ton që përdorte me motrat e saj. Ishte vetëzgjedhur drejtuese midis motrave me taktikat e saj bindëse. Ato zakonisht ia plotësonin kërkesat; e dinin që mund t'i fuste në telashe nëse nuk bindeshin. Tani ajo po qortonte nënën e saj me të njëjtin zë të ashpër, dhe i erdhi keq për lëndimin që po i shkaktonte, por s'mund të bënte ndryshe. S'mund t'i duronte më lutjet e kota të nënës ndaj Perëndisë së saj që nuk ekzistonte.

Koha kalonte dhe Lingu vazhdonte të punonte shumë. Ia doli mbanë të shmangte sugjerimin e njerkut për t'u martuar dhe më në fund ai hoqi dorë e vazhdoi ta shpërfillte. Lingu e ndiente se ndryshimi i njerkut vinte për shkak të ndikimit të nënës. Kur u ndie e lehtësuar, u ndie gjithashtu fajtore për mënyrën se si e kishte konfrontuar aq ashpër. Duke shpresuar të korrigjonte gabimin për shpërthimin e saj, vazhdoi ta shoqëronte nënën në takimet e përjavshme të kishës.

Kur erdhi pranvera, Lingu i kishte flakur tej mendimet për vetëvrasje.

Po punonte në mullirin e tofusë një ditë kur nëna nxitoi drejt saj duke thirrur: «Ling, ai është këtu!»

«Kush është këtu?», – pyeti Lingu.

«Ungjilltari për të cilin kemi dëgjuar të flitet kaq shumë!» – iu përgjigj e ëma. «A nuk e mban mend që të kam treguar për të? Ai do të predikojë sonte dhe u thashë të tjerëve që do të jemi atje. Shko pastrohu! Nxito!»

Para se Lingu të kishte mundësi të refuzonte, nëna ishte larguar me nxitim.

«Oh, mrekulli», mendoi ajo, «një autoritet i vetëshpallur i Perëndisë.»

Shkoi në takimin e kishës atë mbrëmje, kryesisht për të kënaqur nënën. Predikuesi i moshuar foli rrjedhshëm dhe pa sforcim. Nuk ishte shumë predikim, ai thjesht tregoi historinë e Adamit dhe

Evës, duke shpjeguar se si mëkati kishte hyrë në botë dhe duke i siguruar që Perëndia i donte aq shumë saqë dërgoi Birin e Tij të vdiste në kryq që mëkatet e tyre të mund të faleshin. Lingu e ndjeu zemrën t'i zbutej ndërsa fjalët e tij i hynë thellë në shpirt. Nuk kishte njohur kurrë një dashuri dhe sakrificë të tillë. E kishte dëgjuar historinë më parë, por nuk kishte pasur aq shumë kuptim sa tani.

Më vonë atë mbrëmje, entuziazmi në shpirt u rrit ndërsa vështroi një pikturë të një kryqi të varur në murin e shtëpisë së tetos së saj. Shkoi drejt tij, zgjati dorën për ta prekur ndërsa ndër mend i vinte historia që kishte treguar me aq gjallëri predikuesi. *Nëse Jezusi ka vdekur për mua, çfarë kam bërë unë për Të?* – pyeste ajo veten ndërsa një valë pendese i përshkoi shpirtin. Lingu ra në dysheme dhe qau, duke thirrur Perëndinë e padukshëm, të cilin e kishte mohuar me aq vendosmëri.

«Oh, mami! Më vjen keq», – u ngashërye ajo. «Më vjen keq për të gjitha ato gjëra të këqija që kam thënë për Perëndinë tënd dhe për mënyrën se si të kam tallur me mosbesim. Jam njeri shumë i keq. Si mundet Perëndia të më falë?»

Sytë e nënës së Lingut shkëlqenin prej lotëve të gëzimit ndërsa përqafonte të bijën dhe motrën e saj të re në Krisht. «Ling, e dashur, je e falur», – tha ajo. «Hiri i Perëndisë të ka tërhequr këtu sonte dhe tani do të jesh përherë bija e Tij. Asgjë s'mund të më bënte më të lumtur. Besoj se Ai ka një plan të veçantë për ty; E kam besuar këtë për një kohë të gjatë».

Lingu nuk kishte qarë aq shumë që kur i kishte vdekur i ati.

QENGJA NË MES TË UJQVE

Vitin që pasoi ajo vazhdoi të shkonte me nënën në takimet javore të Biblës, jo më si spektatore, por si anëtare e bashkësisë së tyre, e cila ishte gjithnjë e në rritje. Depresioni ishte zëvendësuar me një gëzim të brendshëm dhe besonte se telashet i kishte lënë pas. Më vonë pa një ëndërr: Rrugica e ngushtë të çonte drejt e në fushë. *Në anën e majtë gruri ishte i imët dhe i gjelbër, lëkundej lehtë në erë. Në anën e djathtë, ishte i pjekur dhe disa kallinj po rrëzoheshin nga pesha e kokrrave të pjekura. Lingu shikonte në*

të gjitha anët ndërsa gruri zhdukej në horizont. Pyeste veten se sa i çuditshëm duhet të ketë qenë moti apo toka që kishte dhënë një prodhim të tillë.

Ajo ia tregoi nënës ëndrrën e pazakontë të nesërmen në mëngjes. Për habinë e saj, nëna kishte parë të njëjtën ëndërr. Kishte parë kallinjtë e pjekur e të rëndë të grurit, por edhe një filiz të vogël që rritej në mes të fushës dhe dëgjoi një zë që e udhëzonte «Ujite këtë filiz të njomë se mund të thahet».

Asnjëra prej tyre nuk e dinte se çfarë kuptimi kishin ëndrrat, por e dinin që duhej të kishte një arsye që kishin pasur të njëjtin vizion. Përgjigjja erdhi javën që pasoi në takimin e lutjes, kur teksti për atë mbrëmje ishte nga Ungjilli i Lukës, kapitulli 10: «E korra është e madhe, kurse punëtorët janë pak; lutjuni Zotit të së korrës të çojë punëtorë në të korrën e vet. Shkoni; ja, unë ju dërgoj si qengja në mes të ujqve».[1]

Duke vrarë mendjen, nëse ky ishte kuptimi i ëndrrave të tyre, Lingu ishte sa e frikësuar, aq edhe e emocionuar për çka kishte rezervuar Perëndia për të. Ishte kurioze edhe se kujt i referohej pjesa e dytë e pasazhit. «Si mund të jem unë predikuese?», – pyeti ajo t'ëmën ndërsa diskutonin pasazhin. «Jam shumë e re dhe nuk di asgjë. Nuk kam as Bibël».

E ëma e vështroi Lingun dhe buzëqeshi. E dinte plotësisht kuptimin e ëndrrave: vajza e saj do t'u sillte ungjillin shpirtrave të humbur të Kinës. Këtë e dinte me siguri.

Shumë shpejt pasi mbushi shtatëmbëdhjetë, me shumë pak para dhe ushqim, pa Bibël dhe pa destinacion, Lingu u nis e vetme për të predikuar ungjillin në Kinë. Kishte dashur të priste që të mësonte më tepër, por e ëma kishte këmbëngulur. «Nuk është e nevojshme të dish shumë. Thjesht ndaj historinë e Jezusit. Tregoju njerëzve çfarë di. Nëse është nga Perëndia, Ai do ta bekojë shërbesën tënde». Me nxitjen e s'ëmës, ajo u nis.

Shkonte fshat më fshat duke ndarë besimin e saj. Sa herë që kalonte një fshat që kishte një Bibël, studionte për të mësuar përmendsh vargje për mesazhin tjetër. Mësoi gjithashtu edhe himne. Nuk e kishte kuptuar asnjëherë sa bukur këndonte derisa pa që njerëzit tërhiqeshin nga zëri i saj dhe qëndronin për të

dëgjuar çfarë kishte për të thënë predikuesja e re. Thjesht fakti që ishte e re, beqare dhe udhëtonte e vetme përmes Kinës ishte mjaft për të tërhequr vëmendjen e shumicës së njerëzve.

Perëndia e bekoi shërbesën e Lingut. Sa më shumë që udhëtonte e predikonte, aq më tepër njerëz mblidheshin! Habitej kur shihte që numri i njerëzve nga shtatë në fshatrat e parë shkonte në shtatëdhjetë në fshatrat që vizitonte javën tjetër. Shkrimi ishte i vërtetë: E korra ishte e madhe. Njerëzit ishin të uritur të dëgjonin ungjillin, dhe Perëndia e thirri për të qenë një prej lajmëtarëve të Tij. Ishte e mrekullueshme dhe Lingu lutej vazhdimisht që të ishte e denjë për thirrjen. Për më tepër donte të ishte shembull. Donte të predikonte atë çka dinte dhe kishte përjetuar.

Dëshironte shumë të kishte një Bibël dhe filloi t'i lutej Perëndisë për t'i siguruar një. «Si mundet një predikues i Fjalës së Zotit të mos ketë një Bibël?» – e pyeste ajo.

Të rinjtë ishin veçanërisht të tërhequr ndaj personalitetit karizmatik të Lingut dhe zjarrit të saj për Zotin. Disa prej tyre ofronin ta shoqëronin dhe ungjilltarja e re pranonte me kënaqësi.

Ndërsa turmat rriteshin, rritej edhe pasioni i saj për ungjillin dhe e ndiente që s'mund të vazhdonte më pa një Bibël. Kishte vizituar një fshat, ku besimtarët kishin vetëm një pjesë të Ungjillit të Mateut dhe kishin lexuar në kapitullin 25 shëmbëlltyrën e dhjetë virgjëreshave. Pesë prej tyre ishin treguar të urta dhe kishin hedhur vaj rezervë në llamba, ndërsa pesë të tjera ishin të marra dhe nuk kishin marrë vaj rezervë që t'i mbanin llambat ndezur. Duke e marrë kuptimin e pasazhit fjalë për fjalë, çdo anëtar kishe në fshat mbante vaj rezervë me vete gjatë gjithë kohës për t'u siguruar që nuk do mbeteshin pa të kur Zoti të kthehej. [2]

Lingu dëshironte shumë të kishte një Bibël të plotë që të mund ta studionte dhe t'i ndihmonte besimtarët e tjerë ta kuptonin. Kështu që kur dëgjoi që një grua rreth gjashtë kilometra larg kishte Bibla, nxitoi ta arrinte sa më shpejt që të mundej. Zbuloi që gruaja kishte disa Bibla që kishin dalë në breg ndërsa anëtarët e një grupi të një misioni të krishterë ishin detyruar t'i hidhnin jashtë anijes ndërsa përpiqeshin t'i sillnin në Kinë natën. Disa besimtarë përgjatë

bregut kishin marrë Biblat dhe kjo grua i kishte tharë faqet me kujdes një për një në dritën e diellit.

Kur Ling i kërkoi një prej Biblave, duke i shpjeguar se si e kishte thirrur Perëndia për të predikuar ungjillin, gruaja u alarmua. «Jo, jo!» – u përgjigj ajo. «Këto Bibla janë shumë të çmuara. E di sa e vështirë është të kesh një Bibël? E nga ta di unë që ti je besimtare?»

Lingu këmbënguli duke iu lutur, por nuk ia doli mbanë. Gruaja nuk jepte as edhe një nga Biblat e saj. E shkreta Ling dukej aq e dërrmuar saqë gruaja i tha se, nëse do të mund të thoshte përmendësh Lutjen e Zotit pa asnjë gabim, do ta merrte në konsideratë kërkesën.

Lingu u largua, e inkurajuar që mund të kishte ende shpresë. Udhëtoi drejt një fshati ku e dinte që ndodhej një Bibël në shtëpinë e një besimtari të moshuar. Ky vëlla e ruante atë me një nderim të shenjtë, dhe kur Lingu e pa, e kuptoi pse. Bibla e burrit të moshuar ishte e gjitha e shkruar me dorë. Në fakt, duart e vëllait ishin të deformuara për shkak të mijëra e mijëra orëve që kishte kaluar duke kopjuar me shumë kujdes çdo varg shkronjë më shkronjë.

REALIZIMI I NJË ËNDRRE, FILLIMI I NJË MISIONI

Kur Lingu paraqiti kërkesën e saj, burri i moshuar i zgjati me kujdes Biblën e tij dhe e lejoi të kopjonte Lutjen e Zotit në mënyrë që ta mësonte përmendsh. Ishte e mahnitur nga shkronjat e shkruara aq pastër dhe pyeste veten se sa vjet kishte kaluar duke kopjuar mijëra vargje. Mundi të shihte edhe Bibla të tjera si këto gjatë udhëtimit të saj. Këto vepra të mrekullueshme dashurie i dhanë një vlerësim të ri për rëndësinë e Fjalës së Zotit dhe ajo u përkushtua për të mësuar sa më shumë pasazhe që të ishte e mundur. U zotua gjithashtu të shpërndante Bibla në të gjithë Kinën ...nëse Perëndia do ta bënte të mundur këtë ëndërr.

Gjatë rrugës për në shtëpinë e gruas, Lingu vriste mendjen nëse e kishte mësuar saktë Lutjen e Zotit. Po sikur të kishte bërë ndonjë gabim? Po sikur ta kishte kopjuar gabim?

Por nuk kishte pse shqetësohej. E kaloi testin dhe e tha Lutjen e Zotit pa gabime. Megjithatë, gruaja i kërkoi të lutej me zë

të lartë që të sigurohej se ishte e sinqertë. Më pas i bëri disa pyetje rresht për shërbesën dhe se si e kishte njohur Krishtin. Pasi përfundoi marrja në pyetje, gruaja u ul në gjunjë me Lingun, përqafoi Biblën dhe ia dha. I kërkoi ndjesë që ishte treguar aq dyshuese dhe i shpjegoi: «Pasi vëllezërit tanë morën Biblat nga bregu, filluan t'i shpërndajnë nëpër Kinë. Ishte shumë e rrezikshme dhe disa e paguan me jetën e tyre. Duke kujtuar sakrificën e tyre, i ruaj këta libra me shumë kujdes».

Lingu u largua me Biblën e saj. Një pjesë e saj ishte ende e lagur, sepse gruaja nuk kishte përfunduar së thari të gjitha faqet. E hapi te Luka 10, duke ngritur me kujdes faqet e lagura dhe lexoi fjalët e njohura me lot në sy: «E korra është e madhe, kurse punëtorët janë pak; lutjuni Zotit të së korrës të çojë punëtorë në të korrën e vet. Shkoni; ja, unë ju dërgoj si qengja në mes të ujqve».

Lingu e kishte kuptuar plotësisht pjesën e parë të urdhërimit të Jezusit. Kishte dalë vetëm, si punëtore e Zotit dhe e korra kishte qenë vërtet e madhe. Tani ndërsa po pyeste veten se si do të përmbushej pjesa e dytë e këtij pasazhi, u lut për forcë.

E KËRKUAR

Posteri dukej ogurzi: «Kërkohen për krime kundër shtetit», – shpallej me të madhe. «Nëse dikush i ka parë personat në listë duhet të raportojë menjëherë tek autoritetet vendase. Do të jepet një shpërblim». Lingu lexoi fjalët dhe u drodh ndërsa vështroi listën, duke lëvizur buzët ndërsa lexonte emrat. Shumë prej tyre ishin miq dhe bashkëpunëtorë, dhe ... në listë, ishte edhe emri i saj.

Nuk u habit, por ky zbulim ishte shqetësues. Gjërat kishin shkuar vaj për pak kohë. Lingu ishte mjaft frytdhënëse në shërbesën e saj. I kujtohej se si predikuesi i moshuar i kishte ndryshuar jetën kur kishte ardhur në fshatin e saj dhe thjesht kishte folur për Adamin dhe Evën, për mëkatin dhe për sakrificën e madhe të Jezu Krishtit. Ajo kishte ndjekur shembullin e tij. Shumë shpejt mësoi se një nga mënyrat më të fuqishme që të mund të arrinte njerëzit ishte thjesht të lexonte pasazhe nga Shkrimi me zë të lartë. Shumë kinezë e dinin se sa e rrallë ishte Bibla, dhe i dëgjonin historitë me ëndje, duke e kuptuar mesazhin shpejt.

Çuditërisht telashet filluan me të afërmit e saj. Ndërsa Lingu udhëtonte nëpër fshatra, lajmi i shërbesës së saj u shpërnda me shpejtësi dhe të afërmit e akuzonin se i kishte sjellë turp të madh familjes. «Ajo është e madhe», – ziheshin ata me njëri-tjetrin. «Duhet të martohet dhe jo të endet sa andej-këndej si e çmendur!»

Lingu kishte konsideruar të shkonte në shtëpi për disa arsye. Njerku i saj ishte i tërbuar nga zemërimi që prodhuesja e tofusë ishte larguar. Në fillim besoi se do të kthehej së shpejti për shkak të urisë, por ndërsa muajt kalonin, e kuptoi që ajo ishte larguar përgjithmonë. Sigurisht, kthehej herë pas here, por asnjëherë më shumë se sa për një vizitë pasditeve.

Shu-Tan refuzoi të blinte një ka dhe e detyroi nënën e Lingut të punonte në mulli. Kur Lingu dëgjoi për zemërngurtësinë e njerkut, shkoi në shtëpi fshehurazi dhe i tha nënës: «Kjo është shumë për ty. Do të qëndroj në shtëpi».

«Jo! Absolutisht jo», – iu përgjigj e ëma. «Duhet të më premtosh që do t'i qëndrosh besnike thirrjes së Perëndisë. Unë mund t'ia dal mbanë. Ky është çmim shumë i vogël për t'u paguar që ti të predikosh ungjillin. A e kupton? Duhet të vazhdosh punën në të korrat e Zotit».

Lingu veproi ashtu si i tha e ëma, por shumë shpejt pati probleme të tjera. Në disa nga fshatrat policia vendase kishte filluar të shkatërronte «takimet e paligjshme» dhe «aktivitetet e kultit». Shumë besimtarë kishin frikë ta lejonin Lingun të qëndronte në fshatin e tyre; në disa vende iu refuzua, madje edhe një vakt i vetëm. U gjend duke udhëtuar gjithnjë e më larg në këmbë, ndërsa shtyhej më në thellësi të vendit. Mund të kishte udhëtuar me autobus vetëm për pesëdhjetë cent, por nuk kishte aq para me vete.

Fatmirësisht, kur mbështetësit e saj dëgjuan për udhëtimet e saj, i dhuruan këpucë që të mund të vazhdonte të ecte. Lingu i pranoi me kënaqësi.

Pavarësisht presioneve gjithnjë e më të mëdha, ajo po përjetonte rezultate të mëdha në shërbesën e saj. Turmat shpesh i kalonin të njëqindat dhe zëri i saj mbeti i fortë ndërsa u drejtohej njerëzve në takimet e hapura. Grupet e kishave në shtëpi u hapën në

shumë fshatra, dhe këto tërhoqën vëmendjen e qeverisë. Në fillim të krishterët e mohonin që kishin refuzuar kishën zyrtare të sponsorizuar nga qeveria, të quajtur Lëvizja Patriotike. Sepse, nëse ata do të donin të merrnin pjesë në të, bashkësia më e afërt ishte qindra kilometra larg!

Shumë shpejt policia filloi persekutimin e të krishterëve. Si pasojë e kësaj, besimtarët i zhvillonin takimet në pyll dhe këndonin e predikonin me zë të ulët. Lingu duhej të bënte kujdes kujt t'i besonte dhe refuzonte të qëndronte në një zonë për një kohë të gjatë. Ajo njihej edhe me shumë misionarë në atë zonë, dhe shpesh kërkonin ta takonin. E dinte që këto takime mund të ishin të rrezikshme dhe tërhiqnin vëmendjen e policisë, por ajo dëshironte shumë të takohej me motra e vëllezër të krishterë jashtë vendit që t'ua bënte të ditur se çfarë po bënte Perëndia në Kinë. Misionarët i sillnin Bibla, të cilat Lingu i shpërndante me kënaqësi në kishat e vogla që mblidheshin në shtëpi. Ato ishin ende shumë të rralla kudo që shkonte, dhe shpesh jepte vetëm një për bashkësi. Kopjimi me dorë vazhdonte.

GJUNJË TË PËRBALTUR, ZEMRA TË MBUSHURA PLOT

Në dimrin e vitit 1983, persekutimet dhe arrestimet e të krishterëve u shtuan. Lingu ishte vazhdimisht në arratisje, duke e ditur se ajo dhe shumë bashkëpunëtorë të saj ishin në listën e të kërkuarve të qeverisë. Nuk bëhej fjalë tani ta takonte t'ëmën. Policia do të ishte duke e vëzhguar. Gjatë vizitës në një fshat të quajtur Toukil, ajo i kishte çuar fshatarët thellë nëpër fusha për të ndarë ungjillin e sigurt. Binte shumë shi dhe nuk kishte strehë, por të gjithë qëndruan, të magjepsur nga mesazhi duke përpirë çdo fjalë.

Në momentin që ajo i drejtoi në një lutje pendese, dëgjuesit u ulën në gjunjë në baltën e trashë. Gjunjtë e Lingut u fundosën plotësisht, po ashtu edhe të të tjerëve. Atë ditë më shumë se njëqind veta pranuan Krishtin dhe Lingu gëzohej me ta ndërsa i druhej asaj që e priste më vonë. E dinte se zjarri i persekutimit do të bënte që Fryma e Shenjtë të frynte më fort e më gjatë. U përkushtua sërish për t'i qenë besnike thirrjes së saj, pavarësisht se çfarë e priste më vonë.

Njëzetë kilometra më larg, në fshatin Datuin, Lingu takoi disa predikues, që kishin udhëtuar në të gjithë vendin duke ndarë ungjillin ndërsa përpiqeshin t'i shmangeshin persekutimit. Njëri prej tyre ishte i njohur si xhaxha Foni, por edhe të tjerët kishin të njëjtin pasion dhe vizion me të; ata kishin shumë vite që i shërbenin Zotit. Xhaxha Foni ishte anëtari më i vjetër i grupit. Ai kishte qenë në një kamp pune të detyruar për një periudhë pesëvjeçare.

Lingu u bashkua me të tjerët, dhjetë ungjilltarë: nëntë burra dhe ajo, të cilët i ishin përkushtuar predikimit të mesazhit të thjeshtë të Krishtit derisa kishat të pajiseshin me udhëheqësinë e tyre. Bënë gjithashtu edhe një marrëveshje që ata që ishin beqarë në grup, siç ishte Lingu, të mbeteshin të tillë derisa puna e tyre të themelohej mirë.

Sfida më e madhe me të cilën përballeshin ungjilltarët nuk ishte persekutimi, por nevoja për Bibla. Ranë dakord që Lingu të ishte përgjegjëse për sjelljen e Biblave të tjera meqenëse kishte zhvilluar tashmë kontakte me misionarë të huaj, që i kishin sjellë fshehurazi. Kur nuk ishte në fshatra për të mbjellë kisha, Lingu me ndihmën e xhaxha Fonit, ndiqte çdo zë se ku mund të gjendeshin Bibla.

PUNË E VËSHTIRË, RREZIKSHMËRI E LARTË

Përveç ungjillëzimit dhe shpërndarjes së Biblave, tanimë Lingu udhëtonte tridhjetë a më shumë kilometra çdo ditë, kryesisht me biçikletë. Udhëtimet ishin shumë të rrezikshme. Ajo e dinte që policia po e ruante. E dinte që ishte vetëm çështje kohe para se ta arrestonin. Për t'u përgatitur, u lexonte gjithnjë e më tepër pasazhe rreth persekutimit besimtarëve në kishat e fshatrave. Donte që të ishin të përgatitur, dhe, nëse i ndodhte asaj, donte të ishte shembull i mirë.

Puna bëhej gjithnjë e më e vështirë. Shpesh kalonte më shumë se një ditë pa ngrënë, dhe disa anëtarë të kishës e shihnin me sy kritik: Ishte vetëm njëzetë vjeç, beqare, dhe, grua. Ç'punë kishte ajo të merrte përsipër një punë të tillë? Disa prej fjalëve ishin për shkak të kulturës, të tjerët thjesht ishin xhelozë. Sidoqoftë, komentet ishin të vështira për t'u pranuar nga Lingu.

Gjatë gjithë vitit 1980-të, ajo dhe bashkëpunëtorët e saj vazhduan me udhëtimet e tyre, duke dëgjuar gjithnjë e më tepër raporte për arrestimet e të krishterëve, madje edhe për tortura nga autoritetet. Shqetësimi i qeverisë qendrore e Kinës po shtohej me rritjen e shpejtë të «kishave shtëpi» në të gjithë vendin, ndërkohë që kishat zyrtare TSPM humbisnin anëtarë. Për Lingun dhe ungjilltarë të tjerë, ishte e qartë që besimtarët po kërkonin derdhjen e re të Frymës së Perëndisë që rezultoi në lëvizjen e fshehtë të «kishave shtëpi». Si pasojë, udhëheqësit e qeverisë drejtuan një fushatë mbarëkombëtare për të shuar rritjen e këtyre kishave. Persekutimi u intensifikua ndërsa policisë vendase iu dha autoritet për t'u marrë me të krishterët si të dëshironin, veçanërisht me drejtuesit e krishterë. Shpesh, kjo do të thoshte tortura dhe burgosje pa gjyq.

Në fillim të viteve '90-të, Lingu ishte bërë e njohur nga mijëra besimtarë si një drejtuese e urtë dhe e dhembshur. Në njëfarë mënyre u kishte shpëtuar autoriteteve, të paktën deri tani.

MBAJTJA E PËRKUSHTIMIT

Në prill të vitit 1994, Lingu ishte e rraskapitur fizikisht. «Duhet të pushosh pak», – i thoshte xhaxha Foni. «Ndoshta është koha e Perëndisë për ty që të martohesh».

Lingu e refuzoi këtë sugjerim. «Ti e di që kam bërë një përkushtim ndaj të tjerëve në grupin drejtues. Thamë që nuk do të martohemi derisa kisha të ndërtohej me themele të forta. Besimtarët kanë nevojë për udhëheqje që të mbahen të fortë dhe t'i rezistojnë persekutimit të tmerrshëm që po ndodh. Përveç kësaj, një ngarkesë tjetër me Bibla ka ardhur me anije në Guangzhou. Do të marr Shenin dhe Jamin me vete për të marrë disa. Do të kthehemi pas disa ditësh.

Plaku Fon u shqetësua disi, por e la mënjanë dëshirën për të diskutuar me të. Lingu ishte shumë kokëfortë, por kjo ishte arsyeja që e kishte pranuar në grup. E dinte që Perëndia mund ta përdorte përkushtimin e saj të zjarrtë për të ndihmuar në mbjelljen dhe rritjen e «kishave shtëpi». Përveç kësaj, xhaxha Foni dhe gruaja e tij e donin si vajzën e tyre.

Ai i dinte problemet e Lingut, se si ndonjëherë i duhej të merrej me xhelozinë e anëtarëve të kishës për shkak të pozitës së saj, dhe se si i duhej të duronte keqkuptimin e vazhdueshëm të atyre, që s'mund ta kuptonin pse nuk ishte martuar. Duke menduar për të gjitha sfidat me të cilat përballej, xhaxha Foni u lut në heshtje ndërsa e shihte të largohej.

MË NË FUND U KAP

Herët në mbrëmje Lingu dhe bashkëpunëtorët e saj kishin marrë ngarkesën me Bibla dhe kishin arritur në shtëpinë e miqve të tyre gjatë rrugës për në shtëpi. U gëzuan në miqësinë e ngrohtë dhe pushimin qetësues pas udhëtimit të gjatë. Ishte mjaft vonë kur Lingu kërkoi të bënte një telefonatë para se të shkonte në shtrat. Ndërsa doli jashtë apartamentit në një rrugë të qetë, dëgjoi një burrë të thërriste emrin e saj. Ai po nxitonte drejt saj dhe ndërsa u afrua, nën dritën e rrugës, ajo mundi të shihte që ishte oficer policie. Instinkti i parë i saj ishte të largohej, por ndërsa u kthye, u konfrontua me një oficer tjetër.

Mirë pra, mendoi Lingu, *më kapën më në fund*. Që kur kishte parë emrin e saj në listën e të kërkuarve vite më parë, e kishte pritur këtë moment, por kishte besuar shumë se do të ndodhte kur Perëndia ta lejonte.

«Duhet të vish me ne», – tha një nga oficerët ndërsa treguan distinktivin. Me sa duket e kishin pritur dhe, megjithëse e dinte shumë mirë se çfarë do të pasonte, ajo mori frymë e lehtësuar nga mendimi që do të merrnin vetëm atë, pa shqetësuar besimtarët e tjerë apo pa kërkuar në apartamentin e vogël.

Në vend që ta përcillnin për në makinë, oficerët e drejtuan për në apartament.

«Ku po më çoni?», – pyeti Lingu.

«Brenda», – iu përgjigj oficeri i parë. Ai ishte i gjatë si Lingu dhe fliste me një zë të qetë, që e acaronte. Ndërsa e shoqëronin për në ndërtesë, ajo vriste mendjen: *Shen dhe Jan janë të dy të martuar, sigurisht që policia nuk do t'i dërgojë në burg. Sa Bibla do të gjejnë? A i shkatërrova udhëzimet për në shtëpinë e pastorit pasi mora Biblat atje?*

Duke hyrë në apartament më parë se oficerët, Lingu i pështpëriti shpejt Shenit dhe Janit: «Thuajuni se ju kam marrë unë me pagesë dhe se nuk dini asgjë. Ma lini mua përgjegjësinë».

Policia e ndau shpejt Lingun nga të tjerët, e ulën në karrige dhe i shpalosën një dokument, në dukje zyrtar. E pa emrin e saj të shkruar në njërin prej rreshtave në paragrafin e parë. «Firmose këtë», – ulëriti zoti Gjatosh dhe Zemrërlig. I vuri një stilolaps në duar dhe ajo i hodhi një sy të shpejtë dokumentit. Ishte një mandat që thoshte se ata mund të kërkonin dhe të merrnin çdo «të dhënë» nga dhoma e saj. E firmosi fletën dhe papritur u ndje e mposhtur nga lodhja. E dinte që do të ishte natë e gjatë...

Oficerët filluan të rrëmonin nëpër apartament. I shihte ndërsa i kontrollonin rrobat dhe më pas gjetën kutitë me Bibla...

Lingu u dërgua në burgun 91, një prej katër burgjeve të famshëm në Kinë. Oficerët që e morën në pyetje donin vetëm tri gjëra: emra, emra dhe përsëri emra. «Kush të mbështet? Cilët janë drejtuesit e tjerë? Kush t'i dha këto Bibla?» Duke e ditur çfarë i priste, nëse identifikonte ndonjë nga grupi, ajo refuzoi të përgjigjej.

Marrja në pyetje vazhdoi pa ndërprerje për dy muajt vijues.

Jo vetëm që i duhej të merrej në pyetje, por të punonte bashkë me të burgosurit e tjerë. Ata duhej të bënin çakmakë dhe kontrolli i cilësisë ishte i rreptë, sepse çakmakët transportoheshin për në Perëndim. Lingu u sëmur rëndë, me temperaturë të lartë, por nëse nuk e plotësonte kuotën ditore, e rrihnin.

«NE DIMË SI TË TA HAPIM GOJËN»

Në korrik, Lingu u transferua. Policia në vendlindjen e saj zbuloi se ajo ishte arrestuar dhe kërkuan ta ekstradojnë. Pasi kishin dhjetë vjet që e ndiqnin, u gëzuan kur zbuluan që ishte burgosur. Policia e vendlindjes kishte më tepër përvojë në marrjen në pyetje të të burgosurve. Ashtu siç i tha njëri prej tyre: «Ne dimë si të ta hapim gojën».

Tashmë e dobët prej temperaturës dhe punës së detyruar në Burgun 91, Lingu vuante shumë ndërsa marrja në pyetje vazhdonte. Buzët i kishte të ftohta dhe ndihej sikur do humbiste ndjenjat. Sesionet e marrjeve në pyetje kishin qenë të vështira,

por nuk kishte rezultuar asgjë. Përdorën teknika të tjera për të njëjtin informacion: emra. «Me kë punon tjetër?» – e pyesnin ata herë pas here. «Cilët janë personat me të cilët ke kontakte jashtë shtetit? Na trego për takimet ilegale. Kush ju jep libra dhe Bibla?» Pyetjet ishin marramendëse, por ajo përsëri u përmbajt dhe nuk e zbuloi identitetin e të tjerëve, megjithëse tundimi ishte shumë i fortë. Ndonjëherë personat që e merrnin në pyetje i tregonin fotografitë e saj me bashkëpunëtorët. *Nëse e dinë tashmë se me kë punoj; pse duan t'u tregoj emrat?* – pyeste veten ajo. *Çfarë dëmi tjetër mund të bëj tani?*

Një ditë të tmerrshme, dhjetë burra hynë në dhomën e hetuesisë. Njëri po mbante një morsetë të vogël e të hapur nga të dyja anët. Dy prej rojave e detyruan Lingun të shtrihej përmbys në dysheme. I tërhoqën njërin prej krahëve rreth ijeve për në shpinë dhe ia tërhoqën krahun tjetër mbi supe në mënyrë që të ishte disa centimetra larg shtyllës së saj kurrizore. Pastaj, një rojë tjetër ia vendosi takën e çizmes mbi shpinë në mënyrë që të kishte mjaft forcë për t'ia bashkuar duart, ndërsa ata që po i mbanin krahët nxituan të vendosnin një morsetë në dy gishtat e mëdhenj të duarve. E shtrënguan morsetën, duke ia bashkuar fort gishtat.

Lingu ndjeu kockat t'i kërcisnin ndërsa nyjat e supeve ishin ndrydhur në pozicion jo të natyrshëm. Atëherë ia lëshuan krahët dhe e gjithë forca e pozicionit të saj të ndrydhur torturues i shkaktoi një dhimbje të tmerrshme në të gjithë trupin.

«Morseta e gishtave» ishte aq mizore, sa qeveria e kishte ndaluar përdorimin e saj te gratë. Në mjerimin e saj, ndërsa rënkonte vërejti ironinë: shumë në fshatin e saj e kishin shkurajuar që të mos përfshihej në shërbesë, sepse ishte grua dhe po bënte atë që konsiderohej punë burrash. Tani po torturohej si një burrë.

Lingu e dinte ç'do të ndodhte. Në atë moment mendoi se kishte një zgjedhje: të përballej me vdekjen ose të tradhtonte vëllezërit e saj. Vendosi që vdekja do të ishte më pak e dhimbshme.

«Ngrihu!» – ulëriti një oficer ndërsa i shkelmonte këmbët. Po përpiqej të ngrihej në gjunjë kur u shemb përtokë nga goditja e vrullshme e një shkopi në shpinë. Dhimbja i përshkoi trupin si

rrufe. S'mundi të merrte frymë dhe zor se mund të lëvizte. Kyçet e duarve i ishin ënjtur dhe krahët i ishin ndrydhur, sepse ia kishin mbërthyer pas shpine.

«Ju lutem! S'mundem...» Zëri i Lingut dridhej ndërsa luftonte të qëndronte e vetëdijshme. Bula djerse të ftohta i ranë prej ballit dhe ia dogjën sytë ndërsa i thërriste Perëndisë në agoninë e saj. Pyeste veten nëse Jezusi ishte ndier kështu ndërsa lutej në Gjetsemani, duke e ditur që do të vuante dhe do të vdiste. Nuk e dinte nëse do të vdiste...

Marrja në pyetje vazhdoi për tri orë me gishtat e Lingut të mbërthyer pas shpine, me trupin e saj të shtrembëruar e në agoni. Më në fund humbi ndjenjat prej dhimbjes.

Kur Lingu erdhi në vete, e pa veten përmbys në dyshemenë e qelisë së saj të ndyrë. Mund të dëgjonte zëra aty afër dhe në fakt, dikush erdhi në qeli dhe e ngriti prej shtratit të drunjtë. S'mundi të lëvizte, dhimbja ishte shumë e madhe. S'mundi as të ngrihej për të ngrënë apo për të përdorur kovën. Për pesëmbëdhjetë ditë qëndroi në shtrat ndërsa oficerët vendosnin çfarë të bënin me të.

Gradualisht e mori veten nga trajtimi torturues dhe u mbijetoi kushteve të tmerrshme në burg për pesë muaj të tjerë. Më vonë, për shkak se autoritetet nuk kishin fakte reale kundër saj dhe s'mund t'i nxirrnin emrat e besimtarëve të tjerë në rrjetin e saj të gjerë, e lanë të lirë.

VUAJTJA ËSHTË SHKOLLË

Ishte ditë e ftohtë shtrëngate në janar të vitit 1995 kur Lingu trokiti në derën e një bashkëpunëtoreje. «Ling!» thirri shoqja e saj, Ruthi, kur pa figurën e brishtë të qëndronte para saj. E tërhoqi me të shpejtë brenda në shtëpi, e përqafoi dhe e pyeste pa pushim: «Ling, ishim shumë të shqetësuar për ty. Pse nuk na kontaktove? Sa e dobët që je! A je mirë? Policia nuk na tregoi asgjë për ty. Si mbijetove? Si dole?»

Një festë e menjëhershme u organizua sapo lajmi i kthimit të Lingut qarkulloi midis besimtarëve. Ajo ishte e rraskapitur, por entuziaste që ishte përsëri me motrat dhe vëllezërit e krishterë. Ndërsa u mblodhën për të falënderuar dhe për t'u lutur, ajo tha:

«Faleminderit për lutjet e ethshme për mua gjatë muajve që shkuan! E di që s'do t'ia kisha dalë pa ndihmën e Perëndisë dhe mbështetjen tuaj në lutje. Më besoni, kishte ditë kur nuk mendoja se mund të vazhdoja më gjatë, por Perëndia është besnik dhe më kujtonte gjithmonë për dashurinë e Tij gjatë asaj kohe. Mendoj se vuajtja është shkollë. Ndërsa isha atje, s'mund të varesha tek askush tjetër përveç se te Perëndia, dhe kjo varësi më afroi pranë Tij. Ju kam mësuar gjithmonë të qëndroni të fortë për Perëndinë dhe të përballeni me çdo sprovë. Tani mund t'ju them me siguri edhe më të madhe se Jezusi do të jetë me ju, pavarësisht çfarë kaloni».

Përpara arrestimit, Lingu studionte dhe jepte mësim mbi jetën e Palit dhe apostujve të tjerë të Dhiatës së Re, të cilët vuajtën për Krishtin. Tani bënte shaka me bashkëpunëtorët e saj që kur të shkonte në parajsë, donte të përshëndeste Jezusin dhe më pas të takonte Palin e ta pyeste: «Kur ishe gjallë në tokë, a ishte jeta jote po aq e vështirë sa edhe imja?»

Pa mbushur të tridhjetat, Lingu kishte kaluar aq shumë abuzime fizike sa vështirë se trupi i saj mund të funksiononte normalisht. Sidoqoftë, me dëshirën për të qenë shembull i mirë, ajo vazhdoi menjëherë me punën në «kishat shtëpi», me mësimin dhe drejtimin e studimeve të Biblës, takimin me kontaktet jashtë vendit për të koordinuar ndihmën dhe informacionin dhe të sigurohej që fluksi i Biblave të vazhdonte në zonat në brendësi të Kinës. Për shkak të persekutimit të ashpër nga qeveria gjatë viteve '80-të, besimtarët u shpërndanë në të gjithë Kinën dhe rrjeti i «kishave shtëpi» ishte rritur në disa milionë njerëz. Lingu punonte me më tepër urgjencë për t'u siguruar që çdo kishë të kishte të paktën një Bibël.

Një mbrëmje në shtator të 1996-ës, pasi u përshëndet me një çift misionarësh nga Evropa u kthye në shtëpi, kur rreth orës 10 të mbrëmjes, ajo dhe shoqja e saj e shtëpisë dëgjuan një trokitje në derë. Një zë burri thirri: «Përshëndetje! Duam vetëm të kontrollojmë kartën e qëndrimit».

Lingu vështroi Fonin dhe Shenin e tundi kokën. E dinte që ishte policia. Hapi derën, dhe pesë oficerë hynë brenda. «Je e arrestuar!» deklaroi njëri prej tyre, ndërsa një polic tjetër i vinte

prangat Lingut dhe miqve të saj. Ajo vështroi e tronditur ndërsa edhe një herë policët ia bënë gjërat lëmsh. Do të ishte një tjetër natë e gjatë...

MIQ TË VJETËR

Kur mbërritën në stacionin e policisë, ajo iu paraqit komisionerit, një njeri me zë të qetë, i cili ishte marrë me të gjatë arrestimit të fundit. «Zotëri, kjo është zonja Ling...» – nisi të flasë vartësi.

«Po, e njoh», – iu përgjigj ai ndërsa i shpëtoi një buzëqeshje. «Jemi miq të vjetër. Mirë, pra, Ling, mendoj se s'do të shkosh gjëkundi për ca kohë. Dosjes tënde dhe të grupit tënd i janë shtuar faqet. Kapëm edhe dy drejtues të tjerë sonte. Në përgjithësi, do të thosha se ka qenë ditë e mirë pune». Fërkoi mjekrën duke u larguar. «Vendoseni në bllokun e qelive 12», – tha ndërsa doli jashtë. «Po shkoj në shtëpi».

Me kalimin e javës ankthi iu shtua kur sillte ndër mend qëndrimin e shkujdesur të oficerit. Pse nuk po e merrnin në pyetje? Pse ishte aq i qetë oficeri? Si i zbuluan të tjerët që ishin arrestuar? Lingu luftonte me valët e panikut ndërsa e kuptoi se sa shumë duhej të dinin ata. Mendoi se policia e kuptonte më qartë tani mbi ndikimin e saj të madh. Ndoshta e kishin ndjekur që kur e kishin liruar nga arrestimi i parë, kështu që pa dyshim e dinin se sa shpesh ishte takuar me kontaktet jashtë vendit. Sigurisht që dinin edhe për njerëzit që e kishin vizituar në provincën e saj dhe që kishin kërkuar të takoheshin me të në lidhje me lëvizjen e «kishave shtëpi».

Mirë pra, mendoi ajo, e gjithë kjo kishte kuptim tani. Kisha ishte rritur shumë, kështu që policia herët a vonë ishte e detyruar të mësonte detajet e aktiviteteve të saj. Ia dorëzoi veten jetës së burgut, duke u dridhur kur mendonte se fjalët e Jezusit «po ju dërgoj si qengja mes ujqve» ishin bërë realitet përsëri për të.

Katër muajt që pasuan ishin torturues për Lingun. «Ju lutem», – u përgjërohej ajo, «Nëse doni të më vrisni, atëherë më vrisni, nëse doni të më dënoni, më dënoni. Nëse doni të më lironi, atëherë më lironi, por mos më mbani këtu pa asnjë arsye, siç vepruat edhe herën e shkuar».

I thoshte këto gjëra me gjithë forcën e saj, por askush nuk ia vinte veshin veçse kur ndonjë rojë e pështynte apo e tallte herë pas here...

Ndonjëherë Lingu mendonte se do të çmendej. Çdo ditë qëndronte në stolin e drunjtë, që i shërbente edhe si shtrat. Qelia e vogël, që ishte ndërtuar vetëm si një dhomë arrestimi e përkohshme, ishte vazhdimisht e lagur për shkak të një rrjedhje uji. Ndonjëherë duheshin njëzetë gra që ta thanin dyshemenë nga uji.

Megjithëse të burgosurat e tjera lëviznin shpesh nga qelia e arrestimit, para se të transferoheshin në një burg tjetër apo para se të liroheshin, Lingu shpërfillej nga autoritetet dhe rrallëherë largohej nga hapësira e ngushtë. Nuk lejohej as të shtrihej apo të mbështetej në mur gjatë ditëve të gjata, por detyrohej ose të qëndronte në këmbë ose të ulej drejt në dërrasën e drunjtë, që i shërbente si shtrat. Dyndje mushkonjash dhe mizash e bënin këtë qeli të ndyrë një vend edhe më të mjerueshëm.

Më në fund, komandanti i policisë u shfaq një ditë në derën e qelisë me një formular në dorë. «Firmose këtë», – urdhëroi ai.

Lingu zgjati dorën përmes kangjellave për të marrë formularin. «Çfarë është?» – pyeti ajo.

«Vetëm firmose» – iu hakërrye komandanti, duke ia flakur fletën. «Do të të transferojnë».

Zemra e Lingut u zhyt në dëshpërim ndërsa i hodhi një sy me të shpejtë dokumentit dhe pa se ishte një shënim, që thoshte se po e dërgonin në një «kamp reformimi pune» për një periudhë trevjeçare. Kina u garantonte të burgosurve pesëmbëdhjetë ditë për të paditur apo për t'u mbrojtur pasi merrnin një shënim të tillë, por Lingu nuk do t'i kishte këto të drejta. «Do të largohesh sot», – i tha komandanti.

Para se ajo të mund protestonte, ai u largua, me takat e ndritshme të këpucëve, që kërcisnin në beton ndërsa u zhduk në korridorin e gjatë të burgut.

Tre vjet.

Oh, Perëndi, të lutem ruaji kishat, u lut Lingu në heshtje ndërsa makina e burgut e çonte në një zonë të njohur si *Lumi njëzetë e tetë kilometërsh*, ku ndodhej kampi i punës. Ishte

mirënjohëse për çfarë kishte bërë me bashkëpunëtorët e saj, por në të njëjtën kohë, ishte në ankth se çfarë do t'u ndodhte atyre tani. Nga dhjetë drejtuesit kryesorë në rrjetin e «shtëpive kisha», të paktën katër prej tyre ajo e dinte që ishin në burg. Përveç saj, xhaxha Foni ishte në burgun e zonës dhe dy drejtues të tjerë u dërguan në një tjetër kamp pune.

Kur mbërritën, Lingut i dhanë një tas me oriz dhe një kuti të vogël me gjërat personale dhe më pas e drejtuan për në qeli.

LUTJA NË BURG, AQ JETËSORE SA EDHE FRYMËMARRJA

«Mirë se erdhe, Ling! Na thanë se po vije!» – e përshëndeti një zë ndërsa dera e qelisë u mbyll. Zbuloi se disa nga besimtarët e grupit të Lingut do të ishin shoqet e qelisë në kamp. Buzëqeshi ndërsa dëgjoi përshëndetjen e tyre të gëzueshme. Ato dukeshin të lumtura për burgosjen e saj, por arsyeja e sigurtë ishte vetëm se do të ishin bashkë në të njëjtën qeli. Ndërsa u përqafuan me njëra-tjetrën dhe pëshpëritën një lutje të shkurtër, Lingu mendonte për ato besimtare të reja që do t'i bashkoheshin grupit.

U caktua në katin e sipërm të një shtrati marinar. Natën e parë, u ngjit për në shtratin e saj dhe filloi të lutej me zë të lartë. «Hej!» – thirri njëra prej grave në qeli. «S'mund të lutesh këtu. Nëse të kapin, do të dënohesh».

«Nuk ka se si të mos e lejosh një të krishterë të lutet. Do të ishte si të mos e lejoje të merrte frymë», – u përgjigj Lingu.

«Epo, kështu është», – tha gruaja. «Dhe jo vetëm kjo, por nuk lejohet as të kesh flokë të gjatë».

Lingu kaloi gishtat përmes flokëve të saj të zinj të gjatë e të mëndafshtë. Nuk mburrej me pamjen e saj, por s'mund ta imagjinonte veten me flokë të shkurtër. Kishte pasur gjithmonë flokë të gjatë, si nëna e saj. Mendonte se sa e shëmtuar do të bëhej po t'i priste. Ndjeu lotët e parë t'i mbushnin sytë ndërsa në heshtje i lutej Perëndisë për këtë. E kuptoi para se ta mbaronte lutjen që ishte kërkesë pa kuptim. Hodhi sytë rreth e rrotull qelisë dhe vuri re që të gjitha gratë kishin flokë të shkurtra, dhe sa keq dukeshin të gjitha!

Jeta në kamp ishte ndryshe nga jeta në burg. Pas javëve të gjata të izolimit, Lingu ishte e gëzuar që po dilte jashtë gjatë ditës.

Ushqimi ishte pak më i mirë aty, por për një periudhë pune tremujore, duhej të punonte pesëmbëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë orë në ditë duke bërë paruke. Mendoi përsëri për ironinë ndërsa fërkonte kokën e rruar. Puna e bërjes së parukeve ishte e lodhshme dhe e vështirë, dhe ishte e zakonshme për punëtorët të villnin nën trysninë e kuotave ditore. Lingu e kishte të vështirë të mendonte për ndonjë gjë tjetër.

Jeta u bë rutinë, ec, ha, puno, fli. Kishte raste që disa punonin edhe gjatë natës nëse ngarkesa ishte e madhe apo nëse nuk kishin plotësuar kuotën e ditës. Për Lingun, sfida më e madhe ishte të gjente kohë për t'u përqendruar te Perëndia dhe lutja në mënyrën që ishte mësuar. Pas kaq shumë vitesh udhëtimi lirshëm nëpër Kinën Qendrore duke predikuar, duke dhënë mësim dhe duke u kujdesur për njerëzit, kjo jetë e re me gjithë rregullat e saj dhe kufizimet ishte një goditje e fortë.

«PERËNDIA KA NJË QËLLIM PËR NE KËTU»

Çdo mëngjes shoqet e qelisë ngriheshin nga shtrati në orën pesë kur binte bilbili, dhe kishin dhjetë minuta kohë për të rregulluar shtratin dhe u rreshtuar në oborr, pesëmbëdhjetë minuta për të ngrënë, dhe gjithë ditën për të punuar në fabrikë. Ndiqnin këtë orar pa pushim shtatë ditë në javë. Për pjesën më të madhe prej tyre, përfshirë edhe Lingun, jeta u bë gjendje e përhershme rraskapitjeje dhe monotonie. Lingu punonte përkrah prostitutave, shitëseve të drogës, hajduteve, rrëmbyeseve dhe të tjerave, që konsideroheshin «mbeturinat e shoqërisë». E shteruar prej orëve të gjata të punës, e kishte edhe më të vështirë të lutej natën, sepse kishte shumë nevojë për gjumë.

Megjithatë, pas disa javësh, ndjeu se po e rimerrte veten ndërsa ia dorëzoi situatën Perëndisë. U ndie përsëri e nxitur për të ndarë besimin e saj me besimtare të tjera. «Qëllimi përfundimtar i Perëndisë në çdo situatë është të mësojmë bindjen, apo jo?» – u tha atyre. «Kështu që e di që Perëndia ka një qëllim për ne këtu. Jemi të rrethuara nga kriminele me gojë të ndyrë, që veprojnë në lloj-lloj mënyrash dhe e di që Perëndia dëshiron të mësojmë t'i duam këta njerëz dhe t'u tregojmë dashurinë e Tij. Është e lehtë

të duash ata që janë jashtë, miqtë dhe bashkëpunëtorët tanë, por Perëndia dëshiron të mësojmë t'i duam edhe këta njerëz».

Lingu ishte mirënjohëse për atë grup besimtaresh në gjithë atë kamp të madh pune. Kur njëra prej besimtareve ndihej e shkurajuar, një tjetër i qëndronte pranë për t'i dhënë zemër. Megjithëse ishte e vështirë, pasi s'mund të takoheshin hapur për t'u lutur dhe për të folur, Lingu gjente kohë për t'i inkurajuar gratë kur u lejohej të shkonin në tualet gjatë ditës së punës ose kur qëndronin në radhë për drekë.

Shumë shpejt, aftësitë drejtuese të Lingut u bënë të dukshme për oficerët në kamp ndaj e caktuan si drejtuese të grupit të saj. Kjo ngritje në detyrë i dha asaj më tepër mundësi për të dëshmuar ndërsa ishte në ngarkim të pesëdhjetë grave në fjetoren e saj dhe si mbikëqyrëse e prodhimit për dyqind gra si drejtuese tjera në fabrikën e parukeve. Ndërsa puna ishte sfiduese dhe përleshjet midis të burgosurave ndonjëherë e acaronin, Lingu e kryente detyrën e saj shkëlqyeshëm. Në fakt, fitoi zemrat e disave që ishin nën mbikëqyrjen e saj.

«Pse je këtu?» – e pyesnin disa gra. «Ti je kaq e sjellshme dhe drejtuese kaq e mirë. Mund të kesh një punë të mirë jashtë burgut».

Lingu shfrytëzonte çdo mundësi për të ndarë arsyen e burgosjes së saj dhe, si rezultat i dëshmisë së saj, shumë prej tyre u bënë besimtare në fshehtësi. Megjithëse nuk kishin Bibla, ajo u mësonte vargje nga Shkrimet, këngë dhe si të luteshin. I kujtoheshin Biblat e vëllezërve të moshuar të shkruara me kujdes me shkrim dore dhe përkushtimi i saj për të mësuar pjesë të gjata nga Shkrimi. Tani ishte e kënaqur që i kishte mësuar.

«A MUND TË BESOJË NJË PERSON SI UNË?»

Përgjegjësve të burgut u ra në sy puna e shkëlqyer e Lingut dhe fakti që skuadra e saj ishte më e mira në prodhim dhe dukej të kishte më pak përleshje apo aksidente se skuadrat e tjera. Një ditë, mbikëqyrësja e Lingut, zonja Tao, e ndaloi në korridorin e fabrikës.

«Ling, kam parë dosjen tënde», – tha ajo. «Di për aktivitetet e tua dhe faktin që ke ndikim të madh si drejtuese e krishterë.

Që prej njëmbëdhjetë muajsh të qëndrimit tënd këtu, kam parë punën dhe sjelljen tënde me të burgosurat e tjera, veçanërisht me ato të egrat dhe zemëraket që shkaktojnë lehtë telashe. Dukesh të kesh dhembshuri të madhe për këto të burgosura dhe përsëri nuk sillesh si ato. Pse?»

Lingu u ndie e ngazëllyer ndërsa i tregoi mbikëqyrëses së saj. «Nuk sillem si ato, sepse jam e krishterë dhe ia kam dorëzuar jetën time Jezu Krishtit. Ai është arsyeja pse jetoj dhe që mund t'i dua gjithë këta njerëz të vështirë për t'u dashur.» Lingu mbajti frymën, duke pritur reagimin e zonjës Tao. Thjesht përmendja e fesë mund t'i shtonte më tepër kohë dënimit të saj ose mund të mbyllej në «kuti» në një qeli izolimi. Ajo nuk e dinte nëse kjo ishte thjesht një pyetje për ta vënë në kurth, por për habinë e Lingut, mbikëqyrësja tha: «A mundet një person si unë t'i besojë Jezusit?»

«Sigurisht!» – u përgjigj Lingu. «Por nuk ke frikë ta humbasësh pozitën tënde? A nuk ke frikë se qeveria do të të përjashtojë nga ushtria?»

«A nuk ke frikë ti se mund të të dënoj duke i shtuar vite dënimit tënd, sepse ke folur gjepura?» – ia ktheu zonja Tao sy për sy.

«Për sa kohë që e di se qëndrimi im këtu ka një qëllim, për aq kohë sa të di që ti ke besuar te Jezusi, mund të qëndroj këtu përgjithmonë».

«Të pëlqen të qëndrosh këtu?»

«Jo, aspak», – u përgjigj Lingu. «Por arsyeja pse jam këtu është se Jezusi të do ty. Jeta ime edhe jotja janë dhënë nga Perëndia.»

Zonja Tao pyeti edhe më shumë dhe Lingu iu përgjigj çdo pyetjeje ndërsa ajo i tregonte mbikëqyrëses së saj mirësinë e mrekullueshme të Perëndisë.

Zonja Tao ishte e interesuar, por nuk bindej lehtë, ndaj ato vazhduan bashkëbisedimet e tyre klandestine për shumë muaj. Më në fund, një ditë ajo i tha Lingut: «Edhe nëse besoj, duhet të besoj në fshehtësi. Ka disa të krishterë në lagjen time, por nuk u kam folur asnjëherë. Është e vështirë për shkak të pozitës sime. Ti je e krishtera e parë që kam njohur vërtet».

Lingu vetëm mund të buzëqeshte si përgjigje dhe të lutej në heshtje për zonjën Tao.

Ajo vazhdoi të punonte dhe t'i shërbente Perëndisë në kampin e punës sa mundi, edhe për dy vjet të tjerë, por shëndeti i saj u përkeqësua për shkak të orëve të gjata të punës dhe mungesës së ushqimit. Kishte ditë kur mendonte se edhe për sa kohë mund të duronte. Një ditë dhjetori zonja Tao e thirri në zyrën e saj. Ishte ulur në tavolinën e saj me një pamje të ngrysur në fytyrë, duke mbajtur një fletë letre.

«Çfarë është?» – e pyeti Lingu.

«Më kanë dhënë një rekomandim dënimi për ty dhe më duhet ta firmos», – u përgjigj ajo.

Lingu u habit. Po vriste mendjen për ndonjë incident të kohëve të fundit që mund të kishte shkaktuar rritjen e dënimit. Sigurisht që asgjë nuk i vinte ndër mend, megjithëse dikush mund ta kishte futur në kurth duke u gënjyer oficerëve. Zonja Tao dhe Lingu ishin bërë shoqe, dhe ajo kishte qenë e lirshme të fliste me të për Krishtin. Ndoshta dikush mund t'i ketë dëgjuar të flisnin dhe mund të ketë raportuar.

Ku nuk i shkonte mendja, erdhi në vete ndërsa dëgjoi zonjën Tao të lexonte duke thënë: «... dënimin me një vit».

Lingu ra në dëshpërim. Atëherë zonja Tao ngriti sytë për ta parë dhe u habit nga pamja e trishtuar në fytyrën e saj. «Ling! Më dëgjove?», – tha ajo sikur ta shkundte nga përhumbja. «Të kanë konsideruar si plotësisht të rehabilituar dhe e kanë reduktuar dënimin tënd me një vit!»

Lingu mbeti pa fjalë.

«Mirë pra, duhet të them se kjo është hera e parë që të shoh pa fjalë». Zonja Tao po buzëqeshte tani. «Urime, Ling, do të lirohesh pas tre javësh».

NDRYSHE, SI NATA ME DITËN

Tri javë më vonë, i ftohti i mëngjesit përshkoi trupin e dobët të Lingut ndërsa priste me ankth jashtë kampit në dëborën e trashë ardhjen e xhaxha Fonit. E *rehabilituar* po mendonte ajo. Kjo do të thoshte që nuk ishte kapur duke dhënë mësim apo duke ungjillëzuar të burgosurat e tjera. Do të thoshte, shpresonte ajo, që do ta linin të qetë për ca kohë.

Ishte e emocionuar që po i kthehej përsëri punës së saj ungjillëzuese dhe inkurajimit të anëtarëve të kishës, por e dinte gjithashtu që gjendja e saj fizike nuk ishte si më parë. Kishte shumë gjëra nga jeta e burgut prej të cilave nuk do të shkëputej lehtë. «*Oh, Zot, të lutem më përshtat me jetën jashtë burgut dhe të lutem vazhdo të jesh me motrat që janë ende atje!*»

Pati një takim entuziast e të gëzueshëm me Fonin dhe Shenin kur ata mbërritën me makinën e vogël. Që të mos i fuste në telashe besimtarët e tjerë, ajo i kishte patur të pakta vizitat në burg gjatë dy viteve të fundit. Tani mori vesh që disa prej drejtuesve ishin martuar, anëtarë të tjerë të kishës kishin fëmijë, dhe disa grupe të reja bashkësie kishin filluar.

Sapo makina hyri në trafik, Lingu ndjeu ta përfshinte një valë përzierje në stomak. «*Ja një gjë tjetër që nuk kam bërë për ca kohë*, mendoi ajo, *të udhëtoj me makinë.*» Udhëtimi prej katër orësh ishte i tmerrshëm për Lingun, e mbledhur kruspull në sediljen e pasme duke vuajtur nga përzierja në stomak ndërsa përpiqej të përqendrohej në emocionin e të qenët e lirë.

Ashtu siç e priste, Lingu pati vështirësi të përshtatej me jetën normale. Burgu ishte ndryshe si nata me ditën. Kur ishte në kampin e punës, oficerët nuk lejonin të fikeshin dritat. Tavolinat e prodhimit ishin pothuajse gjithmonë të zëna, dhe madje edhe qelitë ishin të ndriçuara mirë. Udhëheqësia në kishë ishte themeluar mirë pa të, duke e bërë të vështirë për Lingun të rimerrte rolin e saj, veçanërisht sepse ishte grua. U trishtua kur pa se nuk kishte vend për të mes drejtuesve të kishës, por e dinte edhe se i duhej të pushonte dhe të mos merrte shumë përgjegjësi derisa ta merrte veten fizikisht. Ndoshta kjo ishte më e mira për të.

TË GJITHË TË ARRESTUAR

Lingu shkoi në familjen e njërit prej drejtuesve të krishterë. Ata jetonin në një shtëpi të madhe në Kinën Qendrore dhe i dhanë një dhomë në katin e dytë. Drejtuesit kishin vendosur të takoheshin fshehurazi në këtë shtëpi nga nëntëmbëdhjetë deri në njëzetë e tre gusht. Edhe Lingu donte të merrte pjesë, por iu dha një detyrë e rëndësishme në Kinën Perëndimore gjatë javës së takimit. Ajo

dyshonte që drejtuesit po përpiqeshin ta mbanin larg rrezikut, por nuk ishte e sigurt. Mbi tridhjetë drejtues kyç priteshin në këtë takim dhe do të ishte një mundësi e mirë të kontaktonte me lidhjet e vjetra, dhe të ripërtërinte përkushtimin e saj në rolin drejtues. Por nuk ishte e thënë.

E përfundoi detyrën e saj në Kinën Perëndimore në mbrëmjen e 23 gushtit, kur mori një mesazh urgjent. «Ling! Kthehu shpejt», – i thanë. «Të gjithë drejtuesit janë arrestuar, secili prej tyre. Vetëm ti ke mbetur!»

Lingu mbërriti në shtëpi të nesërmen dhe i gjeti besimtarët në panik. Disa prej grave të drejtuesve të kishës ia nxorën zemërimin asaj, duke menduar se në njëfarë mënyre ajo ishte përgjegjëse. Kishte vetëm gjashtë muaj që ishte jashtë burgut, dhe miqtë e saj i thanë se policia po kërkonte edhe atë.

Lingu e mori situatën në kontroll. Në fillim mblodhi të gjithë besimtarët e zonës dhe i dha secilit grup detyrën e ruajtjes së kontaktit me një apo dy prej drejtuesve të arrestuar. Ata duhej të mblidhnin veshje, ushqime e para dhe t'i dërgonin në stacionin e policisë për drejtuesit e «tyre».

Arrestimi pati një ndikim të madh në të gjithë Kinën, sepse pastorët ishin drejtuesit kryesorë në zonat përkatëse. Lajmi i arrestimit të tyre u përçua në botën e jashtme përmes imelit dhe u shpërnda shpejt në të gjithë Kinën nga transmetimi në stacionin e radios të *Zërit të Amerikës*. Lingu kërkoi të koordinonte rrjedhën e informacionit ndërsa njerëz nga mbarë Kina dhe bota filluan të telefononin për të mësuar detajet e fundit. Shumë shpejt familjet e pastorëve iu drejtuan asaj dhe ajo me mirësjellje u përpoq t'i vinte në dijeni sa mundi.

Pas pesë javësh, të gjithë, përveç gjashtë drejtuesve u liruan, por jo para se të paguanin gjoba të kripura (deri në dhjetë mijë jen secili), sigurimi i të cilave ishte përgjegjësi e Lingut. Besimtarët ishin shumë të varfër dhe ishte shumë e vështirë të mblidheshin para për aq shumë drejtues. Por Lingu nuk mposhtej lehtë. Vëllezërit e saj të burgosur vlenin më tepër se çdo shumë parash dhe ajo vazhdoi të kërkonte e të mblidhte fonde derisa më në fund pati mjaftueshëm.

Ishte e rraskapitur dhe ndihej sikur do të shembej prej presionit, por s'mund të pushonte derisa të bënte gjithçka për të ndihmuar në lirimin e gjashtë pastorëve të mbetur, drejtuesit me më tepër ndikim në organizatën e tyre, edhe pse çmimi ishte më i lartë. Tani ajo i druhej ekzekutimit të drejtuesve.

I mbetej vetëm një gjë për të bërë. Telefonoi stacionin e policisë.

«Dua të flas me komisarin, ju lutem!»

«Kush është?» – pyeti nëpunësi i stacionit.

«Më quajnë Ling. Komisari e di se kush jam. Ai po më kërkon».

«Ling, mikja ime e vjetër! Habitem që të dëgjoj» – u dëgjua në linjë zëri i qetë i komisarit. «Nga po më telefonon?»

«S'ka rëndësi. Dua të bisedoj me ju për miqtë e mi që po i mbani në burg».

«Sigurisht, eja në stacion dhe mund të flasim!»

«Jo. Do bie dakord të takohem me ju në hotelin 'Brait Mun'. Duhet të vini vetëm. Do të jem duke ju vëzhguar, dhe nëse dikush vjen me ju, nuk do të takohemi.»

Lingu e dinte që ai do të binte dakord. Nëse jo për gjë tjetër, vetëm kurioziteti do ta çonte atje. Pse do ta ftonte në një takim ungjilltarja që u kishte shpëtuar ndjekjeve të tij muajve të fundit?

«Në rregull. Kur dëshiron të takohemi?»

«Sonte në shtatë», – tha ajo.

Pasi mbylli telefonin, Lingu u takua me një prej vëllezërve, që e dinte se mund t'i besonte. I shpjegoi situatën dhe i kërkoi ta shoqëronte në hotel dhe të priste jashtë. «Nëse nuk dal jashtë, atëherë do ta kuptosh që më kanë arrestuar».

Në 6:50 pasdite, Lingu dhe vëllai në besim qëndruan pranë hotelit, duke parë dhe pritur të fshehur. Panë komisarin; ishte i shoqëruar nga një grup oficerësh. Lingut sa nuk i pushoi zemra; ishte gati të largohej kur vuri re se vetëm komisari hyri në hotel ndërsa oficerët e prisnin jashtë. E takoi në restorant duke hyrë nga dera e pasme e hotelit.

«Ling. Gëzohem që të takoj!» – tha ai përzemërsisht, sikur të ishin vërtet miq të vjetër. «Nuk ke frikë se do të të arrestoj?»

«Nëse do të kisha frikë, nuk do isha këtu, por ja ku jam.»

Të dy porositën dhe Lingu i tregoi kamerierit se do të paguante ajo. Më pas, pa humbur kohë hapi diskutimin: «Çfarë po bën me miqtë e mi? Ke liruar disa prej tyre me anë të gjobave. Nëse dëshiron para, do të t'i jap. Sa do?»

«Më ngadalë, Ling!» – tha komisari. «Nuk kemi ngrënë ende. Përveç kësaj, s'mund të bëj gjë për ta dhe ky është faji yt. Ti e shndërrove këtë në spektakël publik».

Lingu e dinte se ai po përpiqej ta frikësonte dhe refuzoi të zmbrapsej, por donte të provonte taktika të tjera. Folën edhe për dy orë gjatë darkës, gjatë së cilës Lingu nuk ngurroi të deklaronte mbi besimin e saj; shpjegoi se pse ajo dhe pastorët e burgosur ishin aq të dhënë pas ndarjes së mesazhit të Jezu Krishtit. Komisari dëgjoi me respekt, duke parë shqetësimin në sytë e Lingut për miqtë e saj, por ishte e kotë. Refuzoi t'i ofronte ndonjë shpresë që ata të mund të liroheshin.

Lingu kaloi gishtat nëpër flokët e saj të zinj. Më në fund po rriteshin. Iu kujtua lutja e nënës që të ishte një sakrificë dhe solli ndër mend pasazhin nga Shkrimi, që e kishte sjellë deri këtu: «*Të korrat janë të mëdha...punëtorë ka pak...qengja mes ujqve*».

Lingu vriste mendjen nëse ishte koha të kthehej në shkollën e vuajtjes.

PËRSËRI NË SHKOLLË

Kur komisari përfundoi ushqimin, Lingu e kuptoi që ishte koha të largohej. E dinte që oficerët po prisnin jashtë derës së hotelit. Bëri edhe një ofertë të fundit. «Mirë pra, më ke kërkuar mua dhe ja ku jam. Më merr mua dhe lëri miqtë e mi të shkojnë».

Komisioneri tundi kokën dhe buzëqeshi lehtë. «Ling», – tha ai sinqerisht. «Pa dyshim që je një nga gratë më të veçanta që kam takuar ndonjëherë».

Pastaj, pa asnjë fjalë tjetër, u ngrit dhe u largua nga restoranti.

Lingu qëndroi në qetësi për disa minuta, duke e ndier që kishte dështuar. Zemra i ishte rënduar dhe u kthye në shtëpi me një ndjenjë dëshpërimi. E dinte që nuk do të shkonte mirë për bashkëpunëtorët e saj, miqtë e saj që mbetën të arrestuar.

Me kalimin e kohës, mori vesh që dy punëtorë të tjerë të krishterë ishin arrestuar, dhe drejtuesit që ishin ende të burgosur, u ishin kthyer autoriteteve të distrikteve të tyre vendase, ku po torturoheshin ashpër. Dënimet e tyre varionin nga dymbëdhjetë deri në njëzetë e katër muaj punë të rëndë.

Lingu vazhdoi punën e saj me një ndjenjë të thellë vetmie. Ishte ende mjaft e sëmurë nga periudha e fundit e burgimit dhe duke parë që shëndeti i saj po përkeqësohej, shumë prej drejtuesve të tjerë i sugjeronin të mos merrte shumë përgjegjësi. Por ajo refuzonte, duke kujtuar se sa shumë e kishte inkurajuar e ëma dhe sa shumë kishte punuar ajo në mullirin e sojës në mënyrë që Lingu të mund të vazhdonte me shërbesën e saj. E kishte marrë malli për nënën. Kishte vite që nuk e kishte parë, por ishte shumë e rrezikshme t'i bënte ndonjë vizitë tani.

Lingu mbeti gruaja e vetme mes grupit të drejtuesve dhe shpesh e gjente veten duke qarë e vetme në dhomën e saj e duke i kërkuar Perëndisë fuqi për ta përfunduar udhëtimin e saj.

Më 16 prill, ra përsëri telefoni i Lingut. Tridhjetë të krishterë nga grupi i saj ishin rrëmbyer nga një kult fanatik kinez. Ajo i telefonoi «mikut» të saj në stacionin e policisë. Përsëri në punë...

EPILOG

Lingu vazhdon të ketë një jetë të vështirë, por shpërblimet për punën e saj janë të dukshme. Përmes takimeve të saj të «organizuara» me komisarin, Perëndia hapi një derë për të për të folur në emër të padrejtësive të kryera ndaj të krishterëve kinezë në «kishat shtëpi». Por në të njëjtën kohë, kontakti i saj me autoritetet solli më tepër kundërshtime mes të krishterëve. Në përgjigje ndaj kritikave të tyre, Lingu tha: «Ne mund të jemi të krishterë, por jemi ende kinezë dhe ky është ende vendi ynë».

Lingu nuk i kompromentoi kurrë pikëpamjet e saj, nuk u tërhoq nga aktivitetet ungjillëzuese. Nuk ka lejuar as frikën dhe as rrezikun e burgosjes ta pengojë të shfrytëzojë çdo mundësi për t'i mbrojtur me guxim vëllezërit dhe motrat. Ajo mbetet në listën e ruajtjes së qeverisë, por është edhe në listën e ruajtjes së

Perëndisë, dhe Ai e ka mbrojtur në mënyrë të mrekullueshme dhe e ka ruajtur që të mos kthehet përsëri në burg.

Megjithatë Lingu është gati të kthehet nëse bëhet e domosdoshme. «Jam gati të kthehem në shkollë», – thotë ajo. «E di se, nëse Perëndia ka numëruar çdo fije floku në kokën time, Ai do të bëjë vullnetin e Tij në mua, dhe unë do të qëndroj në vullnetin e Tij».

Një tjetër sfidë me të cilën është përballur Lingu ka qenë përkushtimi i saj për të mbetur beqare derisa udhëheqësia e kishës të bëhej e qëndrueshme. Grupi mendonte se do mund të ishte një përkushtim dhjetë vjeçar, dhe Lingu mendonte se do kishte mjaft kohë për t'u martuar më pas. (Ishte vetëm një adoleshente në atë kohë.) Megjithatë, në Kinë është shumë e vështirë për një grua të jetë beqare pas moshës tridhjetë vjeçare.

I është thënë vazhdimisht (madje edhe nga pastorët e «kishave shtëpi» në të cilat ka ndihmuar për t'u formuar) që pozicioni i një gruaje është në shtëpi, të pastrojë, të gatuajë dhe të kujdeset për fëmijët. Lingu nuk e mohon këtë rol jetësor, por gjithashtu e di se Perëndia ka plane të ndryshme nga ato që presim. Ajo i kujton kritikët e saj se, gjatë rritjes fillestare të lëvizjes së «shtëpive kisha», ishin gratë që morën përsipër punën e rrezikshme të ungjillëzimit. Ajo thekson gjithashtu, se ashtu siç janë të vetëdijshëm edhe shumë drejtues të krishterë, dy e treta e grupeve të ungjillëzimit që dërgoheshin në zonat e largëta të Kinës ishin gra.

Vizioni i radhës për Lingun janë Lojërat Olimpike, që do të zhvillohen në Beijing në vitin 2008. Ajo beson se kjo do të jetë mundësi e pabesueshme për «kishat shtëpi» të rriten e të japin fryte.

Le t'i përvishemi punës...

Gledis:

Një jetë në falje

Indi
Nëntor 1981

Ishte ditë e ngrohtë dhe e lagësht kur tridhjetë vjeçarja, Gledis Uedhërhed, mbërriti në distriktin e Majurbhanjit, rreth 170 kilometra në jugperëndim të Kalkutës në shtetin e Orisës, në kufi të Beit të Benegalit. *S'më besohet që jam vërtet këtu*, mendoi ajo ndërsa me gjithë shqisat e saj përpinte çdo tingull e çdo pamje përreth. Aroma e fortë e specave djegës shpërndahej nga dritaret e hapura të shtëpive dhe në dyqane ndihej era e kalbur prej pirgjeve të mbeturinave, kanaleve të ujërave të zeza të pambuluara dhe lopëve të shenjta, që endeshin lirshëm rrugëve.

Ardhja nga kufiri i Pakistanit kishte qenë përvojë besimi për Gledisin ndërsa shoferi i saj mundohej t'i shmangej trafikut, kamionëve dredhues, rikshave (automjet i lehtë e i mbuluar me dy rrota që tërhiqet nga një apo dy persona), taksive, lopëve, biçikletave, dhe një lumi të gjatë njerëzish, që popullonin rrugët si një turmë e çrregullt në kaos. Duke qenë se ishte rritur në një qytet të qetë në Australi, Gledisi u habit vërtet që një kaos i tillë pranohej si pjesë e jetës së përditshme në Indi.

Kishte parë pamjen nga dritarja e hotelit me frikë e nervozizëm, duke mbajtur frymën sa herë ndonjë nënë me fëmijë kalonte në trafikun e tmerrshëm, dhe lutej në heshtje kur shihte gratë të qëndronin në vendin e pasmë të motorit, duke mbajtur fort pakot në vend që të kapeshin pas personit që ngiste. U shpëtonin për fije autobusëve apo kamionëve në rrugët e zëna nga trafiku.

Popullsia e përgjithshme e Indisë ishte rreth një miliard dhe Gledisi mahnitej me numrin e njerëzve, që gjendeshin pothuajse kudo.

Habitej me shumëllojshmërinë e njerëzve që ndodheshin rreth saj në rrugë: fëmijë këmbëzbathur me fytyra të papastra, nëna të veshura me sari me ngjyra me shenjën tradicionale të hinduve në ballë, burra të moshuar me lëkurë si të djegur, secili prej tyre ishte një krijesë e Perëndisë.

Gledisit po i pëlqente shumë çka po përjetonte. Pas dymbëdhjetë vjetësh shkurajimi të vazhdueshëm, po realizonte ëndrrën e saj dhe po i bindej thirrjes së Perëndisë për t'u shërbyer të varfërve në një vend të huaj. Shpesh kishte pyetur veten nëse do të vinte ndonjëherë kjo ditë.

E TËRHEQUR NGA NJË JETË NË SHËRBIM

Gledisi kishte qenë vetëm tetëmbëdhjetë vjeç kur ndoqi një konferencë misioni të krishterë në vendin e saj në Australi dhe aty iu përgjigj thirrjes së Perëndisë për shërbesë në mision. E rritur në një fermë në Kuinsland, kishte dëgjuar shumë predikime në kishë, madje kishte takuar disa misionarë që prindërit e saj i kishin ftuar në shtëpinë e tyre. Çdo të shtunë pasdite nëna e Gledisit i mblidhte të gjithë fëmijët dhe u lexonte tregime nga misionet në Afrikë, Indi, Kinë... Gledisi mahnitej nga tregimet emocionuese të jetës në vendet e largëta dhe e admironte përkushtimin e misionarëve.

Me këtë prejardhje të bazuar fort në punën misionare, Gledisi nuk duhej të ishte habitur që konferenca e misionit do ta ndikonte aq thellë, por ja që u habit. Nuk kishte dyshim në mendjen e saj që Perëndia po e tërhiqte drejt një jete shërbimi në një vend të huaj; e kuptoi kur ndjeu diçka ndryshe në zemër. Po fillonte të kuptonte arsyen pse misionarët kishin një pasion të tillë për punën e tyre.

Gjatë të njëzetave, Gledisi mori çdo vendim në bazë të përkushtimit të saj për të qenë misionare. Përfundoi trajnimin si infermiere, një zgjedhje e qartë për një punëtore në një vend të huaj, dhe bëri më të mirën për të mbajtur larg çdo të dashur të mundshëm, nëse nuk kishte të njëjtën thirrje për të punuar jashtë vendit. Kjo pjesë ishte e vështirë, por Gledisi e dinte që Perëndia nuk do të donte që ajo të përfshihej në një marrëdhënie nëse kjo do të thoshte të humbiste fokusin. Ishte shumë e mirë në punën e saj dhe fitoi një pozitë drejtimi në një klinikë të vogël. Jepte

mësim edhe në shkollën e së dielës dhe ndihmonte në kishë sa herë që kishte mundësi.

Entuziazmohej veçanërisht sa herë që ndonjë punonjëse humanitare e krishterë vizitonte bashkësinë e tyre të vogël, përpinte çdo fjalë të prezantimit ndërsa imagjinonte se si do të ishte për të një ditë. Pyeste veten nëse do t'i duhej të fliste ndonjëherë në publik; kjo pjesë e të qenët misionare më tepër se emocionuese, ishte e frikshme. Jo se Gledisi ishte shumë e ndrojtur, por thjesht sepse besonte se Perëndia nuk i kishte dhënë atë lloj dhuntie. *Do të kënaqem duke treguar dashurinë e Perëndisë në mënyrë praktike me aftësitë e mia si infermiere,* thoshte ajo me vete.

Në vitin 1980-të, Gledisi ishte njëzetë e nëntë vjeç, kohë kur dhe nisi të mendonte më ethshëm për realizimin e ëndrrës e saj. Thellë në zemër, e kishte sigurinë se Perëndia ishte në kontroll dhe se të gjitha gjërat ndodhin në kohën e Tij. Por në mendje i përlesheshin mendime kontradiktore dhe luftonte me një dilemë të brendshme për të marrë një drejtim tjetër e të martohej. Nuk ishte më e vogël dhe në dëshmitë e tyre, shumë prej misionarëve thoshin se si Perëndia i kishte dërguar në fushën e misionit në fillim të të njëzetave apo madje edhe më herët. Ndërkohë shumë prej kolegëve të Gledisit po martoheshin dhe bëheshin me fëmijë; duke i parë të kënaqeshin në familjet e tyre në rritje, i bëhej edhe më e vështirë të mbahej pas ëndrrës së saj për t'u shërbyer të varfërve në një vend të huaj.

Më vonë atë vit, ajo takoi Majk Hein, një punëtor në Operacion Mobilizimin. Ai kishte qenë i aktivizuar në misionin në Indi për rreth dy vjet dhe asaj i bëri menjëherë përshtypje entuziazmi i tij. E shtyrë edhe nga shqetësimi i saj, ajo e mbyti me pyetje rreth punës së OM-s në Indi: «Si janë njerëzit atje? A mund të predikosh pa problem? Sa të hapur janë? Si vepron OM-ja? Ku e gjen mbështetjen financiare?»

Majku buzëqeshi, duke ndier entuziazmin e vajzës të rritej ndërsa u përgjigjej me durim të gjitha pyetjeve të saj.

Ndoshta kjo është, mendoi Gledis. *Ndoshta kjo është përgjigja e gjithë viteve të mia të pritjes!* Në javët që pasuan, lexoi çdo gjë që mund të gjente rreth Operacion Mobilizimit. Mësoi se

kërkohej një përkushtim dyvjeçar dhe se çdo person duhej të kërkonte drejtimin e Perëndisë për vendin ku duhej të shërbente. Ndërsa vazhdoi të kuptonte natyrën e OM-s dhe nivelin e thellë të përkushtimit të punëtorëve dhe të drejtuesve të tij, e kuptoi që ishte organizata e duhur për të. Ndjeu një paqe të brendshme dhe vendosi të përfshihej me OM-n.

Në maj të vitit 1981, ajo u bë gati për t'u larguar nga Australia për herë të parë në jetën e saj. Nuk e kishte fare idenë ku do të punonte për periudhën dyvjeçare, por u largua për ta kaluar verën në Evropë për orientim dhe trajnim. Zemrën e kishte plot pritje të ethshme ndërsa përshëndeti familjen dhe miqtë. Ideja për të punuar në Indi iu ngulit në mendje me kujtimin nga takimi me misionarin entuziast Majk Hej, por donte të qëndronte plotësisht e hapur ndaj planit të Perëndisë. Para largimit, familja u mblodh rreth saj dhe kënduan një prej himneve të tyre të preferuar, «Sepse Ai Jeton».

«Unë mund të përballem me të nesërmen», – u tha Gledisi kur kënga përfundoi, «Sepse e di që Ai mban të ardhmen».

Vera në Evropë ishte një përvojë e vërtetë mësimi për Gledisin dhe ajo e përpiu të tërën me të njëjtin shpirt përkushtimi, që e kishte çuar atje. Fjetja në dyshemetë e ftohta, dush një herë në javë, pastrimi i tualeteve dhe fjetoreve, shërbimi ndaj popullit aziatik në Angli dhe kërkimi i drejtimit të Perëndisë se ku duhej të shkonte pas mbarimit të verës ishin të gjitha pjesë të trajnimit për fushën e misionit në një vend të huaj. Gledisi përballej me çdo sfidë me një ndjenjë këmbëngulëse qëllimi ndërsa vazhdonte të ëndërronte për Indinë. Nuk dinte shumë për këtë vend apo për njerëzit atje, por kurioziteti dhe dëshira që rritej brenda saj nuk e linin të qetë.

Në përfundim të sesionit të verës, ndërsa ishte duke ngrënë së bashku me një çift që kishin koordinuar skuadrat e shërbesës në Angli, ata pyetën se ku do të shkonte për programin afatgjatë.

Gledisi shpjegoi se kishte aplikuar për shërbesën në anije të OM-s dhe gjithashtu në skuadrat në Indi. «Në këtë pikë nuk jam plotësisht e sigurt se në cilin drejtim të shkoj», – tha ajo. «Thjesht dua të shkoj atje ku Perëndia mund të më përdorë më shumë».

«Gledis, ti je më e madhe», – tha gruaja me butësi. Ajo ngriti kokën kur e quajtën «të madhe». Vërtet mund ta kishte filluar punën e saj në një vend të huaj më vonë se të tjerët, por ishte ende vetëm tridhjetë vjeç. Duke e parë se sa e habitur dukej, gruaja buzëqeshi dhe nxitoi të shpjegohej. «Jo, jo. Nuk je e madhe në moshë. Thjesht je më e madhe dhe më e pjekur se pjesa më e madhe e punëtorëve të rinj në OM. Ke pasur më shumë trajnime për Biblën dhe udhëheqjen si edhe shumë përvojë në jetë. India ka nevojë për njerëz si ti».

Gledisi buzëqeshi dhe falënderoi Perëndinë për fjalët, urtësinë dhe inkurajimin e gruas. Ishte në thelb e njëjta këshillë që i kishte dhënë Majk Heji dhe tani ndjeu sigurinë dhe konfirmimin, gjë për të cilën ishte lutur. I erdhën ndër mend fjalët e këngës që ishin bërë tema e jetës: «E di që Ai mban të ardhmen dhe jeta tash ka vlerë, sepse Ai jeton».

SHTËPIA E LEBROZËVE

Ishte rrugës për në stacionin e parë të OM-s në Kutak, Indi, kur shoferi kërkoi të shkonin diku tjetër në fillim. E shpërqendruar nga turmat e pafund të burrave, grave, dhe fëmijëve që mbushnin rrugët e zëna, ajo nuk e kishte dëgjuar shoferin derisa ai tha: «... në shtëpinë e lebrozëve në Majurbhanj. Nuk e ke problem, apo jo Gledis? Nuk do të vonohemi shumë atje».

Në shtëpinë e lebrozëve, shoferi u takua me një punonjës të gjatë e të pashëm australian të quajtur Graham Steins. Ajo kishte dëgjuar për australianë të tjerë që punonin në këtë zonë, por nuk dinte asnjë prej emrave të tyre. Grahami e shoqëroi Gledisin në shtëpinë e misionit, ku ajo priti vetëm ndërsa të dy burrat vazhduan punën e tyre.

Duke vështruar rreth e qark pa një librushkë për punonjësen e parë të shtëpisë, Keit Alenbaj. Gledisi u mahnit nga historia intriguese e shtëpisë. Vuri re se shtëpia njëkatëshe shtatëdhjetëvjeçare të krijonte një ndjenjë paqeje. Çdo pjesë saj e tregonte qartë vjetërsinë, që nga dyshemetë e ftohta prej betoni, deri te muret dyzetë e pesë centimetra të gjerë të mbuluar me disa shtresa gëlqereje e veranda e gjerë, që siguronte hije nga nxehtësia e papërballueshme.

Ndërsa priste, Gledisi u çudit pse gruaja e Grahamit nuk kishte dalë për t'i ofruar çaj, duke e ditur tashmë që ishte një traditë indiane. Por nuk u duk askush dhe shumë shpejt ajo dhe shoferi u larguan në drejtim të jugut për në Kutak.

Jeta me skuadrat e OM-s muajt e parë ishte shumë e ngarkuar dhe e mrekullueshme, ndërsa Gledisi përpiqej të mësonte traditat dhe zakonet e vendit. Kishte kaluar gjashtë javët e para në Kutak me një grup bamirësie vendas. Gjashtë gra jetonin në dy dhoma të vogla të mbushura me kuti literaturash të shpërndara gjithandej, ushqimi ishte në ngjyrë të verdhë, uji mbahej në kova dhe sistemi i tualetit nuk ishte tjetër veçse një rrasë çimentoje me një gropë në të. Gledisi falënderonte Perëndinë që ishte rritur në fermë dhe ia dinte vlerën punës, por kishte ditë që shkurajohej ndërsa luftonte të ruante qëndrimin e saj pozitiv «çfarëdo që Perëndia ka për mua».

Çdo ditë dilnin në dyshe dhe përpiqeshin të shisnin libra të krishterë derë më derë e të bisedonin me njerëzit për Zotin. Gledisit i pëlqente t'u bënte vizitë njerëzve në qytet, por zemra e saj dëshironte shumë të shkonte në fshatrat e largët të Santalit, që mbulonin malet në veri dhe perëndim të Baripadas. Kishin kaluar në disa prej këtyre fshatrave gjatë vizitës së parë. Kasollet e drejta me mure prej balte dhe me çati kashte ishin shumë pranë rrugës dhe rrethoheshin me pemë. Një pellg i gërmuar me dorë gjendej në çdo shtëpi fshati.

I kishin treguar për traditat dhe adhurimin e shpirtrave të Santalit dhe se si sakrifikonin, madje edhe njerëz për të kënaqur shpirtrat. Kushtet e tyre të jetesës ishin primitive dhe fëmijët vdisnin në një shkallë alarmuese nga sëmundjet, që ishin lehtësisht të parandalueshme dhe të kurueshme nga standardet moderne. Familjet e Santalit i shpenzonin paratë për të blerë temjan për të djegur dhe kafshë për t'i sakrifikuar në përpjekjen e tyre të kotë për të qetësuar shpirtrat dhe shpëtuar fëmijët.

Si infermiere, Gledisi e dinte që këta njerëz mund të ndihmoheshin me pak edukim bazë, dhe si e krishterë, e dinte që Jezusi mund t'u ofronte shërim të plotë, duke i çliruar nga skllavëria e tmerrshme e shpirtrave. Diçka e fuqishme e pushtoi ndërsa mendonte për gjendjen e tyre të mjerë dhe ndjeu dëshirën

t'i digjte në zemër për të shkuar e për të ndarë lajmin e mirë në këto fshatra.

Në janar të vitit 1982, Gledisit iu krijua një mundësi. Detyra tjetër e skuadrës së saj përfshinte vizita në disa fshatra, ku misionarët merrnin pjesë në «kampet e xhunglës», që organizoheshin nga të krishterët e zonës. Një prej fshatrave që vizituan ishte njëmbëdhjetë kilometra larg pasi kaloje përmes terrenit të ashpër malor, por ajo kishte plot gëzim që ndodheshin atje. Merrte pjesë me entuziazëm në gjithçka: nxirrte ujë nga pusi, lante në lumë dhe flinte mes çimkave. Grave të zonës u pëlqente të qëndronin me infermieren e gjatë bardhoshe dhe i mësonin me shumë dëshirë mënyrën e tyre të thjeshtë të jetesës.

DASHURI PËR MË TË VARFRIT E TË VARFËRVE

Fshati nuk ishte shumë larg nga shtëpia e lebrozëve në Majurbhanj, dhe Gledisi pati disa mundësi për të takuar Grahamin, për të cilin mori vesh që nuk kishte qenë asnjëherë i martuar. Shumica e takimeve kishte të bënte me punët e misionit, por ajo ndjeu që po tërhiqej prej tij... megjithatë u përpoq t'i shmangte ndjenjat e saj dhe të përqendrohej në punë.

Më pas u dërgua në një detyrë tjetër. Gledisi ishte mirënjohëse për mundësinë për të parë shumë nga India ndërsa udhëtonte nga një vend në tjetrin me skuadrat e OM-s, por vizita në shtëpinë e lebrozëve dhe njerëzit e Santalit i kishin lënë mbresa të veçanta. Duke parë mënyrën se si Grahami dhe të tjerët kujdeseshin për pacientët e tyre, për ata që vuanin nga lebra dhe të dëbuarve prej fshatrave, ajo u prek thellë. Hinduizmi i detyronte ata që vuanin nga lebra të besonin se ishin mëkatet nga jetët e mëparshme që u kishin shkaktuar sëmundjen. U ishte thënë se nuk ishin të denjë as t'u jepej një gotë ujë. Si rezultat, ata që vuanin nga lebra jetonin në gjendje të mjerueshme, duke lypur rrugëve dhe u përzënë përfundimisht nga shtëpitë dhe familjet e tyre. Nuk ishte asnjë tjetër më i varfër dhe i poshtëruar sesa ata që vuanin nga lebra dhe askush nuk u ofronte më tepër dashuri se sa Grahami.

Të sëmurëve që vinin në shtëpinë e lebrozëve u jepej mjekimi që ndalonte përparimin e sëmundjes dhe u tregohej dashuri

dhe dhembshuri nga stafi, i cili u mësonte se sëmundja ishte e kurueshme dhe nuk ishte mallkim nga Perëndia. Gledisi mahnitej nga transformimi që shihte në shumë prej pacientëve, thjesht nga një prekje e dhembshur njerëzore dhe fjalë të thëna me dashuri. Mjekimi bënte pjesën e tij për të shëruar plagët, por dhembshuria e stafit u shëronte shpirtin.

Ajo mahnitej nga puna që bëhej në atë shtëpi, por ndonjëherë i vinte në dyshim motivet e saj. A ishte e tërhequr nga Grahami apo nga misioni atje? Megjithëse po vazhdonte të kishte ndjenja për të, e dinte që nuk ishte ai arsyeja që ishte në Indi. Përveç kësaj, nuk e dinte nëse Grahami ndjehej njësoj karshi saj. Po nëse ka të njëjtat ndjenja? – mendonte ajo. Sidoqoftë i duhej të fliste me drejtuesit e OM-s përpara se të fillonte çfarëdo lloj marrëdhënieje. Ky ishte rregulli.

Në fillim të pranverës, Gledisit nuk i duhej të vriste mendjen për synimet e Grahamit. I thanë se ai u kishte kërkuar drejtuesve të OM-s leje për të filluar korrespondencë me të dhe ky fakt e emocionoi shumë! Gjatë pranverës dhe verës e njohën njëri-tjetrin më mirë ndërsa shkëmbenin letra. U habitën kur panë se sa shumë gjëra të përbashkëta kishin. Ishin rritur vetëm gjashtëdhjetë e katër kilometra larg njëri-tjetrit, kishin prejardhje të ngjashme dhe të dy, që në moshë të re ishin thirrur në mision. Sa më shumë që shkëmbenin letra aq më shumë e kuptonin që Perëndia po i bashkonte. U martuan në Australi më 6 gusht të vitit 1983, para një turme të kënaqur familjarësh dhe miqsh.

Në shtëpinë e lebrozëve, të gjithë ishin të kënaqur për Grahamin dhe nusen e tij. «Dada» siç njihej midis vendasve, kishte shërbyer me besnikëri dhe pa u lodhur në Majurbhanj për rreth njëzetë vjet dhe tani Perëndia e kishte shpërblyer me një bashkëshorte të mrekullueshme, që e donte Perëndinë me të njëjtin zell dhe kishte të njëjtin pasion për njerëzit në Indi. Për banorët e fshatit dhe pacientët në shtëpi, martesa e Grahamit dhe Gledisit ishte dëshmi e mahnitshme e dashurisë së Perëndisë dhe të gjithë prisnin me padurim kthimin e çiftit Steins nga Australia.

Por nuk do të ishte aq e lehtë. Gledisi dhe Grahami do të përballeshin me sprovën e tyre të parë si çift kur qeveria indiane

refuzoi t'i jepte Gledisit një vizë të re. Dukej e pashpjegueshme, por zyrtarët thjesht refuzuan ta lejonin të kthehej. Më në fund vendosën që Grahami të kthehej pa të dhe të përpiqej për vizë kur të ishte vetë në Indi.

U deshën disa muaj dhe shumë lutje para se qeveria të binte dakord të lejonte Gledisin të bashkohej me Grahamin, por përsëri, i dhanë vizë vetëm si bashkëshortja e Grahamit dhe jo si punonjëse e huaj. I duhej të premtonte të mos ndryshonte dhe as të përpiqej të kthente hinduistët në krishterim. Ajo ra dakord. Sidoqoftë, Gledisi dhe Grahami e dinin që s'mund ta detyronin dikë të pranonte Krishtin. Qëllimi i tyre kryesor ishte të tregonin dashurinë e Perëndisë duke punuar mes pacientëve lebrozë dhe nëse këta zgjidhnin t'i përgjigjeshin kësaj dashurie, atëherë ishte zgjedhja e tyre.

DËSHIRAT E ZEMRËS

Gledisi u kthye më në fund në Baripada në fund të 1984-ës për t'u bashkuar me Grahamin, i cili ishte i lehtësuar dhe mirënjohës. E emocionuar që ishte sërish pranë bashkëshortit të saj, shumë shpejt Gledisi u vendos në rolin e saj të ri si grua dhe zonjë shtëpie. E merrte shumë malli të shkonte në fshatra siç kishte bërë më parë, por e pranoi rolin e ri me të njëjtin qëndrim të shkujdesur, që i kishte lehtësuar përballjen me shumë sfida në të shkuarën.

Kishte si moto vargun nga Shkrimi që varej në murin e shtëpisë së bukur njëkatëshe të misionit të vjetër «Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës tënde».[1] I pëlqente të punonte në shtëpinë e re dhe të ndihmonte me pacientët lebrozë. I pëlqenin veçanërisht udhëtimet që ajo dhe Grahami bënin herë pas here për të vizituar kishat në Santal, ku mund të merrte pjesë në shërbesën e së dielës dhe të inkurajonte gratë.

Në vitin 1985, Gledisi dhe Grahami pritën fëmijën e tyre të parë, Ester Xhoin, që u pasua nga dy vëllezër, Filipi në vitin 1988 dhe Timoteu në vitin 1992. Gledisi ndihej rehat të kujdesej për familjen e saj të vogël dhe zbuloi që kjo gjë i dha mundësinë të shërbente në fusha të reja ndërsa fëmijët rriteshin dhe luanin me fëmijët e tjerë në komunitet.

T'IA DORËZOSH ÇDO GJË PERËNDISË

Gjatë viteve 1990-të, Gledisi dhe Grahami vazhduan të punonin me besnikëri midis të sëmurëve lebrozë dhe komuniteteve të Santalit. Ajo pëlqente t'i çonte fëmijët e saj në fshatra për të luajtur me fëmijët santalë dhe ata donin të «shkonin» me babin e tyre në kampe të ndryshme të xhunglës, konferenca vjetore pesëditore të organizuar nga pastorët vendas. Grahami merrte pjesë për të ndihmuar pastorët me mësimdhënie dhe predikime.

Të dy bashkëshortët e dinin se shumë prej fshatarëve të Santalit përballeshin vazhdimisht me persekutimin për shkak të besimit të tyre të krishterë. Ata përpiqeshin të tregoheshin të ndjeshëm ndaj nevojave të fshatarëve dhe luteshin për urtësi. Grahami nuk shkoi asnjëherë në fshat për të kthyer apo për të bindur dikë për të ndryshuar besim. Ai mbështeste pastorët vendas dhe kishat që kishte themeluar Perëndia. Megjithatë, të krishterët santalas përballeshin me kundërshtime dhe shpesh akuzoheshin që ishin kthyer në besimin e krishterë, sepse detyroheshin apo sepse pranonin para nga të huajt.

Një djalë dymbëdhjetëvjeçar u sulmua, sepse ishte i krishterë. Kur u ngjit në një pemë në kërkim të gjedhit të tij, djem të tjerë nga fshatrat, të tërbuar që ai ishte bërë i krishterë, e kishin rrethuar pemën dhe nuk e kishin lejuar të zbriste. Pasi e kishin ngacmuar dhe e tallur për besimin e tij, i kishin ngulur një shkop në ijë derisa vdiq. E ëma, e cila ishte vejushë, u shkatërrua plotësisht nga dhimbja.

Një grup hinduistësh qëlluan me gurë dhe më pas mbytën në ujë një tjetër djalë të ri për shkak të besimit të tij. Përveç sulmeve fizike, të krishterëve u duhej të duronin shqetësimet e përditshme nga vendasit. Prona e tyre ndonjëherë vidhej apo dhunohej, ose ndaloheshin të punonin tokën apo të merrnin ujë nga pusi i fshatit. Çdo vit vinin raporte persekutimesh, por Gledisi dhe Grahami ende nuk kishin marrë ndonjë kërcënim dhe nuk ishin shqetësuar ndonjëherë se mund të bëheshin shënjestër nga fanatikët. Gledisi arsyetonte: «Ne u shërbejmë njerëzve me lebër. Sa kërcënuese është kjo?»

Një mëngjes të qetë të enjten, në janar të vitit 1999, Gledisi po kënaqej në kohën e saj të qetë duke lexuar pjesën e caktuar

për atë ditë. Historia që po lexonte atë ditë ishte për një vajzë dymbëdhjetëvjeçare, që po humbiste shikimin. Kur pastori i kësaj vajze erdhi për t'i bërë vizitë në spital, ajo i tha: «Pastor, Perëndia po më merr shikimin».

Për pak kohë ai qëndroi në heshtje dhe më pas i tha: «Xhesi, mos e lër të ta marrë!»

Vajza u habit dhe më pas pastori i urtë vazhdoi. «Dorëzoja Atij», – tha ai.

Historia e preku Gledisin në mënyrë të veçantë dhe ndjeu që Zoti po e pyeste nëse ishte gati të jepte gjithçka që donte, bashkëshortin e saj, fëmijët, gjithçka që kishte për Të. Ndërsa zemra luftonte me këtë pyetje, lotët i rrodhën faqeve. Ia kishte dhënë zemrën Krishtit kur kishte qenë vetëm trembëdhjetë vjeç dhe që nga ajo ditë ishte përpjekur të jetonte vetëm për Të. Nuk kishte mbajtur asgjë kur erdhi në Indi dhe së bashku me Grahamin kishin dhënë jetën në shërbesë. Ajo mendoi se i kishte dhënë Perëndisë gjithçka, por në zemër e dinte që tundimi i saj ishte të mbahej fort te gjërat dhe njerëzit që donte më shumë.

Më në fund u lut, duke i dhënë Perëndisë përgjigjen që Ai meritonte. «Po, Zot Jezus! Po, dua. Merr gjithçka që kam për t'u përdorur për Ty, bashkëshortin tim, fëmijët e mi dhe gjithçka që kam. Të dorëzoj gjithçka». Ndërsa tha *amen*, ndjeu ngushëllimin e Frymës së Shenjtë që e rrethoi dhe e nxiti i erdhi ndër mend historia e Abrahamit që i ofroi Perëndisë djalin e tij, Isakun. Ajo nuk e dinte ç'e priste familjen e saj, por ishte e sigurt që Perëndia do të ishte me ta.

Javën që pasoi, Grahami do të shkonte në fshatin e Mnoharpurit për të marrë pjesë në një tjetër kamp në xhungël. Ishte veçanërisht i emocionuar që do të merrte Filipin dhjetëvjeçar dhe Timoteun gjashtëvjeçar me vete, dhe djemtë ishin po aq të emocionuar. U pëlqente shumë të shkonin në kampe. Ishte si aventurë të qëndronin në xhip pa energji elektrike apo ujë të rrjedhshëm. Por, më tepër atyre u pëlqente të kalonin kohë me t'atin. Pushimet e Krishtlindjes kishin qenë të ngarkuara nga një fluks i vazhdueshëm vizitorësh, dhe Gledisi e dinte që ishte e nevojshme për djemtë të kalonin kohë vetëm për vetëm me

Grahamin. Udhëtimi me makinë prej katër orësh do t'u jepte mundësi për të biseduar.

Trembëdhjetëvjeçarja Ester kishte dy shoqe nga shkolla me konvikt që do të vinin për vizitë, kështu që ishte e kënaqur të qëndronte në shtëpi dhe të çlodhej me shoqet dhe mamin.

Të mërkurën më 20 janar, Gledisi po nxitonte, duke u përpjekur t'i organizonte të gjithë dhe t'i përcillte. «Fil, mbarove me paketimin?» – i tha djalit më të madh. Ai ishte shumë praktik, si i ati, dhe aq i mirë, gjithmonë i ndjeshëm ndaj të tjerëve. Gledisi ishte krenare për mënyrën se si tregonte dashuri ndaj të gjithëve. Nuk mund ta besonte që për dy muaj ai do të mbushte njëmbëdhjetë vjeç. Ishin gjithmonë aq të zënë saqë kishte ditë, kur u dukej sikur jeta e fëmijëve po u kalonte rrëmbimthi pa iu gëzuar plotësisht.

«Djema, gati për të ikur», – tha Grahami. Gledisi shoqëroi djemtë për te xhipi ku po i priste i ati. I puthi dhe i përqafoi e më pas bëri të njëjtën gjë me Grahamin. Gjithmonë përshëndeteshin, sepse nuk i dihej se ç'mund të ndodhte, veçanërisht në trafikun e çmendur indian. Gledisi e dinte që Timi mund të ishte pak nervoz gjatë udhëtimit për shkak të një aksidenti që kishte pësuar nëntorin e kaluar. Një makinë e kishte flakur tej dhe, edhe pse nuk ishte lënduar rëndë, ishte tronditur. Më pas, vetëm disa javë më parë, e kishte parë veten keq ndërsa një kamion i madh i ishte afruar shumë afër xhipit në një rrugicë mali. Gledisi e kuptonte shqetësimin e Timit për udhëtimin me makinë dhe u përpoq ta siguronte përpara se të largohej.

«Kalofshi shumë mirë! Shihemi të hënën», – tha ajo ndërsa ata largoheshin.

Kur u kthye në shtëpi u kujtua se nuk e kishte kontrolluar çantën e Filit. *Shpresoj të jetë kujtuar të ketë marrë xhaketën,* mendoi ajo me keqardhje.

Pastaj mendja i vajti te Timi. Ai vuante nga një ftohje ndaj ajo i kishte pajisur me disa veshje shtesë për të, duke e ditur se sa ftohtë mund të bëhej në male. Buzëqeshi duke shpresuar që ai nuk do ta mundonte shumë zërin duke kënduar. Ai ishte këngëtari dhe predikuesi i shtëpisë. I pëlqente të predikonte si i ati dhe kishte

raste kur e ëma e gjente duke rregulluar karriget në dhomën e ndenjies e duke luajtur kishash. Megjithëse kishte pak kohë që nuk e kishte luajtur më këtë lojë, të hënën, ndërsa kalonte për në dhomën e ndenjies, ajo e gjeti duke predikuar e duke kënduar me kënaqësi para karrigeve bosh të rreshtuara për bashkësinë e tij imagjinare.

Kishte dashur të ulej për ta dëgjuar sapo të mbaronte atë çka kishte nëpër duar, por kur ishte kthyer, ai kishte filluar një aktivitet tjetër.

Ajo nuk kishte si ta dinte që do të ishte hera e fundit që Timi do të luante kishash.

Telefoni ra në katër e gjysmë të mëngjesit të shtunën më 23 janar. U ngrit duke u penguar nga shtrati nëpër errësirë dhe e hapi telefonin përgjumësh. Dëgjonte ndërsa përpiqej të përmbahej nga frika, që i përshkoi shpinën si një shigjetë e akullt. Esteri dhe shoqet e saj u zgjuan prej telefonit dhe u shfaqën në prag të derës kur Gledisi e mbylli.

«Mami, ç'po ndodh?» – pyeti Esteri.

«Dikush ka djegur xhipin e misionit», – iu përgjigj Gledisi. «Nuk di asgjë tjetër, kështu që le të përpiqemi të mos shqetësohemi. Do të lutemi dhe pastaj ju vajza përpiquni të flini. Jam e sigurt që gjithçka do të shkojë mirë, e dini që do të kemi një ditë të ngarkuar përpara. Do t'ua bëj të ditura detajet kur t'i marr vesh».

Por kur të vinin këto detaje, do të ishin më të tmerrshme se ç'mund të kishte imagjinuar ndonjëherë Gledisi...

ZEMËRIM I PAPËRMBAJTSHËM

Fshati i vogël i Manoharpurit prej kohësh ishte ndarë nga ana kulturore. Gjatë viteve, 22 nga afërsisht 150 familjet e fshatit janë kthyer në krishterim. Pjesën më të madhe të kohës, dy grupet kanë jetuar në bashkekzistencë paqësore, por kohët e fundit ky fis ishte i irrituar shumë me të krishterët.

Në verën e vitit 1998 tensioni shpërtheu kur disa fermerë të krishterë zemëruan njerëzit e fisit duke vazhduar të punonin tokën gjatë festivalit të Raxhas, kohë kur santalasit besojnë se toka pastrohet. Shkëmbimet e nxehta midis të krishterëve dhe

santalasve tradicionalë në fakt ishin qetësuar, por ndjenjat mbetën të tensionuara. Vetëm disa javë para kampit të xhunglës në të cilin Grahami dhe djemtë e tij morën pjesë, kishte ndodhur një incident tjetër, shkak i të cilit kishte qenë muzika e krishterë santalase e luajtur në dasmat e krishtera të fshatit. Fisi njihej si ruajtës i zellshëm i traditave, kështu që kjo ndarje kulturore nxiti anëtarët më tradicionalë duke shkaktuar zemërimin e tyre të papërmbajtshëm.

Ardhja e Grahamit në fshat u dha santalasve të zemëruar mundësinë që kishin pritur. Tani mund të hakmerreshin ndaj atyre që shkonin kundër zakoneve tradicionale. Kështu kërkuan ndihmën e Dara Singut, një aktivist social dhe fetar i zellshëm, mjeshtër në shpërthimin e incidenteve sociale. Aktivizimi i tij merrte zakonisht formën e dhunës ndërsa u kundërvihej si të krishterëve, edhe myslimanëve.

Në orët e hershme të mëngjesit të 23 janarit, aktivizimi i tij ogurzi arriti kulmin, shkallën më të lartë të tërbimit.

Një mbrëmje më parë, Grahami dhe djemtë sapo kishin përfunduar së ngrëni dhe po përshëndesnin bashkëpunëtorët e tyre. Ishte pothuajse nëntë e gjysmë kur treshja u ngjesh në pjesën e pasme të xhipit dhe ra për të fjetur. Ajri i natës ishte i ftohtë, kështu që Grahami kishte vendosur dyshekë kashte sipër automjetit për t'i mbajtur ngrohtë. Përpiqej gjithmonë t'i rehatonte djemtë sa më mirë të mundej dhe gjithnjë luteshin para se të shtrihej pranë tyre.

Xhipi ishte parkuar para sallës së lutjes, pranë një xhipi tjetër të njërit prej miqve të Grahamit, doktor Goshit, i cili po flinte në shtëpinë e një familjeje të krishterë, aty pranë. Rreth mesnatës, i zgjuar nga të bërtiturat dhe ulërimat, kërceu nga shtrati dhe shkoi drejt dritares. U tmerrua kur pa një turmë të madhe që vraponte nëpër fusha, burra të pajisur me sëpata, shkopinj, thika, dhe elektrikë dore ndërsa ishin rreshtuar duke u drejtuar dy xhipave. Duke ulëritur me zemërim, ata sulmuan si të çmendur xhipin e Grahamit, duke i çarë gomat dhe thyer dritaret. Rrahën njerëzit në automjet dhe shtinë me armë ndërsa Grahami përpiqej më kot të mbronte dy djemtë e tij të çmuar.

Doktor Goshi vrapoi drejt derës, por kuptoi që e kishin bllokuar nga jashtë. I zënë në kurth, vetëm mund të shihte në agoni ndërsa ngjarja e tmerrshme ndodhte para syve të tij.

Turma e çmendur nuk tregoi aspak mëshirë për Grahamin dhe djemtë. Nuk kishte shpëtim nga masakra brutale. Ata kishin vendosur edhe një numër rojash në çdo kasolle rreth kompleksit për të ndaluar ndonjë person të ndihmonte viktimat dhe u ulërinin fshatarëve të pafuqishëm: «Mos dilni, përndryshe do t'ju vrasim edhe ju!»

Hasda, bashkëpunëtori i Grahamit, për më tepër se njëzetë vjet, thërriste në agoni që sulmi i egër të ndalonte. Ai shihte i tmerruar ndërsa sulmuesit vendosën kashtë poshtë xhipit; Dara Sing ishte i pari që vuri zjarrin. Kur Hasda hyri për t'u përpjekur të shuante flakët me ujë, u rrah barbarisht. Turma e pamëshirshme qëndronte dhe shihte ndërsa Grahami, Filipi dhe Timoteu ulërinin në agoni derisa flakët u dhanë fund thirrjeve të tyre dhe i kthyen trupat në hi.

Ndërsa dhuna po shpërthente, vetëm njëqind metra më tutje një grup të rinjsh santalas kërcenin një valle tradicionale Dangri me rrahjen ritmike të daulleve, duke u sjellë sikur asgjë e jashtëzakonshme nuk po ndodhte.

Pas një ore, turma u zhduk në fusha. Hasda me të shpejtë, duke qenë se po ndiqej më parë nga turma, kishte shkuar te kryetari i fshatit për ndihmë. Një lajmëtar u dërgua për të informuar policinë njëzetë e katër kilometra larg në një fshat tjetër, por ishte tepër vonë. Kur Hasda u kthye në vend, u përpi nga trishtimi ndërsa dalloi skeletin e djegur të xhipit të Grahamit. Brenda mund të shihte qartë tre trupat e djegur të mbledhur së bashku në një përqafim të fundit. Ky imazh do t'i mbetej në kujtesë gjatë gjithë jetës.

Ndërsa të krishterët e tmerruar dolën nga kasollet e tyre dhe u mblodhën në skenën rrëqethëse, qëndruan të tronditur në heshtje për një moment. Të gjithë në zemër bënin të njëjtën pyetje. *Si do t'ia tregojnë Gledisit dhe Esterit?*

DALLGË DHIMBJEJE

Në orën shtatë Gledisi po vishej dhe po përgatitej për një ditë tjetër të ngarkuar kur ra zilja e telefonit për herë të dytë atë mëngjes. Ishte një reporter, që pyeste për moshën e Grahamit dhe të djemve.

«Për çfarë po flisni?» – pyeti Gledisi.

Duke e kuptuar që ajo nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur dhe duke mos dashur të ishte ai që t'ia tregonte, reporteri u përshëndet dhe e mbylli. Telefoni vazhdoi të bjerë, sikurse edhe pyetjet nga njerëzit në fshatrat fqinj. «Gledis, thonë se Grahami dhe djemtë nuk gjenden», – i tha një shoqe.

«Nuk gjenden? O Perëndia im!» – thirri ajo. «Çfarë po u ndodh djemve të mi të çmuar? Janë atje jashtë vetëm?»

Më në fund shoqja e saj Gjathri e mori përsipër telefonin, por gjërat u përkeqësuan edhe më. Gledisi nuk po kuptonte çfarë kishte ndodhur. Zemra e saj ishte e trazuar, ndërsa priste që Grahami dhe djemtë të hynin në derë nga çasti në çast. Ajo e largoi nga mendja mundësinë që të mund të kishte ndodhur ndonjë gjë e keqe, dhe qëndroi optimiste që ata do të vinin në shtëpi së shpejti.

Gjatë dy orëve që pasuan, miqtë filluan të vinin dhe më tepër reporterë donin të nxirrnin fotografi. Gjendeshin shumë njerëz atje, brenda, jashtë, në verandë, kudo. Gjithçka ishte kaotike dhe Gledisi ishte e zënë duke përshëndetur vizitorët dhe duke u kujdesur për Esterin. Ajo nuk e kuptonte ende çfarë kishte ndodhur, dhe askush nuk dinte si t'ia jepte lajmin e tmerrshëm.

Më në fund, rreth orës nëntë e tridhjetë, Gjathri i mori dorën dhe i tha: «Gledis, duhet të flas me ty». Duke zbrazur një prej dhomave dhe duke tërhequr brenda Gledisin, ajo i tha: «Nuk dua që të bëhesh gur, por duhet të jesh e fortë për Esterin».

Gledisi e dëgjoi lajmin me mosbesim. Mendja e saj donte ta mohonte të vërtetën e atyre fjalëve, por ato u thanë e s'mund të ktheheshin pas. *Jo!* Ulërinte ajo. *S'mund të jetë e vërtetë! S'mund të kenë qenë në xhip. Është bërë ndonjë gabim. S'mund të kenë qenë, s'mund të jenë djegur të gjallë. Si mund të ndodhte diçka e tillë? Kush mund të gjente guximin për ta bërë një veprim kaq të ligë?*

Një valë trishtimi kërcënonte ta përpinte, por Gledisi duhej

ta pyeste edhe një herë shoqen e saj. Ndoshta gabohej. Ndoshta lajmi ishte i gabuar...

«Gjathri... do të thuash se kanë... vdekur? Grahami, Filipi dhe Timoteu kanë shkuar?»

Sytë e vajtueshëm të Gjathrit i thanë se nuk ishte bërë asnjë gabim, dhe Gledisi u ul e mposhtur. «Si do t'ia them Esterit?» – vajtonte ajo.

Koha ndaloi, por jeta vazhdonte. Minutat që pasuan kaluan në mjerim të heshtur ndërsa Gledisi përgatitej për ta ndarë lajmin e tmerrshëm me Esterin. Telefoni po binte, njerëzit po telefononin nga Australia për të ditur çfarë kishte ndodhur. Miq dhe fqinj erdhën në shtëpi për të marrë pjesë në vajtim, blicet e aparateve fotografike të reporterëve vazhdonin, por Gledisi e kishte mendjen vetëm te vajza e saj.

«Mami, çfarë ka?» – pyeti Esteri.

Gledisi ia mori dorën së bijës në të sajat duke e vështruar në sytë e saj të pafajshëm. «Duket sikur na kanë lënë vetëm», – i tha ajo me butësi së bijës. Më pas, shtoi: «Por ne do t'i falim».

«Po, mami, do t'i falim».

Esteri e humbi vështrimin në hapësirë ndërsa tronditja e mbërtheu. Gledisi e shtëngonte fort dhe përpiqej të kuptonte ligësinë e veprimit që kishte ndryshuar jetët e tyre kaq shpejt dhe në mënyrë aq dramatike. Emocionalisht ishte e mpirë prej realitetit të situatës, por rrjedha e vazhdueshme e aktivitetit e ndihmoi ta mbante veten. Më në fund mjekët e zonës iu afruan dhe i thanë me zë të ulët: «Ata duan të dinë çfarë të bëjnë me trupat».

Kjo deklaratë fshiu çdo dyshim që kishte, që e gjithë kjo mund të ishte një gabim i tmerrshëm.

«Sillini në Baripada. Grahami dha jetën e tij për këtë vend. Ai do të donte të varrosej këtu», – tha ajo.

Gjatë javës që pasoi, ajo u mor me vizitorët, reporterët dhe zyrtarët e qytetit. Më në fund bashkëpunëtorët e Grahamit mbërritën nga Manoharpuri dhe detajet e sulmit të tmerrshëm u sqaruan. Gledisi mësoi se disa prej fshatarëve kishin dëshmuar se kishin parë një rreze të madhe drite nga larg, që vinte nga mjeti që digjej. Mësoi gjithashtu për tmerrin e të krishterëve në kampin

e vogël ndërsa i ndaluan të ndihmonin, dhe për guximin e mikut të tyre, Hasdas, që ishte përpjekur të shuante zjarrin.

Gradualisht kuptoi se ky nuk kishte qenë një incident i rastësishëm i shkaktuar nga fshatarë të dehur apo të zemëruar. Në fakt, ishte pjesë e një komploti më të madh për t'i dhënë një goditje përfundimtare komunitetit të krishterë dhe komplotuesit kishin zgjedhur Grahamin si shënjestrën e tyre.

I gjori Hasda nuk ishte në vete nga pikëllimi. Prindërit e tij kishin qenë banorë të shtëpisë së lebrozëve dhe Hasda kishte lindur atje. Gledisi e dinte sa i donte ai Grahamin dhe djemtë, ndaj edhe i dhimbsej shumë.

ATË, FALI ATA...

Funerali u zhvillua të hënën në mëngjes në orën dhjetë, në të njëjtën orë që Grahami dhe djemtë do të ktheheshin në shtëpi nga kampi i xhunglës. Tre arkivolet mbërritën, të mbuluar me lule dhe shumë shpejt u duk sikur e gjithë Baripada kishte ndalur. Dyqanet dhe shkollat ishin mbyllur dhe shumë zyrtarë të qytetit erdhën për të treguar respektin e tyre ndaj Grahamit dhe djemve. Gledisi dhe Esteri habitën turmën prej afërsisht një mijë të ftuarish duke zgjedhur të uleshin në bar me banorët e shtëpisë së lebrozëve, që ishin mbushur me pikëllim për humbjen e «Dadas» së tyre. Shërbesa tradicionale indiane dukej se ishte organizuar në mënyrë hyjnore ndërsa pjesëmarrësit ndanin spontanisht vargje nga Shkrimi dhe jepnin ngushëllimet e tyre. Gledisi u nxit për të thënë disa fjalë, por nuk ishte përgatitur të qëndronte dhe t'i fliste turmës masive. Në vend të kësaj, i kërkoi Esterit: «A je në gjendje të ngrihesh e të këndosh me mua?»

Esteri ra dakord dhe turma qëndroi në heshtje ndërsa Gledisi dhe vajza e saj u drejtuan për nga platforma. Atje kënduan këngën që e kishte mbajtur Gledisin me shpresë për kaq shumë vite.

«Sepse Ai jeton kam fuqi për nesër...» Pavarësisht sigurisë kur po këndonte himnin me Esterin, në të vërtetë ajo me mendje po këndonte, *Sepse Ai jeton kam fuqi për sot*. E vërteta ishte se të ardhmen do ta përballte çdo çast, dhe kjo do t'i mjaftonte për ta

kaluar gjithë këtë, dhe vërtet, jeta e saj u bë dëshmi e një besimi të palëkundur në mes të tragjedisë. Megjithëse ishte plot pikëllim dhe emocionalisht e shteruar, thellë brenda vetes, ajo ishte në paqe dhe donte t'i tregonte botës se ishte e nderuar që bashkëshorti dhe fëmijët e saj ishin martirizuar për Krishtin.

Në një deklaratë për shtypin, e guximshmja Esteri tha: «Jam falënderuese që Perëndia i lejoi të vuanin për hir të Tij» dhe Gledisi e përkrahu ndjenjën e Esterit me deklaratën e saj: «Lutem vërtet, 'Atë fali ata, sepse nuk e dinë se ç'bëjnë'. Dhe besoj se çdo gjë bashkëvepron për mirë për ata që e duan Perëndinë, ata që janë thirrur sipas qëllimit të Tij. Sigurisht, përmes këtij incidenti, Perëndia do të kryejë qëllimin e Tij të përsosur. Lëvduar qoftë emri i Tij!»[2]

Shumë miq dhe familjarë e nxisnin të mblidhte plaçkat dhe të nisej me Esterin te të afërmit në Australi. Ata mendonin se puna në shtëpinë e lebrozëve do të ndërpritej nëse Gledisi nuk gjente dikë tjetër për të zënë vendin e Grahamit. I bënin gjithashtu një mal me pyetje: «A do t'i kthesh trupat në Australi? Çfarë do të bëni tani ti dhe Esteri? Po shtëpia e lebrozëve?»

Ajo habitej me hamendësimet e tyre. India ishte shtëpia e saj dhe nuk e konsideroi asnjëherë largimin. Kur reporterët e pyesnin për të ardhmen, ajo përgjigjej: «Perëndia im është në kontroll të të gjithë situatave dhe rrethanave. Ai do të bëjë vetëm të mirën. Ai është fuqia dhe qëndresa ime. Ka premtuar që nuk do të më lërë dhe nuk do të më braktisë.[3] Unë do të shërbej në Indi me këtë shpresë».

FALJA SJELL SHËRIM

Dy muaj më vonë, Gledisi u përgatit për të pranuar çmimin indo-australian për nder të Grahamit. U kërkua të fliste gjatë ceremonisë dhe më tepër se treqind njerëz kishin mbushur auditorin e vogël pas lajmit se Gledisi do të ishte atje. Ishte hera e parë që kishte rënë dakord të fliste në publik që kur Grahami dhe djemtë u martirizuan. Një numër i madh oficerësh policie ishin të pranishëm për mbrojtjen e Gledisit.

Ndërsa përgatitej t'i drejtohej turmës, ajo u ul në heshtje duke

lexuar poemën e vjetër nga Eni Xhonson Flint që i kishte dhënë forcë kohët e fundit:

Hiri i Tij shtohet kur barra jonë rritet
Ai na fuqizon kur mundimet na rëndojnë
Kur vuajtjet shtohen, Ai derdh bekime
Ndaj sprovave të shumta Ai paqen shumëfishon.

Dashuria dhe Mirësia Tij nuk shterojnë,
Fuqia e Tij s'ka kufi njerëzorë
Prej pasurisë së pafundme në Jezusin
Ai na jep e na jep me bollëk.

Ajo përfundoi vargun e fundit ndërsa drejtuesi i ceremonisë mbylli prezantimin e saj.

Gledisi iu afrua platformës dhe filloi të tregonte dhembshurinë e Grahamit. «Nëse dikush ishte sëmurë, ai ishte atje», – tha ajo. «Pavarësisht kohës, natën vonë apo herët në mëngjes, s'kishte rëndësi. Grahamit nuk i duhej të mendonte çfarë të bënte për dikë në nevojë. Ai thjesht vepronte».

Ajo përfundoi me përshtypjet e saj dhe pranoi çmimin, e më pas u ftua të qëndronte për darkë. S'mbeti askush pa e përshëndetur; të gjithë donin ta përshëndesnin vejushën e guximshme që nuk kishte asnjë fjalë të keqe për të thënë ndaj atyre që i kishin vrarë pa mëshirë bashkëshortin dhe dy djemtë. Ndërsa qëndronin në pritje për darkën, një grua i tha Gledisit: «Nuk e kuptoj se si mund të falësh».

Pa menduar Gledisi iu përgjigj: «Duhet të falësh. Falja sjell shërim».

Ajo nuk e kishte kuptuar të vërtetën e fjalëve derisa i shprehu me zë të lartë. I kishte falur vrasësit e bashkëshortit dhe të djemve që në çastin që kishte dëgjuar për lajmin e tmerrshëm. Por falja i kishte sjellë shërim dhe që në atë moment vendosi se cili do të ishte mesazhi tjetër.

Ftesa të panumërta për të folur nisën t'i vinin dhe kur pranonte, ajo fliste gjithmonë për faljen. Në çdo prezantim thoshte: «Dashuria duhet të jetë e sinqertë. Duhet të nderojmë njëri-tjetrin si na thonë

Romakëve 12: 'Bekoni ata që ju persekutojnë; bekoni dhe mos mallkoni! Gëzohuni me ata që gëzojnë dhe qani me ata që qajnë! Kini të njëjtat mendime; mos lakmoni për lart, por rrini me të përulurit; mos e mbani veten për të mençur! Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe. Kërkoni të bëni mirë para të gjithë njerëzve! Po të jetë e mundur dhe aq sa varet nga ju, jetoni në paqe me gjithë njerëzit.'» [4]

Që prej prezantimit të saj të parë publik në ceremoninë e çmimeve, Gledisi është ftuar në shumë shkolla, kisha dhe ngjarje publike, ne raste duke folur edhe në gjashtë takime rresht brenda një kohe prej tridhjetë e gjashtë orësh. Sot mesazhi i saj bindës shërben si kujtim i vazhdueshëm për një komb, ku sulmet e dhunshme ndaj të krishterëve po shtohen, dhe askush s'mund të jetë më i përshtatshëm se Gledis Steines për ta ndarë këtë mesazh.

EPILOG

Gledisi jeton ende në Shtëpinë e Lebrozëve në Majurbhanj, por ka udhëtuar rreth e qark globit duke folur për persekutimet në Indi dhe duke ndarë mesazhin e saj të faljes. Shteti i Indisë është tronditur nga dëshmia dhe mesazhi i dashurisë së Krishtit që vjen nga një lajmëtar i pazakontë: një e huaj.., vejushë.., një grua e thjeshtë, qëllimi i vetëm i së cilës është shërbimi ndaj të varfërve dhe të mjerëve.

Fatkeqësisht u desh vrasja brutale e një perëndimori dhe dy djemve të tij të çmuar për të tërhequr vëmendjen e kombit. Por Gledisi ka shërbyer me besnikëri si lajmëtarja e Perëndisë, duke vërtetuar se Ai bën që «të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për mirë për ata që e duan Perëndinë». [5] Si rezultat i mesazheve të saj, Gledisi ka marrë mijëra letra nga njerëz nga mbarë India, madje edhe hinduistë, duke kërkuar ndjesë për krimin e tmerrshëm ndaj familjes së saj.

Ajo ka mësuar fuqinë e faljes, dhe e di që ky mbetet një mesazh kyç edhe për të gjithë të krishterët në kishë. Gjatë një konference për gra, ku Gledisi do të ishte folëse, i thanë se një burrë nëntëdhjetë vjeçar po e priste jashtë, duke këmbëngulur ta takonte këtë grua që mundi t'i falte ata, që i vranë familjen. Kur më në fund arriti të fliste me Gledisin, i tregoi se si vajza e tij kishte

vdekur shumë vite më parë për shkak të një neglizhimi mjekësor dhe ai nuk kishte qenë kurrë në gjendje ta falte mjekun. Gledisi qëndroi me të për ca kohë, duke e drejtuar në lutje për falje.

Një vit pas sulmit, Dara Singh dhe katërmbëdhjetë të tjerë u arrestuan dhe u akuzuan për vrasjen e Grahamit, Filipit dhe Timote Steinsit. Në qershor të vitit 2002, Gledisit i kërkuan të dëshmonte gjatë gjyqit dhe u përball me sfidën më të vështirë që nga vrasja e bashkëshortit dhe djemve: me përgjegjësit. Ishte testimi i saj për një falje të vazhdueshme.

Avokati i Singhut, duke shpallur pafajësinë e klientit të tij, përpiqej të diskreditonte Grahamin ndërsa deklaroi se ai i kishte vënë vetë flakën xhipit me anë të një sobe gatimi. Ndërsa avokati vazhdonte të fliste, Gledisi vështronte Dara Singhun duke këqyrur në zemrën e vet. I kërkoi Perëndisë ta ndihmonte të tregonte dashuri dhe dhembshuri dhe të mos e shihte me urrejtje. Në kohën kur ky libër u nis për botim, gjyqi ishte ende në proces.

E takuam Gledisin dhe Esterin në Kalkutë, dhe, para se të ndaheshim, ajo na tregoi për një poemë tjetër që kishte shërbyer si një inkurajim i madh që nga vdekja e bashkëshortit dhe djemve. E shkruar nga Edgar Gest, titullohet «I sigurt në shtëpi».

Jam në shtëpi në Parajsë, të dashur
Oh, sa lumturi dhe sa shkëlqim!
Sa gëzim dhe bukuri të përsosur
Në këtë dritë të pambarim!

E gjithë dhimbja dhe pikëllimi shkuan
Ka kaluar çdo shqetësim e farsë
Tani jam përjetësisht në paqe
Më në fund në shtëpi në parajsë.

A pyetët veten nëse qetësisht
Kam ecur në luginën e hijes?
Oh! Dashuria e Jezusit ndriçoi
Çdo shteg të errët të vdekjes.

Ai erdhi Vetë për të më takuar
Në atë rrugë rëndshëm të vështirë
I mbështetur në krahët e Jezusit
Si mund të kisha frikë apo dyshim?

Ndaj, s'keni pse vajtoni kaq fort
Sepse ju dua pa dyshim shtrenjtë:
Ndalni të shihni përtej hijeve të tokës
Lutuni t'i besoni t'Atit vullnet.

Ka akoma shumë për të bërë
Prandaj duhet të mos qëndroni kot
Bëjeni ndërsa keni jetë
Që të preheni në Jezusin Zot.

Kur e gjithë puna të jetë kryer
Ai do t'ju ftojë në Shtëpi ngrohtësisht
Oh, çfarë takimi i ngazëllyer,
Oh, sa gëzim kur të t'shoh të vish!

Mai:

Përsëri në Vietnam për të predikuar ungjillin

Vietnam
Nëntor 1989

Ndihej aroma e oqeanit, megjithëse s'mund ta shihnin ende. Mai ndiqte vëllanë e madh, Hongun, pothuajse në çdo hap përgjatë rrugicës së ngushtë. Edhe një kodër tjetër për t'u ngjitur. Ajri i kripur i shpupuriti flokët dhe i gjallëroi shpirtin. Mai ndjeu gëzimin t'i rritej. Çdo hap e sillte më pranë lirisë!

Më në fund arritën në majë të kodrës dhe ajo pa varkën, një platformë dërrase e palatuar dhe e mbuluar me katran në të cilën varej një trung i vogël bambuje që shërbente si «urë». Të jepte përshtypjen sikur varka do të bëhej copë e çikë me një goditje të vetme. Ndaloi hapat dhe kapi dorën e Hongut që të mos shkonte më tej.

«S'mund të hipi tek ajo gjëja atje!» – i tha ajo, duke i tërhequr krahun derisa ai u kthye nga ajo. «S'mund të shkojmë as deri në mol e jo më deri në Hong Kong!»

«Duhet të shkosh, Mai» – i tha Hongu, duke u kthyer në drejtim të ujit dhe duke e tërhequr pas. Ajo hodhi një vështrim tjetër dhe ndjeu frikën t'i rritej përbrenda. Varka nuk ishte as si një kasolle bambuje, bordi ishte i pastër dhe i sheshtë. Refugjatë të tjerë vietnamezë po ngjiteshin, disa duke vështruar me kujdes pas vetes me ankthin nëse policia kineze do të zgjidhte këtë moment për t'i sulmuar dhe kthyer të gjithë në Vietnam.

«S'mundem, Hong» – mërmëriti ajo. «Unë nuk jam... Nuk jam gati për këtë».

«Ti nuk ishe gati as të kaloje kufirin për në Kinë dhe ia dolëm. Tani eja, duhet të shkojmë. A nuk e di se sa ka sakrifikuar babai për këtë?»

Hongu futi dorën në xhep dhe nxori shaminë e rreckosur. Duke e hapur me kujdes e duke kontrolluar pas, ia tregoi përsëri dy monedhat e arit. Secila peshonte më pak se një gram dhe me secilën do të blinin udhëtimin me varkë për në Hong Kong, bileta e tyre drejt lirisë.

«A e di sa kohë iu desh babait për të kursyer kaq shumë?» – vazhdoi ai. «Ai e ka planifikuar dhe e ka pritur këtë prej vitesh. Nuk ka zgjedhur për ta shijuar as vetë lirinë, për ta blerë për ty. Hip në varkë tani!»

«Ai nuk e bleu për mua. Ishte bileta e Tungut» – u përgjigj Mai me zemërim. Vëllai më i madh i Mait duhej të ishte shoqëruesi i udhëtimit të Hongut. Babai i Mait kishte planifikuar të dërgonte dy djemtë drejt lirisë, duke shpresuar se ata do të përfitonin dhe do të ishin në gjendje të ndihmonin që vëllezërit e motrat e tjerë të largoheshin nga Vietnami.

«Po, ishte bileta e Tungut. Por ti e di që gruaja e tij sapo lindi një foshnjë. Ai s'mund të largohej për momentin, kështu që ti je fatlumja. Do të jesh e lirë në Amerikë apo në Australi. Do të mund të arsimohesh dhe një ditë do të jesh e pasur!»

Ai i mbante dorën Mait, pjesërisht duke e drejtuar e pjesërisht duke e tërhequr drejt varkës.

«Çfarë do përdorim për nevoja personale?» – u ankua ajo. «Nuk ka tualet në atë gjënë».

«Tualeti do të jetë kudo rreth nesh», – tha ai me një të qeshur tallëse. Më në fund ndaloi së ecuri dhe u kthye drejt saj. «Kjo është mundësia jonë Mai,» – i tha. – «Të ikim nga Vietnami, të jemi të lirë, të arsimohemi, të përfitojmë nga puna jonë. Sepse ai bëhej keq sa herë mendonte që fëmijët e tij do ta kalonin jetën në varfëri. Ndaj do të bëhej më keq nëse do të të shihte se po heziton. *Eja* tani!»

Ishin në mol dhe një burrë me pamje të ngrysur u hodhi një sy të dyve duke zgjatur dorën. Hongu e dinte se çfarë donte: copat e arit. Ia vendosi shaminë në duar dhe hapi njërin cep të saj për të treguar monedhat. Kapiteni i vështroi monedhat nga afër dhe provoi njërën me dhëmbë për të parë nëse ishte e vërtetë.

«Hipni» – tha ai nëpër dhëmbë.

Ata vepruan sipas udhëzimit. Sa do të donte Mai ta kishte përqafuar edhe një herë mamanë para se të largoheshin! Ose të kishte biseduar me babanë edhe pak më tepër. Vriste mendjen nëse varka, që më në fund e quajti të tillë, do t'i çonte në vendin ku dëshironin të shkonin dhe iu lut me të shpejtë shpirtit të gjyshit e të stërgjyshit për siguri në udhëtim.

Zgjodhën një vend për të qëndruar larg zhurmës së motorit. Mai nisi të ndihej keq nga ankthi dhe lëvizja e dallgëve para se varka të largohej nga moli. Qau ndërsa pa bregun të zhdukej në horizont.

Ditët në varkë ishin si një ushtrim i vazhdueshëm mërzitjeje dhe Mai e Hongu e kuptuan shpejt që nuk kishin marrë ushqim të mjaftueshëm për udhëtimin e gjatë. Pasi nuk kishin më, iu desh të lypnin ushqim nga disa prej dyzetë e tre pasagjerëve të tjerë. Ditët me zor shtyheshin dhe koha dukej sikur s'kalonte fare.

STUHIA

Mai u shfaq përsëri, duke u përpjekur të dilte në sipërfaqe ndërsa villte ujin e kripur dhe përpiqej të mbushej me frymë. «Ndihmë!» – thirri ajo, duke parë me padurim për Hongun, varkën apo cilindo. Një dallgë tjetër u përplas mbi të dhe ajo u përpoq me dëshpërim të merrte frymë para se koka t'i zhytej përsëri në ujin tërë shkumë.

Kur doli përsëri për ajër, ndjeu një krah rreth saj. «Noto drejt bregut» – i thirri një zë burri në vesh. Mai e njohu si njërin prej të arratisurve që largohej nga vendlindja e tij me varkën shkatarraqe. Notuan së bashku. Ajo kthente kokën pas nga dallgët që vinin, duke thirrur dhe duke paralajmëruar sa herë që vinte drejt tyre. Ai i mbante sytë të fokusuar drejt bregut.

Më në fund mund të preknin tokën me këmbë; ecën disa hapa dhe pastaj ranë të rraskapitur në rërë. Edhe të tjerët nga varka po mblidheshin në plazh duke u dridhur prej erës së fortë që vinte prej detit. Rrobat e lagura u ngjitën pas rërës. Mai thirri e lehtësuar kur gjeti Hongun dhe të dy u përqafuan. Në stuhi nuk kishte asnjë mënyrë për të ndezur zjarr, kështu që u mblodhën së bashku, duke u përpjekur më kot të ngroheshin me padurim që dielli të lindte.

Mai po mendonte për kthesën tronditëse që po merrte jeta e saj. Disa ditë më parë ishte një nxënëse shtatëmbëdhjetë vjeçare

në veri të Vietnamit, që jetonte e lumtur me babanë dhe nënën e saj në një shtëpi me çati me tjegulla të kuqe afër kufirit kinez. Tani ishte e mbledhur kruspull në një plazh të rrahur nga era në Kinë, duke pyetur veten nëse do t'ia dilnin mbanë të shkonin në Hong Kong dhe të ishin të lirë.

Babai i Mait kishte dashur gjithmonë që shtatë fëmijët e tij të kishin jetë më të mirë se të tijën. Mai e kishte dëgjuar aq herë fjalimin e tij për arsimimin saqë mund ta recitonte përmendsh, por fjalimi nuk përfshinte asnjëherë mbytje anijeje...

Mendoi për nënën e saj, që qeshte me ambiciet e të shoqit për fëmijët; ajo mendonte se shkolla ishte humbje kohe dhe parash. Ajo kontrollonte familjen, financat dhe refuzonte t'u jepte fëmijëve para për libra apo për mjete shkollore. Shpesh, babai i Mait shiste ndonjë pulë apo ndonjë kafshë tjetër dhe u jepte ca para fëmijëve për të mbuluar edhe një javë më shumë shkollim. Sa herë që e shoqja e zbulonte se çfarë kishte bërë, shpërthente ndonjë zënkë e tmerrshme, fyerje dhe mallkime ndaj njëri-tjetrit. Fëmijët përpiqeshin të qëndronin jashtë grindjeve. Më e rëndësishmja ishte që vazhdonin të shkonin në shkollë.

Njëri prej vëllezërve më të mëdhenj të Mait ishte larguar nga Vietnami dhe kishte punuar për ca kohë si punëtor në Bullgari. Ai e kishte parë botën jashtë, dhe rrëfimet e tij i shtonin babait dëshirën që fëmijët e tij të largoheshin.

Tani Mai ndodhej jashtë Vietnamit, por jo në vendin që mendonte i ati. Ajo ishte mbledhur kruspull në plazh dhe batanija i kishte humbur diku në detin e shkumëzuar. Stuhia i kishte detyruar të gjithë pasagjerët të notonin për në breg. Kapiteni qëndroi me varkën, duke iu drejtuar valëve dhe duke u përpjekur të dilte prej stuhisë. Pas ca kohësh, që u dukën shekuj, era u qetësua, dhe më në fund doli dielli. Mai s'kishte qenë ndonjëherë aq mirënjohëse për agimin e një dite të re.

Refugjatët ishin mbledhur në plazh derisa kapiteni u tha të ktheheshin në varkë. Notuan për të shkuar përsëri në trenin e tyre pluskues të lirisë. Nuk kishte mbetur gjë në bord nga stuhia. Veshjet, batanijet, ushqimi, enët e tiganët, nuk kishte mbetur asgjë. Mai dhe Hongu shpresonin që nuk do të kishte më stuhi

deri në Hong Kong. Nuk e dinin nëse varka do të lundronte përsëri kur të gjithë pasagjerët të mblidheshin.

Pas dyzetë e dy ditëve të pafundme pasi kishin hipur në varkë, mbërritën në Hong Kong. Por nuk u mirëpritën; policia nuk i lejonte refugjatët të zbarkonin. U dërguan në Ishullin e Lopës, një rrip toke jotërheqës ku fermerët rrisnin lopë. Më në fund Mai, Hongu dhe të tjerët mund të dilnin prej varkës, por ajo çka i priste ishte pothuajse po aq keq sa edhe vendi nga po largoheshin. Pothuajse njëqind varka si e tyrja zbarkonin çdo ditë në Ishullin e Lopës. Grupet e ndihmave humanitare ndanin kanaçe ushqimesh, dhe Mai, e pamësuar me atë lloj ushqimi sëmurej pas çdo vakti.

JETA NË KAMPE

Një javë pasi zbarkuan në Ishullin e Lopës, Mai dhe Hongu u transferuan në kampin e tyre të parë të refugjatëve. Një muaj më vonë, u transferuan përsëri, këtë herë në Kampin Nëntë. Rreth një vit më vonë u dërguan në Kampin Tre.

Me mbërritjen në çdo kamp të ri, duhej të gjenin një vend për të fjetur e për të jetuar. Shumë prej banorëve të kampit ishin territoristë të dhunshëm dhe Mai e Hongu duhej të kishin kujdes për njëri-tjetrin dhe të ruheshin prej atyre që mund t'i sulmonin. Kampi Tre ishte veçanërisht i dhunshëm, një zonë beteje virtuale. Refugjatët nga të njëjtat zona të Vietnamit bashkoheshin kundër atyre të zonave të ndryshme. Çdo gjë në kamp, tulla, llamba elektrike, kabllo, pjesë të shtretërve dhe kangjella të mprehta u bënë armë.

Ndonjëherë betejat vazhdonin për ditë të tëra, me grupe të ndryshme, që përpiqeshin të kontrollonin kampin. Policia e Hong Kongut s'mund t'i kontrollonte kampet, kështu që jeta brenda gardhit sundohej nga anarkia darviniane.

Gjatë betejave, gratë dhe fëmijët fshiheshin, duke u përpjekur të qëndronin larg ndërsa burrat luftonin njëri-tjetrin. Ashtu si disa të tjerë, Mai mblidhej në shtratin e saj pas një dërrase të mbështetur pas ca gurëve, duke shpresuar që luftimi do të përfundonte shpejt. Ashtu si të tjerët, dëshironte shumë të largohej nga kampi dhe të ishte vërtet e lirë.

«PERËNDIA E DESHI AQ BOTËN»

Pas një zënke të ashpër, Hongu dhe Mai u transferuan përsëri në një kamp tjetër, Lang Xhin. Ishte kamp dënimi, i projektuar për të izoluar «telashebërësit» dhe Mai nuk e dinte pse i kishin dërguar atje. Megjithatë ky «dënim» shërbeu pozitivisht. Aty kishte një ndërtesë që shërbente si kishë, edhe pse Mai s'e kishte idenë se çfarë ishte kisha. Por një ditë u ndodh pranë saj dhe vështroi brenda dhomave. Në mur varej një flamur i madh i bardhë dhe në qendër të tij ishte një kryq i kuq. Nën kryq, pa disa fjalë të shkruara në vietnamisht. Vështroi fshehurazi përmes derës për të lexuar fjalët: «Perëndia e deshi aq botën».

E tërhequr nga kureshtja, hyri brenda. Njerëzit në dhomë po këndonin një melodi, që nuk e kishte dëgjuar kurrë më parë. Një burrë ishte në këmbë dhe fliste në vietnamisht, Mai dëgjonte me kujdes. I pëlqeu ajo çka po thoshte zotëria ndërsa përshkruante një Perëndi që kujdesej, i cili në fakt i donte njerëzit në vend që t'i frikësonte apo t'i dominonte. Donte të mësonte më tepër për këtë grup dhe mësimet e tyre të çuditshme, por nuk kishte ndër mend të linte fenë që kishte mësuar prej prindërve. Ajo e shihte Perëndinë si një gjë tjetër që mund ta adhuronte, përveç paraardhësve dhe idhujve të saj.

Pas dy vjetësh e ca në kampet e refugjatëve në Hong Kong, një prej shoqeve të Mait e çoi te një fallxhore. U ul përballë gruas, duke shpresuar që ajo mund t'i tregonte sa shpejt do të dilnin ajo dhe i vëllai nga kampi në një vend të lirë. Gruaja e moshuar e vështroi thellë Main në sy dhe ia mori të dyja duart.

«Ah, po. E shoh tani. Ke një të dashur».

Mai u hutua. «Jo, nuk kam. Nuk kam të dashur».

Fallxhorja dukej e shqetësuar. «Ah», – tha ajo, duke pohuar shpejt me kokë, «Duhet të jetë një i dashur nga jeta jote e shkuar që po të ndjek në këtë jetë».

«Po më ndjek?» – pyeti Mai, duke parë me dyshim nga fallxhorja drejt shoqes së saj. Ajo mendoi se gruaja po i thoshte që një demon po e ndiqte. «Çfarë do ai? Si mund ta detyroj të më lërë të qetë?»

«Duhet të shkosh në shtëpi dhe ta adhurosh. Lutu dhe kërkoji që të të lërë të qetë!»

Nuk ishte hera e parë që Mai akuzohej se kishte një demon. Kur kishte qenë shtatë vjeç, ishte sëmurë rëndë. Temperatura e lartë i sfiliti trupin dhe s'mund të hante e as të pinte. E ëma thirri xhaxhanë e vajzës, një mjek magjistar, për të kryer disa rituale që të largonin shpirtin e lig. Xhaxhai e godiste me shkop, duke thënë se do të largonte shpirtin e lig dhe sëmundjen prej saj. Mai thërriste që dikush ta ndihmonte, por familja e mbante ndërsa rrihej. Atëherë xhaxhai e kapi prej flokësh dhe ia përplasi kokën në skeletin e hekurt të krevatit, duke u përpjekur të largonte demonin prej saj. Ndonjëherë të rrahurat zgjasnin gjithë natën. Mai ulërinte nga dhimbja, por thirrjet e saj në agoni vetëm shtonin përpjekjet e xhaxhait ndërsa thoshte me krenari: «Tani djalli po del prej saj». Kishte edhe një kalë të vogël metali me të cilin i çante lëkurën që të nxirrte djallin prej saj.

Asnjë prej përpjekjeve të tij nuk pati sukses. Mai vazhdonte të ishte e sëmurë. Më në fund i ati e dërgoi në spital. Disa ditë pasi mori mjekimet që i dhanë mjekët, u shërua. Ajo vriste mendjen pse mjekimi ishte më i fuqishëm se një mjek magjistar. Tani pyeste veten nëse fallxhorja po i tregonte të vërtetën. A ishte e mundur që *nderimi* i këtij të «dashuri» ta bindte vërtet demonin ta linte të qetë?

Mai shkoi në një tempull të madh budist në kamp dhe ofroi adhurim ashtu si kishte parë të bënin prindërit e saj. Nuk ishte plotësisht e sigurt në përshkrimin e fallxhores, por nuk kishte kuptim për të të rrezikonte, veçanërisht nëse ky «i dashur» mund ta pengonte të merrte vizën që të shkonte drejt lirisë. Ndezi aromat dhe i kërkoi me mirësjellje shpirtit të largohej dhe ta linte të qetë.

Por, sa më shumë që lutej në altar, aq më pak paqe ndiente. Thellë brenda vetes e dinte që ndjenjat e saj të turbullta nuk kishin të bënin aspak me botën shpirtërore. Mai ndihej si në kurth në kampin e refugjatëve, me padurimin për të dalë. Beteja e vazhdueshme për mbijetesë nuk i ndahej dhe miqësia e saj e natyrshme u venit nga ankthi dhe frika. S'mund ta kuptonte trishtimin që dukej të kishte zënë rrënjë në zemrën e saj. Dëshironte shumë diçka më tepër dhe pyeste veten nëse të shkuarit në një vend të lirë do ta mbushte boshllëkun në jetën e saj.

Të nesërmen e gjeti veten duke shëtitur përsëri pranë kishës. Duke parë shenjën e dashurisë së Perëndisë, pyeti përsëri veten se kush ishte në të vërtetë ky Perëndi dhe pse Ai e «donte aq shumë botën». E donte Ai «aq shumë» edhe atë?

Duke hyrë brenda, u hodhi një sy rafteve të librave dhe tërhoqi librin më të madh që mundi të gjente, duke shpresuar që ai mund t'i tregonte diçka rreth këtij Perëndie të dashurisë. Duke e hapur, lexoi: «Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën...»

Ky është libër historie, mendoi ajo pasi lexoi disa vargje të tjera. E kishte urryer orën e historisë në shkollë, me gjithë ato data, njerëz dhe vende për t'i mbajtur mend. E mbylli me të shpejtë dhe e vendosi përsëri në raft. Duke kaluar gishtat nëpër raft, mori librin më të hollë, një volum i thjeshtë me mbështjellje të bukur lëkure. E hapi dhe pa fillimin, një listë e gjatë emrash, e më pas nisi të lexonte me kujdes. Ishte historia e një çifti të ri, që po prisnin një foshnjë. Por foshnja ishte i veçantë, për shkak të një ylli që shënonte këtë rast dhe dijetarëve të mëdhenj që shkuan për ta mirëpritur atë në këtë botë.

Kush është ky djalë? – pyeste ajo veten. *Kush është Jezusi*?

DUKE VRAPUAR DREJT PERËNDISË QË E DONTE

Atë të diel Mai u kthye në dhomën e takimit, ku predikuesi po fliste për fuqinë e Perëndisë. «Djalli,» – tha pastori, «nuk ka frikë nga asgjë dhe nga asnjë. Përveçse nga një person. Ai ka frikë nga Perëndia. Ku është Perëndia, nuk do të ketë djaj».

Sytë e Mait u hapën me habi. Dyshonte nëse folësi e dinte në njëfarë mënyre për të dashurin nga e shkuara e saj, i cili mendohej se e ndiqte. Mai donte të besonte te Perëndia me të mbaruar predikimi. Nuk donte të kishte të bënte me botën frymore, që i kishte shkaktuar aq shumë frikë dhe dhimbje që në fëmijëri. Donte vetëm paqe.

Kur pastori bëri një thirrje për pendesë në fund të mesazhit, Mai doli përpara. Ajo nuk ishte e sigurt për detajet, por e dinte që donte të adhuronte Perëndinë prej të cilit djajtë largohen, Perëndinë që e donte dhe do ta çlironte.

Që nga ai çast, sa herë që Mai frikësohej, shtrihej zakonisht në shtrat, duke dëgjuar zënkat rreth e qark saj dhe lexonte Dhiatën

e Re e i lutej Perëndisë. Pastori i kishte thënë se djalli kishte frikë kur ajo lexonte Fjalën e Perëndisë, kështu që vazhdonte ta lexonte çdo ditë me besnikëri!

Pjesa më e madhe e njerëzve në kamp shkonin në tempullin budist dhe Mai shkonte me ta, madje edhe pasi kishte dalë përpara kishës dhe ishte lutur. Djajtë mund të kishin frikë kur ajo lexonte Biblën, por mendonte se ishte mirë t'u ofronte sakrifica sido që të ishte puna. Kishte ende idhuj në çadër dhe çdo ditë i lutej Perëndisë së të krishterëve dhe perëndive të saj. Nëse një fe ishte e mirë, mendonte ajo, atëherë dy duhet të ishin edhe më mirë. Të tjerët në kamp bënin të njëjtën gjë, duke zgjedhur dhe marrë pjesët që pëlqenin nga fetë e ndryshme që ofroheshin në kamp.

Kur një të diel, pastori i krishterë foli për të mos pasur dhe ndjekur perëndi të tjera. Ai tha se të krishterët duhej të ndiqnin vetëm një fe dhe të kapeshin pas Perëndisë së vetëm e të vërtetë. Pas shërbesës, Mai u kthye në çadrën e saj dhe i hodhi të gjithë idhujt. Disa nga budistët u përpoqën ta ndalonin, por ajo këmbënguli. Nëse Perëndia donte që ajo të ndiqte vetëm Atë, do të largonte çdo shenjë të fesë së saj të mëparshme.

«VETËM MË PËRDOR»

Një të diel tjetër, shumë shpejt pasi hodhi idhujt, u predikua për vdekjen e Jezusit në kryq, për pagën e Tij për mëkatet tona. Mai shkoi përsëri përpara, duke e kuptuar për herë të parë thellësinë e mëkatit të saj dhe u pendua për të. «Më fal, Perëndi!»- u lut ajo. «Më përdor si të dëshirosh, ku të dëshirosh. Vetëm më përdor».

Megjithëse dinte shumë pak për Biblën apo për mësimet e krishtera, filloi të fliste për të me të gjithë në kamp. Vazhdoi ta lexonte me etje, dhe Fryma e Shenjtë e ndihmoi që të kishte më tepër njohuri. Sa më shumë që mësonte, aq më tepër dëshmonte për Krishtin.

Duke dashur të dinte se në çfarë ishte përfshirë e motra, Hongu shkoi në disa takime të kishës në kamp. Më pas edhe ai e pranoi Krishtin, por përkushtimi i tij nuk ishte aq i thellë sa i Mait. Fokusi i tij ishte liria, dalja nga kampi dhe të shkuarit në një vend ku do të ishte i lirë. Bënte shumë plane në mendjen e tij për të punuar

dhe për të filluar biznese të suksesshme. Hamendësonte se të qenët i krishterë mund ta ndihmonte të merrte më shpejt një vizë për në perëndim.

Në kishë, Mai takoi një djalë më të madh se veten dhe të dy filluan të takoheshin. Edhe ai po priste për të shkuar në perëndim, duke shpresuar të krijonte një biznes e të fitonte shumë shpejt para. Ndërsa marrëdhënia e tyre po thellohej, Mai ndjeu se po u nënshtrohej disa prej interesave të tij. Etja e saj për Shkrimet u venit dhe lutjet shteruan. Mendonte më tepër se si do t'i shpenzonte paratë kur të ishte e lirë dhe lutej vetëm mjaftueshëm sa të ndiente që Jezusi do ta pranonte dhe lejonte në parajsë kur të kthehej.

Lutjet e thella me zemër që dikur i dilnin nga shpirti kishin avulluar. Tani lutej më tepër që Perëndia ta nxirrte nga kampi dhe ta çonte drejt lirisë. Të dy diskutuan për martesë dhe Mai e dëshironte këtë gjë, por mendonte se njëzetë vjeç ishte shumë e re.

Një natë, ndërsa qëndronte e shtrirë në shtrat, dëgjoi një zë. *Nuk do të të lë pas*, i tha zëri. *Kur të vij përsëri, do të të marr me Vete*.

Mai u zgjua dhe pastaj iu duk sikur dëgjoi diçka tjetër: një e qarë me zë të lartë, e mprehtë dhe agonizuese.

A e dëgjove atë të qarë? Fryma e Shenjtë dukej se i fliste drejtpërdrejt zemrës së saj.

«Po» – iu përgjigj Mai. «Çfarë është?»

Është e qara e atyre që kanë mbetur pas. Është e qara e dhimbjes dhe e lëndimit.

«LE TË SHKOJMË... JASHTË KAMPIT»

Të nesërmen në mëngjes, Mai e la mënjanë dembelizmin e saj shpirtëror. Lutjet iu kthyen ethshmërisë së mëparshme dhe ishin më tepër se sa për sukses dhe një biletë për në perëndim. Filloi të lutej për familjen në Vietnam dhe për të krishterët në vendlindjen e saj, që po vuanin për Krishtin.

Një ditë ndërsa po lexonte Biblën, ndaloi te Hebrenjve 13:12-15:

«Prandaj edhe Jezusi, për të shenjtëruar popullin me gjakun e vet, pësoi jashtë derës. Le të dalim, pra, drejt Tij jashtë fushës,

duke mbartur poshtërimin e tij. Sepse nuk kemi këtu qytet të përhershëm, por kërkojmë atë që ka për të ardhur. Me anë të tij, pra, le t'i ofrojmë vazhdimisht Perëndisë një flijim lavdie, domethënë frytin e buzëve që rrëfejnë emrin e tij.»

«Le të dalim drejt Tij, *jashtë fushës*». Fjalët dukej sikur dilnin prej faqes së librit dhe digjnin shpirtin e Mait. Ajo u habit me thirrjen që Perëndia i kishte vendosur në zemër: *Kthehu në Vietnam.*

Ndaje fjalën Time atje. Tregoju atyre që kanë mbetur pas të më thërrasin.

Mai e dinte që t'i shërbeje Krishtit në Vietnam ishte e rrezikshme. E dinte që do të vuante nëse i përgjigjej thirrjes së Perëndisë. Por donte të shkonte. I kishte thënë Perëndisë se do të bënte çdo gjë që Ai t'i kërkonte. Nëse Ai i kërkonte të kthehej në Vietnam, atëherë ishte gati të shkonte.

E njihte edhe thellësinë e errësirës në Vietnam; e kishte parë në familjen e saj. Ndërsa rritej, familja e saj kishte mbajtur në shtëpi një altar vishnje me tre vazo, që digjnin temjan për tre paraardhësit që adhuronin: gjyshi i Mait, stërgjyshi, dhe stër-stër gjyshi. Kur babai i saj të vdiste, familja do ta zëvendësonte enën më të vjetër të temjanit me një të re për të.

Shpirtrat janë kudo, u thuhej vietnamezëve, dhe ashtu si shumica e budistëve atje, familja e Mait përpiqej shumë t'i kënaqte. Thernin një pulë apo gic si sakrificë dhe e ofronin ushqimin mbi altar. Nëpërmjet yshtjeve, ftonin paraardhësit e tyre për të ardhur dhe për të marrë ushqimin, duke shpresuar të fitonin favorin e tyre. Mai dëshironte ta ndante të vërtetën e Perëndisë me familjen e saj dhe me të tjerët, që jetonin në errësirë të tmerrshme në Vietnam.

Herën tjetër që të krishterët u mblodhën për një takim, Mai tha se kishte për të bërë një lajmërim. U ngrit dhe duke buzëqeshur tha: «Kam dëgjuar nga Zoti». Ai më ka folur».

Vështroi rreth e qark dhomës njerëzit që ishin bërë miqtë e saj, pothuajse po aq të afërt si një familje e dytë.

«Perëndia më ka thirrur të kthehem në Vietnam. Ai do që të ndaj dashurinë e Tij me njerëzit atje, t'u tregoj të vërtetën».

Reagimi i shumë prej besimtarëve ishte i menjëhershëm, por jo siç e priste Mai.

«Ky zë është nga *djalli*!» – thirri një burrë.

«Kjo s'mund të jetë nga Perëndia», – tha një grua e moshuar, duke mbyllur Biblën menjëherë. «Perëndia të solli në Hong Kong dhe Perëndia do të të çojë të sigurt drejt lirisë. Ai do të të ndihmojë të kesh sukses në mënyrë që të ndihmosh familjen tënde. Perëndia nuk dëshiron që ti të kthehesh në Vietnam».

«Nëse kthehesh atje, do të vuash», – tha një burrë tjetër. Unë e di. E kam parë. Vuajtja do të të bëjë ta braktisësh Perëndinë. Ai nuk do të të kërkonte *kurrë* të kthehesh atje».

Mai vështroi nga i dashuri i saj, duke shpresuar të shihte një buzëqeshje mbështetje në fytyrën e tij. Por s'kishte as buzëqeshje, as mbështetje. Duke u larguar prej saj, ai doli nga dhoma.

Ndërsa shumë në kishë u përpoqën të flisnin menjëherë me të, i vëllai nuk ishte i kënaqur thjesht duke biseduar për propozimin e saj. Kur ajo i përmendi çështjen, Hongu e qëlloi në fytyrë. «Si mund të pështysh ëndrrën e babait tonë?» – pyeti ai. «Ai ka kursyer prej vitesh që ti të arrish këtu, të arrish në prag të lirisë. Tani do ta flakësh tutje? Do t'u copëtosh zemrën? Mos fol më për t'u kthyer! Asnjë fjalë tjetër!»

Mai pyeste veten se si mund ta trajtonte vëllai i vet në këtë mënyrë dhe si e kritikonin të krishterët e tjerë dëshirën e saj për të ndarë ungjillin. Lutej për urtësi dhe qëndrueshmëri për ta dashur të vëllanë pavarësisht kundërshtimit të tij. Ishte e sigurt për thirrjen e Perëndisë, por lutej që edhe të tjerët do ta kuptonin thirrjen.

Goditjet fizike të Hongut nuk ishin pengesat më të dhimbshme me të cilat u përball. Goditjet më të dhimbshme ishin ato emocionale të marra nga i dashuri i saj.

«Perëndia të nxori nga Vietnami», – i tha ai Mait. – «Pse do të donte të kthehesh atje? S'mund të largohesh!»

Kur s'mundi t'i ndryshonte mendjen, ai u nda me të.

«S'mund të martohem me një grua që heq dorë nga ëndrrat e saj», – i tha ai. – «Perëndia të solli deri këtu dhe, të kthesh shpinën e të largohesh e çnderon Atë dhe familjen tënde».

«Unë kam ëndrra», – iu përgjërua Mai me lot në sy. –

«Tani Perëndia më ka dhënë ëndrra të reja. Ëndërroj t'u tregoj bashkëkombasve të mi për dashurinë e Krishtit. Dua t'u tregoj se nuk duhet të vrasin më kafshë dhe që sakrifica për ta është bërë tashmë!»

«Kemi ëndrra të ndryshme, atëherë», – tha ai me ton të akullt. – «Mes nesh ka marrë fund».

Mai e vështroi teksa largohej, me lotët që i rridhnin faqeve.

Me ushqimin e pakët dhe kushtet e këqija në kamp, shëndeti fizik i Mait po përkeqësohej, por ajo nuk kishte qenë më mirë më parë. Megjithëse i dashuri e la dhe kisha e saj dyshonte tek ajo, Mai ishte e sigurtë mbi atë çfarë duhej të bënte. Perëndia po e thërriste të kthehej në Vietnam.

I VETMI EMËR NË LISTË

Mai la një takim në zyrën e kampit, ku duhej të aplikonte për një udhëtim kthimi për në Vietnam. Një natë para takimit, qëndroi zgjuar me orë të tëra, duke menduar për vendimin e saj. Pyeste veten pse e mbështesnin aq pak veta në kamp. U lut, duke u përkushtuar përsëri se do të shkonte kudo që Ai dëshironte dhe se do të bënte çdo gjë që Ai i kërkonte. U ndje plotësisht në paqe dhe madje, edhe e emocionuar ndërsa mendonte që do t'u tregonte njerëzve në Vietnam për dashurinë e Jezusit.

Më në fund e zuri gjumi dhe në ëndërr pa veten duke u kthyer në Vietnam, por jo vetëm. Një grua dhe një burrë po udhëtonin me të si pjesë e skuadrës. Mai e ndjeu qartë se kjo ishte siguria e Perëndisë që nuk do të kthehej vetëm.

Kur iu afrua zyrës së kampit të nesërmen në mëngjes, nuk kishte dyshim që po merrte vendimin e duhur. Hapi derën dhe shkoi drejt tavolinës.

«Dua të kthehem në Vietnam».

Burri në tavolinë ngriti sytë drejt vizitores së re me një përzierje simpatie dhe hutimi, që e shprehte në fytyrë. «*Dëshiron të kthehesh?*»

«Po».

«Sa kohë ke në Hong Kong?»

«Pothuajse pesë vjet».

«Je afër përfundimit të qëndrimit tënd këtu. Ndoshta brenda pak muajve mund të pajisesh me vizë për të dalë prej këtej, që të mund të shkosh në Amerikë apo Australi. Mos u dorëzo tani!»

«Nuk po dorëzohem», – u përgjigj Mai me vendosmëri. – «Nuk dua më të shkoj në perëndim. Dua të kthehem në vendlindje».

«Nuk ka shumë njerëz me të tillë kërkesë. Për këtë shkak, sapo e kanë ulur pagesën e formularit, sepse askush nuk e plotëson. A e di çfarë do të thotë kjo?»

«E di se çfarë do të thotë», tha Mai e sigurt. «Por Perëndia më ka thirrur që të kthehem».

«*Perëndia* të ka thirrur?» – pyeti ai me kureshtje. «E kuptoj. Mirë, pra, aplikimi yt për vizë do të anulohet dhe dosja jote do tërhiqet. Do të jetë sikur nuk ke qenë asnjëherë këtu.., sikur pesë vitet e fundit nuk kanë ekzistuar».

«E di, por nuk do të shkoj në perëndim».

«Dhe ti e di që qeveria e Vietnamit nuk i mirëpret gjithmonë njerëzit që kthehen»,- tha ai, – «veçanërisht njerëzit që janë arratisur».

«Jam e vetëdijshme për këtë».

Burri e vështroi ngultas për një moment, duke parë fytyrën e gjatë e të ngushtë të Mait. Pastaj iu afrua sirtarit dhe nxori një formular. «Më duhet karta e identitetit të kampit».

Mai ia dorëzoi kartën dhe mori stilolapsin nga dora e tij dhe plotësoi formularin. Një ndjenjë e çuditshme kënaqësie, madje gëzimi, ia mbushi zemrën, dhe nuk ngurroi ndërsa shkroi emrin në letër, duke hequr dorë nga mundësia për të qenë e lirë në perëndim.

Burri nxori një fletë. Në fund të saj ishin fjalët KTHIM NË VIETNAM. Ai shkroi me kujdes emrin e Mait në krye të fletës. Nuk kishte emra të tjerë në listë.

Kur Hongu zbuloi që Mai kishte firmosur formularët e kthimit, e rrahu përsëri.

Një mike e krishterë, zonja Ksujen, tha se Mai ishte e çmendur. Por, kur e pa përsëri të nesërmen, gjithçka kishte ndryshuar. «Ti nuk je e çmendur», – e siguroi ajo Main. «Më vjen keq për ato çka të kam thënë».

«Çfarë ndodhi?» – e pyeti Mai shoqen e saj. – «Dje më the se isha e çmendur që po kthehesha në Vietnam, ndërsa sot të duket vendim plotësisht racional?»

«Zoti më foli mbrëmë», – i tha zonja Ksujen. – «Ai më tha që edhe unë duhej të kthehesha në Vietnam për të ndarë mesazhin e Tij me njerëzit atje».

Zemra e Mait sa nuk u hodh nga gëzimi, kur mori vesh që nuk do ta bënte udhëtimin vetëm. Iu kujtua ëndrra në të cilën një grua kthehej me të. Në ëndërr, ishte edhe një burrë dhe ajo nisi të vriste mendjen se me cilin po punonte Perëndia për t'u kthyer me to.

Zonja Ksujen shkoi në zyrën e kampit dhe plotësoi të njëjtët formularë që kishte plotësuar Mai. Emri i saj ishte i dyti në listë.

Disa ditë më vonë, një anëtar tjetër i kishës së tyre të vogël, zoti Truong, erdhi te Mai dhe i tha se edhe ai e kishe ndjerë thirrjen e Perëndisë për t'u kthyer në Vietnam. «Por është e vështirë të jetosh në Vietnam», – tha ai. – «Si mund të mbijetoj atje dhe t'i shërbej Perëndisë në të njëjtën kohë?»

«Mos u shqetëso», – i tha Mai. «Perëndia do të kujdeset për këtë».

Ndërsa ajo përgatitej për udhëtimin e kthimit, u bë dëshmitare se si Perëndia hapi dyert dhe zgjidhi detajet e udhëtimit. Ishte viti 1994 dhe kishte qëndruar në Hong Kong për pothuajse pesë vjet. Kur anëtarët e kishës u mblodhën për të takuar të tre besimtarët, shumë prej tyre u përpoqën me lot në sy t'i bindnin të qëndronin.

Hongu shoqëroi Main dhe të tjerët drejt portës metalike të kampit të refugjatëve.

«Si mund ta bësh këtë?» – e pyeti përsëri Main. – «I kam shkruar babait dhe i thashë për çmendurinë tënde. Ai nuk do që ti të kthehesh, do që të jesh e lirë. E di se sa telashe do të kesh në Vietnam? Ata nuk i pranojnë të krishterët. Të krishterët persekutohen, arrestohen dhe rrihen, Mai. Nuk është vonë për të ndryshuar mendje».

«E kam mbledhur mendjen», – i tha ajo.

«S'më besohet që të solla këtu», – tha ai me zemërim. -- «Kush të ruajti këta pesë vjet? Kush të mbrojti gjatë përleshjeve në

kampe? Kush sigurohej që ti të kishe pjesën tënde të orizit kur të tjerët donin të ta merrnin? Do të doja të kishte ardhur Tungu me mua në vendin tënd. Ai nuk do të më çnderonte mua dhe babanë tonë ashtu siç po bën ti. Tungu ka respekt. Si munde ta bësh këtë?»

Mai e pa të vëllanë me trishtim. «Mund ta bëj këtë sepse Perëndia më ka thirrur», – tha ajo. – «Ti dëshiron të jesh i lirë, të shkosh në një vend të lirë. Por nuk e sheh që ka gjëra më të rëndësishme se sa liria, politika apo të fitosh para? Kush do t'i tregojë familjes sonë për Jezusin? Kur do t'u tregojë atyre se si të jenë të lirë, se si të shkojnë në qiell? Perëndia më ka kërkuar të veproj kështu dhe unë do bindem. Mund të mos jem kurrë e pasur ashtu si ti, por do të bëj atë që Perëndia më ka kërkuar të bëj. Një ditë, Hong, shpresoj të më kuptosh».

I vëllai e pa i ngrysur ndërsa të tre hipën në një furgon të vogël të bardhë që do t'i çonte në aeroport. Ai nuk e përshëndeti. Të krishterët e tjerë vështronin nga porta, përmes lotëve që u rridhnin faqeve. Mai vështroi pas ndërsa furgoni u largua, duke u përpjekur me dëshpërim të mbante mend çdo fytyrë, me mendimin nëse do t'i shihte më.

PUNË SEKRETE

Pasi avioni zbriti në Vietnam, Mait iu desh ta gjente vetë rrugën nga aeroporti për në shtëpi. Kishte shpresuar për një mikpritje të ngrohtë, por nuk gjeti mikpritje fare. I ati që kishte punuar aq shumë për të siguruar një të ardhme për të, e shpërfilli plotësisht. Nuk i fliste fare. E ëma jo. I bërtiti ashpër duke e pyetur pse i kishte zemëruar shpirtrat e familjes duke mos adhuruar më paraardhësit.

Pavarësisht nga reagimi i fortë i familjes, Mai u përpoq të sillej mirë. Lutej shpesh dhe këndonte këngë adhurimi me zë të ulët në dhomë. Përmes dëshmisë dhe shembullit të saj, shumë shpejt fitoi besimtaren e parë në Vietnam. Pasi e motra e pyeti në fillim për besimin e saj të ri, s'kaloi shumë dhe ajo pranoi Krishtin si Shpëtimtar. Të dyja filluan të luteshin shpesh së bashku dhe Mai nisi të ndante Shkrimin me të.

Por përndjekja nga prindërit vazhdonte dhe Mai po hutohej e iu lëshua zemra. *Mendoja se doje që të kthehesha në Vietnam,* u lut ajo. Si përgjigje ndjeu udhëzimet e Perëndisë: «*Mblidhi delet e mia. Shko në provincën Van Dong!*»

Mai nuk kishte qenë asnjëherë në Van Dong, por kishte dëgjuar që atje kishte të tjerë që kishin gjetur Krishtin në Hong Kong dhe ishin kthyer në Vietnam. Ajo u nis për në këtë zonë, duke u lutur vazhdimisht ndërsa shkonte. Përpiqej të fliste sa më pak që të mundte gjatë udhëtimit. Nuk kishte dokumente që të miratonin udhëtimin e saj dhe kishte frikë se, nëse policia e zbulonte që ishte e krishterë, do ta arrestonin.

Në Van Dong takoi të krishterë të tjerë. Filloi të shkonte fshehurazi në xhungël që policia të mos merrte vesh për takimet e tyre. Mai ndjeu thirrjen e Perëndisë për të kërkuar delet e humbura dhe filloi një projekt më ungjillëzues. Jetonte ende në shtëpi me prindërit e saj, por udhëtonte për në provincë rregullisht për të zhvilluar takime. Shumë shpejt u mboll një kishë e vogël në Van Dong, por ndërsa kisha rritej, shtohej dhe presioni ndaj anëtarëve.

I ati i Mait e dinte për udhëtimet e saj në xhungël me të krishterë të tjerë dhe filloi ta ngarkonte me punë shtëpie, duke e mbajtur shumë të zënë për të mos u përfshirë në kishë. Duke parë se sa me kokëfortësi kapej vajza e tij pas fesë së saj të re, më në fund e ngadalësoi ritmin. E lejonte të ndiqte shërbesat e zakonshme të kishës, por jo të shkonte në takimet e lutjeve, në ndonjë shërbesë të veçantë apo të shoqërohej me besimtarë të tjerë. Kur Mai vazhdonte të shkonte në takime të ndaluara dhe të bënte punën e saj të krishterë, i ati e nxori nga shtëpia. Disa ditë më vonë e lejoi të kthehej, por ky cikël do përsëritej shumë shpesh.

Policia filloi të ruante çdo lëvizje të Mait. Fjala për punën e saj të krishterë ishte përhapur dhe policia nisi të ushtronte presion mbi t'atin e Mait që t'i ndihmonte të ngrinin një akuzë kundër saj. «Ku shkon ajo?» – pyesnin ata vazhdimisht. «Me kë takohet? Çfarë thonë? Pse e lejon vajzën tënde të veprojë kështu?»

Ndërsa muajt kalonin, presioni rritej. Në fakt, autoritetet nuk ishin të kënaqur të vizitonin babanë e Mait në shtëpi. E urdhëruan të shkonte në stacionin e policisë.

«Nëse s'mund ta kontrollosh vajzën tënde», – i thoshin me keqdashje, – «atëherë do ta kontrollojmë ne».

Duke pasur frikë për sigurinë e vet dhe të Mait, ai e urdhëroi shumë herë të qëndronte në shtëpi.

«S'mund të shkosh», – i thoshte i ati. – «A e di ç'do të më bëjnë mua? Ç'do të të bëjnë ty?»

Në fillim, Mai thoshte se do të dilte për të takuar ndonjë shoqe apo se do të punonte me ndonjë projekt punë dore. Ndërsa u bë më e guximshme në dëshminë e saj, u bë edhe më e guximshme me t'atin: «Do të shkoj të bëj punën e Zotit», – i pohonte ajo thjesht.

S'mund ta duronte që i ati ishte kundër saj. Lutjet u bënë edhe më të ethshme. «*Perëndi*», u lut ajo një natë, «*do të bëj çdo gjë për Ty. Jam gati të shkoj edhe në burg për Ty. Madje do të vdisja për Ty, nëse ky është vullneti Yt. Por, të lutem, Perëndi, mos e lejo babanë të më persekutojë. Kjo është më shumë se ç'mund të duroj*».

Por persekutimi nuk ndaloi. Vite më vonë, Mai e kuptoi që Perëndia e kishte përdorur këtë kohë për të përgatitur terrenin. Nëse mund të duronte nën presionin e babait të saj të dashur, atëherë nuk kishte asnjë persekutim që mund ta mbante larg prej punës që Perëndia e kishte thirrur të bënte.

REFUZOI PËRSËRI LIRINË

Mai takoi disa misionarë amerikanë në Vietnam. Kur panë pasionin dhe vendosmërinë e saj, ata i ofruan me bujari që ajo të shkonte në një shkollë biblike në Shtetet e Bashkuara. Ishte mundësi e mrekullueshme. Mai kishte kaluar pesë vjet në Hong Kong në kampin e refugjatëve, duke pritur të shkonte në perëndim. Tani, në Vietnam, po ftohej të shkonte në Amerikë me të gjitha shpenzimet e hequra!

Kur Mai u tregoi prindërve për ofertën, i ati u përgjigj me entuziazëm. «Kjo është mundësi e mrekullueshme», – tha ai. – «Prindërit e tu amerikanë duan të bëjnë të mundur që të shkosh në Amerikë, ku do të kesh lirinë për t'u arsimuar. Ky është lajm i mrekullueshëm! Duhet të shkosh».

Por vizioni i Mait kishte ndryshuar. Ajo rilexoi Hebrenjve 13:12-15, vargjet që Perëndia i kishte përdorur për ta thirrur përsëri në Vietnam. Pasioni i saj për ata «jashtë porte» në vendlindjen e saj nuk ishte zbehur.

«Dua të punoj në Vietnam», – u tha ajo prindërve. – «Perëndia më ka thirrur për të punuar me njerëzit e mi këtu».

«A s'mund të jetë kjo mënyra e Perëndisë tënd për të të ndihmuar?», – pyeti i ati. – «Je e çmendur që po e refuzon!»

Por Mai zgjodhi të qëndronte në Vietnam. Në vend që të shkonte në Shtetet e Bashkuara, ajo vazhdoi një kurs intensiv trajnimi në Saigon. Për të nuk kishte rëndësi se ku e merrte trajnimin dhe ku e mësonte ungjillin; dëshira e saj e vetme ishte t'i shërbente Perëndisë dhe t'i shihte bashkëkombësit e vet të fituar për Të. Misionarët ofruan ndihmë për shpenzimet në Saigon, por Mai refuzoi me mirësjellje. E dinte që Perëndia do t'i mbulonte shpenzimet e saj nëse kursi ishte në planin e Tij.

Për gjashtë muaj ajo qëndroi në një shtëpi në Vietnamin Jugor, për t'u larguar vetëm në rastet e udhëtimeve të misionit për në zonat rurale të vendit. Dialekti i saj verior do të vihej re nëse dilte në rrugët e Saigonit, gjë që mund ta rrezikonte sepse nuk kishte leje për të qenë në jug. Kështu qëndroi në hije për gjashtë muaj rresht, ndonjëherë duke vështruar me mall nga dritarja trafikun, duke dashur të dilte qoftë edhe për një çast dhe të ishte pjesë e jetës, që po jetohej rreth e qark saj. Por qëndroi jashtë saj.

Ditët ishin të gjata, trajnimi ishte intensiv dhe çdo gjë duhej të bëhej në fshehtësi. Kalonin shumë orë në ditë në lutje dhe adhurim, duke studiuar Shkrimet dhe duke marrë trajnim pastoral.

PASION PËR FISET

Në kursin e trajnimit ishte i përfshirë edhe informacioni për njerëzit e fiseve në Vietnam. Mai ishte rritur me mendimin se të gjitha minoritetet etnike në Vietnam ishin të mbrapshta, njerëz të ligj që ndiqnin ritualet fisnore, të cilat drejtoheshin prej supersticioneve hokus-pokus (që kanë si bazë magjinë). Ndërsa u takua me të krishterë që punonin midis njerëzve të fiseve, Perëndia mbolli një pasion në zemrën e saj për t'i parë të shpëtuar për Krishtin.

Vietnami kishte më shumë se pesëdhjetë grupe etnike fisnore të cilët persekutohen ashpër. Për të homogjenizuar kulturën, qeveria kishte quajtur të jashtëligjshme çdo gjë që botohej në ndonjë prej gjuhëve të fiseve: vetëm gjuha vietnameze mund të botohej. Njerëzit e fiseve tallen e shahen dhe përballen me persekutimin, madje edhe para se të pranojnë të ndjekin Krishtin.

Për të arritur këta njerëz, një grup kandidatësh prej gjashtëmbëdhjetë personash që po trajnoheshin për pastorë dilnin me tetë motorë në zonat rurale në malësinë qendrore. Udhëtimet ishin të tmerrshme. Në stinën e thatë, pluhuri ishte aq i dendur saqë ishte e pamundur të shihje më tepër se pesë këmbë përpara motorit. Në stinën e shirave, rrugët bëheshin si copa të lagura xhami. Për të shmangur policinë, grupi udhëtonte kryesisht natën dhe aksidentet ishin të zakonshme. Një herë motori i Mait goditi një qen dhe ajo dhe shoku i saj fluturuan tej. Mai ra me fytyrë, dhe kur erdhi në vete, gjaku i rridhte në fytyrë, supe, gjunjë dhe kokë. Qeni i verdhë ngordhalaq kishte ngordhur.

Vurratat u bënë shenja nderi midis drejtuesve të rinj dhe grupi bënte shaka me «trofetë» e tyre. Vendosnin kripë në plagë që të ndalonin infeksionin, i lidhnin si të mundnin dhe vazhdonin udhëtimin.

«Do të jesh mirë», – i tha njëra nga gratë Mait ndërsa e ndihmoi të pastronte dhe të lidhte plagët pas aksidentit. – «Mban mend se çfarë tha pastori? Nëse nuk keni ndonjë shenjë, nuk jeni gati të bëni punën e krishterë në Vietnam. Mirë, pra Mai, je më shumë se gati tani!»

KRIJESË E RE NË KRISHTIN

Pas gjashtë muajsh trajnimi, Mai u kthye në veri. Punonte për mbjelljen e kishave dhe trajnimin e drejtuesve. Prindërit e saj vazhdonin presionin për të ndërprerë punën. Më në fund, i dëshpëruar, i ati i Mait organizoi një takim për të gjithë familjen, duke përfshirë edhe njerëzit më të largët.

«Çfarë të bëjmë me Main?» – pyeti ai me sy përgjërues që kalonin në dhomë nga një fytyrë te tjetra. – «Ajo vazhdon me këtë besëtytni të huaj. Jemi përpjekur ta bindim të heqë dorë

dhe të kthehet në rrugët e familjes sonë, por nuk bindet. A do të vazhdojmë të merremi me telashet që na sjell, apo do ta dëbojmë nga familja?»

Zemra e Mait u thye ndërsa dëgjonte t'atin të fliste dhe të vështronte fytyrat e të afërmve të mbledhur, njerëz që kishte një jetë që i njihte. Lutej për ta ndërsa flisnin dhe që Perëndia t'i jepte urtësi për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

Dhe pyetje kishte shumë.

Ajo iu përgjigj secilës prej tyre me dashuri dhe durim derisa të gjitha mbaruan. Heshtja u rëndua në dhomë dhe të gjithë e dinin që ishte koha për të marrë një vendim. Mai bëri një kërkesë të fundit, duke vështruar t'atin drejt e në sy. U lut me të shpejtë që Perëndia do t'i jepte fjalët e duhura.

«Babi,» – filloi ajo, – «unë nuk do ta mohoj Jezusin, por nuk do të të mohoj as ty. Ti mund ta mohosh Perëndinë tim, por edhe nëse e bën, Ai do të jetë përsëri Perëndi. Ti mund të më mohosh mua nëse dëshiron, por unë përsëri do të jem vajza jote. Nëse nuk do të më shohësh më, në rregull. Por në zemrën tënde, jam akoma vajza jote. Madje, edhe nëse më nxjerr jashtë dhe refuzon të më njohësh, unë do të të njoh ty. Ti do të jesh gjithmonë babai im dhe unë do të të dua gjithmonë».

Kur votimi përfundoi, Mai u pranua përsëri në familje duke vazhduar shërbesën e saj për Perëndinë. Më vonë atë ditë, i ati e mori mënjanë. «Nëse ke nevojë për një vend për të fjetur», – i tha ai duke u përpjekur ta shmangte emocionin prej zërit të tij, – «je gjithmonë e mirëpritur këtu».

Mai falënderoi Perëndinë që familja e kishte pranuar dhe vazhdoi të lutej me pasion që edhe ata të njihnin Krishtin.

Grupi i misionit me të cilin punonte Mai vazhdonte t'i ofronte trajnim. Për këtë qëllim ajo udhëtonte drejt Saigonit disa herë, për në shkollën e fshehtë të Biblës. Për të shkuar deri në vend i duhej të bënte një udhëtim të gjatë me tren, pastaj me motor dhe në fund të ecte gjatë në këmbë. Mai lutej para çdo udhëtimi dhe sa herë kalonte në ndonjë pikë kontrolli apo stacion policie. Ajo nuk kishte leje qeveritare për të udhëtuar dhe as shpjegim ligjor për vizitën e saj në Saigon. Udhëtimet e gjata me tren i jepnin

shumë kohë për të menduar dhe për t'u lutur, dhe mendimet e saj e çonin shpesh tek i ati. S'mund të bënte gjë tjetër veçse të lutej për shpëtimin e tij, gjë që ajo e bënte me shumë dëshirë.

Gjatë një udhëtimi, Mait i dërguan fjalë të kthehej menjëherë në shtëpi. «Babai yt është shumë sëmurë», – i thanë. – «Është në spital».

Diagnoza ishte një fjalë që mbart frikë dhe trishtim në çdo gjuhë: kancer. Mai shkoi menjëherë pranë shtratit të babait dhe u përkujdes për të ditë e natë. Çfarëdo që dëshironte i ati, ajo ia plotësonte. Gjatë gjithë kohës lutej për të dhe filloi t'i fliste butësisht për besimin e saj. Ajo kalonte orë të tëra duke ia lexuar Biblën me zë të lartë.

Disa nga bashkëpunëtorët e saj vinin për t'i bërë vizitë babait të Mait dhe ai s'mund të mos vinte re kujdesin që tregonin. Tani shqetësohej gjithnjë e më pak për fenë e çuditshme të së bijës dhe më tepër për vetë shpirtin e tij. Kur një pastor, i cili kishte ndihmuar në trajnimin e Mait erdhi për vizitë, qëndroi në dhomë për një kohë të gjatë, duke biseduar me babanë e Mait ndërsa besimtarët e tjerë ishin mbledhur jashtë dhomës duke u lutur për bisedën e tyre. Kur pastori u largua nga dhoma, babai i Mait ishte bërë një krijesë e re në Krishtin. Ai thirri menjëherë të bijën, të krishterën e parë që kishte njohur ndonjëherë.

Të dy u përqafuan të përlotur ndërsa ai i tregonte për vendimin për të ndjekur Krishtin për aq kohë sa do t'i mbetej në tokë. «Tani mund ta shoh që qeveria po persekuton kishën», – tha ai.

«Më parë, s'mund ta shihja. Madje i kam lejuar të më përdorin për të persekutuar vajzën time». Zëri i tij shprehte keqardhjen që ndiente. Mai e përqafoi t'atin dhe i tha se persekutimi i tij kishte qenë pjesë e planit të Zotit, një mënyrë për të testuar dhe për të forcuar besimin e saj.

DUKE RREZIKUAR SHUMË PËR T'U KUJDESUR PËR DELET E SHPËRNDARA

Kur i ati u nda nga jeta, Mai vajtoi për vdekjen e tij, por njëkohësisht ngazëllehej që një ditë do ta shihte përsëri në parajsë. Ndaj iu kthye punës së krishterë me forca të reja. Në vitin 1996, grupi i

misionit me të cilin punonte, organizoi një sesion trajnimi treditor për drejtuesit e krishterë. Ndërsa Mai po lutej gjatë përgatitjes për takimin, Zoti i foli përmes një ëndrre, ashtu siç e kishte thirrur për t'u kthyer në Vietnam.

Në ëndërr, Mai qëndronte në mes të një xhungle të dendur. «Ku jam?» – pyeti ajo.

«Kjo është zonë fisesh. Kam punë për ty këtu». «Kur do të shkoj?» – pyeti ajo. – «Dhe s'mund të vijë dikush me mua për të bërë këtë punë?»

Perëndia iu përgjigj pyetjes së saj me një premtim: «Do të dërgoj një burrë, një luftëtar për të shkuar me ty».

Shumë fytyra iu shfaqën në mendje, një paradë njerëzish që kishin veshje plot ngjyra. Secili përfaqësonte fise të ndryshme te të cilët Mai duhej të shërbente.

Pas ëndrrës dhe trajnimit të veçantë që pasoi, filloi të punonte rregullisht me grupe fisesh të ndryshme. Duke përdorur motoçikletën, i ra Vietnamit kryq e tërthor, duke predikuar dhe çuar mesazhin e shpëtimit. Në shumë zona, policia kishte vendosur pika kontrolli. Një trung i thjeshtë bambuje formonte një portë në rrugë, ku policia ndalonte udhëtarët për t'u kërkuar dokumentet. Nëse diçka nuk ishte në rregull, e arrestonin personin ose të paktën ushtronin presion për të paguar ndonjë ryshfet që të mund të shkonin.

Pa leje udhëtimi dhe duke mbajtur Bibla të paligjshme, Mai anashkalonte postblloqet, duke u larguar tinëz nga rruga dhe kaluar përmes pyjeve të dendura kur ishte e nevojshme të shmangte pikat e kontrollit. Ajo e dinte që qeveria ishte në dijeni të aktiviteteve të saj të krishtera dhe që emri ishte në listën e të kërkuarve. Rreziku ishte i madh: ata që u shmangeshin pikave të kontrollit mund të qëlloheshin sapo të dalloheshin. Ndonjëherë Mai kapej dhe mbahej gjatë natës. Ndonjëherë ia konfiskonin Biblat që kishte dhe herë të tjera Zoti i fshihte në mënyrë të mrekullueshme që të mos i shihnin. Mai gëzohej në heshtje sa herë që ia jepnin çantën me ngarkesën e çmuar të paprekur.

Ungjilltarja e re po shihte një kishë në rritje mes njerëzve në fise dhe ishte e bekuar nga kuraja e tyre përballë persekutimit

intensiv. *Fiset janë si dele të shpërndara*, mendoi ajo. *Askush nuk i mbron përveç vetë Zotit*.

Mai dëgjonte historitë e pjesëtarëve të fiseve rreth persekutimeve dhe përpiqej t'i inkurajonte. Një burrë i moshuar u var në ajër dhe u rrah derisa u këput litari. Ra në tokë në një pellg plot gjak. Policia i detyronte të krishterët të lëviznin nga një rajon i vendit në një tjetër, duke kërkuar t'i izolonte nga vetë njerëzit e tyre. Të krishterët përpiqeshin ta shmangnin policinë dhe ndonjëherë duhej të linin pas gjithçka e të arratiseshin për në xhungël.

Në një fshat, Mai dhe të krishterë të tjerë u ftuan në shtëpinë e një anëtari fisi, i cili vuante nga një infeksion i tmerrshëm dhe kur Mai hyri, u përpoq të mos villte prej erës së keqe. Familja pyeti nëse ishte mjeke apo kishte sjellë ndonjë mjekim. «Nuk jemi mjekë, – u tha Mai, – dhe nuk kemi ndonjë ilaç, por njohim Mjekun më të mirë në botë, Atë që do të mund t'ju shërojë».

Ata u lutën për shërim për të sëmurin. Një muaj më vonë, kur u kthye në fshat, burri ishte pothuajse i shëruar. Pas dy muajsh, ishte plotësisht i shëruar. Ky njeri mezi priste të bisedonte me Main. «Dua të vish me mua», – tha ai. «Do të të çoj te njerëzit e mi, por është larg prej këtej, në xhungël. Nuk do të jetë e lehtë dhe do të duhet kohë. Duhet të udhëtojmë bashkë për tridhjetë ditë».

Mai u lut për ofertën e burrit dhe ndjeu konfirmimin e Perëndisë. Ra dakord të shkonte me të në fshatin e tij të lindjes në një cep të largët në Vietnamin Verior. Fshatarët atje ishin shumë të varfër dhe secili prej tyre kishte vetëm një veshje, që e mbanin gjatë gjithë vitit. Disa punëtorë të krishterë u prekën shumë nga kushtet primitive dhe era e keqe e fshatit. Të tjerët ishin larguar prej kulturës së fisit, gjë që kishte shkaktuar mosbesim të thellë ndaj të huajve. Duke pasur me vete personin që ishte rritur në fshat për të bërë prezantimin, Mai u mirëprit. Shumë shpejt u mboll një kishë, e cila filloi të rritej. Burri falënderonte vazhdimisht Main që kishte sjellë Jezusin në fshatin e tij.

«Kur shohin Krishtin tek ne», – shpjegonte ajo më vonë, – «e pranojnë më lehtë».

Mai ndiente një dashuri të veçantë për njerëzit midis fisit Hmong dhe filloi të planifikonte udhëtime të tjera njëmujore mes

tyre. Udhëtimet ishin rraskapitëse, duke filluar me një të tillë gjatë gjithë natës me tren, i cili pasohej nga një tjetër gjatë ditës në një autobus që kundërmonte nga era mbytëse për të vazhduar të nesërmen me autobus pjesën e parë të ditës dhe në fund gjithë udhëtimi mbyllej në këmbë. Rrugët në male janë të thepisura dhe gjatë stinës së shirave janë shumë të rrezikshme. Një hap i gabuar dhe Mai mund të gjendej duke rënë në lumin që ndodhej shumë poshtë. Herë-herë, detyrohej të kacavirrej maleve me këmbë e duar, duke luftuar sa herë që hidhte një hap.

Policia hoqi dorë së ndaluari takimet e krishtera në këta fshatra të largët; rrugët ishin shumë të rrezikshme. Në një prej fshatrave ku mundën të arrinin, rrahën ashpër pesëdhjetë familje të krishtera dhe më pas i detyruan të lëviznin në një zonë tjetër të vendit.

Ndërsa Mai ndante ungjillin me Hmongët, shikonte gjithnjë e më tepër fuqinë transformuese të Fjalës së Perëndisë. Shumë prej tyre ishin alkoolistë para se të pranonin Krishtin ndërsa të tjerë praktikonin ritualet e çuditshme të magjive, që përfshinte pirjen e gjakut të kafshëve. Pasi pranonin Krishtin, ata ishin gati të hiqnin dorë nga ritualet dhe të përballeshin me persekutimin për besimin e tyre. Ata besonin se Krishti do të kthehej së shpejti dhe donin të ishin gati.

Mai e ndiente etjen e tyre ndaj filloi t'i trajnonte të krishterët Hmong si të drejtonin në shërbesë. Shumë prej tyre udhëtonin në këmbë për dy ditë për të shkuar në vendin e trajnimit. Në disa fshatra nuk kishte Bibla; në disa të tjerë, të krishterët ndiheshin të bekuar që kishin një Bibël, të cilën e ndanin midis dyzetë apo dyzetë e pesë familjeve. Disa familje shisnin gjithçka që zotëronin për të shkuar në Hanoi në kërkim të një kopjeje të vetme Bible. Por as atje s'mund të gjenin Bibla në gjuhën Hmonge. Sa herë që i vizitonte, Mai sillte më tepër Bibla në gjuhën hmonge të botuara nga kontaktet e misionit të saj. Emocionohej sa herë që shihte lot mirënjohës gëzimi në sytë e të krishterëve hmong ndërsa e mbanin Fjalën e Perëndisë në duar për herë të parë.

Udhëtimet e gjata ishin shteruese për fuqinë e Mait. Ajo sëmurej sa herë që udhëtonte, ashtu siç i kishte ndodhur në anije për në Hong Kong. Ndonjëherë pyeste veten ndërsa përpiqej të

luftonte përzierjen, se pse Perëndia e thërriste në një shërbesë, ku udhëtonte dhe nuk e shëronte nga kjo sëmundje e mërzitshme. Përpiqej të ulej afër banjave në tren, sepse e dinte që do të sëmurej. Kalonte orë të tëra duke u përpjekur të mbante çantat me Bibla në ekuilibër në motoçikletë ndërsa udhëtonte në rrugët me baltë. Ecte shumë kilometra duke mbajtur Bibla. I qepte emrat e kontakteve të krishtera në tegelat e veshjeve të saj që policia të mos i gjente nëse e arrestonin.

NJË LLOJ TJETËR LIRIE

Pjesa më e madhe e udhëtimeve kalonte pa probleme, por Mai nuk ishte e panjohur për policinë. Ishte arrestuar dhjetë herë dhe zakonisht kalonte nga disa orë deri në pesëmbëdhjetë ditë nën mbikëqyrjen e policisë. Çdo herë, Biblat që mbante i konfiskoheshin, duke i lënë të krishterët pa Fjalën e Perëndisë. Shpesh mendonte mbi çfarë i kishte thënë i vëllai ndërsa largohej nga kampi në Hong Kong. Megjithëse ai nuk e dinte se sa të vërteta do të kishin qenë fjalët e tij, me sa telashe do të përballej e motra kur të kthehej.

«Je duke predikuar në mënyrë të paligjshme!» – i thoshte policia. «Kushtetuta e Vietnamit premton liri fetare, por vetëm në vendndodhje adhurimi të miratuara nga qeveria dhe në kohën e miratuar prej tyre». Një herë policia i paraqiti një deklaratë pohuese për ta firmosur, ku thuhej se ajo kishte predikuar vërtet në mënyrë të paligjshme.

«Ky raport nuk është i vlefshëm», – shkroi Mai në fund të faqes, pa thënë asnjë fjalë.

Komandanti i policisë bëri përpara duke menduar se e kishte thyer të krishterën dhe kishte firmosur. Kur lexoi tekstin, e grisi në copa të vogla. «Mendon se jemi budallenj?» – i ulëriti ai Mait.

Pas një arresti tjetër, policia u përpoq ta detyronte të firmoste një rrëfim për botim të paligjshëm të Shkrimeve dhe literaturë të «jashtëligjshme».

«Perëndia ma jep këtë të drejtë», – iu përgjigj Mai. – «Në Vietnam kemi liri besimi, kështu që besoj çfarë të dua, çfarëdo lloj feje. Kur eci me Bibël, ky është besimi im. Kur flas me njerëzit – drejtuesit e krishterë në sesionet e trajnimit, – ata janë tashmë

besimtarë, kështu që ky nuk është predikim. Ne thjesht ndajmë besimin së bashku».

«Ka liri» – i thoshte policia, – «Por në Vietnam ne e mbajmë lirinë në kuti. Vendosim ne kush është i lirë dhe kush nuk është».

Policia i kërkoi Mait të shkruante një raport të punës së saj dhe të firmoste një përkushtim që të mos predikonte më. Mai ra dakord ta shkruante raportin dhe filloi të hidhte në letër dëshminë e saj. Shkroi se si ishte rritur duke adhuruar paraardhësit e saj, se si e kishte takuar Perëndinë në kampin e refugjatëve në Hong Kong dhe ishte kthyer në Vietnam, dhe se si Ai i kishte ndryshuar jetën. Shkroi të gjithë dëshminë e saj.

Kur erdhi koha për të shkruar premtimin për të mos predikuar, shkroi një mesazh tjetër: «Bibla është Libër që qeveria e lejon të botohet (në sasi të kufizuara) dhe të shpërndahet. Aty thuhet se duhet të adhurojmë Perëndinë, duhet të lexojmë në shtëpi, duhet të ndajmë ungjillin. Unë bëj çfarë më thotë Bibla».

Policia lexoi «rrëfimin» e saj dhe ishte mrekulli që vendosën ta linin të lirë...

Sa herë që Mai shkonte diku për të shërbyer, fillimisht kalonte shumë orë në lutje si përgatitja më e mirë për udhëtimin. Një mëngjes herët, ndërsa ishte duke u përgatitur për udhëtimin e ardhshëm, ndjeu se do të kishte probleme. U tha bashkëpunëtorëve të saj rreth ndjenjave të saj, por i siguroi që ishte në vullnetin e Perëndisë nëse do të ishte në burg apo jashtë. Një bashkëpunëtor që ishte caktuar të shkonte në udhëtim me të qau kur Mai ia përshkroi ndjenjat. «Ai e lejoi këtë që ti të mund të vije me mua këtë herë dhe të mund të inkurajonim njëri-tjetrin. Mos u shqetëso! Unë jam ajo që organizoi takimin. Ti s'duhet të përgjigjesh për asgjë. Fajin do ta mbaj unë».

Ata u nisën me makinë; dy gra dhe një burrë misionar, dhe shoferi. Ashtu si Zoti ia kishte treguar Mait, grupi pati probleme. Policia i arrestoi; në stacion morën dy burrat në një dhomë dhe dy gratë në një tjetër. Në fund të dhomës së grave ishte një gropë e ndyrë në tokë që shërbente si banjë; mizat mbulonin çdo sipërfaqe të dhomës. Të gjitha Biblat dhe materialet e krishtera u konfiskuan.

Pas fundjavës, Mai u çua në burgun Lan Fourtin. Kur arriti në qeli, gjeti brenda disa gra kineze. Ato ishin larguar nga Kina dhe po përpiqeshin të shkonin në Malajzi kur u arrestuan nga policia vietnameze. Gratë donin të praktikonin anglishten, kështu Mai bisedonte me to me aq pak anglisht sa dinte. Grupi ndante vetëm një enë me oriz në çdo vakt, çdo person merrte nga e njëjta enë. Mai dhe miqtë e saj të krishterë e kalonin pjesën më të madhe të kohës së tyre në qeli, duke u lutur për njëri-tjetrin dhe për gjithë të burgosurit e tjerë të qelisë.

Çdo mëngjes në orën tetë, një rojë e nxirrte Main jashtë qelisë. Për tri orë e merrnin në pyetje. E kishin konsideruar si «të burgosur politike» dhe marrja në pyetje ishte intensive.

«Pse e urren qeverinë?» – e pyeti një oficer.

«Nuk e urrej qeverinë tonë», – iu përgjigj ajo, duke u përpjekur të ruante qetësinë dhe tonin e zërit. «Jam ndjekëse e Jezusit dhe Ai na ka thënë t'i respektojmë udhëheqësit e qeverisë. Unë lutem për ta».

«Ti lutesh për ta?» – tha oficeri me tallje. «Nga vijnë këto Bibla? Je takuar me spiunë të huaj? Trego të vërtetën!»

«I kam marrë këto Bibla në Hanoi dhe në Ho Chi Mihn (Saigon), – iu përgjigj ajo. – «Dhe nuk njoh ndonjë spiun të huaj».

«Ti jo vetëm që i njeh», – tha oficeri, duke ngritur zërin, – «por edhe punon për ta! Ti punon për të huajt kundër vendit tënd!»

«Unë e dua vendin tim», – këmbënguli Mai. – «Ja pse u ktheva, sepse i dua njerëzit këtu».

«Për kë punon? Cilët janë të krishterët e tjerë me të cilët punon, drejtuesit?»

Mai refuzoi t'i përmendte besimtarët e tjerë. «Nëse dëshiron të dish për ta», – iu përgjigj Mai, – «duhet të shkosh t'i pyesësh vetë». Ajo falënderoi Zotin në heshtje që nuk kishin zbuluar emrat e qepur në rrobat e saj.

Marrja në pyetje vazhdonte në të njëjtën mënyrë derisa e kthenin në qeli për një pushim. Pasdite kthehej përsëri në dhomën e hetimit për tri orë të tjera marrje në pyetje. Vazhdoi kështu për dhjetë ditë, policët vinin për ta marrë në pyetje çdo ditë. Disa provonin taktika të ashpra, duke i bërtitur dhe duke përplasur tavolinën. Të

tjerët i flisnin butësisht, duke i thënë se dinin gjithçka për takimet e krishtera, kështu thjesht duhej të tregonte të vërtetën.

Ditën e dhjetë i thanë të merrte gjërat e saj, sepse do të shkonte në një qeli tjetër. Në vend të kësaj e çuan në një dhomë ku duhej të firmoste letrat e lirimit. Iu kujtua hera e fundit që kishte firmosur dokumentet për t'u larguar. Dukej kohë shumë e gjatë që kur ishte larguar nga Hong Kongu. Kur rojat e nxorën në fotografi për të dokumentuar lirimin, Mai ishte duke buzëqeshur. Nuk kishte kryer asnjë krim dhe koha në burg vetëm kishte konfirmuar besnikërinë e Perëndisë ndaj saj dhe shërbesës për të arritur ata në «portat e jashtme».

Jam e lirë, mendoi ajo me vete ndërsa u largua nga burgu, *vërtet e lirë.* Mendoi për babanë e saj dhe fjalimet e tij të shumta për të shkuar në Perëndim dhe për të marrë lirinë. *Por gjeta një tjetër lloj lirie. Jo lirinë që babai im mendonte se do të gjeja, por një liri akoma më të madhe!*

EPILOGU

Pavarësisht shërbesës së suksesshme, Mai kishte shumë dëshirë për shoqëri. Ajo i kujtoi Perëndisë që i kishte premtuar një luftëtar, që do të ecte përkrah saj në betejat e jetës. Besimtarë të tjerë luteshin me të që Perëndia do t'ia zbulonte këtë «luftëtar» dhe Ai e bëri.

Nam ishte një bashkëpunëtor i krishterë dhe një ish- polic komunist. Perëndia ia kishte prekur zemrën me dashurinë për Main, por nuk ia kishte thënë për shumë muaj. Ai thjesht lutej që Perëndia do t'ia zbulonte ndjenjat e tij Mait kur të ishte koha e duhur. Dhe shumë shpejt Perëndia e bëri të dukshme për Main dhe për drejtuesit në kishë që ata të dy ishin për njëri-tjetrin. U martuan dhe vazhduan shërbesën e tyre, duke udhëtuar së bashku në zonat rurale për të predikuar dhe për të trajnuar drejtuesit e krishterë.

I ati i Namit ishte anëtar i rangut të lartë të qeverisë komuniste dhe sigurisht që nuk ishte i lumtur me zgjedhjen e bashkëshortes të djalit. Në fillim refuzonte t'i fliste Mait apo madje të ishte në të njëjtën dhomë me të. Kur Mai dhe bashkëshorti i saj ftonin të

krishterë për t'u takuar në shtëpinë e tyre, vjehrri i saj qëndronte para shtëpisë dhe përzinte miqtë që vinin. Namit dhe Mait iu desh të ndërtonin një mur rreth shtëpisë së tyre që i ati të mos shihte se kur takoheshin me besimtarë të tjerë.

Mai dështoi fëmijën e tyre të parë gjatë njërit prej udhëtimeve të shërbesës në xhungël. Mjekët thanë se ajo nuk do të mund të lindte më fëmijë pas kësaj, por të sapomartuarit këmbëngulës iu lutën Perëndisë t'u jepte një familje. Mai mbeti përsëri shtatzënë, por shtatzënia ishte shumë e vështirë. Mjekët e këshilluan ta abortonte fëmijën, por Mai refuzoi. Kur erdhi koha për të lindur, kishte dhimbje, por nuk kishte asnjë përparim. Mjekët i thanë Namit të zgjidhte nëse donte që të mbijetonte gruaja apo fëmija; ata nuk mendonin se do të mund të jetonin të dy. Çifti u lut, duke i kërkuar Perëndisë të kursente jetën e fëmijës së tyre.

Perëndia i shpëtoi të dyja. Mai lindi një vajzë të shëndetshme dhe shumë shpejt u shërua edhe vetë.

Me lindjen e fëmijës, shërbesa e Mait ka ndryshuar fokus ndërsa ajo nuk është më në gjendje të udhëtojë në vendet e largëta të Vietnamit. Mai po punon me kishat lokale afër shtëpisë dhe me trajnimin e drejtuesve të krishterë, që vijnë në qytet për dishepullizim. Nami vazhdon punën rurale, duke udhëtuar në fshatrat e xhunglës të paktën një herë në muaj.

Perëndia i ka vënë në zemër Mait dëshirën për të arritur jetimët dhe fëmijët e pastrehë. Ajo po vendos themelet për këtë punë dhe imagjinon ditën kur vajza e saj do të punojë përkrah saj për t'u treguar fëmijëve «jashtë portës» për Perëndinë që e do botën, që largon të ligun, dhe është Perëndia i vetëm.., që mund të na çlirojë.

Shënime

ADELA:
MES TMERRIT… SHPRESË

1. Filipianëve 4:13.
2. *Xhihadi* është fjala arabisht për «luftën e shenjtë».
3. «Perëndia është i mrekullueshëm! Perëndia është i mrekullueshëm!»

PURNIMA:
FËMIJË E BURGOSUR, SHPIRT I ÇLIRUAR

1. Mateu 10:28.
2. Shiko Mateu 5:10.

AIDA:
ZËRI I TË HESHTURVE

1. Këto revista të krishtera ilegale botoheshin nga kishat e fshehta baptiste në Bashkimin Sovjetik. Komunistët lejonin të botoheshin vetëm revistat e krishtera «të miratuara», që përmbanin artikuj dashamirës ndaj qeverisë sovjetike. Të krishterët e fshehtë duke dashur të tregonin historinë e vërtetë të kishës rrezikonin burgimin për botimin dhe ndarjen e tyre.
2. Shiko Filipianëve 3:10.
3. Për informacion të mëtejshëm për Aidën dhe gjyqin e saj, lexo Michael Bourdeaux, «*The Evidence That Convicted Aida Skripnikova* (Faktet që dënuan Aida Skripnikovën) Angli: Qendra për Studimin e Fesë dhe Komunizmit, 1972; botimi amerikan: Elgin: Ill.: David C. Cook Publishing Company, 1973.

SABINA:
NJË DËSHMITARE E DASHURISË SË KRISHTIT

1. «Pastori! Pastori!»
2. Zanafilla 19:17.
3. Mateu 16:25.

LING:
NË SHKOLLËN E VUAJTJES

1. Luka 10:2-3.
2. Shiko Mateu 25:1-13.

GLEDIS:
NJË JETË NË FALJE

1. Psalmi 37:4.
2. Shiko Luka 23:34 dhe Romakëve 8:28.
3. Shiko Hebrenjve 13:5.
4. Romakëve 12:14-18.
5. Romakëve 8:28.

PËRMBAJTJA

Hyrje 4

Mirënjohje 6

Hyrje: Zemra të Zjarrta me Kurajë dhe Bindje 8

Adela/Mel: Mes Tmerrit, Shpresë 10

Purnima: Fëmijë i Burgosur, Shpirt i Çliruar 45

Aida: Zëri i të heshturve 72

Sabina: Një Dëshmitare e Dashurisë së Krishtit 98

Tara: Jetë në arratisje 141

Ling: Në Shkollën e Vuajtjes 171

Gledis: Një jetë në falje 205

Mai: Përsëri në Vietnam për të predikuar ungjillin 228

Shënime 258

«Martohu, përndryshe do të vdesësh!...»
«Nëse je e krishterë, atëherë
nuk ka vend për ty në këtë qytet...»
«Do të vdesësh këtu e vetme.»

Fjalët e fundit të babait të Tarës i sollën në mendje vetëm një gjë vajzës gjashtëmbëdhjetë vjeçare: të largohej për të shpëtuar jetën. E rrahur gati për vdekje, Tara, vajza e një myslimani të përkushtuar pakistanez, u mbajt e mbyllur në dhomë si e burgosur pa ushqim apo kujdes mjekësor.

E gjithë kjo, sepse e kishin kapur me një Bibël.

Historia e Tarës nuk është e vetmja midis këtyre tetë grave të guximshme në «Zemra të Zjarrta». Që nga vajza e vogël vietnameze, që refuzon lirinë për të ungjillëzuar njerëzit e vendlindjes së saj komuniste, deri te misionarja australiane që shpërndan mesazhin e faljes dhe shërimit në mbarë Indinë pasi i shoqi dhe djemtë iu dogjën të gjallë nga disa banorë të fshatit, këto gra kanë kaluar fatkeqësi ekstreme duke u bërë drejtuese në kishën e fshehtë në mbarë botën.

Zëri i Martirëve sjell histori të vërteta të grave të guximshme, heroina të besimit, të cilat janë përfaqësuese të një numri të pafund grash, që përballen me situata të ngjashme në mbarë botën. Këto modele të besimit dhe pasionit do të të frymëzojnë për të ndjekur Krishtin me zemër të zjarrtë, pa marrë parasysh çmimin.

Gratë kanë qenë vazhdimisht të rëndësishme në kauzën e Krishtit. «Zemra të Zjarrta» përshkruan në mënyrë rrënqethëse punën e tetë grave, misioni i të cilave vazhdon t'i tregojë botës që Ai është ngritur dhe me ringjalljen vjen dashuria, hiri dhe falja. Mos e humb!»

Meri Graham Presidente e «Gra të Besimit»

The Voice of the Martyrs

OM EAST